

**DORACAK PËR KRYETARËT E
KOMUNAVE DHE PËR
ANËTARËT E KËSHILLAVE TË
KOMUNAVE NË REPUBLIKËN E
MAQEDONISË**

Botues:



BNJVL

Bashkësia e njësive të vetëqeverisjes lokale të
Republikës së Maqedonisë - BNJVL,
www.zels.org.mk
tel. ++ 389 2 3099033

- Për botuesin: : **GORAN ANGELOV**
 Kryetar i BNJVL-së,
- Titulli: : **Doracak për kryetarët e komunave dhe për anëtarët e këshillave të komunave në Republikën e Maqedonisë**
- Këshilli redaktues: : Mr. **MARJAN NIKOLOV**,
 Redaktor: : VNG International
- Projekt menaxher: : **JADRANKA KUNGULOVSKA**,
 VNG International
- : **GORAN ANGELOV**,
 Kryetar i BNJVL-së
- : **IMER SELMANI**,
 Nënkyetar i BNJVL-së
- : **DUSHICA PERISHIÇ**,
 Drejtor egzekutiv i BNJVL
- : **BARBARA NOST**,
 Seksioni për reformë në administratën publike - OSBE
- : **KRISTINA JOVANOVSKA**,
 Seksioni për reformë në administratën publike - OSBE
- : **CLAIR SNEED**,
 Seksioni për reformë në administratën publike - OSBE
- : **JANA VOLDANOVA**,
 Ekspert i jashtëm, VNG International
- : **HENK GOLOUZI**,
 Ekspert i jashtëm, VNG International
- Ekspert lokal dhe recenzent i Doracakut: : Prof. Dr. **GORDANA SILJANOVSKA**
- Ilustrator : **JORDAN GORÇEV**
- Përkthyes: : Në gjuhën angleze: **Naser Maksut (OSBE)** dhe **Vlatko Naumovski**
 Në gjuhën shqipe: **Rexhep Prekopuca, Lirim Dalipi** dhe **Albinot Shaqiri**
- Përpunimi kompjuterik: : **Miroslav Millanoviq**
- Tirazhi: : 2600 në gjuhën maqedone, 1300 në gjuhën shqipe dhe 400 kopje në gjuhën angleze
- Botoi: : Alfa 94

CIP Katalogjizimi në publikim:
 Народна и универзитетска библиотека
 „Св. Климент Охридски, Скопје

352 (497.7) (035)

DORACAK për kryetarët e komunave dhe për anëtarët e këshillave të komunave në Republikën e Maqedonisë / [avtor i Kire Kitevski ... [i dr.]; ilustrator Jordan Gorçev; përkthyes në gjuhën angleze Naser Maksut dhe Vlatko Naumovski; në gjuhën shqipe Rexhep Prekopuca]. - Skopje: Bashkësia e njësive të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Maqedonisë - BNJVL, 2005. - 176 str.: ilustr.; 30 cm

ISBN 9989-2369-5-X

1. Kire, Kitevski
 a) Локална самоуправа – Македонија – Прирачници

COBISS.MK - ID 60613130

Shprehim faleminderim të posaçëm ndaj OSBE-së, si donator i mjeteve për realizimin e Doracakut, për ndihmën e ekspertëve të tyre, si dhe për ndihmën e përgjithshme teknike, veçanërisht ndaj: Shaun Barcavage, Naser Maksutit, Kristina Jovanovskës, Lirim Dalipit, Albinot Shaqirit, Zage Filiposkit, Kristina Jovanovës dhe Vilijam Henlit.

Falemnderim të veçantë deri tek Jadranka Ivanova nga Ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor për kontributin e saj si ekspert.

Faleminderojmë tërë skuadrën e VNG-së, si realizues i Projektit për botimin e Doracakut, për ndihmën dhe përkrahjen e tyre.



Të respektuar,

Disa muajt e fundit të jetës i kaluat në kampanjë zgjedhore për zgjedhjet lokale, që ju sollën triumf zgjedhor me çka u bëtë përfaqësues i bashkëqytetarëve të juaj në këshillin e komunës ose kryetar i komunës.

Para jush janë katër vite, në të cilët do të duhet të realizoni pjesën më të madhe të programeve, që ju keni premtuar votuesve. Poashtu, para jush qëndron edhe një përcaktim i përbashkët për të gjithë juve, si dhe për qytetarët tonë. DECENTRALIZIMI, si proces, ju duhet ta implementoni për të mundur qytetarët tanë t'i ndejnë përfitimet e shoqërisë së decentralizuar, drejt së cilës është drejtuar vendi ynë dhe, pa të cilën me vështirësi do të na hapen dyert e Unionit evropian.

Libri, të cilin e mbani në duart e juaja, do t'ju ndihmojë më lehtë të ballafaqoheni me obligimet e juaja, si kryetar i komunës ose si anëtar i këshillit të komunës. Puna e juaj është bashkim i teorisë dhe praktikës, ndërsa autorët e saj janë ekspert të lëmisë së vetëqeverisjes lokale ose kryetarë të komunave, të cilët ju bartin përvojën e tyre të pasur nga puna e tyre disavjeçare.

Ju bind se ky libër, në shumë raste, do të jetë me levërdi të madhe dhe në shumë situata të paqarta do t'ju tregojë rrugën e vërtetë, në të cilën duhet të lëvizni. Jam i sigurt se administrata e Bashkësisë së njësive të vetëqeverisjes lokale është në disponim për të gjitha nevojat e juaja, të cilat janë të lidhura me këtë libër dhe, kuptohet, për të gjitha nevojat tjera të lidhura me vetëqeverisjen lokale.

Me respekt,

Bashkësia e njësive të vetëqeverisjes lokale

Kryetar
Goran Angellov



Lexues të nderuar,

Është privilegj i OSBE-së të bashkëpunojë me organizatat e vendit dhe ato ndërkombëtare për të pregaditur këtë Doracak për Zyrarët e Zgjedhur Lokal, që është i pari i këtij lloji në shtet. Shpresojmë se ky Doracak do të shërbejë si një libër referimi për Kryetarët e komunave dhe këshilltarët pas marrjes së përgjegjësisë të rëndësishme për të udhëhequr në sistemin e decentralizuar.

Ky doracak është i pregaditur me qëllim që të jetë një dokument i rrjedhshëm dhe i përshtatshëm i cili do të ketë nevojë për plotësim dhe ripunim në muajt dhe vitet që do të pasojnë. Si i tillë, shpresojmë se përmbajtjet e kapitujve të këtij doracaku do të korrigjohen në përputhje me amandamentet dhe ndryshimet e legjislacionit të lidhura ngushtë me këto kompetenca.

Në ndërkohë, inkurajojmë shfrytëzuesit të zgjërojnë njohuritë e tyre, e gjithashtu të kërkojnë informata të reja rreth këtyre temave nga Shoqata e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale, Ministria për vetëqeverisje lokale dhe institucioneve tjera simotra.

Gjithashtu inkurajojmë shfrytëzuesit të parashtrajnë rekomandimet e tyre me qëllim të përmirësimit të përmbajtjes të këtij doracaku në mënyrë që të bëhet më i përshtatshëm për lexuesin në të ardhmen.

Me dëshirë për një proces të suksesëshëm të decentralizimit,
Me nderime,

Ambasadori **Carlos Pais**
Udhëheqës i Misionit të OSBE-së







1 KORNIZA LIGJORE E VETËQEVERISJES LOKALE

Kire Kitevski

Ky është një rast i mirë të fitoni informatat për rregullativën juridike, e cila do t'ju ndihmojë gjatë mandatit në kryerjen e funksionit.

Ky është një rast i mirë të fitoni informatat për rregullativën juridike, e cila do t'ju ndihmojë gjatë mandatit në kryerjen e funksionit. Sa më shpejtë dhe më mirë jeni të njohuar me rregullativën juridike, aq më shpejtë do të filloni me kryerjen e funksioneve tuaja, për çka edhe jeni zgjedhur. Nga niveli i njohjes suaj të ligjeve, që kanë të bëjnë me vetëqeverisjen lokale, do të varet sa do të jeni aktiv në kryerjen e detyrave, që ju presin gjatë mandatit. Për këtë, së pari, duhet të njohetoheni me faktin se njësitë të vetëqeverisjes lokale në shtetin tonë, ju është dhënë vend i posaçëm në Kushtetutën dhe ligjet. Kjo, për ju, do të thotë obligim i shtuar për kryerjen me sukses të obligimeve, që qëndrojnë para jush. Me këtë do të arsyetoni besimin e dhënë nga qytetarët.

1.1. KORNIZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE

Qytetarët ju kanë dhënë besimin, duke shfrytëzuar të drejtën e tyre për vetëqeverisje lokale, që ju është dhënë me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë. Kjo e drejtë nuk është vetëm deklarative por vetëqeverisja lokale është njëra ndër vlerat themelore të rendit kushtetues të shtetit tonë. Ajo (vetëqeverisja lokale), në Kushtetutë është përpunuar në një kapitull. Të përkujtohemi se në atë kapitull, janë paraqitur të drejtat e qytetarëve për pjesëmarrje gjatë vendosjes për çështje me rëndësi lokale në lëmitë e urbanizmit, mbrojtjes së ambientit jetësor, zhvillimit ekonomik lokal, veprimtarive komunale, kulturës, sportit dhe rekreimit, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve, arsimit, mbrojtjes shëndetësore, mbrojtjes kundër zjarrit. Poashtu, në Kushtetutë është paraqitur edhe mundësia e bartjes së kompetencave nga organet shtetërore në nivel lokal. Në shtetin tonë, Kushtetuta parasheh vetëqeverisje lokale të një niveli. Kjo do të thotë se njësitë e vetëqeverisjes lokale janë komunat. Qytetiit të Shkupit, si kryeqyteti i shtetit, iu është dhënë trajtim i posaçëm me faktin, që ai parashihet si njësi e posaçme e vetëqeverisjes lokale. Për të kryer kompetencat e tyre, komunat duhet të kenë mjete financiare. Me Kushtetutë, është garantuar e drejta e komunave për financim nga burimet personale të të ardhurave, si dhe nga mjetet e Republikës. D.m.th, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë jep bazë për rregullim të mëtutjeshëm të vetëqeverisjes lokale me ligje.

Për të organizuar komunat në njësi të vetëqeverisjes lokale, në të cilat qytetarët do të realizojnë të drejtën e tyre të vendosin për çështje me rëndësi lokale, kjo materie duhet të rregullohet me ligj. Ligji për vetëqeveri-



sje lokale është ligj sistemor dhe aprovet me dy të tretat e votave, si dhe me shumicën e votave të deputetëve - përfaqësues të bashkësive, që nuk janë shumicë në shtetin. Ky ligj rregullon çështjen e kompetencave të komunës (listë të kompetencave), pjesëmarrjen e drejtëpërdrejtë të qytetarëve gjatë vendosjes (iniciativë qytetare, tubim i qytetarëve, referendum), organizimin dhe punën e organeve të komunës (këshilli dhe kryetari i komunës), administratën komunale (organizimin e saj dhe punët, që duhet t'i kryej), aktet, që i sjellin këshilli dhe kryetari i komunës, pronën e komunës, mbikëqyrjen mbi punën e organeve të komunës (mbikëqyrje mbi ligjshmërinë dhe kontrollim dhe revizion të punës materialo - financiare), shpërndarjen e këshillit të komunës, mekanizmat e bashkëpunimit në mes organeve të komunës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, bashkësinë lokale (kompetencat, themelimi, organizimi), mbrojtjen e vetëqeverisjes lokale, përcaktimin e gjuhëve zyrtare në komunë, si dhe çështje të tjera, me rëndësi për vetëqeverisjen lokale.

Këtu duhet të përmendet edhe banimi, e drejta për stemë dhe flamur, tribunat dhe anketat publike, këshilli për mbrojtjen e konsumatorëve, komisioni për marrëdhënie në mes bashkësive etj.

Meqë Ligji për vetëqeverisje lokale është ligj i përgjithshëm, është e nevojshme disa çështje të përpunohen me ligje të posaçme, për çka do të bëhet fjalë më poshtë, në suazat e kësaj teme.

Siç përmendëm më lartë, me Ligjin për vetëqeverisje lokale është e rregulluar edhe çështja e së drejtës së banimit. Në këtë ligj është thënë se qytetarët e Republikës së Maqedonisë, të cilët kanë vendbanim të përherëshëm në territorin e komunës, janë banorë të komunës. Çështja e së drejtës së banimit është e rëndësishme për realizimin e të drejtave të caktuara të qytetarëve, me rëndësi lokale. Vetëm qytetarë të komunës mund të zgjidhen për kryerje të funksioneve në pushtetin lokal. Më tutje, nëpërmjet të së drejtës për banim, qytetarët kanë të drejtë nëpërmjet formave të vendosjes së drejtëpërdrejtë të japin propozime dhe iniciativa për zgjidhjen e çështjeve të caktuara me karakter lokal. E drejta e banimit është e rëndësishme për faktin se vetëm banorët e komunës mund të plotësojnë disa obligime ndaj komunës.

Çdo komunë mund të ketë stemë dhe flamur. Stema dhe flamuri përcaktohen me procedurë, e cila është përcaktuar në statutin e komunës. Ato do të përdoren, pas regjistrimit të tyre në regjistrin e Ministrisë për vetëqeverisje lokale.

Shembull: pjesa e tatimit personal, që është e ardhur e komunës, do të paguhet në komunën, në të cilën i ngarkuari është banor.

Në fillimin e tekstit thamë se Qyteti i Shkupit është njësi e posaçme e vetëqeverisjes lokale. Organizimi i tij, kompetencat, mënyra e financimit, përdorimi i gjuhëve të bashkësive, si dhe bashkëpunimi në mes Qytetit të Shkupit dhe komunave të tij, është rregulluar me Ligjin për Qytetin e Shkupit, që është ligj i posaçëm.

Për të pasur njohuri të tërësishme për komunat, si njësi të vetëqeverisjes lokale, është e nevojshme të dihet si themelohen, në cilën sipërfaqe, cili është emri, ku do ta ketë selinë, cilët janë kufijtë dhe si përcaktohen, çfarë lloji të vendbanimeve egzistojnë dhe çfarë emri kanë, mundësinë për bashkangjittje, ndarje dhe ndryshim të kufijve dhe çështje të tjera, që kanë të bëjnë me organizimin territorial të Republikës së Maqedonisë. Përgjigjet e këtyre pyetjeve do t'i gjeni në Ligjin për organizim territorial të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Maqedonisë, me të cilin janë të rregullar këto çështje.

Të fillojmë me themelimin e komunave. Komuna themelohet me ligj. Kjo do të thotë se në asnjë mënyrë tjetër dhe me asnjë akt tjetër juridik, nuk mund të themelohet komunë. Komuna themelohet në sipërfaqe të një ose më tepër vendbanimeve, me komunat e tyre kadastrale. Komunat kadastrale janë të përcaktuara në pajtim me dispozitat, që kanë të bëjnë me matjen dhe kadastrën. Territori (sipërfaqja), në të cilën themelohet komuna, duhet të paraqet tërësi natyrore, gjeografike dhe ekonomike, të lidhur. Në këtë sipërfaqe, duhet të egzistojë komunikacion ndërmjet vendbanimeve. Kjo do të thotë se ndërmjet vendbanimeve duhet të egzistojnë rrugë të ndërtuara, kurse vendbanimet të gravitojnë drejt një qendre të përbashkët. Poashtu, në sipërfaqen e komunës, është e nevojshme të egzistojnë objekte të infrastrukturës (instalime të ujësjellësit, kanalizimit, elektrikimit dhe instalime të tjera), si dhe të egzistojnë objekte të standardit shoqëror (shkolla, ambulanca, objekte kulturore dhe sportive etj).

Sipërfaqen e Qytetit të Shkupit e përbëjnë sipërfaqet e komunave në Qytetin e Shkupit.

Duhet të dijmë, cilët janë kufijtë e komunave, që të mos ndodhë dy e më tepër komuna të kanë kompetenca të njëjta për punë të caktuara, me rëndësi lokale. Poashtu, kufijtë e komunave janë të rëndësishëm edhe për përcaktimin e së drejtës së banimit të qytetarëve, sepse vetëm ata qytetarë, që janë banorë të komunës, kanë, në mes tjerash, të drejtë për të zgjedhur dhe për të qenë të zgjedhur. Kufijtë e komunave, janë kufinj të



komunave kadastrale të vendbanimeve, që janë në përbërje të komunave në pjesën, që kufizohen me komunën fqinje. Dy vendbanime i takojnë dy komunave të ndryshme, që kufizohen në mes tyre. Kufiri në mes këtyre dy komunave do të jetë i njëjtë me kufirin e komunave kadastrale të vendbanimeve. Këtu vlen të përmendet se kufijtë e komunave kadastrale, nuk guxojnë të prehen. Poashtu, nëse ndonjë sipërfaqe e komunës gjendet afër kufirit të Republikës së Maqedonisë me ndonjë shtet tjetër fqinj, kufiri i asaj komune do të jetë i ngjajshëm me kufirin shtetëror.

Komunat themelohen për një ose më tepër vendbanime. Duhet të jemi në dijeni për llojet e vendbanimeve. Vendbanimet mundën me qenë qytete dhe fshatra.

Qytet, në kuptim të Ligjit për organizim territorial të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë, është vendbanimi, i cili ka më tepër se 3000 banorë, ka strukturë të zhvilluar të veprimtarive, ndërsa mbi 51% nga të punësuarit janë jashtë veprimtarive primare. Kjo do të thotë se vendbanimi duhet të ketë më tepër lloje të veprimtarive (industri, tregëti, hotelieri dhe të ngjajshme), dhe mbi 51% të jenë të punësuar në veprimtaritë e përmendura pak më lartë.

Për të qenë qytet, vendbanimi duhet të ketë të ndërtuar fizionomi urbane me zona për banim, për ekonomi, rekreim dhe gjelbërim publik. Të ketë të ndërtuar shesh, sistem të rrugëve, shërbime komunale dhe të paraqet qendër funksionale të vendbanimeve përreth tij. Kjo do të thotë se vendbanimi duhet të sjell plane urbane, me të cilët përcakton fizionominë e tij urbane, i përcakton zonat për banim dhe ekonomi, sipërfaqet e dedikuara për gjelbërim dhe rekreim. Rrugët dhe sheshi duhet me qenë në pajtim me planet urbane, ndërsa për kryerjen e **shërbimeve publike** komunale (ujë për pije, bartjen e ujërave të përdorura dhe ujërave atmosferike, mirëmbajtjen e higjienës në sipërfaqet publike të trafikut, marrjen e hedhurinave dhe të ngjajshme), të egzistojë ndërmarrje publike komunale. Dhe në fund, gjithsesi, duhet që vendbanimi të paraqesë vend, në të cilin qytetarët nga vendbanimet e tjera, do të realizojnë të drejtat e tyre.

Fshat, në kuptim të ligjit të njëjtë, është vendbanim me rëndësi një funksionale, në të cilin mbisundon një veprimtari, ndërsa sipërfaqja e vendbanimit ka fizionomi dhe funksion agrarë.

Vendbanimet kanë kufijtë e tyre, që janë të ndryshëm nga kufijtë e komunave kadastrale ku bëjnë pjesë. Kështu, kufijtë e qytetit, si vendbanim, përcaktohen me sjelljen e planit urban gjeneral, ndërsa kufijtë e fshatit, si vendbanim, përcaktohen me sjelljen e planit urban për vende të banuara.

Përcaktimi i kufijve të vendbanimeve është punë tejet e rëndësishme, sepse me këtë përcaktohet hapësirë e caktuar, në të cilën mund të kryhen punë të caktuara. Me aprovimin e planeve urbane, me të cilët parçaktohen kufijtë, trualli që gjendet në suazat e kufijve është truall ndërtimor dhe, si i tillë, ka regjim të posaçëm të shfrytëzimit. Në suazat e planeve të përcaktuara, mund të bëhet ndërtim i objekteve, gjithsesi, me leje për ndërtim. Më tutje, komuna është kompetente për rregullimin e truallit ndërtimor. Kryerja e veprimtarive publike komunale, bëhet në suazat e kufijve të përcaktuara me planet.

Çdo vendbanim ka emrin e tij. Emrat e vendbanimeve përcaktohen me ligj. Sipas rregullës, në territorin e komunës, dy ose më tepër vendbanime nuk mund të kenë emër të njëjtë.

Komunat dhe Qyteti i Shkupit, kryerjen e kompetencave e financojnë nga burimet personale të të ardhurave dhe nga burime tjera të financimit. Komunat janë të pavarura në përdorimin e mjeteve financiare. Pavarësia përbëhet në përcaktimin e lartësisë së nivelit të tatimeve lokale, taksave dhe kompenzimeve, nga ana e juaj. Poashtu, mjetet e mbledhura do t'i planifikoni dhe harxhoni për realizimin e programeve. Burime personale të të ardhurave janë tatimet lokale, taksat dhe kompenzimet komunale, taksat lokale, dotacionet dhe burime të tjera për financim, të përcaktuara me Ligjin për financimin e njësisve të vetëqeverisjes lokale. Me këtë ligj, poashtu, rregullohen çështjet e buxhetit, kontabilitetit, hua - marrjes dhe çështje tjera, që kanë të bëjnë me financimin e komunave.

E drejta për vetëqeverisje lokale, nënkupton të drejtën e qytetarëve të vendosin për çështje me interes publik, me rëndësi lokale. Marrja e vendimeve mund të bëhet nëpërmjet formave të vendosjes direkte nga ana e qytetarëve: iniciativë qytetare, tubim i qytetarëve, referendum ose në mënyrë indirekte, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur nga ana e qytetarëve. Këtu do t'ju përkujtojmë procesin zgjedhor për zgjedhje të anëtarëve të këshillit të komunës dhe procesin zgjedhor për zgjedhjen e kryetarit të komunës. Zgjedhja e anëtarëve të këshillit të komunës dhe kryetarit të komunës është e rregulluar me Ligjin për zgjedhje lokale. Sipas këtij ligji, anëtarët e këshillit të komunës dhe këshillit të Qytetit të Shkupit, si dhe kryetarët e komunës, zgjedhen nga



ana e qytetarëve të komunës në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë. Për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit të komunës, në Ligjin është pranuar modeli proporcional, ndërsa për zgjedhjen e kryetarit të komunës-modeli i shumicës. Këto dy modele janë të ndryshme, si në pjesën e votimit (modeli proporcional mbaron me një rreth të votimeve, ndërsa te modeli i shumicës janë të mundur dy rrethe të votimit), ashtu edhe në pjesën e vërtetimit të rezultateve.

Kush ka të drejtë për të zgjedhur dhe kush mundet me qenë i zgjedhur? Të drejtë për zgjedhje ka secili qytetar i Republikës së Maqedonisë, që ka mbushur 18 vjet jetesë, ka aftësi të veprimit dhe ka vendbanim të përhershëm në suazat e komunës, gjegjësisht të Qytetit të Shkupit. Të drejtë për t'u zgjedhur ka çdo shtetas i Republikës së Maqedonisë, që ka mbushur 18 vjet jetesë dhe ka aftësi të veprimit, është banorë i komunës dhe nuk është në mbajtje të dënimit me burg për vepër të kryer penale. Këtu, në mes të drejtës aktive dhe pasive zgjedhore, ka vetëm një dallim. Të drejtë për të zgjedhur kanë edhe personat, të cilët gjenden në mbajtje të dënimit me burg për vepër penale të kryer. Mirëpo, këta persona nuk mund të zgjedhen. Kjo dispozitë është krejtësisht logjike, Nëse këta persona kanë të drejtën e zgjedhjes së tyre, atëherë parashtrohet pyetja: si do të kryejnë funksionin, meqë nuk janë prezent në komunë? Poashtu, personave të zgjedhur në funksionet e pushtetit lokal, mund t'ju ndërpritet mandati edhe para skadimit të tij, nëse janë në mbajtje të dënimit me burg për vepër penale të kryer.

Propozimi i kandidatëve për anëtarë të këshillit të komunës, bëhet me paraqitjen e listës së kandidatëve, ndërsa paraqitja e kandidaturës për kryetar të komunës, bëhet me paraqitjen e listës për kandidat. Në listën e propozuar të kandidatëve për anëtarë të këshillit të komunave dhe të Qytetit të Shkupit, secila gjini do të jetë e përfaqësuar me, më së paku, 30% edhe në pjesën e lartë edhe në pjesën e poshtme të listës. Gjegjësisht, 30% të gjinisë duhet të shpërndahen në listën, ashtuqë të ketë edhe në pjesën e lartë edhe në pjesën e poshtme të listës, e jo të ketë 30% të gjinive edhe në pjesën e lartë edhe në pjesën e poshtme të listës. Propozuesit e listës në njësinë e vetëqeverisjes lokale, në të cilën më së paku 20% të qytetarëve flasin gjuhë zyrtare, të ndryshme nga gjuha maqedone, paraqitjen e listës e bëjnë në gjuhën dhe shkrimin, që e flasin në këtë njësi të vetëqeverisjes lokale.

1.2. KONVENTA EVROPIANE PËR VETËQEVERISJE LOKALE

1.2.1. Parime themelore të Konventës evropiane për vetëqeverisje lokale

Konventa evropiane për vetëqeverisje lokale është sjellur nga ana e Këshillit të Evropës në vitin 1985. Sipas Konventës për vetëqeverisje lokale, vetëqeverisja lokale është formë e udhëheqjes në njësitë e vetëqeverisjes lokale, në të cilat qytetarët, drejtpërdrejtë ose në mënyrë indirekte nëpërmjet përfaqësuesve, të zgjedhur nga ana e tyre, vendosin për interesat dhe punët me rëndësi lokale.

Për të fituar në rëndësi vetëqeverisja lokale, Konventa evropiane parasheh, ajo, të rregullohet me ligj. Ndërsa në ato vende, ku është e mundur, edhe me Kushtetutë. Sipas Konventës, e drejta e vetëqeverisjes lokale nënkuptohet si e drejtë dhe aftësi e pushteteve lokale, në pajtim me ligj, të rregullojnë dhe udhëheqin me punët publike në bazë të përgjegjësisë personale dhe në interes të popullatës lokale. Çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë se organeve të zgjedhura nga ana e qytetarëve, ju është dhënë e drejta e sjelljes së dispozitave, me të cilat do të rregullohet mënyra e kryerjes së punëve publike. Më tutje, kjo do të thotë se ato janë përgjegjës për kryerjen e punëve. Më në fund, kjo do të thotë se puna e pushteteve lokale, duhet të jetë në interes të popullatës lokale, gjegjësisht në interes të popullatës, që jeton në komunë. Mirëpo, sipas Konventës, pushtetet lokale, gjegjësisht organet e komunës, nuk janë forma e vetme e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e marrjes së vendimeve. Ata mund të marrin pjesë në procesin e vendosjes për punë me rëndësi lokale edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, nëpërmjet formave të ndryshme, siç janë: tubimi i qytetarëve, iniciativat qytetare, referendumi dhe forma të tjera. Nëpërmjet të kësaj të drejteje, paraqitet mundësi qytetarët, drejtpërdrejtë, të marrin pjesë në marrjen e vendimeve për punët me interes për përditshmërinë e tyre dhe me rëndësi lokale.

Në lidhje me çështjen e përcaktimit të kompetencave të vetëqeverisjes lokale, Konventa evropiane për vetëqeverisje lokale, niset nga disa parime:



1. Sipas Konventës, të drejtat dhe obligimet themelore të pushtetit lokal përcaktohen me kushtetutë dhe me ligj. Kjo nënkupton, që vendi-nënshkrues i Konventës në kushtetutën dhe ligjet e saj, duhet të parashikojë të drejtat dhe obligimet e njësisë të vetëqeverisjes lokale. Ose, më konkretisht në kushtetutë, gjegjësisht në ligj të thuhet: cilat janë organet nëpërmjet të cilëve egzekutohet pushteti lokal dhe cilat janë të drejtat dhe obligimet e tyre.

2. Më tutje, sipas konventës, pushteteve lokale, gjegjësisht organeve të komunës, duhet t'ju pranohet e drejta e diskrecionit të kryejnë punët, që nuk ju janë nën **kompetencë** të tyre dhe, as që janë nën kompetencat e ndonjë forme tjetër të pushtetit, në pajtim me ligj. Ky parim për përcaktimin e kompetencave të pushtetit lokal, ka për qëllim vendosjen e pushteteve lokale në pozitë të kryejnë punë me interes lokal dhe rëndësi lokale, nëse në territorin e asaj njësisë të vetëqeverisjes lokale ka punë të tillë.

3. Parimi për përcaktimin e kompetencave, sipas Konventës është: punët publike duhet të kryhen nga ato forma të pushtetit, që janë më afër qytetarëve.

4. Funksionet, të cilat i besohen pushtetit lokal, sipas rregullës janë të plota dhe përjashtuese. Kjo do të thotë se ato nuk guxojnë të mirren ose të kufizohen nga ana e pushtetit qendror, përveç në rastet e parashikuara me ligj. D.m.th. kompetenca e pushtetit lokal për themelimin e **shërbimeve publike** për kryerjen e punëve nga kompetencat e tyre, duhet të jetë e plotë, në mënyrë që pushteti lokal të vendos nëse do të themelojë shërbim publik, cilat do të jenë veprimtaritë, të realizojnë mbikëqyrjen mbi punën e **shërbimeve publike**, të aprovojnë planet dhe llogaritë vjetore etj.

Shembull: punët publike komunale me rëndësi lokale, sipas këtij parimi, duhet t'i kryejë pushteti lokal, meqë ai është më afër qytetarëve.

5. Pushteti lokal, kryerjen e kompetencave të dhëna nga ana e pushtetit qendror, mund ta përshtat sipas kushteve lokale. Gjatë kësaj, duhet të respektohen standarde të caktuara.

6. Kur planifikohen dhe sillen vendime të caktuara nga ana e pushtetit qendror, e që kanë të bëjnë me pushtetin lokal, pushteti lokal në mënyrë të përshtatshme dhe në kohë konsultohet.

Sipas Konventës kufijtë e territorit, në të cilin shtrihen kompetencat e pushtetit lokal, nuk guxon të ndryshohen pa konsultim paraprak të njësisë të vetëqeverisjes lokale në fjalë. Ky konsultim duhet të bëhet me referendum, nëse është e paraparë me ligj.

Për të qenë në pozitë me sukses të kryejnë kompetencat sipas Konventës evropiane për vetëqeverisje lokale, pushtetet lokale kanë të drejtë të themelojnë organe të tyre administrative, në të cilët do të punësohet kuadër profesional. D.m.th., pushteti lokal do të organizojë administratën e tij. Strukturën e brendshme do ta përcaktojnë vetë, në pajtim me nevojat e tyre. Në administratë, do të punësohet kuadër profesional, në pajtim me nevojat dhe kompetencat të pushtetit lokal, në pajtim me kriteriumet e profesionalizmit dhe **kompetencës**. Për të arritur nivel të lartë të profesionalizmit dhe kompetencës, të punësuarve do t'ju mundësohen kushte dhe mundësi për trajnim, shpërblym adekuat dhe mundësi për përparim në shërbimin.

Sipas Konventës evropiane për vetëqeverisje lokale për bartësit e funksioneve lokale duhet të vlejnë rregullat, si vijon: kushtet për punë të funksionerëve lokal të zgjedhur duhet të mundësojnë kryerje të lirë të funksioneve të tyre. Këto kushte nënkuptojnë kompenzim adekuat financiar të harxhimeve të paraqitura, gjatë kryerjes së funksioneve. Të gjitha funksionet dhe aktivitetet, që nuk janë në kundërshtim me kryerjen e detyrës së funksionerit lokal, përcaktohen me ligj ose me parime themelore juridike.

Lidhur me çështjen e mbikëqyrjes administrative mbi punën e pushtetit lokal, Konventa evropiane për vetëqeverisje lokale parasheh se të gjitha llojet e mbikëqyrjes administrative mund të kryhen vetëm në raste dhe sipas procedurës së përcaktuar me kushtetutë ose me ligj. Mbikëqyrja administrative ka të bëjë me pajtueshmërinë e punës së pushtetit lokal me kushtetutën dhe me ligjet.

Në lidhje me financimin e pushtetit lokal, në Konventën evropiane për vetëqeverisje lokale theksohet se pushteti lokal, në pajtim me politikën ekonomike të vendit, ka të drejtë në burime personale, adekuate të financimit, me të cilat disponojnë lirisht në suazat e kompetencave të tyre. Konventa preferon, më së paku, një pjesë e mjeteve të pushtetit lokal të rrjedh nga taksat lokale dhe kompenzimet tjera, nivelin e të cilëve, në kufijtë e ligjit, kanë të drejtë ta përcaktojë pushteti lokal.

Për mbrojtje dhe përparim të interesave të përbashkëta të pushteteve lokale, Konventa përcakton se çdo vend duhet të pranojë të drejtën për anëtarësinë e tyre në shoqata, si dhe të anëtarësohen në organizatat ndërkombëtare të pushteteve lokale.



Duke pasur parasysh se pushtetet lokale kanë kompetenca të tyre burimore, kryerjen e të cilave vetë e rregullojnë në suazat e standardeve të përcaktuara, në Konventën potencohet se pushtetet lokale kanë të drejtë për mjete juridike për të siguruar kryerje të lirë të funksioneve të tyre dhe respektim të parimeve të vetëqeverisjes lokale të dhëna me kushtetutë dhe ligj. Kjo do të thotë se pushteti lokal ka të drejtë, para gjyqeve kompetente, të kërkojë mbrojtje, nëse me akte dhe aktivitete të organeve shtetërore bëhet pengimi i kryerjes së kompetencave.

1.2.2. Rregullativa juridike e Maqedonisë dhe Konventa evropiane për vetëqeverisje lokale

Në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, vetëqeverisja lokale është njëra ndër vlerat themelore të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë. Në Kushtetutë, garantohet e drejta e vetëqeverisjes lokale për qytetarët. Kushtetuta thekson se vetëqeverisja lokale do të rregullohet me ligj, i cili sillet me dy të tretat e votave. Ligji për vetëqeverisje lokale, në mënyrë më konkrete, rregullon çështjen e vetëqeverisjes lokale. Kjo do të thotë se është pranuar parimi i Konventës evropiane për vetëqeverisje lokale, që parasheh rregullimin e vetëqeverisjes lokale me kushtetutë dhe me ligj.

Njësitë e vetëqeverisjes lokale, janë të pavarura në kryerjen e kompetencave të tyre. Kjo e drejtë e pavarësisë, gjatë kryerjes së kompetencave, rrjedh nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë dhe nga Ligji për vetëqeverisje lokale. Kjo zgjidhje është në pajtim me parimin e Konventës evropiane, sipas së cilës vetëqeverisja lokale nënkupton të drejtën dhe aftësinë e pushtetit lokal, në pajtim me ligjin, të rregullojë dhe udhëheq me aspektet e rëndësishme të punëve publike, në bazë të përgjegjësisë personale dhe për interes të popullatës lokale.

Njësitë e vetëqeverisjes lokale kanë organe, këshill dhe kryetar të komunës, zgjedhja e të cilëve është rregulluar me ligj. Më këtë zgjidhje është pranuar parimi i Konventës evropiane për vetëqeverisje lokale, sipas të cilit e drejta e vetëqeverisjes lokale realizohet nëpërmjet këshillave ose kuvendeve të përbërë nga anëtarë të zgjedhur në zgjedhje të përgjithshme, të drejtë për drejta dhe me votim të fshehtë.

Kompetencat e vetëqeverisjes lokale, janë të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe me ligje tjera. Poashtu, me Ligjin për vetëqeverisje lokale është dhënë mundësia e bartjes së kompetencave nga organet e administratës shtetërore mbi njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Njësitë e vetëqeverisjes lokale, në suazat e ligjit dhe në pajtim me parimin e subsidiaritetit, kanë të drejtë, në rajonin e tyre, të kryejnë punët me karakter lokal dhe interes publik, që nuk janë jashtë kompetencave të tyre dhe në të njëjtën kohë, nuk janë nën kompetenca të organeve shtetërore. Kompetencat e njërive të vetëqeverisjes lokale, sipas ligjit, janë të plota dhe nuk mund të mirren ose kufizohen, përveç në rastet e përcaktuara me ligj.

Mënyra e kryerjes së punëve, kryerja e të cilëve është deleguar nga ana e administratës shtetërore, mund të adaptohet në kushtet lokale me respektim të standardeve të përcaktuara me ligj.

Njësitë e vetëqeverisjes lokale, do të konsultohen në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme, gjatë procedurës së planifikimit dhe vendosjes për çështje, që kanë të bëjnë me ato. Në këtë drejtim, Konventa parasheh mundësinë që kryerja e disa kompetencave të bartet mbi pushtetin lokal, si dhe informimin me kohë dhe në mënyrë të përshtatshme për procedurën e planifikimit dhe vendim-marrjes për çështje, që kanë të bëjnë me ato.

Për shkak të kryerjes së punëve në **kompetencë** të organeve të komunës, organizohet administratë komunale. Organizimi, fushëveprimi dhe mënyra e kryerjes së detyrave, përcaktohet me vendim. Për punësimin, të drejtat dhe obligimet, sistemin e rrogave dhe kompenzimeve të rrogave, përgjegjësinë, vlerësimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës të të punësuarve, aplikohen dispozitat e Ligjit për nëpunësit shtetëror. Me këto zgjidhje është aplikuar parimi i Konventës evropiane, me të cilin pushteti lokal i garantohet e drejta për organe administrative dhe kuadër profesional.

Anëtarët e këshillit kanë të drejtë për kompenzim për pjesëmarrje në mbledhje dhe kompenzim për harxhime të rrugës dhe harxhime ditore, kurse kryetari, i cili kryen funksionin në mënyrë profesionale, ka të drejtë për



rogë dhe kompenzime të tjera. Edhe këto dispozita janë në pajtim me parimin e Konventës, me të cilin përcaktohet obligimi i sigurimit të kushteve për punë të lirë dhe kompenzim adekuat për bartësit e funksioneve në nivel lokal.

Edhe përkrah pavarësisë gjatë kryerjes së kompetencave, Kushteta e Republikës së Maqedonisë dhe Ligji për vetëqeverisje lokale parashohin mbikëqyrje mbi kryerjen e kompetencave. Këtu përfshihet mbikëqyrja mbi ligjshmërinë dhe kontrollin dhe revizionin e punës materialo-financiare. Në lidhje me kryerjen e kompetencave të deleguara, Ligji parashihet mbikëqyrjen mbi ligjshmërinë dhe efikasitetin. Në këtë drejtim, Konventa parashihet mbikëqyrje administrative mbi kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e punës së pushtetit lokal, që kryhet nga ana e organeve qendrore.

Financimi i njësive të vetëqeverisjes lokale është i rregulluar me Ligjin për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, në të cilin janë përcaktuar burimet personale të të ardhurave, si dhe burimet plotësuese. Në këtë kuptim, në Konventën është thënë se pushteti lokal ka të drejtë në burime personale të përshtatshme, të financimit dhe disponim të lirë me këto burime. Më tutje, Konventa thotë se, së paku një pjesë e të ardhurave të pushtetit lokal rrjedh nga taksat dhe kompenzimet tjera lokale, nivelin e të cilave, në pajtim me Ligjin, ka të drejtë ta përcaktojë pushteti lokal.

Me Ligjin, komunave ju është dhënë e drejta për mbrojtje dhe përparim të interesave të tyre të bashkoheshme në shoqatë. Poashtu, Ligji pranon të drejtën e bashkëpunimit të njësive të vetëqeverisjes lokale, me njësi të vetëqeverisjes lokale nga vendet tjera, si dhe të anëtarësohen në organizata ndërkombëtare të pushteteve lokale. Konventa përcakton se çdo vend duhet të pranojë të drejtën e pushteteve lokale për anëtarësim në shoqatat e pushteteve lokale, si dhe anëtarë të organizatave ndërkombëtare të pushteteve lokale.

Për shkak të mbrojtjes së pozitës kushtetuese të komunave, kryetarit të komunës dhe këshillit të komunës me ligj ju është dhënë e drejta, para Gjyqit Kushtetues të Republikës së Maqedonisë, të paraqesin iniciativë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e akteve të përgjithshme të ministrive dhe organeve të tjera të administratës shtetërore. Komunave, poashtu, ju është dhënë e drejta e mbrojtjes gjyqësore para gjyqeve kompetente, në aspekt të akteve dhe aktiviteteve të administratës shtetërore dhe të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Në këtë kuptim, Konventa potencon se pushteti lokal ka të drejtë në mjete juridike për shkak të sigurimit të kryerjes së lirë të funksioneve të tyre dhe respektimit të parimeve të vetëqeverisjes lokale, të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.

Të konstatojmë se rregullativa juridike e Maqedonisë, që ka të bëjë me vetëqeverisjen lokale, është e përshtatur me Konventën evropiane për vetëqeverisje lokale. Republika e Maqedonisë ka ratifikuar këtë Konventë në vitin 1997.

1.3. KOMPETENCAT E KOMUNAVE DHE QYTETIT TË SHKUPIT

Në këtë pjesë, shkurtimisht do të njoftohemi me ligjet, me të cilët më konkretisht përcaktohen kompetencat e komunave, gjegjësisht me ligjet, me të cilët bëhet decentralizimi.

1.3.1. Kompetencat e komunës

Komunat kanë **kompetencë** të përgjithshme, e cila e përfshin të drejtën, në suazat e ligjit dhe në pajtim me parimin e subsidiaritëtit, në territorin e tyre të kryejnë punët me interes publik dhe rëndësi lokale, që nuk janë të përjashtuara nga kompetenca dhe nuk janë nën **kompetencë** të organeve të administratës shtetërore. D.m.th. nëse ndonjë punë e caktuar me interes publik nuk është nën **kompetencë** të organeve shtetërore dhe nuk është parashikuar si **kompetencë** e komunës, këtë punë e kryen komuna, si **kompetencë** të saj. Meqë këto punë, me interes publik, nuk janë parashikuar lihet mundësia, që komuna t'i parashihet ato në statutin e saj. Pse është lënë mundësia komunat vetë t'i përcaktojnë? Sepse çdo komunë ka specifikat e saja në aspekt të zhvillimit, traditave, resurseve natyrore dhe të ngjajshme. Mund të ndodhë në një komunë të egzistojnë punë të caktuara me interes publik, ndërsa në komunë tjetër këto punë të mos egzistojnë.



Punë e tillë me interes publik nuk mund të paraqitet në komunat, të cilat nuk kanë liqen. Mirëpo, në këto komuna mund të egzistojë ndonjë punë tjetër me interes publik. Duke i përcaktuar punët me interes publik në statut, komunat do të përcaktojnë edhe mënyrën e kryerjes së tyre.

Shembull: komuna në territorin e saj ka liqen. Rregullimi i bregut të liqenit dhe përshtatja e tij për përdorim si plazhë publike në këtë moment nuk është dhënë si kompetencë e komunës e as që është nën kompetencë të ndonjë organi të pushtetit shtetëror. Për këtë, komuna, në territorin e së cilës gjendet liqeni, ka kompetencë të kryej këtë punë me interes publik.

Në kryerjen e punëve me interes publik dhe rëndësi lokale, në pajtim me ligj, komunat janë të pavarura. Kjo do të thotë se ato vetë do të përcaktojnë mënyrën e kryerjes së punëve, kuptohet në pajtim me ligjin, dhe janë përgjegjëse për kryerjen e tyre.

Kompetencat e komunave, sipas rregullës, janë të plota dhe të përjashtueshme dhe nuk mund të mirren ose të kufizohen, përveç në rastet e përcaktuara me ligj.

Sipas listës së kompetencave, komunat janë kompetente për punët në lëmitë e ardhshme:

1. Planifikim urban (urban dhe rural) - lëshimi i lejeve për ndërtim të objekteve me rëndësi lokale; rregullimi i hapësirës dhe rregullimi i truallit ndërtimor. Përcaktimi i llojeve të planeve; procedurës për sjelljen e tyre; vendimet për kushte të lokacionit; si dhe punët tjera të lidhura me planifikimin, që janë nën **kompetencë** të komunës përcaktohen me Ligjin për planifikim urban dhe hapësinor. Përcaktimi i objekteve me karakter lokal, si dhe lëshimi i lejes për ndërtim, mbikëqyrje dhe punë të tjera të lidhura me ndërtimtari, për kryerjen e të cilave është kompe-

tente komuna, përcaktohen me Ligjin për ndërtimtari. Meqë ndërtimtaria bëhet në truall, i cili është parashikuar për ndërtim, rregullimi i truallit të tillë, si dhe rregullimi i hapësirës si **kompetencë** e komunës, përcaktohet me Ligjin për truallin ndërtimor.

2. Mbrojtja e ambientit jetësor dhe natyrës - nënkupton ndërmarrjen e masave për mbrojtje dhe pengim të ndotjes së ujit, ajrit, truallit, mbrojtjen e natyrës; mbrojtjen nga zhurma dhe rrezatimit jojonik. Cilat masa ju do t'i ndërmirri, çfarë dispozita do të sillni, si do të rregullohet mbikëqyrja (në suazat e kompetencave të komunës), është e përcaktuar në Ligjin për mbrojtjen e ambientit jetësor, Ligjin për ajrin ambiental, Ligjin për ujëra, Ligjin për mbrojtje nga zhurma dhe me ligje tjera, me të cilat barten kompetenca konkrete mbi komunën.

3. Zhvillimi ekonomik lokal - nënkupton planifikimin e zhvillimit ekonomik lokal; përcaktimin e prioriteteve zhvillimore dhe strukturore; udhëheqjen e politikës ekonomike lokale; përkrahjen e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mëdha dhe të sipërmarrjes në nivel lokal; vendosjen dhe zhvillimin e rrejtit lokal të institucioneve dhe agjensive dhe promovimin e partneritetit. Çka do të përfshijnë kompetencat e komunës në këtë lëmi dhe cilat masa do të mund t'i ndërmerr në kuptim të planifikimit, dhënies së prioritetit gjatë përcaktimit të planeve strategjike, çfarë forme do të ketë përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, çfarë rrjete të institucioneve dhe agjensioneve do të zhvillojë - do të varet nga kompetencat, të cilat barten me Ligjin për tregëti, Ligjin për veprimtari hotelierike, Ligjin për shoqata tregëtare, Ligjin për ndërmarrje publike dhe ligjeve tjera nga kjo lëmi.

4. Veprimtaria komunale - nënkupton furnizim të qytetarëve me ujë për pije nëpërmjet ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrjeteve të ujësjellësit; bartje të ujit teknologjik; bartje dhe pastrim të ujërave të hedhur dhe ujërave atmosferike nëpërmjet ndërtimit të kanalizimit fekal dhe atmosferik dhe stacioneve pastruese; ndërtim dhe mirëmbajtje të ndriçimit të rrugëve; mirëmbajtje të pastërtisë publike; transport dhe procedurë të lidhur me hedhurinën e ngurtë dhe hedhurinat teknologjike komunale; rregullim dhe organizim të transportit lokal të udhëtarëve; furnizim me gaz dhe energji ngrohëse; mirëmbajtje të varreve, varrezave, krematoriumeve dhe dhënie të shërbimeve të varrimit; ndërtim, mirëmbajtje dhe mbrojtje të rrugëve lokale dhe objekteve tjera të infrastrukturës; rregullim të regjimit të trafikut, ndërtim dhe mirëmbajtje të signalizimit rrugor të trafikut, ndërtim dhe mirëmbajtje të hapësirës publike për parkim, largim të automjeteve të parkuara kundër rregulave, largim të automjeteve të shkatërruara nga sipërfaqet publike; ndërtim dhe mirëmbajtje të tregjeve; pastrim të oxhaqeve, mirëmbajtje dhe shfrytëzim të parqeve, gjelbërimit, maleve-parqe dhe sipërfaqeve rekreative; rregullim, mirëmbajtje dhe shfrytëzim të shtretërve të lumenjëve në pjesët e urbanizuara; përcaktim të emrave të rrugëve, sheveve dhe objekteve tjera të infrastrukturës.

Në këtë lëmi, një pjesë e punëve do të kryhen në pajtim me ligj, ndërsa për pjesën tjetër është e nevojshme sjellja e dispozitave të përshtatshme nga ana e komunës, me të cilat do të rregullohet mënyra e kryerjes së tyre. Duhet të dihet, cilat ligje kanë të bëjnë me këtë lëmi: Ligji për furnizim me ujë për pije dhe bartjen e ujërave të hedhura urbane, Ligji për udhëheqjen me hedhurinat, Ligji për transport në trafikun rrugor, Ligji për



rugët publike, Ligji për varreza, Ligji për ujëra, Ligji për përcaktim të emrave të rrugëve. Për rregullimin e punëve, që kanë të bëjnë me pastrimin e oxhaqeve, ndërtim dhe mirëmbajtje të sinjalizimit rrugor të trafikut, ndriçimit publik, mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të parqeve, gjelbërimit, maleve-parqe dhe sipërfaqeve rekreative - komuna, në suazat e kompetencave të saja, duhet të sjell dispozita. Këtu duhet të merret parasysh Ligji për veprimtari komunale, në të cilin janë paraqitur veprimtaritë, që kanë karakter të veprimtarisë publike komunale. Pse është me rëndësi të njihemi me përcaktimet e këtij ligji? Është me rëndësi, sepse ofron zgjidhje si të kryhen ato. Poashtu i rëndësishëm është edhe Ligji për ndërmarrje publike, sepse me këtë ligj është rregulluar themelimi i ndërmarrjeve publike, organizimi dhe mënyra e punës së tyre. Për kryerjen e një pjese më të madhe të veprimtarive, themelohen ndërmarrje publike, veprimtarinë e të cilëve e përcaktojnë organet e komunave (këshilli), me vendimin për themelimin e tyre. Poashtu, gjatë mandatit të juaj, ndoshta do të vlerësoni se është më ekonomike dhe më efikase nëse kryerjen e ndonjë veprimtarie do t'ia besoni ndonjë personi të caktuar fizik ose juridik, me marrëveshje.

5. Kultura - nënkupton përkrahje institucionale dhe financiare të projekteve të institucioneve kulturore; ruajtjen e folklorit, traditave, artizanateve të vjetra dhe vlerave të ngajshme kulturore; organizim të manifestacioneve kulturore; shtytje të formave të ndryshme specifike të krijimtarisë. Këtu, vend të meriruar merr Ligji për kulturë, me të cilin përcaktohet çka është **kompetencë** e komunës. Duke përcaktuar institucionet me karakter nacional, jep hapësirë për komunat, ato të përcaktojnë vetëm institucionet me karakter lokal. Në çdo rast, nuk guxojmë të anashkalojmë Ligjin për muze dhe Ligjin për biblioteka, si dhe ligjet tjera nga kjo lëmi, me të cilat barten kompetencat mbi komunat.

6. Sporti dhe rekreimi - nënkupton zhvillimin e sportit masovik dhe aktiviteteve rekreative; organizim të shfaqjeve dhe manifestacioneve sportive; mirëmbajtjen dhe ndërtimin e objekteve për sport; përkrahje të lidhjeve sportive. Me çfarë përfshirje dhe cilat punë nga kjo lëmi do të kryhen nga ana e komunave, është përcaktuar me Ligjin për sport.

7. Mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve - nënkupton financimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e foshnjoreve për fëmijë dhe të shtëpive për të moshuarit; realizimin e kujdesit social për persona të invalidizuar; fëmijët pa prindër dhe kujdes prindëror; fëmijët me probleme edukativo-sociale; fëmijët me nevoja të veçanta; fëmijët me familje me një prindër; fëmijët e rrugës; personat e nënshtruar në rrezik social; personat e prekur me keqpërdorimin e alkoolit dhe drogës; ngritjen e vetëdijës së popullatës; vendosjen e personave me rrezik social; realizimin e të drejtës dhe edukimin e fëmijëve të moshës para shkollore. Suazat e kompetencave në këtë lëmi janë përcaktuar me Ligjin për mbrojtje sociale, Ligjin për mbrojtje të fëmijëve dhe me ligje të tjera, që kanë të bëjnë me këtë lëmi.

8. Arsimi - nënkupton themelimin, financimin dhe administrimin me shkollat fillore dhe shkollat e mesme, në bashkëpunim me pushtetin qendror dhe në pajtim me ligji; organizim të transportit dhe ushqimit dhe vendosjen e tyre në konviktet dhe shtëpitë shkollore. Mënyra e themelimit, financimit dhe administrimit (zgjedhja e organeve të shkollës), është zgjidhur me Ligjin për arsim fillor dhe me Ligjin për arsim të mesëm.

9. Mbrojtja shëndetësore - nënkupton udhëheqje me rretën e organizatave shëndetësore, publike dhe me objektet e mbrojtjes shëndetësore primare, që duhet të sigurojnë përfaqësim të vetëqeverisjes lokale në të gjitha këshillat drejtuese të të gjitha organizatave shëndetësore në pronësi publike; arsimim shëndetësorë; përparimi të shëndetësisë; aktivitete preventive; mbrojtje të shëndetit të të punësuarve gjatë punës; mbikëqyrje shëndetësore mbi ambientin jetësor; mbikëqyrje mbi sëmundjet ngjitëse; ndihmë pacientëve me nevoja speciale. Në këtë lëmi, kompetencat e komunës përcaktohet me Ligjin për mbrojtje nga sëmundjet ngjitëse dhe me Ligjin për mbrojtje shëndetësore.

10. Realizimi i përgaditjeve dhe ndërmarrja e masave për mbrojtje dhe shpëtim të qytetarëve dhe të mirave materiale nga shkatërrimet luftarake, fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe nga pasojat e shkaktuara prej tyre.

11. Mbrojtjen kundër zjarrit - e kryejnë njësitë zjarrfikëse, territoriale. Cilat njësi zjarrfikëse janë në **kompetencë** të komunës, si funksionojnë, si plotësohen ato, si pajisen dhe si financohen, është rregulluar me Ligjin për zjarrfikje.

12. Mbikëqyrje mbi kryerjen e punëve nën **kompetencë** të komunës- këtë **kompetencë** komunat e kanë me qëllim të kryerjes së mbikëqyrjes të punës së ndërmarrjeve publike, të themeluara nga ato. Mbikëqyrja kryhet nëpërmjet aprovimit të programit për punë dhe me aprovimin e planeve financiare të **shërbimeve publike**, që i ka themeluar komuna, si dhe nëpërmjet aprovimit të raporteve për punë dhe llogarive vjetore të ndërmarrjeve publike.



1.3.2. Kompetencat e Qytetit të Shkupit

Në këtë pjesë të materialit, do të ndalemi vetëm në kompetencat, që i kanë Qyteti i Shkupit dhe komunat në qytet. Nuk do të përsëriten ligjet, me të cilët bëhet decentralizimi, sepse ata janë përmendur më lartë në pjesën e tekstit, i cili përshkruan kompetencat e komunave.

Këtu do të përmenden kompetencat, që janë parashikuar me Ligjin për Qytetin e Shkupit.

1. Planifikimi dhe rregullimi i sipërfaqes

- sjellje e planit urban hapësinor;
- dhënia e mendimit për propozim-planet urbane detale, projektet urbane dhe planet urbane për vende të banuara, që i sjellin komunat në qytetin e Shkupit;
- rregullim të truallit ndërtimor;
- përcaktim të standardeve dhe dhënien e lejeve për ngritjen e objekteve me karakter të përkohshëm, mobiljeve dhe pajisjeve urbane në rajonin e Qytetit të Shkupit.

2. Mbrojtja e ambientit jetësor dhe natyrës

- mbrojtje dhe ndërmarrje të masave për pengimin e ndotjes së ujit, ajrit, truallit, mbrojtjen e natyrës, mbrojtje nga zhurma dhe rrezatimit jojonik në rajonin e Qytetit të Shkupit.

3. Zhvillimi i ekonomisë lokale

- planifikimi i zhvillimit të ekonomisë lokale në Qytetin e Shkupit;
- përcaktimi i prioriteteve zhvilluese dhe strukturore në nivel të Qytetit të Shkupit;
- përcaktimi i politikës ekonomike lokale;
- përcaktimi i strategjisë dhe dhënies së përkrahjes të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe sipërmarjes;
- zhvillim dhe nxitje të turizmit alternativ dhe turizmit kulturor;
- përmirësimin e kushteve për qëndrim të turistëve në Qytetin e Shkupit dhe informim propagandistik në lëminë e turizmit.

4. Veprimtari komunale

- ndërtim, shfrytëzim, mbrojtje dhe mirëmbajtje të rrugëve magjistrale dhe rrugëve të tjera dhe objekteve tjera të infrastrukturës;
- kategorizim dhe emërim i vendbanimeve të qytetit, rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve të tjera të infrastukturës;
- furnizim me ujë për pije nga sistemi i vetëm furnizues i Qytetit të Shkupit;
- bartje dhe pastrim të ujërave të përdrura; bartjen dhe hedhjen e ujërave atmosferike;
- përpunim dhe bartje të ujit teknologjik;
- ndërtim dhe mirëmbajtje të ndriçimit publik të rrugëve magjistrale dhe rrugëve mbledhëse në rajonin e Qytetit të Shkupit;
- mbledhje dhe transportim të hedhurinave komunale dhe hedhurinave tjera të pa rrezikshme;
- mirëmbajtje të deponimeve për hedhurina komunale dhe hedhurina tjera të parrezikshme;



- rregullim dhe organizim të transportit publik urban dhe ndërrurban të udhëtarëve;
- mirëmbajtje të pastërtisë publike të sipërfaqeve publike;
- mirëmbajtje dhe shfrytëzim të parqeve të qytetit, maleve-parqe në rajonin e Qytetit të Shkupit, zonat ujore, sportive dhe rekreative të përcaktuara me planin urban gjeneral dhe rajone tjera të mbrojtura, në pajtim me ligj;
- mirëmbajtje të gjelbërimit në rrugët magjistrale dhe në rrugët mbledhëse;
- ndërtim, mirëmbajtje dhe shfrytëzim të parkingjeve publike me rëndësi për Qytetin e Shkupit të përcaktuar me planin urban;
- vendosje, ndërrim dhe heqje të shenjave të komunikacionit dhe paisjeve mbrojtëse në rrugët lokale;
- përcaktim të kushteve dhe regjimit të trafikut në rajonin e Qytetit të Shkupit;
- mirëmbajtje të varreve, varrezave, krematoriumeve dhe dhënie të shërbimeve të lidhura me varrim në varrezat e Qytetit, të përcaktuara me planin urban;
- furnizim me gaz natyror dhe energji nxehtë;
- ndërtim, udhëheqje, mirëmbajtje dhe shfrytëzim të sistemit gjeografik-informativ të Qytetit të Shkupit;
- rregullim mirëmbajtje dhe shfrytëzim të shtretërve të lumenjëve në pjesët e urbanizuara;
- dezinfektim në rajonin e Qytetit të Shkupit;
- ndërtim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje të tregjeve për tregëti me shumicë dhe tregjeve për tregëti me automjete në rajonin e Qytetit të Shkupit;
- eliminim të kafshëve endacake;
- përcaktim të vendeve për varrim të kafshëve të vdekura dhe varrim të tyre;
- zbukurim të Qytetit të Shkupit.

5. Kulturë

- përkrahje institucionale dhe financiare të institucioneve kulturore dhe projekteve kulturore me rëndësi për Qytetin e Shkupit;
- ruajtje e folklorit, traditave, artizanateve të vjetra dhe vlerave të ngjajshme kulturore;
- organizim të manifestimeve kulturore, nxitje të krijimtarisë së lloj-llojshme specifike;
- shënim të ndodhive dhe personave me rëndësi për Qytetin e Shkupit.

6. Arsimi

- themelim, financim dhe pjesëmarrje me përfaqësues të tij në organet e drejtimit të shkollave publike të mesme në rajonin e Qytetit të Shkupit, në pajtim me ligj;
- emërim të drejtorëve të shkollave të mesme publike dhe të konvikteve shkollore, në pajtim me ligj;
- organizim të transportit, ushqimit dhe vendosjen e nxënësve në konviktet shkollore, në pajtim me ligj;

7. Sport

- sigurim të kushteve për zhvillim të sportit kualitativ në Qytetin e Shkupit;
- organizim, nxitje dhe përkrahje të manifestimeve dhe shfaqjeve sportive me rëndësi për Qytetin e Shkupit;
- ndërtim dhe mirëmbajtje të objekteve sportive me rëndësi për Qytetin e Shkupit.



8. Mbrojtje sociale dhe mbrojtje të fëmijëve

- realizim të kujdesit social për persona të invalidizuar, fëmijët pa prindër dhe përkujdesje prindërore, personat me probleme arsimoro-sociale, fëmijët me nevoja të posaçme, fëmijët prej familjeve me një prindër, fëmijët në rrugë, personat të nënshtruar rrezikut social, personat e prekur me keqpërdorimin e drogës dhe alkoolit, ngritjen e vetëdijës së qytetarëve, vendosjen e personave me rrezik social;
- pronësi, udhëheqje, themelim, financim dhe mirëmbajtje të institucioneve publike-shtëpive për persona të moshuar, në pajtim me ligj;
- pronësi, udhëheqje, themelim, financim dhe mirëmbajtje të institucioneve publike-pushimore për fëmijë, në pajtim me ligj;
- pjesëmarrje me përfaqësues të tij në organet e drejtimit të institucioneve publike për fëmijë - foshnjoreve për fëmijë, në rajonin e Qytetit të Shkupit, në pajtim me ligj.

9. Mbrojtje shëndetësore

- pjesëmarrje në drejtimin e rrjetës së institucioneve shëndetësore publike dhe objekteve për mbrojtje shëndetësore primare me rëndësi për Qytetin e Shkupit;
- ndërmarrjen e masave për mbrojtje të shëndetit të punëtorëve dhe mbrojtjes gjatë punës;
- arsimim shëndetësor, përparim të shëndetit dhe aktivitete preventive;
- mbikëqyrje shëndetësore të ambientit jetësor dhe të sëmundjeve ngjithëse;
- ndihmë të pacientëve me nevoja speciale.

10. Mbrojtje dhe shpëtim

- koordinim të aktiviteteve për mbrojtje dhe shpëtim të qytetarëve dhe të mirave materiale nga shkatërrimet luftarake, fatkeqësive elementare dhe fatkeqësive të tjera dhe nga pasojat e shkaktuara prej tyre

11. Mbrojtja kundër zjarrit

- mbrojtje kundër zjarrit në rajonin e Qytetit të Shkupit.

1.3.3. Kompetencat e komunave në qytetin e Shkupit

1. Planifikim dhe rregullim të hapësirës

- ndërmarrje të inicijativave për sjellje, ndryshim dhe plotësim të planit hapësinor dhe gjeneral të Qytetit të Shkupit dhe dhënie të mendimit lidhur me këto plane urbane;
- sjellje të planeve urbane detale, projekteve urbane dhe planeve urbane për vende të banuara;
- realizim të planeve dhe projekteve urbane dhe lëshim të dokumentacionit për ndërtim të objekteve me rëndësi lokale (kushte për ndërtim, pëlqim urban, leje për ndërtim);
- lëshim të lejes për vendosje të objekteve me karakter të përkohshëm, mobilje dhe pajisje urbane;
- rregullim të truallit ndërtimor në pjesën e pajisjes së truallit ndërtimor me objekte dhe instalime të infrastrukturës sekundare.

2. Mbrojtje të ambientit jetësor dhe natyrës

- ndërmarrje të inicijativave dhe ndërmarrje të masave për mbrojtje dhe pengim të ndotjes së ujit, ajrit, truallit, mbrojtje të natyrës, mbrojtje nga zhurma dhe nga rrezatimi jojonik.



3. Zhvillimi i ekonomisë lokale

- planifikim të zhvillimit të ekonomisë lokale, përcaktimin e prioriteteve zhvillimore dhe strukturore dhe përkrahje të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe përmbytje të sipërmarrjes.

4. Veprimtari komunale

- ndërtim, mirëmbajtje, rikonstruim dhe mbrojtje të rrugëve ndihmëse dhe rrugëve në rajonet e banimit dhe objekte të tjera të infrastrukturës;
- mirëmbajtje të pastërtisë publike të rrugëve ndihmëse dhe rrugëve në rajonet e banimit;
- organizim, hudhje dhe transportim të hedhurinës komunale dhe llojit tjetër të hedhurinave të pa rezikshme;
- ndërtim dhe mirëmbajtje të ndriçimit publik të rrugëve në rajonet e banimit dhe të rrugëve ndihmëse në rajonin e komunës;
- mirëmbajtje të varreve dhe varrezave dhe dhënie të shërbimeve për varrim në varrezat e komunës të përcaktuara me plane urbane;
- ndërtim, mirëmbajtje dhe shfrytëzim të parkingjeve publike me rëndësi për komunën, që janë të përcaktuara me plan urban;
- mirëmbajtje dhe shfrytëzim të gjelbërimit në rrugët ndihmëse dhe rrugët në rajonet banuese;
- heqje të automjeteve të pa regjistruara dhe të automjeteve tjera, prej sipërfaqeve publike;
- mirëmbajtje dhe shfrytëzim të tregjeve publike;
- dezinfektim dhe dezinfektim;
- ndërtim dhe mirëmbajtje të nyjeve sanitare publike.

5. Kulturë

- mirëmbajtje institucionale dhe financiare të institucioneve kulturore dhe projekteve kulturore me rëndësi për komunën;
- ruajtje e folklorit, traditave, artizanateve të vjetra dhe vlerave të ngjajshme kulturore;
- organizim të manifestimeve kulturore, nxitje të krijimtarisë së lloj-llojshme specifike;
- shënim të ndodhive dhe personave me rëndësi për komunën.

6. Arsim

- themelim, financim dhe pjesëmarrje me përfaqësues të saj në organet e drejtimit të shkollave fillore në rajonin e komunës, në pajtim me ligj;
- emërim të drejtorëve të shkollave fillore, në pajtim me ligj;
- Organizim të transportit dhe ushqimit të nxënësve në shkollat nën **kompetencë** të saj, në pajtim me ligj;

7. Mbrojtje sociale për fëmijë

- pronësi, udhëheqje, themelim, financim dhe mirëmbajtje të institucioneve publike për fëmijë, foshnjoreve për fëmijë, në pajtim me ligj;
- ndërmarrje të masave nga lëmia e mbrojtjes sociale, në pajtim me ligj.

8. Mbrojtje shëndetësore

- ndërmarrje të masave për mbrojtje të shëndetit të punëtorëve dhe mbrojtjes gjatë punës;
- arsim shëndetësor, përparim të shëndetit dhe aktivitete preventive;



- mbikëqyrje shëndetësore të ambientit jetësor dhe të sëmundjeve ngjitëse;
- ndihmë të pacientëve me nevoja speciale.

9. Mbrojtje dhe shpëtim

- mbrojtje dhe shpëtim të qytetarëve dhe të mirave materiale nga shkatërrimet luftarake, fatkeqësitë elementare dhe fatkeqësitë tjera dhe nga pasojat e shkaktuara prej tyre.

1.4. KOMPETENCA TË DELEGUARA

Nëse vlerësohet se kryerja e punëve të caktuara në **kompetencë** të organit të caktuar të administratës shtetërore do të jetë më efikas, organi i tillë i administratës shtetërore mund të delegojë kryerjen e **kompetencës** së tij mbi kryetarin e komunës. Mënyra e kryerjes, mund të përshtatet në pajtim me kushtet lokale, duke pasur parasysh standardet e përcaktuara me ligj. Në rastet e situatave të këtilla, mjetet financiare për kryerjen e kompetencave të tilla rrjedhin prej Buxhetit të Republikës së Maqedonisë. Për mos kryerje ose për moskryerje në kohë të punëve, përgjegjës do të jetë edhe organi i administratës shtetërore.

1.5. MËNYRA E KRYERJES SË KOMPETENCAVE

Komunat me qëllim të kryerjes së kompetencave të tyre, mund të themelojnë ndërmarrje publike në pajtim me ligj. Psh, në lëminë e veprimtarive komunale, komunat themelojnë ndërmarrje publike; në lëminë e kulturës, komunat themelojnë institucione kulturore me karakter lokal - biblioteka, muze etj.

Komuna mund të bëjë delegimin e kryerjes së punëve të caktuara me interes publik dhe me rëndësi lokale edhe mbi persona juridik dhe fizik, në bazë të marrëveshjes së arritur për kryerje të punëve me interes publik në pajtim me ligj. Psh, me marrëveshje të bart mirëmbajtjen e pastrimit publik ose largimin dhe transportimin e hedhurinave komunale të ngurta dhe teknologjike nga vendbanimi ose nga një pjesë e vendbanimit.

Edhe në të dy rastet, komuna është përgjegjëse për kryerje të punëve me interes publik.

Fjalë kyqe: kompetencë, kompetencë e deleguar, shërbime publike.

Korrniza juridike:

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 52/91);
- Ligji për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 5/02)
- Ligji për organizim territorial të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 55/04)
- Ligji për Qytetin e Shkupit ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.55/04);
- Ligji për financim të njësisve të vetëqeverisjes lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 61/04);
- Ligji për zgjedhjet lokale (tekst i pastruar), ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 45/04)
- Konventa evropiane për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 23/97).



2 ORGANET E KOMUNËS - ORGANIZIM DHE ADMINISTRIM EFIKAS

Kire Kitevski

Pas marrjes së urimeve për funksionin e ri dhe përgjegjësitë tuaja para qytetarëve atë, që në fillim duhet të dini janë përgjigjet në pyetjen: cilat janë obligimet dhe të drjetat dhe si të punoni në mënyrë efikase dhe efektive. Shpresojmë se faqet në vijim, do t'i lexoni me vëmendje të veçantë.

2.1. KËSHILLI I KOMUNËS

2.1.1. Konstituimi i këshillit

Zgjedhjet mbaruan. Si do të konstituohet **këshilli**? Mbledhjen e parë të **këshillit**, do ta thërret **kryetari i këshillit** nga përbërja e më parshme në afat prej 20 ditëve nga dita e mbarimit të zgjedhjeve. Nëse kryetari i përbërjes së më parshme të **këshillit** nuk e thërret mbledhjen, atëherë vetë **këshilltarët** e posazgjedhur në afat prej 10 ditëve, pas kalimit të afatit të mëparshëm mblidhen dhe, nën udhëheqje të anëtarit më të vjetër e konstituojnë **këshillin**. Duhet të kihet kujdesë ky afat të mos lëshohet, sepse në të kundërtën do të duhet të shpallen zgjedhje të reja.

Qytetarët ju zgjedhën të jeni anëtar i organit të tyre përfaqësues, ku do të vendosni në suazat e kompetencave të komunës. Numri i anëtarëve të **këshillit**, varësisht nga numri i banorëve, është i ndryshëm. Kështu, **këshilli** më i vogël numëron 9 **këshilltarë**, ndërsa **këshilli** më i madh 33 **këshilltarë**.

Për dallim nga komunat **Këshilli** i Qytetit të Shkupit, si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale, ka 45 **këshilltarë**.

Qytetarët, me zgjedhjen e juaj si anëtarë i **këshillit**, ju kanë dhënë të drejtën për pjesëmarrje në punën e **këshillit** nëpërmjet diskutimit për materialet e vendosura në rend të ditës; të drejtë të propozoni zgjidhje dhe konkluzat për këto materiale, si dhe të parqitni pyetje deri te **kryetari i komunës**. Poashtu, mund të propozoni sjelljen e dispozitave të caktuara, me të cilat do të rregullohet çështje e caktuar nën kompetencë të komunës, të filloni iniciativa dhe jepni propozime. Në rend të ditës është sjellja e programit për rregullimin e truallit ndërtimor. Në këtë program nuk është parashikuar ndërtimi i kanalizimit në pjesën e vendbanimit, në të cilën jetoni. Ju mund të propozoni ndryshim ose plotësim të propozim-programit, me qëllim të ndërtimit të kanalizimit edhe në pjesën e vendbanimit ku ju jetoni. Materiali, i cili është i propozuar për rend të ditës, konsideroni se nuk ofron zgjidhje të mirë ose ai nuk është mirë i përpunuar. Në këtë rast ju mund të propozoni zgjedhje më të mirë ose të kërkonte të sillat konkluzë, me të cilën do të obligohet propozuesi të bëjë përpunimin e materialit të këtillë.



Në punën e **këshillit**, si përfaqësues i qytetarëve, vendosni sipas bindjes së juaj dhe nuk mund të shkarkoheni nga funksioni, e as të thirrëni në përgjegjësi penale ose të paraburgoseni për mendimin e shprehur nga ana e juaj ose për mënyrën e votimit të juaj, gjatë punës së **këshillit**.

PAPËLQYESHMËRIA E FUNKSIONIT

Me zgjidhjen e juaj në funksionin e ri, nuk do të mund të kryeni funksione dhe detyra tjera.

Kështu, kryetari i komunës nuk mundet, në të njëjtën kohë, me qenë kryetar i Republikës së Maqedonisë, kryetar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, deputet, ministër, gjygtarë, gjygtarë në Gjygin kushtetues, prokuror publik, avokat popullor. Më tutje, nuk mund të kryej funksionin, zgjedhjen ose emërimin e të cilit e bën Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Nuk mund të kryej punë profesionale ose administrative në organet e administratës shtetërore dhe nuk mundet me qenë anëtarë i këshillave drejtuese ose përfaqësues i kapitalit shtetëror në shoqatat tregëtare. Poashtu, nuk mund të kryej veprimtari ekonomike ose veprimtari tjetër fitimprurëse. Kryetari i komunës nuk mundet me qenë në të njëjtën kohë edhe anëtar i këshillit, ndërsa kryetari i Qytetit të Shkupit nuk mundet me qenë anëtar i këshillave të komunave të qytetit të Shkupit.

Funksioni anëtar i këshillit, në të cilin ju kanë zgjedhur qytetarët, ju kufizon të drejtën të jeni kryetar i Republikës së Maqedonisë, kryetar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, deputet, ministër, gjygtar, gjygtar në Gjygin kushtetues, prokurorë publik, avokat i popullit. Poashtu, nuk mund të kryeni funksion, zgjedhja dhe emërimi i të cilit bëhet nga ana e Kuvendit dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe as që mund të punësoheni në administratën e komunës.

Meqenëse kuvendi vendos për çështje me rëndësi lokale, mund të ndodh të vendos për çështje, nga e cila ju osë bashkëshorti i juaj, fëmija ose farefis deri në gjeneratën e dytë, mund të keni interes financiar ose interes tjetër. Në këto raste, ju nuk guxononi të merrni pjesë gjatë vendosjes dhe për këtë, jeni i obliguar të informoni **këshillin**.

2.1.2. Kompetencat

Këshilli i komunës i përbërë nga përfaqësues të qytetarëve është kompetent për:

- sjelljen e statutit dhe dispozitave tjera të komunës;
- sjelljen e buxhetit të komunës dhe llogarinë vjetore të komunës;
- përcaktimin e lartësisë së burimeve të të ardhurave personale për financim të komunës, në suazat e përcaktuara me ligj;
- themelimin e shërbimeve publike, në suazat e kompetencave të komunës dhe bën mbikëqyrje mbi punën e tyre;
- emërimin e anëtarëve të **këshillave** drejtuese të shërbimeve publike, që i themelon;
- aprovimin e planeve për punë dhe planeve financiare për financimin e shërbimeve publike, që i ka themeluar komuna;
- e aprovimin e raportit për kryerjen e buxhetit dhe aprovimin e llogarisë vjetore të komunës;
- vendosje për dhënien e lejës për kryerje të veprimtarisë me interes publik, me rëndësi lokale në pajtim me ligj;
- aprovimin e raportit për punë dhe llogarive vjetore të shërbimeve publike, që i ka themeluar komuna;
- vendosje për mënyrën e përdorimit të pronësisë së komunës;
- vendosje për mënyrën e kryerjes së kontrollit financiar të buxhetit të komunës, në pajtim me ligj;
- zgjedhje të personit, i cili udhëheq me njësinë lokale të Ministrisë për punë të brendshme, në pajtim me ligj;

- shqyrtim dhe aprovim të raportit për siguri publike në territorin e komunës, të cilin e dorëzon deri te ministri për punë të brendshme dhe avokati popullor.

2.1.3. Komisionet e këshillit

Kompetencat e komunës janë të mëdha dhe shtrihen në lëmi të ndryshme. Për këtë paraqitet nevoja e formimit të **komisioneve** të përkohshme dhe të përhershme, si trupa të **këshillit**. Cilat **komisione** do të formo-



hen dhe sa do të jetë numri i anëtarëve të tyre, do të vendosni vetë, nëpërmjet statutit të komunës. Zakonisht, **komisionet** formohen për lëmi të caktuara ose për më tepër lëmi të afërta dhe gjatë zgjedhjes së anëtarëve të komisioneve, duhet pasur vëmendje ata të njohin lëminë. Këshilli, me propozim të **kryetarit të komunës**, sjell buxhetin e komunës dhe llogarinë vjetore.

Në rend të ditës është sjellja e programit për mirëmbajtjen e higjienës në sipërfaqet publike. Komisioni për veprimtari komunale, i formuar nga ana e **këshillit**, pasi që paraprakisht do të shqyrtojë këtë program, **këshillit** mund t'i propozojë zgjidhje më të ndryshme nga zgjidhjet e ofruara ose të propozojnë programi të plotësohet me zgjidhje të reja. Sillet plan urbanistik. Komisioni për urbanizëm dhe ndërtimtari, me siguri do të jep kontribut në sjelljen e planit kualitativ.

Meqë komisioni është i përbërë nga **këshilltarë**, që i përkasin partive të ndryshme politike, gjatë formimit të **komisioneve** duhet të respektohet përfaqësimi profesional i të gjitha partive politike, që kanë anëtarë të tyre në **këshill**.

Përbërja e popullatës në komunë, sipas regjistrimit të fundit është i tillë, që më tepër se 20%, i takojnë bashkësisë së caktuar. Për zgjidhjen e marrëdhënieve në mes këtyre bashkësive, formohet **komision për marrëdhënie në mes bashkësive**. Komisioni duhet të përbëhet nga numër i njëjtë i çdo bashkësie prezente në komunë dhe zgjedhja e tyre do të rregullohet me statutin e komunës. Atëherë kur komisioni do të diskutojë për marrëdhëniet në mes bashkësive dhe do të ndërtojë mendim ose do të ketë zgjidhje se, si këto marrëdhënie të zgjidhen, mendimin dhe zgjidhjen do të dorëzojë deri të **këshilli**. Këshilli, gjatë një situatë të tillë, është i obliguar të shqyrtojë mendimet dhe zgjidhjet e ofruara dhe të vendosë në lidhje me ato.

Institucionet publike, të cilat themelohen nga ana e **këshillit** të komunës për realizimin e kompetencave të komunës, japin shërbime.

Ndërmarrja publike komunale i mbledh hedhurinat. Shfrytëzues të këtij shërbimi janë persona juridik dhe fizik. Këshilli për mbrojtje të konsumatorëve duhet të jetë i përbërë nga përfaqësues të personave juridik dhe fizik. Poashtu, **këshilli** për mbrojtje të konsumatorëve, që është i përbërë nga shfrytëzues të shërbimit të përmendur, ka mundësi të bëjë vlerësimin dhe mund të propozojë masa për përmirësimin e tij. Mbledhja e hedhurinave bëhet një herë në javë në një rrugë të caktuar. Kjo në praktikë nuk është e mjaftueshme, sepse kovet janë të stërmbrushura dhe hedhurinat shpërndahen në rrugë. Këshilli për mbrojtje të konsumatorëve, mund të propozon mbledhja e hedhurinave të bëhet dy herë në javë ose zgjidhje tjetër më adekuate.

2.1.4. Zgjedhje dhe obligime te kryetarit

Në mbledhjen e parë konstitutive të **këshillit** të komunës, vërtetohet mandati i zgjedhjes së anëtarëve të **këshillit**. Është e nevojshme të zgjidhet **kryetar i këshillit**. Si do të bëhet kjo?

Nëse në rrethin e parë të zgjedhjeve, asnjë nga kandidatët nuk ka fituar numrin e duhur të votave, atëherë votohet në rrethin e dytë, vetëm për dy kandidatë, të cilët në rrethin e parë të votimit kanë fituar më tepër vota. Në rrethin e dytë të votimit, i zgjedhur do të konsiderohet ai kandidat, që ka fituar më tepër vota.

Kryetari i zgjedhur do të thërras mbledhjet e **këshillit** dhe do të udhëheqë me ato. Thirrja e mbledhjeve bëhet me dorëzimin e vendimit, me propozim të rendit të ditës, deri te anëtarët e **këshillit**. Kryetari do të nënshkruaj të gjitha aktet, që i ka sjellur **këshilli** dhe do të dorëzojë aktet deri te kryetari për shpallje në gazetën zyrtare të komunës dhe rezlizimin e tyre të mëtutjeshme.

Shembull: Puna e këshillit do të lehtësohet, nëse ka komision për financim dhe buxhet, sepse ajo do të përbëhet prej anëtarëve, të cilët e njohin këtë lëmi dhe këshillit do të mund t'i dorëzojnë propozime konkrete.

Komuna feston jubileun. Për këtë shkak do të formojë komision të përkohshëm, i cili do të realizojë këtë ngjarje, gjegjësisht do t'i propozojë këshillit si të festohet jubileu. Me kalimin e jubileut, komisioni do të ndërpret egzistimin e tij.

Për përmirësimin e kualitetit të shërbimeve, që i ofrojnë institucionet e këtilla, këshilli ka të drejtë të formojë këshill për mbrojtjen e konsumatorëve, i cili do të përbëhet nga grupet më të mëdha të shfrytëzuesve të shërbimeve publike. Çfarë do të jetë përbërja e tij, zgjedhja e anëtarëve dhe çka do të punojë, do të përcaktohet me statutin e komunës.



2.1.5. Mbledhjet e këshillave

E keni marrur vendimin për thirrje të mbledhjes së **këshillit**, së bashku me propozimin e rendit të ditës. Keni vërejtur se vendimi është i nënshkruar nga ana e kryetarit të **këshillit** të komunës. Kjo do të thotë se **këshilli** i komunës punon në mbledhje, e mbledhjet i thërret **kryetar i këshillit**. Mirëpo, **kryetar i këshillit** do të thërret mbledhje edhe me kërkesë të **kryetarit të komunës** dhe me kërkesë të, së paku, $\frac{1}{4}$ e anëtarëve të **këshillit**. Nëse kërkesa për mbledhje është parashtruar nga ana e **kryetarit të komunës** ose prej anëtarëve të **këshillit** të komunës, **kryetar i këshillit** në afat prej 15 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës, thërret mbledhjen e **këshillit** të komunës. Është logjike parashtrimi i pyetjes: çka nëse **kryetar i këshillit** të komunës nuk e thërret mbledhjen? Në këtë rast, anëtarët e **këshillit** mblidhen vetë dhe zgjedhin kryetar për atë mbledhje.

Vendimi për thirrjen e mbledhjes, së bashku me rendin e propozuar të ditës, duhet të dorëzohet më së voni 7 ditë para ditës kur është caktuar mbajtja e mbledhjes. Kjo kohë është e nevojshme për shqyrtimin e materialeve, që propozohen në rendin e ditës; të mblidhen informata plotësuese në lidhje me materialet, që mund të fitohen nga administrata e komunës ose nga burime tjera; të bëhen konsultime me persona profesional në lëmitë e caktuara, me të cilat kanë të bëjnë materialet e rendit të propozuar të ditës - e gjithë kjo me qëllim të pjesëmarrjes aktive në diskutimin në lidhje me materialet gjatë mbledhjes dhe të me qëllim të sjelljes së vendimeve në interes të qytetarëve.

Në mbledjen e parë, duhet të zgjidhet komision për zgjedhje dhe emërime, si komisioni i përhershëm i këshillit. Ky komision, duhet të jep propozim të kandidatëve për kryetar. Kandidatët duhet me qenë nga rradhët e këshilltarëve. Për propozimin votohet. Për kryetar do të zgjedhet ai kandidat, i cili ka fituar shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve.

Mund të paraqiten disa situata, të cilat nuk mund të parashikohen ose të planifikohen. Në raste të tilla, **këshilli** mund të thërret mbledhje të jashtëzakonshme. Në çfarë raste do të mund të thirret mbledhje e jashtëzakonshme e **këshillit** të komunës, duhet të përcaktohet në statutin e komunës. Për shkak të shirave të mëdha, vjen deri te përmbytja e pjesëve të caktuara të komunës, me çka mund të shkaktohet dëm i madh. Këshilli i komunës, në suazat e kompetencave të tyre, në mbledhje të jashtëzakonshme do të sjell dispozitë ose do të ofrojë zgjidhje për tejkalimin e situatës së tillë ose do të propozojë masa të caktuara për sanimin, gjegjësisht për pengimin e zgjerimit të mëtutjeshëm të përmbytjes. Është paraqitur epidemia e ndonjë sëmundjeje ngjitëse në pjesë të caktuar të komunës. Këshilli është ai, që në suazat e kompetencave të tij, duhet të sjell dispozita të caktuara ose të urdhërojë ndërmarrjen e masave konkrete, me çka do të krijohen mundësi për pengimin e zgjerimit të mëtutjeshëm të epidemisë.

Mbledhjen e jashtëzakonshme e thërret **kryetar i këshillit**, me iniciativë të tij ose me kërkesë të $\frac{1}{3}$ të anëtarëve të **këshillit** të komunës. Në informimin për thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme, përcaktohet vendi dhe koha e mbajtjes së mbledhjes. Për dallim të mbledhjeve të rregullta, në të cilat mund të propozohet ndryshimi dhe plotësimi i rendit të propozuar të ditës, në mbledhjet e jashtëzakonshme, rendi i ditës nuk mund të ndryshohet. Në mbledhjen, para fillimit me punë, **këshilltarët** patjetër duhet të votojnë për arsyeshmërinë e thirjes së mbledhjes, si të jashtëzakonshme.

Shembull: nëse në mbledhje kanë qenë prezent 8 prej 15 këshilltarëve, vendimi do të konsiderohet i sjellur, nëse për atë kanë votuar 5 këshilltarë.

Për të punuar **këshilli**, duhet me qenë prezent shumica e **këshilltarëve**. Kështu, nëse **këshilli** ka 15 **këshilltarë**, gjatë mbledhjes, patjetër duhet me qenë prezent 8 anëtarë. Vendimet, që sillen nga ana e **këshillit** sillen me votim publik. Vendimi do të konsiderohet i sjellur, nëse për atë votojnë më shumë se gjysma e anëtarëve, prezent.

Mirëpo, në statutin e komunës mund të parashikohet shumicë e ndryshme për sjellje të disa dispozitave të caktuara.

Këshilli i komunës në suazat e kompetencave të tij sjell dispozita, që kanë të bëjnë edhe me kulturën, përdorimin e gjuhës dhe shkrimit, në të cilën flasin dhe shkruajnë më pak se 20% të qytetarëve të komunës dhe përcaktimin e përdorimit të stemës dhe flamurit të komunës. Këto dispozita do të konsiderohen të sjellura, nëse "për" votojnë shumica e **këshilltarëve** prezent. Gjatë votimit të tillë, patjetër duhet të ketë shumicë të votave nga anëtarët prezent të **këshillit** të komunës - pjesëtarë të bashkësisë, që nuk janë shumicë në komunë.



Puna e mbledhjeve është e hapur. Me këtë ofrohet mundësia për qytetarët, që ju kanë zgjedhur të jenë të informuar për punën dhe vendimet e sjellura, e që janë në funksion të mundësimit të realizimit të së drejtës për vetëqeverisje lokale të qytetarëve. Ka situata dhe çështje për të cilat do të diskutojë **këshilli** i komunës dhe nga të cilat mund të përjashtohet publiku nga mbledhjet.

Për të mos ardhur deri te keq përdorimi i kësaj të drejteje, është e nevojshme të parashikohen këto çështje në statutin e komunës dhe të paraqiten shkaqe të arsyeshme. Edhe përkrah parashikimit të këtyre çështjeve në statut, gjithmonë është e nevojshme sjellja e vendimit nga ana e **këshillit** për përjashtim të publikut. Një vendim i tillë, sillet me dy të tretat e votës nga numri i përgjithshëm i **këshilltarëve**.

Mirëpo, publiku nuk mund të përjashtohet nëse **këshilli** i komunës diskuton për buxhetin e komunës, llogarinë vjetore të buxhetit dhe për planet urbanistike. Në këto raste, përkundrazi, është i nevojshëm publik sa më i madh për të përcjellur qytetarët ku dhe si bëhet harxhimi i të hollavë, që ata i paguajnë nëpërmjet tatimeve, taksave dhe kompenzimeve. Ndërsa është obligim ligjor kyqja e publikut, gjatë sjelljes së planeve urbane.

Shembull: nëse këshilli numëron 15 anëtarë, vendimi për përjashtimin e publikut mund të sillet, nëse për atë kane votuar 10 anëtarë të këshillit.

2.1.6. Ndërprerja e mandatit

Qytetarët ju kanë zgjedhur për anëtarë të **këshillit** me mandat për katër vite. Më lartë treguam se anëtari i **këshillit** nuk mund të shkarkohet nga funksioni. Mirëpo, nëse paraqiten situata të caktuara, mandati i **këshilltarit** mund të ndërpritet edhe para kalimit të 4 viteve. Kështu, mandati i **këshilltarit** do të ndërpritet:

- nëse **këshilltari** jep dorëheqje nga funksioni;
- në rast të vdekjes;
- në rast të dënimit me vendim të plotfuqishëm për kryerje të veprës penale me dënim me burg në kohëzgjatje më tepër se gjashtë muaj;
- nëse **këshilltari** zgjidhet në ndonjërin nga funksionet e përmendura në fillim të këtij kapitulli ose punësohet në administratën e komunës, atëherë do të ndërpritet funksioni i **këshilltarit**;
- mandati i **këshilltarit** do të ndërpritet edhe në rastet kur **këshilltarit**, me vendim të plotëfuqishëm, i është marrur aftësia e veprimit;
- në fund, mandati i **këshilltarit** do të ndërpritet nëse nuk është më banor i komunës, në të cilën është zgjedhur si anëtar i **këshillit**.

Nëse paraqitet ndonjëri nga rastet e mëparshme, **këshilli** në mbledhjen e parë të ardhshme do të konstatojë shkakun dhe ditën e ndërprerjes së mandatit.

Duke pasur parasysh faktin se qytetarët ju kanë zgjedhur për anëtar të **këshillit** për përfaqësimin e intereseve të tyre, duhet të jeni i rregullt në mbledhjet e **këshillit** të komunës. Nëse nuk jeni prezent në tre mbledhje pa shkaqe të arsyeshme, mandati i **këshilltarit** mund të mirret. Arsyeshmërinë e mungesës e vlerëson **këshilli** i komunës dhe sjell vendim me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i **këshilltarëve**.

2.1.7. Shpërndarja e këshillit

Këshilli i konstituar një herë, mund të shpërndahet në rastet kur për shpërndarje do të përcaktohet shumica e **këshilltarëve**. Mirëpo, **këshilli** do të shpërndahet edhe në rastet nëse:

- përsëri do të sjell dispozitën, të cilën paraprakisht Gjyqi Kushtetues i Republikës së Maqedonisë me vendim e ka asgjësuar ose e ka hedhur poshtë;
- sjell vendim, me të cilin çënohet suvereniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Maqedonisë;



- nuk takohet, gjegjësisht nuk mban mbledhje për kohëzgjatje më të gjatë se gjashtë muaj dhe
- nuk sjell buxhetin dhe llogarinë vjetore të buxhetit deri më 31 mars të vitit në rrjedhim.

Në rast të paraqitjes së rasteve të përmendura më lartë, gjegjësisht nëse vjen deri te shpërndarja e **këshillit** të komunës, punët e **këshillit**, deri në zgjedhjen e **këshillit** të ri të komunës do t'i kryen **kryetari i komunës**. Megjithatë, **kryetari i komunës**, gjatë kryerjes së punëve nën kompetencë të **këshillit** të komunës, nuk do të mund të vendosë për çështje, që kanë të bëjnë me:

- konsiderimin e pronësisë së komunës. Kjo do të thotë se nuk mund të sjell vendime për:
- shitje të pronësisë së komunës
- blerje të pronësisë së komunës
- **kryetari i komunës** nuk do të mund të sjell dispozitat, për sjelljen e të cilave është kompetent **këshilli** i komunës;
- poashtu, **kryetari i komunës** nuk do të mund të vendosë kur ai ose bashkëshorti i tij, fëmijët ose farefisi deri në gjeneratën e dytë në linjë anësore, kanë interes financiar ose interes tjetër personal.

2.2. KRYETARI I KOMUNËS

E keni fituar vërtetimin nga ana e Komisionit zgjedhor komunal, me të cilin vërtetohet se në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira, me votim të fshehtë, jeni zgjedhur për **kryetar të komunës**, gjegjësisht për kryetar të Qytetit të Shkupit. Tash është e nevojshme në afat prej shtatë ditëve të merrni detyrën nga kryetari i mëparshëm i komunës. Funkzioni **kryetar i komunës** do të kryhet në mënyrë profesionale. Kjo do të thotë se do të lidhni marrëdhënie të punës në komunë dhe këtu do të realizohen të drejtat dhe obligimet, që rrjedhin nga marrëdhënia e punës. Nga ana tjetër, kjo do të thotë se nuk do të mund të kryeni veprimtari tjetër profesionale.

Duke pasur parasysh kompetencat e dhëna, e ne krahasim me faktin se fjala është për një person, domosdoshëm paraqitet nevoja për përcaktim të personit, që do t'ju zëvendësojë në rastet kur jeni të penguar të kryeni funksionin. Ju keni të drejtë nga rradhët e **këshilltarëve** të përcaktoni një **këshilltar**, që do t'ju zëvendësojë në rastet kur ju do të jeni të penguar të kryeni funksionin. Procedura e përcaktimit të personit, që do t'ju zëvendësojë është përcaktuar me statutin e komunës. Gjatë zëvendësimit juaj nga ana e **këshilltarit**, atij i pushon funksioni i **këshilltarit**. Kjo do të thotë se anëtari i **këshillit**, derisa bën zëvendësimin nuk mund të merr pjesë në punën e **këshillit**, me të drejtat dhe obligimet e **këshilltarit**. Thënë ndryshe, ai nuk mund të merr pjesë në diskutim në lidhje me materialet e as të vendosë, gjegjësisht të votojë. Vetëm **kryetar i këshillit**, nga të gjithë anëtarët e **këshillit** të komunës, nuk mund të përcaktohet të bën zëvendësimin e kryetarit të komunës.

2.2.1. Kompetencat

Kompetencat e kryetarit mund të ndahen në dy pjesë: punëve nën kompetencë të komunës dhe udhëheqja e **administratës komunale**.

Në kryerjen e kompetencave të komunës, **kryetari i komunës**:

- përfaqëson dhe prezenton komunën;
- kontrollon ligjshmërinë e dispozitave të **këshillit** të komunës;
- publikon dispozitat në gazetën zyrtare të komunës;
- siguron kryerjen e vendimeve të **këshillit** të komunës;
- siguron kryerjen e punëve, të cilat me ligj i janë deleguar komunës;



- deri te **këshilli** i komunës, dorëzon iniciativa dhe propozime për sjellje të dispozitave;
- propozon buxhetin dhe llogarinë vjetore të buxhetit të komunës;
- bën realizimin e buxhetit të komunës;
- emëron drejtorë të ndërmarrjeve publike të themeluara nga ana e komunës, me ndihmë të konkursit;
- rregullisht informon **këshillin** e komunës për kryerjen e obligimeve të tij në pajtim me statutin e komunës;
- zgjidh punë administrative për të drejta, obligime dhe interese të personave juridik dhe fizik. Për kryerje të kësaj kompetence, **kryetari i komunës** mund të autorizojë nëpunës, udhëheqës zyrtarë të drejtojnë procedurën dhe të vendosë në punë administrative, si dhe të nënshkruajë.

Drejtimi i administratës së komunës

- jep propozim-vendim deri te **këshilli** i komunës për organizim të administratës së komunës;
- sjell rregullore për sistematizim;
- udhëheq me administratën e komunës;
- vendos për punësim, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj tjetër.

2.2.2. Kontrolli i ligjshmërisë

Mësuam se **këshilli** është organ i komunës, i cili sjell dispozita. Mund të ndodh, që **këshilli** të sjell dispozitë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet. Dispozitat e këtilla mund të shkaktojnë pasoja të dëmshme. Për të penguar hyrjen në fuqi të dispozitës kundër kushtetutare dhe kundër ligjore **kryetari i komunës** në afat prej 7 ditëve nga dita e dorëzimit deri te ai nga ana e kryetarit të **këshillit** të komunës, patjetër sjell vendim për ndalimin e publikimit të dispozitës në gazetën zyrtare të komunës. Vendimi për këtë patjetër duhet të përmbajë shpjegim për shkaqet pse dispozita, që nuk publikohet është në kundërshtim me Kushtetutën ose me ligjet. Në shpjegimin e vendimit, duhet të citohen dispozitat nga Kushtetuta, nëse është fjala për kundërshtim me kushtetutën, gjegjësisht nga ligji, nëse është fjalë për kundërshtim me dispozitat ligjore. Nuk duhet të thuhet në mënyrë të përgjithshme se dispozita e sjellur nga ana e **këshillit** të komunës është në kundërshtim me Kushtetutën ose ligjin, por saktësisht duhet të përmenden nenet e kushtetutës, gjegjësisht ligjit, me të cilët është në kundërshtim dispozita e sjellur nga ana e **këshillit** të komunës. Ky vendim publikohet.

Nëse paraqitet situatë e këtillë, **këshilli** i komunës është i obliguar në afat prej 15 ditë nga dita e publikimit të vendimit, të shqyrtojë vendimin dhe të vendosë në lidhje me vendimin. Janë të mundshme dy zgjidhje:

- a) **këshilli** të pranojë shkaqet e përmendura në vendim dhe të mos e sjell dispozitën ose, nëse ka mundësi, të sjell dispozitën në pëlqim me Kushtetutën ose ligjin;
- b) **këshilli** të mos i pranojë shkaqet e përmendura në vendim dhe të vërteton dispozitën e mëparshme. Nëse ndodh kjo, atëherë **kryetari i komunës** do të publikojë këtë dispozitë në gazetën zyrtare të komunës.

Me këtë nuk ka mbaruar kompetenca e kryetarit të komunës. Tani duhet të dorëzohet iniciativë për fillimin e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitës së sjellur nga ana e **këshillit** të komunës, deri te Gjyqi Kushtetues i Republikës së Maqedonisë, si dhe patjetër të informojë Ministrinë për vetëqeverisje lokale për iniciativën e parashtruar. Informimi i ministrisë nuk është vetëm sa për të plotësuar formalitetin por ka edhe përmbajtjen e saj. Për të mos hyrë në fuqi dispozita me publikimin e saj në gazetën zyrtare të komunës, Ministria ka të drejtë të mbikëqyr ligjshmërinë e dispozitave të komunës dhe nëse konstaton se ndonjë dispozitë nuk është në pajtim me Kushtetutën ose ligj, me vendim mund të ndalojë aplikimin e saj, deri në sjelljen e vendimin nga ana e Gjyqit kushtetues të Republikës së Maqedonisë.



2.2.3. Konflikt i interesave

Si banor i komunës, gjithsesi edhe **kryetari i komunës**, bashkëshorti i tij, fëmija ose farefisi deri në gjeneratën e dytë nga linja anësore, mund të ketë interes financiar ose interes tjetër personal, për të cilin duhet të vendosë ai. Në raste të këtyra, **kryetari i komunës** nuk do të mund të vendosë vetë e as që të merr pjesë në vendimarrjen. Në situatë të tillë ofrohet zgjidhja, si vijon: **kryetari i komunës** është i obliguar të informojë **këshillin** e komunës për çfarë interesi bëhet fjalë, ndërsa **këshilli** do të zgjedh një anëtar, i cili do të vendosë. Zgjedhja e **këshilltarit**, i cili do të vendosë kryhet sipas procedurës së zgjedhjes së kryetarit të **këshillit** të komunës.

2.2.4. Ndërprerja e mandatit

Edhe pse **kryetari i komunës** zgjidhet për katër vjet, mandati i tij mund të ndërpritet edhe më herët. Mandati i **kryetarit të komunës** do të ndërpritet nëse:

- ai vetë jep dorëheqje në funksionin e kryetarit të komunës;
- në rast të vdekjes së tij;
- në rast të gjykimit të tij me dënim me burg në kohëzgjatje më të gjatë se gjashtë muaj, nëse me vendim të plotëfuqishëm i është marrur aftësia e veprimit.
- në rastet kur paraqitet papajtueshmëri e funksionit **kryetar i komunës** me funksionet e numëruara në fillim të këtij kapitulli.
- Nëse ndodh, që **kryetari i komunës** të mungojë më tepër se gjashtë muaj dhe nëse **këshilli** i komunës, me dy të tretat e votave, konstaton se mungesa nuk ka qenë e arsyeshme, kryetarit të komunës do t'i ndërpritet mandati.
- Në fund, mandati i kryetarit të komunës do të ndërpritet nëse ai më nuk është banor i komunës.

Logjikisht paraqitet pyetje: Çka në këto raste? Anëtari i **këshillit** të komunës, i cili zëvendëson kryetarin e komunës, është i obliguar të informojë Ministrinë për vetëqeverisje lokale, e cila më tutje informon Qeverinë e Republikës së Maqedonisë. Qeveria, pas konstatimit të paraqitjes së njërit nga rastet e ndërprerjes së mandatit të kryetarit të komunës, inicon shpallje të zgjedhjeve për zgjedhje të kryetarit të komunës. Për kryerjen e funksionit të kryetarit të komunës deri te zgjedhja e kryetarit të ri, **këshilli** i komunës do të përcaktojë njërin nga anëtarët e **këshillit**, në procedurë të njëjtë sikurse për zgjedhjen e kryetarit të **këshillit** të komunës.

2.3. ADMINISTRATA E KOMUNËS

Për kryerje të obligimeve nën kompetenca të organeve të komunës, themelohet administratë e komunës.

Meqë egzistojnë komuna, të cilat sipas numrit të banorëve, territorit dhe zhvillimit ekonomik të tyre janë të ndryshme, jepet mundësi për ato komuna, që do të gjejnë arsyeshmëri, të sjellin vendime për themelimin ose ndërprerjen e trupit të përbashkët administrativ, gjegjësisht administratës së përbashkët. Vendimi për themelimin të administratës publike do të konsiderohet i sjellur, nëse ka fituar shumicën e votave të secilit **këshill** të komunave. Në bazë të vendimeve, komunat do të nënshkruajnë marrëveshje më shkrim, me të cilën rregullohen çështjet, siç janë: selia e trupit administrativ, lloji, sasia dhe mënyra e kryerjes së aktiviteteve, shfrytëzimi i objekteve dhe pajisjeve, financimi, mënyra e ndërprerjes dhe kontrolli i punës.

Pse është i nevojshëm organizim i administratës së komunës?

Administrata e komunës organizohet për:

- të përgaditur aktet për **këshillin** dhe kryetarin e komunës;
- të përgaditur mbledhjet e **këshillit** të komunës dhe **komisioneve** të tij të përhershëm dhe të përkohshëm;



- të kryer punë profesionale për **këshillin** dhe kryetarin e komunës;
- të udhëhequr kontabilitetin e komunës;
- të përcjellur problematikën nga lëmitë nën kompetenca të komunës, të kryejë analiza të situatës dhe të fillojë iniciativa dhe të parashtojë propozime për zgjedhjen e tyre;
- të dorëzojë informata dhe të dhëna në lidhje me aktivitetet e komunës, me kërkesë të organeve kompetente ose në bazë të ligjit;
- të udhëheqë me dokumentet e komunës, t'i ruan deri te asgjësimi i tyre, gjegjësisht të dorëzimit deri të Arkivi shtetëror i Republikës së Maqedonisë dhe
- të kryejë punë të tjera, që do t'i përcaktojnë **këshilli** dhe **kryetari i komunës**.

2.3.1. Organizimi

Organizimi dhe përcaktimi i organizimit, kompetencat dhe mënyra e kryerjes së detyrave të **administratës komunale**, bëhet më vendim të sjellur nga ana e **këshillit** të komunës, me propozim të kryetarit të komunës. Administrata komunale, duhet të organizohet në seksione dhe njësi. Gjatë përcaktimit të seksioneve, gjithnjë duhet pasur parasysh madhësinë e komunës, zhvillueshmëria e saj, suazat e kompetencave etj. Në çdo rast, **administrata komunale** nuk mund të ketë më pak se dy seksione. Në përbërje të seksioneve, organizohen njësi, numri i të cilave, poashtu, varet nga madhësia e komunës, zhvillueshmëria e saj dhe suazat e kompetencave. Numri i tyre, gjithashtu, nuk mund të jetë më i vogël se dy njësi.

Numri i nëpunësve, kushtet që duhet të plotësojnë, titujt e tyre në pajtim me Rregulloren për përkrahimin e titujve dhe përshtatshmërinë e vendeve të punës me grupet e titujve, të përcaktuar me Ligjin për nëpunësit shtetërorë, si dhe përkrahimi dhe përcaktimi i vendeve të punës dhe detyrave punuese, që duhet të kryejnë, përcaktohen me rregulloren për sistemim, të cilin e sjell **kryetari i komunës**.

Administrata komunale organizohet për kryerjen e punëve nën kompetenca të **këshillit** dhe kryetarit të komunës. Nga sukcesi dhe efikasiteti i **administratës komunale** në masë të madhe varet edhe sukcesi dhe efikasiteti i organeve të komunës. Për këtë shkak, shumë shkurt do t'ju njoftojmë më statusin e të pnësuarve në **administratën komunale**, punësimin, të drejtat dhe obligimet e nëpunësve shtetërorë, rogat dhe kompenzimet e rrogave, përparimin, vlerësimin dhe përgjegjësinë.

2.3.3. Statusi i të punësuarve

Të punësuarit në **administratën komunale**, që kryejnë punë profesionale, normativo-juridike, egzekutive, administrativo-drejtuese dhe zgjidhin punë administrative, kanë status të nëpunësit zyrtar.

Me fitimin e statusit të nëpunësit zyrtar për të punësuarit në **administratën komunale** në pjesën e punësimin, të drejtave dhe obligimeve, sistemin e rrogave dhe kompenzimeve të rrogave, përgjegjësisë, vlerësimin dhe ndërprerjes së punësimin, do të aplikohen dispozitat e Ligjit për nëpunës shtetëror.

Këtu mund të paraqitet pyetja nëse të gjithë të punësuarit në **administratën komunale** kanë statusin e nëpunësit shtetërorë.

Përgjigja mund të gjendet në vetë nocionin nëpunës shtetëror. Nëpunës shtetëror është personi, që kryen punë profesionale, normativo-juridike, egzekutive, administrativo-drejtuese dhe zgjidh punë administrative në pajtim me këtë ligj. Nga ky definicion i nëpunësit shtetëror, mund të konkludohet se të punësuarit në **administratën komunale**, që kryejnë punë administrativo-teknike ose punë ndihmëse nuk kanë **status të nëpunësit shtetëror** dhe për të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre vlejnjë dispozitat e ligjëdhënies punuese. D.m.th., jo të gjithë të punësuarit na **administratën komunale**, kanë **status të nëpunësve shtetëror**.

Rregullimi i të drejtave, obligimeve dhe përgjegjësisë, si dhe punësimi dhe vlerësimi i nëpunësve shtetërorë me ligj të posaçëm, do të thotë ndarje e tyre nga të punësuarit e tjerë për shkak të specifikës së punës, që e



kryejnë. Me zgjidhje të këtyllë, nëpërmjet afirmimit të parimeve të **administratës komunale**, profesionale, të depolitizuara, efikase dhe të përgjegjshme, sigurohet ofrim i shërbimeve për qytetarët në kohë dhe me kualitet. Kjo zgjidhje, jep mundësi administrata publike me qenë shërbyes i vërtetë i qytetarëve.

2.3.3. Klasifikimi i nëpunësve shtetëror

Nga përgjigja e pyetjes pse është i nevojshëm organizmi i **administratës komunale**, u konstatua se punët, që ajo do të kryejë janë të domosdoshme për funksionimin e organeve komunale. Poashtu, shihet se funksionet e komunës nuk janë të njëjta por dallohen. Për disa është e nevojshme aftësi dhe profesionalitet më i madh, ndërsa për disa-aftësi dhe profesionalitet më i vogël.

Për shkak të gjithë kësaj, është bërë klasifikim i nëpunësve shtetëror dhe ata janë të klasifikuar në tre grupe:

- nëpunës udhëheqës shtetëror;
- nëpunës profesional shtetëror;
- nëpunës profesionalo-administrativ shtetëror.

Gjatë kryerjes së këtij klasifikimi, janë marrur parasysh dy kriteriume. Njëri, që ka të bëjë me karakterin e detyrave zyrtare, gjegjësisht karakterit të punëve, që do të kryejnë dhe kriteriumi i dytë është arsimit.

Nëpunësit shtetëror, që janë në grupin e parë dhe të dytë, gjegjësisht që janë nëpunës udhëheqës shtetëror dhe nëpunës profesional shtetëror, patjetër duhet të kenë arsim të lartë. Është normal për të punësuarit në këto dy grupe të kërkohet arsim i lartë, sepse ata janë bartës të kryerjes së funksioneve të komunës.

Nëpunësit shtetëror të grupit të tretë është e nevojshme të kenë arsim të mesëm, sepse ata kryejnë punë më të thjeshta.

Në grupin e nëpunësve udhëheqës shtetëror, bëjnë pjesë: sekretari gjeneral, sekretari shtetëror, **këshilltari** shtetëror, udhëheqësi i seksionit, ndihmës i udhëheqësit të seksionit dhe udhëheqësi i njësisë. Në **administratën komunale**, si nëpunës udhëheqës shtetëror janë: udhëheqësi i seksionit, ndihmës i udhëheqësit të seksionit dhe udhëheqësi i njësisë.

Në grupin e nëpunësve profesional shtetëror, bëjnë pjesë nëpunësit me titujt, si vijon: **këshilltar**, bashkëpunëtor i lartë, bashkëpunëtor dhe bashkëpunëtor i ri.

Në grupin e tretë, gjegjësisht në grupin e nëpunësve profesionalo-administrativ shtetëror, bëjnë pjesë nëpunësit me titujt, si vijon: referent i pavarur, referent i lartë, referent dhe referent i ri.

Me këtë klasifikim, është paraqitur strukturë e njëjtë e titujve në organet e pushtetit. Janë paraparë 13 tituj, që mund të hasen në strukturën hierarkike të çfarëdo organi të pushtetit ligjvënës, egzekutiv dhe juridik, ndërsa në pushtetin lokal 10 titujt, pa sekretar gjeneral, sekretar shtetëror dhe **këshilltar** shtetëror.

2.3.4. Punësimi

Një person, që të mund të punësohet në **administratën komunale** si nëpunës shtetërorë, duhet të plotësojë disa kushte, të caktuara me ligj.

Si nëpunës shtetëror mund të punësohet person, i cili është nënshkretar i Republikës së Maqedonisë, i moshës madhore, me shkallë adekuata të arsimit, me përvijë të duhur punuese (përveç për titujt bashkëpunëtor i ri

Shembull: Duhet të përpunohet analizë e caktuar e situatës, me realizimin e planeve urbane. Këtë analizë do ta bëjnë nëpunësit shtetëror, që kanë mbaruar fakultet të arkitekturës ose ndërtimtarisë dhe që kanë përvijë të duhur punuese. Këta persona, duke pasur parasysh se realizojnë planet, mund të bëjnë analizë kualitative dhe, në bazë të kësaj të propozojnë ndërmarrjen e masave adekuate në kuptim të fillimit të procedurës për ndryshim ose plotësim të planit ose të konstatojnë se plani urbanistik është i mirë dhe ka hapësirë për realizim të mëtejshëm të tij.

Shembull: Është filluar procedurë administrative për realizimin e së drejtës së caktuar. Procedurën do ta udhëheq personi, i cili ka arsim të lartë nga lëmia përkatëse, sepse ai e njihet atë problematikë, e njeh situatën, i njihet dispozitat, me të cilat rregullohet ajo lëmi dhe do të propozojë të sillat vendim i drejtë.



dhe referent i ri), të mos i është kallëzuar masa e sigurisë për ndalim të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe me aftësi të përgjithshme shëndetësore. Përveç këtyre kushteve të përgjithshme në aktin e sistematizimit, mund të parashihen edhe kushte të tjera plotësuese si psh. njohja e gjuhës së huaj, njohja e punës me kompjuter, etj.

Punësimi mund të realizohet vetëm sipas procedurës së paraparë më ligj. Kjo procedurë fillon me dorëzimin e kërkesës për nevojë për punësim, deri te Agjensioni për nëpunës shtetëror; nëpërmjet publikimit të shpalljes nga ana e Agjencionit; dhënies së provimit profesional (përveç për bashkëpunëtorë të ri dhe referent të ri); përpilimin e listës së kandidatëve, të cilët e kanë dhënë provimin profesional; seleksionimin nga ana e komisionit dhe zgjidhjes nga ana e **kryetarit të komunës**, si funksioner, i cili udhëheq me **administratën komunale**.

2.3.5. Të drejtat e nëpunësve shtetërorë

Nëpunësit shtetëror kanë të drejtë për aktivitet politik, që shprehet nëpërmjet anëtarësisë në parti politike, si mundësi për veprim politik. Meqë më lartë në tekst thamë se **administrata komunale** duhet të jetë shërbyes i qytetarëve, kjo e drejtë ka kufizime të caktuara.

Nëpunësit shtetëror kanë të drejtë të themelojnë sindikate, kanë të drejtën e grevës, të drejtën e mbrojtjes, të drejtën dhe obligimin të aftësohen profesionalisht, të drejtën e pushimit dhe mungesës, si dhe të kërkojnë mbrojtje të drejtave të tyre.

2.3.6. Obligime

Nëpunësi shtetëror është i obliguar të kryen punët me ndërgjegjshmëri, profesionalitet dhe në mënyrë efikase, në rregull dhe në kohë, në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe statutin e komunës. Nëpunësi shtetëror është i obliguar të kryej punët në mënyrë të pa anshme dhe pa shtypje dhe ndikime nga partitë politike. Gjatë kryerjes së punëve, të mos udhëhiqet nga bindjet e tij politike, nga interesat personale financiare, të mos bën keqpërdorimin e autorizimeve dhe statusin, që e ka si nëpunës shtetëror dhe të mbrojtë dinjitetin e organit, në të cilin punon.

Nëpunësi shtetëror është i obliguar të kryejë urdhërat e funksionerit, që udhëheq me organin, gjegjësisht të nëpunësit shtetëror që është i mbicaktuar në hierarki dhe të respektojë ato urdhëra në pajtim me Kushtetutën, ligjin dhe statutin e komunës ose në pajtim me dispozitë tjetër. Nëpunësi shtetëror, nëse konsideron se urdhëri i dhënë nuk është në pajtim me Kushtetutën, ligjin, statutin e komunës ose në nuk është pajtim me dispozitë tjetër, është i obliguar për këtë të njohtëj personin, i cili e ka urdhëruar. Nëse urdhëri i njëjtë është i dhënë në formë të shkruar, nëpunësi shtetëror do të silltet sipas tij, përveç kur ai konsideron se kryerja e urdhërit paraqet vepër penale. Në rast të këtillë, menjëherë informon nëpunësin shtetëror, që është drejtëpërdrejtë i mbicaktuar i nëpunësit, që ka dhënë këtë urdhër.

Obligime tjera të nëpunësit shtetëror, janë: të ruan sekretin shtetëror dhe sekretin profesional dhe, nëse punon me palë të mbajë në vete të shënuar emrin dhe titullin.

2.3.7. Avansimi dhe sistemi i rrogave

Nën avansim kuptohet mundësia e nëpunësit shtetëror të fitojë titull, që është më i lartë se titulli që ka. Nëse nëpunësi shtetëror është me titull bashkëpunëtor i lartë, avansim do të ketë nëse kalon në titullin **këshilltar**,

Gjegjësisht:

- me anëtarësimin e tij në parti politike dhe me pjesëmarrjen e tij në aktivitetet partiake, nëpunësi shtetëror nuk guxon të vendos në pyetje statusin e tij të nëpunësit shtetëror dhe as detyrat, që rrjedhin si pasojë e atij statusi.
- nëpunësi shtetëror edhe pse është anëtar i partisë politike, nuk guxon në mënyrë direkte të merr pjesë në kampanjat zgjedhore ose paraqitje tjera publike të këtij lloji, gjatë kohës së punës.
- nëpunësi shtetëror-anëtar i partisë politike nuk guxon të mbajë ose të paraqet simbollet e partisë politike të tij në hapësirat e tij punuese.



sepse në hierarkinë titulli **këshilltar** është më lartë i ranguar se titulli **këshilltar** i lartë. Kushti themelor për avansimin e nëpunësit shtetëror është egzistimi i vendit të zbrazët me titull më të lartë. Më tutje, për këtë vend të zbrazët, ashtu si edhe për çdo vend tjetër, publikohet shpallje. Të drejtë për tu paraqitur, përveç nëpunësit shtetëror të punësuar me titull më të ulët, kanë edhe secili person tjetër, që punon në sektorin publik ose privat. Nëpunësi shtetëror, së bashku me të gjithë kandidatët e lajmëruar, që i plotësojnë kushtet, jep provim profesional. Rezultatet e provimit të dhënë profesional, janë bazë për rangimin dhe përpilimin e listës së kandidatëve më të suksesshëm. Nëse nëpunësi shtetëror zgjidhet në këtë munëyrë, kjo do të thotë edhe avansim të tij.

Nëpunësit shtetërorë kanë të drejtë për rrogë, çështje që është e rregulluar në mënyrë sistimore dhe vlen për tërë kategorinë e nëpunësve shtetëror. Rroga e nëpunësve shtetëror përbehet prej dy komponentave: komponenta themelore dhe komponenta e veçantë.

Komponentën themelore e përbëjnë: rroga themelore, shtesa e rrogës për titull dhe shtesa e rrogës për karrierë.

Rroga themelore përmban poena për arsimim dhe është e paraparë, që për arsimim të lartë (fakultet) 200 pika, (shkollë normale) 150 pika dhe për arsimim të mesëm 100 pika. Në këtë poenë llogaritet edhe puna e kaluar.

Shtesa e rrogës për titull i përmban poenët për çdo titull dhe është e përcaktuar me ligj.

Shtesa për karrierë vlerëson profesionalitetin e secilit nëpunës shtetëror për çka, paraprakisht, duhe të plotësohen kushte të caktuara. Është e nevojshme të fitohet vlerësim pozitiv për punën e nëpunësit shtetëror dhe stazh minimum në shërbimin shtetëror.

Komponenta e veçantë, përbëhet prej: shtesës së rrogës për kushte të veçanta dhe shtesës së rrogës për punë jashtë orarit punues.

2.3.8. Përgjegjësia

Vërejtëm se detyrat e nëpunësve shtetëror janë të bazuar mbi parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, efektivitetit, ekonomitetit, transparencës, neutralitetit, jodiskriminimit, barazisë, drejtësisë dhe sigurisë. Mospërmbajtja ndaj këtyre parimeve, gjegjësisht moskryerja e obligimeve të nëpunësve shtetëror, sjell si pasojë përgjegjësi.

Përgjegjësia mund të jetë disiplinore dhe materiale. Te përgjegjësia disiplinore, lëndimi mund të paraqitet si parregullësi disiplinore (normë më e lehtë) dhe kundërvajtje disiplinore (normë më e rëndë).

Nëse nëpunësi shtetëror gjatë kryerjes së punëve të tij, ka shkaktuar dëm ndaj organit ku punon ose ndaj personit të tretë, ai do të përgjigjet materialisht në pajtim me dispozitat e Ligjit për nëpunës shtetëror.

2.3.9. Vlerësimi

Vlerësimi bëhet për të fituar vlerësim objektiv për nëpunësin shtetëror, për punën e tij, për kontributin, efikasitetin, kualitetin dhe profesionalitetin në kryerjen e detyrave zyrtare.

Vlerësimi bëhet për çdo vit, më së voni deri në fund të kalimit të tre mujorit të parë në vitin e ardhshëm, për vitin e kaluar.

Vlerësimi bëhet në bazë të të dhënave për kriteriumet për vlerësim (siç janë: njohuria dhe aftësia profesionale, rezultatet e arritura në punë, kreativitet dhe aftësi, etj.) dhe punët e kryera gjatë vitit të kaluar. Gjatë vlerësimit, mund të jepen notat, si vijon: "dallohët", "kënaq" dhe "nuk kënaq".

2.3.10. Ndërprerja e marrëdhënies së punës

Përveç rasteve të parashikuara në Ligjin për marrëdhënie të punës, marrëdhënia e punës, nëpunësit shtetëror i ndërpritet:



- nëse është i gjykuar për vepër penale në lidhje me detyrën zyrtare ose vepër tjetër penale, që e bën të padenjë për nëpunës shtetëror, me ditën e dorëzimit të gjykimit të plotëfuqishëm;
- në rast kur nëpunësi shtetëror-praktikant nuk e kalon provimin për praktikant;
- në rast kur nëpunësi shtetëror nuk e pranon vendosjen e tij në vend tjetër të punës, si pasojë e vlerësimit vjetorë të fituar - "nuk kënaq";
- në rast të heqjes ose bashkimit të organit, zvogëlimit të kompetencave, zvogëlimit të sasisë së punës ose ndryshimit në organizimin e brendshëm me heqjen e vendeve të punës për shkak të ndryshimeve strukturale, nëpunësi shtetërorë nuk vendoset në organin e njëjtë në vend të njëjtë ose më të ulët të punës ose nëse e refuzon këtë vendosje.

Fjalë kyqe: këshill, kryetar i komunës, komisione; kryetar i këshillit, komision për marrëdhënie me bashkësitë, administratë komunale; status të nëpunësit shtetëror

Korniza ligjore:

- Ligji për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 5/02);
- Ligji për nëpunës shtetëror ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 59/00, 112/00, 34/01, 103/01, 43/02, 98/02, 17/03, 40/03 dhe 17/04).





3 | FINANCIMI DHE BUXHETI

Ace Kocevski

"Duam kushte më të mira për jetesë në komunën tonë. Do të sigurojmë kushte më të mira për qytetarët."

Gjithësi se secili prej jush, të respektuar këshilltar dhe kryetarë të komunave do të mundohet të plotësojë këto kërkesa të qytetarëve, të cilët i prezenton. Për këtë, mbani vëmendjen pak më gjatë në këtë pjesë, i cili ka të bëjë me financimet dhe buxhetimit, që të shihni se, si mund të kontribuoni për plotësimin e kërkesave të tilla, me ndihmën e këtyre instramenteve.

3.1. SISTEMI I FINANCIMIT PUBLIK LOKAL

Formimi i sistemit adekuat për financimin e njësive të vetëadministrimit lokal, është njëra ndër punët më të rëndësishme në procesin e decentralizimit dhe, përgjithësisht, në reformën e sistemit të vetëqeverisjes lokale. Është e vërtetë se fitimi i kompetencave të mëdha, pa sigurimin e mjeteve të nevojshme për realizimin e tyre me sukses, më tepër është barrë se drejtësi.

Me aprovimin e regullativës së re ligjore, u krijuan parakushte për krijim të sistemit financiar objektiv, transparent, stabil dhe të drejtë. Posaçërisht është i rëndësishëm krijimi i baraspeshës adekuate në mes madhësisë së komunës, fuqisë së saj ekonomike dhe të gjithë kapacitetet, nga njëra anë dhe suazat e kompetencave, që do t'i kryen komuna, nga ana tjetër. Është me rëndësi të madhe implementimi i nenit 9 të Konventës evropiane për vetë administrim lokal të Këshillit të Evropës, posaçërisht:

- burimet e mjeteve me qenë në baraspeshë me obligimet e reja;
- një pjesë e burimeve të rrjedh nga taksat dhe kompenzimet lokale, niveli i të cilëve do të përcaktohet nga ana e tyre, në suazat e ligjit;
- burimet e mjeteve me qenë të mjaftueshëm dhe elastik;
- të implementohet barazi financiare për mbrojtje të komunave, financiarisht më të dobëta dhe komunat të jenë të konsultuara gjatë ndarjes së mjeteve;
- mjetet, që ju barten komunave, të mos kenë karakter të mjeteve të parapërcaktuara, varësisht prej mundësive dhe
- komunat të kanë qasje në tregun nacional të kapitalit.

Me sistemin duhet të sigurohet autonomi e komunave dhe e drejta për udhëheqje të politikës në suazat e kompetencave të tyre.



3.2. BUXHETI

Buxheti është dokumenti më i rëndësishëm, të cilin këshilli i komunës e sjell në suazat e një viti. Ai është plan vjetor për financimin e funksioneve dhe obligimeve të njësive të vetëqeverisjes lokale i përbërë nga përkrahimi vjetor i të ardhurave (burime dhe harxhime), sipas dedikimit paraprak. Me **buxhetin**, përcaktimet e komunës, konkretizohen në numra.

Buxheti, jo vetëm që definon mënyrën e harxhimit të të hollave por është edhe plan, me të cilin përcaktohen prioritetet e komunës. Përcaktohet çfarë, sa dhe cilat projekte do të realizohen, gjatë vitit.

Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, **buxhetin** për vitin e ardhshëm e sjell këshilli i komunës, me propozim të kryetarit të komunës, më së voni deri më 31 dhjetor të vitit në rrjedhë.

Nëse këshilli i komunës për çfarëdo arsye nuk e sjell **buxhetin** në afatin e caktuar, është i obliguar të sjell vendim për financim të përkohshëm dhe plan financiar për realizimin e tij për çerekun e parë të vitit.

Buxheti i komunës përgaditet sipas Ligjit për **buxhet** dhe udhëzimet e dhëna nga ana e ministrit të financave. Buxheti i komunave patjetër duhet të jetë i balancuar, gjegjësisht nuk është i lejuar deficioni. Komuna është e obliguar, në afat prej 15 ditëve nga dita e sjelljes së **buxhetit**, të dorëzoj **buxhetin** e aprovuar deri te Ministria e financave për shkak të përcjelljes së harxhimeve të përgjithshme publike në vend.

Gjatë sjelljes së **buxhetit**, këshilli i komunës patjetër sjell edhe vendim për egzekutimin e **buxhetit**.


Është me rëndësi të potencohet se mjetet e **buxhetit** duhet të harxhohen sipas dedikimit dhe sipas shumës së përcaktuar. **Buxhetimi** është proces i planifikimit dhe shpërndarje e të ardhurave të komunës, sipas prioriteteve të përcaktuara për kënaqjen e nevojave dhe kërkesave.

Procesi fillon, më së voni, deri më 30 shtator deri kur ministri i financave dorëzon cirkular buxhetor, me të cilin komunat lajmërohen për indikatorët themelor makroekonomik, drejtimet kryesore për përgaditjen e **buxhetit**, **dotacionet** për komunë, që do të transferohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, nga **buxhetet** e fondeve, si dhe nga të ardhurat prej burimeve tjera.

Buxhetimi kryhet në faza në afate të përcaktuara me kalendarin buxhetor të sjellur nga këshilli i komunës.

Kryetari i komunës dorëzon drejtimet kryesore për sjelljen e **buxhetit** deri te shfrytëzuesit e **buxhetit**. Pastaj, shfrytëzuesit e **buxhetit** dorëzojnë planet financiare të tyre deri te kryetari i komunës, ndërsa ai e dorëzon propozim-buxhetin deri te këshilli i komunës.

Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e krijimit të **buxhetit** të komunës është shumë e rëndësishme. Pa qeveri të hapur, nuk ka shoqëri demokratike.





Levërdia është e dyanshme, sepse:

- qytetarët marrin pjesë në përcaktimin e prioriteteve, e pastaj në kontrollin gjatë realizimit të tyre;
- qeveria e provon drejtësinë e politikës së tyre dhe përforcon besimin në mes qytetarëve.

Kjo më së miri bëhet me dorëzimin e informacioneve paraprake deri te të gjithë të interesuarit për **buxhetin**, me lutje për paraqitjen e mendimit të tyre. Pastaj, me organizim të tribunave publike në bashkësitë lokale dhe urbane për shoqatat e qytetarëve, institucioneve nga lëmia e arsimimit, mbrojtjes sociale, kulturës, sportit në lidhje me projekt-buxhetin..

Pas mbarimit të diskutimit publik dhe përfshimit të propozimeve të vyeshme në tekst, propozim-buxheti dorëzohet deri te këshilli për aprovim.

Gjatë vitit fiskal, nëse të ardhurat dhe harxhimet nuk realizohen sipas planit, kryetari i komunës i propozon këshillit të komunës ndryshime dhe plotësime të **buxhetit**.

Për realizimin e **buxhetit**, përgjigjet kryetari i komunës.

Rezerva buxhetore për financimin e harxhimeve të pa planifikuara, nuk mundet me qenë më tepër se 3% të **buxhetit**.


Të gjithë shfrytëzuesit e **buxhetit**, deri te kryetari i komunës, dorëzojnë raporte mujore për realizimin e planeve të tyre financiare, kurse kryetari i komunës, deri te Ministria e financave dhe këshilli i komunës, dorëzon raport për realizimin e **buxhetit**, pas secilit çerek të vitit në rrjedhim.

Këshilli i komunës pas skadimit të vitit fiskal, sjell llogari vjetore të **buxhetit** për vitin paraprak, me propozim të kryetarit të komunës më së voni deri me 15 mars. Llogaria vjetore e aprovuar nga ana e këshillit të komunës dorëzohet deri te Ministria e financave më së voni deri me 31 mars të vitin në rrjedhim.

Si shembull mund të përmend përvojën pozitive të Komunës së Velesit, e cila, tanimë dy vjet, publikon 14.000 egzemplarë të Raportit vjetor për punën e komunës dhe e dorëzon deri te secila familje.

Këshilli i komunës, aprovon edhe raport vjetor, që përbëhet nga:

- llogaria vjetore;
- raporti për mjetet, kërkesat, obligimet dhe burimet e mjeteve dhe vlerën e tyre;
- raporti për realizimin e programeve për investim, **dotacioneve** dedikuere, **dotacioneve kapitale**, **blok-dotacioneve** dhe **dotacioneve** për kompetencat e deleguara, dhe
- raporti nga kontabilisti përgjegjës, me të cilin ai e vërteton saktësinë dhe besueshmërinë e llogarisë vjetore.



Komunat për punën e tyre përgjigjen vetëm para qytetarëve të tyre, për të cilët edhe egzistojnë. Qytetarët, gjegjësisht të obliguarit tatimor patjetër duhet të dijnë ku, si, sa dhe për çka harxhohen të hollat e tyre, që në baza të ndryshme hyjnë në **buxhetin** e komunës.

Transparenca, përgjegjësia dhe llogarishmëria janë të rëndësisë së veçantë. Komunat kanë obligim t'ju prezantojnë raporte qytetarëve të tyre për të ardhurat dhe harxhimet e planifikuara dhe realizuara dhe për projektet e realizuara, me qëllim që qytetarët të mund të vlerësojnë si punon qeveria lokale.



3.3 FINANCIMI I KOMUNAVE

Sigurimi i mjeteve financiare është shumë i rëndësishëm për krijimin e kushteve për realizimin e kompetencave. Iidetë e mëdha nuk vlejnë asgjë, nëse nuk kanë mbështetje financiare.

Kryetarët e komunave gjatë kohës së punës, janë të angazhuar në kërkimin e mbështetjes për projektet, gjetjen e partnerëve, sigurimin e fondeve etj.

3.3.1 Burimet e financimit

Komunat financohen nga burimet e tyre të të ardhurave, nga **dotacionet** prej **buxhetit** qendror, nga **buxhetet** e fondeve dhe me huazim.

Burimet personale të të ardhurave janë të ardhura, që sigurohen nëpërmjet **tatimeve lokale**, taksave lokale, kompenzimeve lokale dhe nga të ardhurat nga pronësia. Në **tatimet lokale** bëjnë pjesë: tatimi i pronësisë; tatimi i trashigimisë dhe dhuratës; tatimi i qarkullimit të patundshmërive dhe tatime tjera lokale të përcaktuara me ligj.

Taksa lokale, janë: taksat komunale, taksat administrative dhe taksa tjera lokale të përcaktuara me ligj.

Kompenzime lokale, janë: kompenzimet për rregullimin e tokës ndërtimore, kompenzimet prej veprimtarisë komunale dhe kompenzimet për planet hapësinore dhe urbane dhe kompenzime tjera lokale të përcaktuara me ligj.

Komuna mund të realizojë të ardhura edhe prej: pronësisë (të ardhura nga qiraja, të ardhura prej interesit dhe të ardhura nga shitja e pronësisë), donacioneve, nga dënimet me të holla të përcaktuara me ligj, të ardhura nga vetëkontributi dhe të ardhura të përcaktuara me ligj.

Shembull: tatimi personal i të ardhurave të të punësuarve në Shkup, të cilët jetojnë në Veles, si dhe të punësuarve në organet shtetërore, instucionet dhe ndërmarrrjet me seli në Shkup (Armata e Republikës së Maqedonisë, Ministria e punëve të brendshme, Ministria e arsimit, Ministria e shëndetsisë, Hekurudhat e Maqedonisë, Elektroekonomia e Maqedonisë, Telekomunikacioni i Maqedonisë), të cilët jetojnë në Veles, janë të ardhura të Velesit.

Komuna nuk ka të drejtë të shesë pronësinë, me tjetërsimin e së cilës mund të çrregullohet kryerja e funksioneve publike dhe autorizimet e komunës.

Komuna, sikurse në shumë shtete tjera, realizon një pjesë të të ardhurave edhe nga tatimi personal i të ardhurave - 3% nga tatimi personal i të ardhurave personale nga rrogat e personave fizik, që jetojnë dhe banojnë në komunën dhe tërë sasinë e tatimit personal të të ardhurave të personave fizik, që merren me veprimtari artizanati, sipas vendit të regjistrimit të veprimtarisë.

Të ardhurat nga donacionet në formë të mjeteve financiare, janë të ardhura të **buxhetit**, ndërsa donacionet në sende evidentohen si pronë e komunës. Në periudhën e tranzicionit, donacionet ishin shumë të rëndësishme për komunat. Kështu do të jetë edhe për një kohë të caktuar. Por, për zhvillim afatgjatë dhe stabil të komunave, patjetër duhet të krijohet sistem i qëndrueshëm dhe i bazuar në burime stabile dhe të qëndrueshme të të ardhurave.

Me shpalljen e vetëkontributit nëpërmjet referendumit, mund të sigurohen mjete për plotësimin e nevojave të caktuara të qytetarëve. Në të kaluarën vetëkontributet ishin të shpeshtë dhe, duke i faleminderuar vetëkontributeve, janë ndërtuar shumë objekte të rëndësishme komunale. Referendumi tanimë është i rrallë për shkak të situatës së rëndë ekonomike dhe sociale, papunësisë së madhe dhe zvogëlimit të fuqisë blerëse. Vitin e kaluar, vetëkontribut kishte vetëm në komunën e Kavadarçës për zgjidhjen e problemit të furnizimit me ujë dhe për ndërtimin e infrastrukturës tjetër komunale, që është për tu lavdëruar.

Nga Buxheti i Republikës dhe nga **buxhetet** e tjera, sigurohen të ardhura plotësuese, në formë të **dotacioneve** për financimin e kompetencave të përcaktuara me ligj dhe për realizimin e projekteve për investime kapitale.

Të ardhurat në lartësi prej 3% të tatimit të vlerës së shtuar, përgjithsisht të mbledhura në vitin paraprak fiskal, do të shpërndahen sipas numrit të banorëve dhe kriteriumeve tjera të përcaktuara me urdhëresë. Këto mjete, kanë karakter të mjeteve për barazim financiarë të komunave. Komunat kanë të drejtë vetë të vendosin për harxhimin e këtyre mjeteve.



Dotacione të dedikuara shpërndahe nëpër komuna, projekte dhe institucione ose programe, prej Ministrisë së financave, sipas propozimit të ministrive kompetente dhe fondeve për financimin e aktivitetit konkret.

Për financimin e projekteve të investimit, jepet **dotacion kapital** në bazë të programit të caktuar nga ana e Qeverisë. Komunitat për projekte, që i tejkalojnë mundësitë e komunave, duhet të përgadisnin projekte kualitative, me konstruksion financiar krejtësisht të mbyllur.

Blok **dotacioni** përcaktohet për financimin e kompetencave të komunës në lëminë e kulturës, sportit dhe rekreimit, shkollimin fillor dhe të mesëm dhe mbrojtjen primare shëndetësore. Paraprakisht, ministritë dhe fondet kompetente, përgadisnin metodologji për përcaktimin e kriteriumeve të shpërndarjes. E rëndësishme është të dihet se lartësia e **dotacionit** nuk mundet të jetë për projekte, që i tejkalojnë mundësitë e komunave më e madhe nga shumata e mjeteve të Buxhetit të Republikës, që janë shfrytëzuar për këtë lëmi në vitin e kaluar.

Për financimin e të ashtuquajturave kompetenca të deleguara, që ndonjë organ i administratës shtetërore do t'ia besojë kryetarit të komunës, shfrytëzohet **dotacion për kompetencë të deleguar**, që sigurohet nga mjetet e organit në Buxhetin e Republikës.

3.3.2. Përcjellje e zhvillimit të sistemit të financimit të komunave

Koha është dëshmitari dhe gjykuesi më i mirë për gjithçka. Sistemi për financimin e komunave, që u përcaktua me decentralizimin e pushtetit, i nënshtrohet testit të kohës. Duhet të përcillet zhvillimi i tij dhe aplikimi i kriteriumeve për shpërndarjen e **dotacioneve**. Sistemi duhet të përmirësohet dhe përsoset me ndërmarrjen e masave konkrete për tejkalimin e mungesave.

Për këtë qëllim, si dhe për përcjelljen e transparencës së procedurave, përgaditjen e raporteve, përgaditjen e masave dhe propozimeve, përcjelljen e shfrytëzimit të **dotacioneve**, sipas dedikimit, Qeveria formon Komisionin për përcjelljen e zhvillimit të sistemit të financimit të komunave.

Në Komisionin, përveç përfaqësuesve të Ministrisë për vetëqeverisje lokale, Ministrisë për financa dhe Ministrisë për punë dhe politikë sociale, anëtarë janë edhe pesë përfaqësues të komunave të propozuar nga Bashkësia e njësive të vetëqeverisjes lokale.

3.4. PËRCAKTIMI DHE Mbledhja e të ardhurave të komunave

Administrata komunale është e autorizuar për përcaktimin dhe mbledhjen e të ardhurave të komunës. Komuna, që nuk ka kapacitet për administrimin e të ardhurave personale ose nuk mund të përcaktojë dhe mbledh të ardhurat e saja, mund të lidh kontratë me komunë tjetër ose me Drejtorinë për të ardhura publike.

Çdo komunë duhet të ketë, së paku, tre persona të punësuar në administratën komunale të kualifikuar për përcaktimin dhe mbledhjen e tatimeve për të marrur mbi vete kryerjen e kësaj pune.

I obliguari me tatim të pronës deri me 31 janar të vitit, për të cilin kryhet përcaktimi i tatimit, patjetër duhet të dorëzojë lajmërim tatimor për pronë të re ose për ndryshimet eventuale të të dhënave në lajmërimin tatimor, që ka dorëzuar më parë.

Kryetari i komunës sjell vendim për lartësinë e tatimit të pronës dhe e dorëzon deri te të ngarkuarit me këtë tatim, më së voni deri me 31 mars.

Niveli i tatimit të pronësisë është prej 0.10% deri 0.20%, ndërsa niveli i tatimit të qarkullimit të patundshmërive është prej 2% deri 4%.

Vërejtje:

Urdhëresa për metodologjinë e shpërndarjes së të ardhurave nga tatimi i vlerës së shtuar, e sjellur nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, me propozim të ministrit për financa dhe me pëlqim paraprak të Komisionit për përcjelljen e zhvillimit të sistemit për financim të komunave, më së voni deri me 30 qershor të vitit në rrjedhë për vitin e ardhshëm, është akt shumë i rëndësishëm.

Ministri i financave, është i obliguar të informon secilën komunë për llojin dhe lartësinë e dotacionit për vitin e ardhshëm buxhetor, me cirkular buxhetor më së voni deri me 30 shtator të vitit në rrjedhë.

Ministritë dhe fondet kompetente, janë të obliguar, më së voni deri me 30 prill të vitit në rrjedhë, të publikojnë kriteriumet e përcaktuara, procedurat dhe afatet për shpërndarjen e dotacioneve dedikuese dhe dotacioneve kapitale.



Niveli i tatimit të trashigimit dhe dhuratës për rendin e parë të trashigimisë, është prej 2% deri 3%, ndërsa për rendin e dytë të trashigimisë, prej 4% deri 5%.

Shembull:
taksa komunale paguhen për secilën ndërmarrje të regjistruar, për shfrytëzimin e sipërfaqeve të parqeve, shfrytëzimin e hapësirave para objekteve afariste, paraqitjen e reklamave, shfrytëzimin e muzikës në lokale publike, shfrytëzimin e shesheve për ekspozitë të sendeve, shfrytëzimin e hapësirës për parkim, për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik etj.

Baza tatimore për të gjitha llojet e tatimeve është vlera tregëtare e të gjitha llojeve të pronësisë, që përcaktohet sipas metodologjisë të përcaktuar nga ana e Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të Ministrisë së financave, ndërsa përcaktimin e kryen komisioni i formuar nga Këshilli i komunës.

Taksat komunale paguhen për shfrytëzimin e të drejtave, sendeve dhe shërbimeve të përcaktuara, me interes publik dhe rëndësi lokale, nga ana e personave juridik dhe fizik, që kryejnë veprimtari dhe nga ana e qytetarëve. Ato paguhen sipas Tarifës për **taksa komunale**, që është pjesë përbërëse e Ligjit për **taksa komunale**. Lartësinë e taksës komunale me vendim e përcakton këshilli i komunës në suazat e përcaktuara me Tarifën për **taksat komunale**.

Taksa administrative paguhen për dokumentet dhe veprimet në punët administrative te organet e komunës, organet e komunave të qytetit të Shkupit dhe organet e Qytetit të Shkupit, sipas dispozitave të Ligjit për taksa administrative.

Komunat shfrytëzojnë edhe të ardhura tjera të përcaktuara me ligj, sipas lëmive të caktuara (veprimtaria turistike dhe hotelierike, dhënien e koncesioneve për shfrytëzimin e pasurive natyrore etj).

Shembull:

- Bashkëpunëtor i lartë për përcaktimin e tatimit të pronës, qarkullim të patundshmërive dhe të drejtave;
- Bashkëpunëtor për taksa komunale
- Referent i pavarur për tatim të pronës
 - Referent i lartë, kontabilist tatimorë
- Referent i pavarur, realizues tatimorë

Lartësinë e niveleve e përcakton këshilli i komunës.

Rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet përfshirjes së përgjithshme të të obliguarve me tatim, përcaktimit të vlerës tregëtare të pronës dhe të sigurohet mbledhje me forcë e borxheve tatimore

Rekomandohet përgaditje e modelit të administratës komunale nga ana e komunave, me numër optimal të punëtorëve, që në mënyrë efikase dhe efektive do të administrojnë me tatimet dhe taksat lokale, që janë të ardhura burimore për komunat.

3.5. MARRJE HUA NGA ANA E KOMUNAVE

Komuna ka të drejtë të merr hua në vend dhe jashtë tij.

Për mbulimin e mungesës së përkohshme të mjeteve financiare, komuna mundet në afat të shkurtër, të merr hua në shumë të përgjithshme, deri në 20% nga realizimi i të ardhurave të përgjithshme të **buxhetit** në vitin e kaluar fiskal.

Për financimin e investimeve kapitale, komuna mund të merr hua në afat të gjatë, me çka shuma e përgjishme vjetore për pagesën e borxhit, nuk guxon të tejkalojë 15% nga të ardhurat e përgjithshme të **buxhetit** në vitin e kaluar fiskal.

Ministria e financave do të përcjell punën e komunave dhe, nëse pozitivisht i vlerëson raportet financiare më së paku 24 muaj dhe, nëse në kohëzgjatje prej dy viteve komuna nuk ka obligime të pa paguara ndaj huadhënësve, komuna mund të merr hua për afat të gjatë në vend dhe të jep garanca për ndërmarrjet publike, që i ka themeluar.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë me mendim paraprak të Ministrisë për financa, jep pajtim paraprak për marrje hua nga ana e komunës jashtë vendit.

3.6. EVIDENCA KONTABILISTE, KONTROLLI DHE REVIZIONI

Komuna dhe shërbimet publike të themeluara nga komuna, mbajnë **evidencë kontabiliteti** në pajtim me Ligjin për kontabilitet për **buxhetet** dhe shfrytëzuesit e **buxheteve**, në pajtim me parimet, praktikën dhe standardet e aprovuara të kontabilitetit, si dhe në pajtim me standardet ndërkombëtare për sektorin publik.



Kryetari i komunës përcakton kontabilist përgjegjës (ekonomist i diplomuar me, së paku, pesë vjet përvojë pune në lëminë e financave), i cili, së bashku me kryetarin e komunës, është përgjegjës për ligjshmërinë në punët e kontabilitetit.

Gjithashtu, komuna është e obliguar të vendos sistem dhe procedura për **revizion** të brendshëm, sipas standardeve ndërkombëtare për punë profesionale të **revizionit** të brendshëm të aprovuara nga Ministria e financave.

Revizori i brendshëm (ekonomist i diplomuar ose jurist i diplomuar me, së paku, dy vjet përvojë pune në lëminë e financave), emërohet nga ana e këshillit të komunës, me propozim të kryetarit të komunës. Ai është i pavarur dhe për punën e tij përgjigjet para kryetarit të komunës dhe këshillit të komunës.

Revizionin e jashtëm të llogarive financiare, e realizon Enti shtetëror për **revizion**. Kryetari i komunës është i obliguar të dorëzojë deri te Enti shtetëror për **revizion** raportin për realizimin e **buxhetit** dhe llogarinë përfundimtare të **buxhetit**, në afat prej 30 ditëve pas sjelljes së tyre.

3.7. JOSTABILITETI FINANCIAR KOMUNËS

Nëse revizori kryesor shtetëror has në parregullsi të mëdha në punën financiare; xhiro-llogaria e komunës është e bllokuar në kontinuitet 30 ditë ose 45 ditë me ndërprerje në periudhë prej 60 ditëve; komuna nuk paguan borxhin e përcaktuar në afat prej 90 ditëve dhe nëse komuna e tejkalon nivelin e lejuar për borxh, paraqitet jostabilitet financiar.

Për tejkalimin e situatës së tillë, formohet komision për tejkalimin e jostabilitetit financiar. Ai përgadit plan të masave dhe aktiviteteve për tejkalimin e jostabilitetit financiar të komunës.

3.8. IMPLEMENTIMI I DECENTRALIZIMIT FISKAL

Procesi i decentralizimit fiskal do të realizohet në faza, që të krijohen para kushte për transfer me sukses të kompetencave nga niveli qendror në atë lokal.

Të gjitha komunat nuk kanë kapacitet të njëjtë për çka është e nevojshme kompetencat të merren gradualisht dhe sigurim fillimor dhe adekuat i mjeteve për realizim efikas dhe pa pengesa të kompetencave të transferuara.

Me qasjen në faza të decentralizimit fiskal, do të sigurohet transferim gradual i kompetencave, në pajtim me kapacitetet e komunave për marrjen e tyre dhe sigurim i drejtë dhe adekuat i mjeteve për kryerje efikase dhe pa pengesa të kompetencave të marrura.

Transferi i mjeteve në fazën e parë të decentralizimit, do të fillojë me 1 korrik të vitit 2005. Në bazë të Urdhëresës për metodologjinë për shpërndarjen e të ardhurave nga tatimi i vlerës së shtuar dhe Urdhëresës për metodologjinë e shpërndarjes së **dotacioneve kapitale** dhe të dedikuara, pa mjetet e parapara për rroga, do të fillojë transferi i **dotacioneve** nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Me rëndësi është të përmendet se Qeveria e Republikës së Maqedonisë, do të formojë komision, i cili do të vlerëson nëse komunat i plotësojnë kushtet për transfer të mjeteve nga faza e parë e decentralizimit (në suazat e administratës komunale të ketë, së paku, dy të punësuar për punë në lëminë e administrimit financiar, buxhetimit dhe kontabilitetit dhe, së paku, tre të punësuar për punë në përcaktimin dhe mbledhjen e tatimeve).

Transferi i mjeteve në fazën e dytë të decentralizimit, gjegjësisht të **blok dotacioneve**, do të fillojë kur komunat do t'i plotësojnë kushtet e fazës së parë dhe kur do të kenë kapacitet adekuat kadrovik edhe për udhëheqje financiare, rezultate të mira financiare, kur në kohë dhe sipas rregullave do të lajmërojnë Ministrinë e financave dhe nuk do të kenë obligime të mbetura ndaj **furnizuesve** dhe huadhënësve.



3.9 FURNIZIME PUBLIKE

Me nocionin furnizime publike nënkuptohen më tepër aktivitete, që komuna i kryen si **furnizues** për shkak të blerjes së mallërave, fitimit të shërbimeve ose për kryerjen e punëve ndërtimore apo punë tjera, për të cilat janë siguruar mjete në **buxhet**.

Me Ligjin për furnizime publike krijohet kornizë ligjore për të drejtat dhe obligimet e pjesëmarrësve në proces.

Në kushtet e ekonomisë së tregut të lirë, patjetër duhet të sigurohet konkurrencë e lirë dhe e shëndoshë, garë e drejtë, transparencë, efikasitet dhe zvogëlim i harxhimeve publike. Në të kundërtën, ç'rregullohen rrjedhat e përgjithshme shoqërore-ekonomike dhe krijohen kushte për korrupsion dhe paraqitje të tjera devijuese.

Për të penguar paraqitjen e korrupsionit të shprehur me lakmi, mito ose dhënie të "provizionit" vendim marrësve për furnizime ose për financimin e partive politike me ndihmën e furnizimeve publike, është i nevojshëm aplikimi konsekuent i rregullativës ligjore.

Konkurrenca në kushte të barabarta, me rregulla të lojës qartë të definuara, me transparencë në punë, do të minimizojë mundësitë për aktivitete korruptive. Efektet për komunën janë të mëdha, sepse do të fitohen shërbime më kualitative për çmime më të ulëta.

Komuna është e obliguar ofruesve t'ju siguron situatë të barabartë jo diskriminuese, me konkurrencë të drejtë dhe me transparencë.

Janë të ndaluara çfarëdo lloj negociatash në mes komunës dhe ofruesve gjatë thirjes së hapur dhe të kufizuar. Është e mundur të kërkohet shpjegim por pa mundësi për ndryshime.

Poashtu, nuk është e lejuar furnizimi publik të ndahet në pjesë, me qëllim të ikjes nga procedura e caktuar të përcaktuar me ligj.


Procedura për **furnizim publik** mund të fillohet vetëm për punët, të cilat janë të planifikuara dhe për të cilat janë siguruar mjete në **buxhet** ose programet të aprovuara nga ana e këshillit të komunës.

Në bazë të dokumenteve të sjellura kryetari i komunës, deri në fund të janarit, sjell plan për të gjitha nevojat për furnizim në vitin në rrjedhë sipas llojit, si dhe plan për dinamikën e realizimit dhe për procedurën.

Pastaj, kryetari i komunës sjell vendim për nevojë, për secilin furnizim veç e veç, në të cilin përcaktohet lloji dhe sasia e furnizimit, shuma dhe burimi i mjeteve të nevojshme për realizimin e tij.

Komuna është e obliguar të ruajë gjithë dokumentacionin për furnizimet publike dhe të mirëmban regjistër për furnizime publike.

Kryetari i komunës formon komision konstant për furnizime publike, për realizimin e procedurës për furnizime publike nga ana e të punësuarve, me mandat prej dy vite dhe me mundësi edhe për një mandat të ardhshëm.



Për t'ju mundësuar të gjithë subjekteve të interesuar qasje të njëjtë thirrja për furnizime publike, patjetër duhet të publikohet në gazetë ditore, "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" ose në gazetën zyrtare të Unionit evropian, varësisht nga lloji i furnizimit.

Komuna përgadit dokumentacion për shpallje publike, sipas nevojave të saja dhe në pajtim me standardet dhe rregullat e llojit të furnizimit. Ky dokumentacion duhet me qenë i arritshëm për informim për të gjithë ofruesit e interesuar.



Ofruesi për vërtetimin e mundësisë së tij financiare, ekonomike dhe teknike, me **ofertën** dorëzon edhe dokumente të përshtatshme.

Pas hapjes së ofertave në bazë të kriteriumeve të përcaktuara më parë, sillet vendim për zgjedhjen e **ofertës** më të mirë për çka informohen të gjithë pjesëmarrësit në procedurë.

Fjalë kyçe: buxhet, tatimeve lokal, taksa komunale, dotacion, dotacion kapital, blok dotacion, dotacion për kompetencë të deleguar, evidencë kontabiliteti, revizion, furnizues, furnizim publik, ofertë.

Korrniza ligjore:

- Konventa evropiane për vetëqeverisje lokale e Këshillit të Evropës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 5/02)
- Ligji për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr 5/02)
- Ligji për financimin e njërive të vetëqeverisjes lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr .61/04)
- Ligji për buxhetët ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.35/01)
- Ligji për kontabilitet të buxheteve dhe shfrytëzuesve të buxheteve ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 61/02; 98/02)
- Ligji për tatimet e pronës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 61/04)
- Ligji për taskat komunale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 61/04)
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për taksa administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 61/04)
- Ligji për revizion shtetëror ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 73/04)
- Ligji për furnizimë publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 19/04)
- Ligji për përcaktimin dhe mbledhjen e të ardhurave publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 13/01; 61/02 dhe 24/03).





4 | MENAXHMENT ME PRONËSINË KOMUNALE

Romeo Dereban

E drejta e pronësisë nuk është vetëm mundësi ligjore por edhe kategori univerzale. Ruajeni pronësinë e komunës, ashtu siç e ruani edhe pronën e juaj. Në këtë mënyrë ju do të kryeni në mënyrë të suksesshme detyrën e juaj. Bashkëqytetarët e juaj do t'ju respektojnë, ndërsa komuna e juaj do të jetë vend më i pasur dhe më i këndshëm për jetë

4.1. PRONA DHE FITIMI I PRONËS THEMELORE KOMUNALE

Udhëheqja me pronën komunale, është njëra ndër kompetencat më të rëndësishme të komunës. Me pronësinë komuna udhëheq, si amvis i mirë. Ligjet parashohin, komunat të shfrytëzojnë pronën për qëllime ekonomike dhe për udhëheqje efikase. Udhëheqja e mirë, do të ketë si rezultat zhvillimin e komunës. Aktivitetet e pa menduara, nga ana tjetër, mund të kenë si rezultat dëm të madh për komunën.

Qysh me formimin e komunave të para, posaçërisht me formimin e 34 komunave në Republikën e Maqedonisë në vitin 1965, nga ana e shtetit komunave ju është dhënë pronësi e caktuar, me qëllim të kryerjes së kompetencave të përcaktuara.

Me sjelljen e ligjit për ndarje territoriale të Republikës së Maqedonisë dhe me përcaktimin e rajoneve të njësi-ve të vetëqeverisjes lokale nga viti 1996, në Republikën e Maqedonisë u themeluan 123 komuna. Me qëllim të krijimit të kushteve për punë për këto komuna, patjetër duhej t'ju shpërndahej pronësi e caktuar për kryerjen e kompetencave të tyre. Me Ligjin për vetëqeverisje lokale të viti 1995 komunave ju garantoheshin pak kompetenca (si psh: rregullimi komunal dhe dhe një pjesë të kompetencave të lidhura me planifikimin hapësinor dhe urban), me çka një numër i madh i kompetencave, që deri atëherë i kryenin u bënë kompetenca shtetërore. Në këtë mënyrë nga komunat u morr një pjesë e madhe e pronësisë (si psh: ndërtesa të gjyqeve komunale, shkollat, foshnjoret, ambulancat, zyret e bashkësisë lokale, zyret e komunave, objektet sportive, trualli ndërtimor etj) dhe ju dha shtetit.

Për shkak të krijimit të kushteve për fillim me punë, posaçërisht për komunat e posaformuara, patjetër duhej t'ju përcaktohet pronë komunave për shkak të kryerjes së kompetencave të tyre. Me qëllim të shpërndarjes së barabartë të pronësisë në mes Republikës dhe Komunave, paraprakisht u krye bilanci ndarës.

Objektet, të cilat me bilancin ndarës janë përcaktuar si objekte të përbashkëta të Republikës dhe komunës, ndërsa nuk është e mundur ndarja fizike e tyre, shfrytëzohen në bazë të marrëveshjes së arritur për shfrytëzim dhe mirëmbajtje të përbashkët (psh. palestra sportive, pishina, etj). Trualli (pjellor dhe jopjellor), si dhe mallet dhe livadhet në sipërfaqen e komunës, edhe më tutje janë të shënuara si pronë shtetërore.



Me Ligjin për organizim territorial të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë në vitin 2004 janë përcaktuar 84 komuna, ndërsa me Ligjin për vetëqeverisje lokale të vitit 2002 për komunat janë përcaktuar kompetenca të reja të konsiderueshme, të cilat duhet të fillojnë të aplikohen në fillim të vitit 2004.

Bilanci ndarës

Për këtë qëllim u formuan komisione të përbëra nga përfaqësues të ministrive të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe përfaqësues të komunave. Komisionet, në bazë të të dhënave, që posedonin komunat dhe të dhënat nga Drejtoria e kadastrës, me proces verbal përcaktuan se, cila pronë e patundshme do të mbetet në pronësi të komunës, e cila do të mbetet në pronësi të Republikës. Prona e komunave të posa formuara, u përcaktua me bilanc ndarës, në mes komunës dhe Republikës nga njëra anë dhe në mes komunave të posa formuara dhe komunave, nga e cila është formuar komuna e re, nga ana tjetër.

Për fat të keq me bilancin ndarës komunat humbën një pjesë të madhe të pronës, sepse ajo iu dha shtetit.

Për shkak të krijimit të kushteve për fillim me punë për kryerjen e kompetencave të reja të përcaktuara, komunave ju është dhënë pronësi e konsiderueshme. Për shembull: komunave ju kthehen shkollat (për arsim fillor dhe të mesëm), një pjesë e objekteve sportive, ambulancat, shtëpitë kundër zjarrit, shtëpitë shkollore, zyret komunale të njëjësive rajonale të ministrive të caktuara, bibliotekat dhe prona tjetër, që duhet ta marrin komunat pas konstitimit të këshillave të komunave dhe pas zgjedhjes së kryetarëve të komunave në zgjedhjet lokale në vitin 2005.

Ta ndajmë pronën komunale në disa kriteriume themelore, edhe ate:

- pronë e patundshme;
- pronë e tundshme;
- infrastrukturë dhe
- financa.

Pronë e patundshme është prona, që nuk mund të lëvizë ose të zhvendoset prej një vendi në vend tjetër, pa u dëmtuar esenca e saj. Si pjesë e pronës së patundshme, janë:

- trualli (vende për ndërtim;
- parqet;
- vendet komunale për deponimin e hedhurinave;
- ndërtesa (psh. zyret e komunës);
- objekte të kulturës;
- shtëpi ose banesa për jetesë;
- objekte afariste;
- varreza;
- morgjet;
- objekte sportive dhe
- pronë tjetër, që sipa natyrës së saj është e patundshme.

Pronë e tundshme është prona, e cila mund të lëvizë ose ç'vendoset. Në pronën e lëvizshme bëjnë pjesë:

- automjetet;
- objektet lundruese;
- makinat, pajisjet, inventari, mobiljet në zyret komunale dhe në hapësirat tjera komunale;

Çka kaloi në pronësi të komunave?

Qeveria e Republikës së Maqedonisë në vitin 2000 solli vendime të veçanta për secilën komunë, për bartje të së drejtës për pronësi mbi pronën e patundshme, nga Republika e Maqedonisë mbi komunën, në bazë të bilancit të realizuar ndarës.

Me bilancin ndarës në pronësi të komunave u bartën:

- a) objekte banimi, objekte afariste, objekte nga lëmia e veprimtarisë arsimore, objekte nga lëmia e mbrojtjes shëndetësore, objekte kulturore, objekte sportive dhe objekte rekreative;
- b) objekte të infrastrukturës komunale;
- c) objekte të bashkësive lokale;
- ç) objekte të përbashkëta.

- dokumentet e arkivit dhe
- sende tjera të lëvizshme.



Në infrastukturë bëjnë pjesë:

- rrjeti i ujësjetillësit;
- rrjeti i kanalizimit;
- stacionet pastruese;
- ndriçimi i rrugëve;
- linja të radio-komunikacionit;
- televizione kablove, etj.

Në financat bëjnë pjesë:

- të hollat,
- shënim i arkës,
- letra me vlerë,
- xhiro-llogari,
- aksione, etj.

Llojet e ndryshme të pronës na imponojnë konkluzat se na duhet plan i mirë për udhëheqjen e saj. Kjo do të thotë se ne nuk na duhet vetëm regjistrim i inventarit por edhe plan gjeneral për zhvillim afatgjatë, që do të përcaktojë bazat për zhvillim të komunës. Psh. plan për 10 vjet dhe të ngjajshëm.

Gjatë krijimit të këtij plani, duhet të kemi parasysh traditat dhe shprehitë e qytetarëve, si dhe mënyrën e tyre të jetës.

Për realizimin e këtyre qëllimeve, komuna duhet të shesë ose të blejë pronë të patundshme. Të hollat, që do të fitohen nga shitja e pronës, duhet të përdoren për fitim të pronës së re ose për rekonstruimin e pronës egzistuese.

4.2. BLERJA DHE SHITJA E PRONËS

Komuna mund të shesë dhe blejë pronë, në pajtim me ligj. Për blerjen dhe shitjen e pronësisë, vendos këshilli i komunës. Këshilli mund të autorizojë kryetarin e komunës për blerje ose shitje të pronës. Kur kemi paraqitje të mirë të pronës së komunës, ajo mund të rritet me blerje të pronës së re nga persona juridik dhe fizik.

Gjithnjë duhet të orvatemi të blejmë pronë, që është e nevojshme për komunën, gjegjësisht për kryerjen e kompetencave të saja.

Pronën, që nuk përdoret komuna mund t'ua shesë personave juridik ose fizik. Komuna, shitjen e pronësisë, duhet ta bëjë nëpërmjet licitacionin publik në pajtim me ligj. Psh. kur shitet banesë ose shtëpi në pronësi të komunës, së pari duhet të kontrollohet nëse objekti i nevojitet komunës. Nëse vërtetohet se objekti nuk i nevojitet komunës, e njëkohësisht harxhimet për mirëmbajtjen e tij janë të mëdha, atëherë objekti mund të shitet. Vendim për shitjen e objektit, sjell këshilli i komunës. Për realizimin e procedurës së shitjes, formohet komision. Komisioni, së pari, përcakton vlerën reale të objektit. Vlera, sipas tregut, nuk guxon të jetë më e ulët se vlera tregëtare reale, që është prezente në rrethinën, ku kryhet shitja e objektit. Komisioni shpall, shpallje publike dhe përcakton ditën e shitjes së objektit. Gjithmonë duhet të merret parasysh se blerësit potencial janë lajmëruar për licitacion publik. Kur ka më tepër të interesuar për blerjen e objektit, atëherë kjo është më e levërdishme për arritje të çmimit më të lartë të objektit në shitje. Kur kemi një blerës potencial në licitacionin publik, atëherë mirë është komisioni të ndërprejë procedurën dhe të shpall, shpallje të re publike për shitje. Së pari, blerësit potencial dorëzojnë një sasi të caktuar të të hollave, para së të fillon licitacioni publik.



Komisioni për blerës të objektit shpall personin, i cili ka ofruar më tepër gjatë licitacionit publik. Blerësi mjetet për blerjen e objektit, i paguan në xhiro-llogarinë e buxhetit të komunës. Mjetet e fituara nga shitja e objektit duhet të shfrytëzohen, sipas dedikimit për blerje, ndërtim ose rekonstrum të objekteve egzistuese.

4.3. DHËNIA E PRONËS ME QIRA

Komuna ka pronë, të cilën nuk e përdor për aktivitete të saja. Pronën e tillë, komuna mund ta jep me qira për kohëzgjatje të caktuar, nëpërmjet licitacionit publik, në pajtim me ligj. Dhënia e pronës me qira, është në kompetencë të komunës. Dhënia e pronës me qira, nuk është patjetër gjithnjë të jetë faktor më i rëndësishëm. Por shumë është me rëndësi për çfarë veprimtarie do të përdoret objekti, pas dhënies së tij me qira dhe çarë do të jenë rezultatet nga ky veprim.

Është ide e mirë, komuna të ndërtojë objekte të tilla dhe t'i jep ato me qira.

Kjo mundet me qenë me rëndësi të jashtëzakonshme për artizanate të caktuara, që janë karakteristikë e komunës (furraxhinjtë, floktarët, filigranistët, kujunxhitë, etj). Gjatë dhënies me qira për këto artizanate, komuna duhet të ketë kujdes qiraja të jetë më e ulët, me qëllim të stimulimit të tyre, e me këtë edhe t'ju ndihmojë në zhvillimin e tyre.

Mjetet e siguruara me anë të qirasë, gjithnjë duhet të harxhohen, sipas dedikimit.

Prona e komunës nuk mund të jepet për **hipotekë**, nëse kryen veprimtari me interes publik.

4.4. REGJISTRI I PRONËS

Komuna për pronën mban **regjistër** dhe pronën e tregon me anë të bilancit pronësor. Komuna është e obliguar të mbajë evidencë të pronës, dhe të shënon ndryshimet. Në fund të çdo viti kalendarik, komuna bën regjistrimin e të gjitha mjeteve materiale. Në praktikë, ezistojnë edhe raste kur është i nevojshëm regjistrim plotësues, posaçërsiht gjatë dhënies së detyrës së udhëheqësve me mjetet, kur bëhen ndryshime statutare dhe të ngjajshme. Regjistrimi ka rëndësi të madhe për shkak të planit të përgjithshëm dhe zhvillimor për udhëheqjen me pronën dhe paraqet faktor të rëndësishëm në planifikimin e të ardhurave the harxhimeve buxhetore.

Prona e komunës është e shpërndarë dhe e ndryshueshme, kohë pas kohe. Komuna është e obliguar të bëjë shënimin e ndryshimeve dhe zhvillimin e pronës së saj - së bashku me regjistrimin vijues të të gjitha ndryshimeve kontraktuese. Kjo nuk është vetëm obligim ligjor por edhe interes i komunës. Prona është e regjistruar në komunë, në pajtim me ligj por, për siguri më të madhe, komisioni regjistruar, duhet të bëjë mbikqyrje të pronës. Para fillimit të regjistrimit, rregull themelore është, që së pari të provohet nëse çdo objekt është i shënuar në kadastër.

Aktivitetet e lidhura me regjistrimin fillojnë me formimin e komisionit regjistruar. Për punë të suksesshme të komisionit regjistruar, përgaditet plan dhe udhëzime për përgaditje për rezlizimin e regjistrimit. Gjendja e regjistrimit tregohet me lista regjistruese. Është më praktike kur regjistrimi kryhet në lista të veçanta regjistruese, si psh. lista të veçanta regjistruese për objektet ndërtimore, lista të veçanta për truall, pronë të lëvizshme, për inventarin e madh dhe lista të veçanta për inventarin e vogël.

Regjistrim bëhet edhe për mjetet financiare. Me regjistrim të mjeteve financiare, përfshihen të gjitha mjetet financiare, që në ditën e regjistrimit gjenden në llogaritë në bankat, që i posedon komuna; mjetet financiare në arkën e komunës si dhe kambialet dhe aksionet, që i posedon komuna.

Pas mbarimit të regjistrimit, përgaditet raport për regjistrimin e kryer. Anëtarët e këshillit komunal, duhet në mbledhjen e parë të këshillit të sjellin vendim për inspektim të plotë dhe kontrollë permanente për regjistrin e pronës së komunës.

Në regjistrin e pronës shënohet tërë pronësia, që e posedon komuna, edhe atë: truall, objekte dhe pajisje, që i kanë financuar dhe i financojnë qytetarët me anë të vetëkontributit ose në mënyrë tjetër kanë marrur pjesë në ndërtim dhe sende të tjera të patundshme dhe të tundshme, mjete financiare, etj.



4.5. MBROJTJE TË PRONËS

Komuna mbron pronën nga ndikimet natyrore dhe nga ndikime tjera në mënyra të caktuar me ligj. Për mbrojtje të pronës, komuna duhet të ndërmerr masa adekuate, edhe atë: mirëmbajtje të mirë të objekteve, masa kundër mos pagimit të qirasë, masa kundër korrupsionit, masa kundër vjedhjes dhe dëmtimeve, masa për mbrojtje prej ndikimeve natyrore, etj.

Prona komunale duhet me qenë e siguruar. Duhet të mendohet se për çfarë rreziqe dhe nën çfarë kushte të bëhet sigurimi. Gjithnjë duhet të kihet parasysh se borxhlinj nuk janë vetëm personat, që nuk kanë paguar qiranë komunës, por edhe personat, që kanë obligim të kryejnë disa punë për komunën. Për këtë qëllim, duhen të ndërmerren veprime të caktuara për mbledhjen sa më të shpejtë të borxheve të pa paguara ndaj komunës dhe realizimin e punëve të pakryera në suazat e afateve të caktuara në marrëveshjet e nënshkruara.

Komuna duhet të jetë e kujdesshme, posaçërisht kur iu jep banesa ose shtëpi me qira, personave fizik. Komuna duhet të dijë në çfarë mënyre dhe si do të mbledh më lehtë qiranë. Nëse qiranë duhet ta paguajnë qytetarët, që bëjnë pjesë në grupin e qytetarëve të rrezikuar nga aspekti social, atyre duhet t'ju mundësohet lehtësi, gjegjësisht, t'ju zvogëlohet qiraja, me qëllim të mbledhjes më të suksesshme të borxhit themelorë, që e kanë ndaj komunës këta qytetarë të rrezikuar nga aspekti social.

4.6 UDHËHEQJA ME PRONËN

Komuna me pronën udhëheq për interes publik dhe patjetër duhet të silllet me përgjegjshmëri.

Sa më e madhe, që është prona, aq më e madhe është edhe përgjegjësia për udhëheqje me të.

Çdo veprim i gabueshëm, mund të ketë pasoja të padëshiruara në të ardhmen (të afërt ose të largët).

Jo vetëm, që duhet pasur dituri për udhëheqjen me pronën por duhet të mirren parasysh edhe niveli tatimor, i lidhur me bazën e pronësisë.

Nëse komuna ka pronë të madhe, ajo mund të themelojë edhe ndërmarrje publike për udhëheqje me pronë. Por, në rend të parë, faktor vendimtar duhet me qenë fakti, nëse kjo ndërmarrje do të jetë profitabile ose jo.

Nëse aktivitetet nuk janë profitabile por varen nga buxheti i komunës, atëherë nuk është punë e mençur të formohet një ndërmarrje e tillë publike.

4.7. PRONË INFRASTRUKTURE

Në pronën infrastrukturore të komunës, bëjnë pjesë: objektet e infrastrukturës, që i ka ndërtuar komuna dhe, që janë në pronësi të saj (rrejt i ujësjelljes, rrjeti i kanalizimit, parqet, hapësirat për parkim të automjeteve, stacionet e autobusave, vend-qëndrimet e autobusave, ndriçimi i rrugëve, që ka ndërtuar komuna, instalimet nëntokësore dhe mbitokësore, që i ka ndërtuar komuna etj.

4.8. BASHKËPUNIMI NË MES KOMUNAVE NË LËMINË E PRONËS

Komunat bashkëpunojnë në mes tyre në lëminë e pronësisë, posaçërisht kur pronësia është e përbashkët dhe kur paraqet tërësi të pandashme, bashkëpunimi në mes komunave është me rëndësi të veçantë, për zgjidhjen e çështjeve të infrastrukturës, si psh. investim i përbashkët në ndërtimin e rrjetit ujësjellës, rrjetit të kanalizimit, ndërtimin e rrugëve lokale, që bëjnë lidhjen e dy komunave fqinje dhe të ngjajshme.

Komunat për bashkëpunim më të suksesshëm ndërmjet tyre, mund të formojnë edhe ndërmarrje publike të përbashkëta.



Poashtu, komunat mund të formojnë ndërmarrje të përbashkët publike, për veprimtari shërbyese dhe veprimtari komunale. Numri i ndërmarrjeve të tilla, varet nga madhësia e komunës, gjegjësisht qytetit.

Shembull për ndërmarrje publike ndërkomunale: "Proakva" (Strugë), për furnizim me ujë të pijshëm dhe pastrim të ujit të përdorur, e formuar me bashkëpunim të komunës së Strugës dhe Ohrit.

Me qëllim të zhvillimit të regjionit, komunat mund të themelojnë edhe asociacione, posaçërisht për zhvillimin e turizmit dhe për ndërmjetësim turistik. Gjithsesi, gjatë formimit të këtyre agjensioneve, patjetër duhet të egzistojnë marrëveshje paraprake, me të cilat do të përcaktohen investimet e përbashkëta, mënyra e punës dhe ndarja e fitimit.

Komunat në rajonet kufitare është e zakonshme të zhvillojnë bashkëpunim me komunat përtej kufirit. Kështu, së bashku, mund të shfrytëzojnë fonde speciale ndërkombëtare, që janë të dedikuara për këtë lloj të bashkëpunimit, si psh. për ndërtim të ujësje-llësit të përbashkët, rrugëve, rrjetit elektrik, rrjetit të kanalizimit, etj.

Nëse e dini sa vlen levërdia nga udhëheqja me pronën e komunës suaj, do të vërtetoheni se është më mirë të bashkëpunoni me komunat tjera ose të themeloni asociacion të përbashkët për udhëheqje. Kjo zgjidhje është e mirë, për shkak të nevojës për udhëheqje me pronën e përbashkët të komunave.

Bashkëpunimi me komunat, mundëson shumë lehtë të arrihet deri te fondet speciale për projekte më të mëdha investuese dhe për ripërtrijen e pronës së komunës. Ndihma financiare e këtyre programeve është e mirëseardhur për shkak të ndërtimit dhe rikonstruimit, posaçërisht të objekteve të infrastrukturës. Nëse jeni anëtarë të këshillit, vlen të harxhohet më tepër kohë për përgaditjen e programeve të këtilla.

Mos harroni kur udhëhiqni me pronën, të kërkonti ndihmë financiare nga institucionet donatore, ndërkombëtare. Por, poashtu, jeni të obliguar të respektoni afatet dhe kushtet e parapara në këto programe.

4.9. SI FITOHET PRONËSIA

Komuna pronën e fiton: nga burimet e saja të të ardhurave, që janë përcaktuar me ligj; me kryerje të veprimtarisë së caktuar ekonomike; me kryerje të veprimtarisë publike dhe profesionale; me financim të qytetarëve, me anë të vetëkontributit ose në mënyrë tjetër; me dhurata; me trashigimi; me donacione dhe mbi baza të tjera.

4.10. PËRGJEGJËSI PËR KEQPËRDORIMIN E PRONËS SË KOMUNËS

Shitja, blerja ose dhënia me qira e pronës së komunës, gjithnjë duhet të bëhet në pajtim me procedurën dhe mënyrën e përcaktuar me ligj. Çdo **transaksion**, i lidhur me pronën e komunës, duhet me qenë publik dhe **transparent**. Gjithashtu, duhet me vëmendje të madhe të përcaktohet një transaksion i tillë, nëse është në interes së komunës. Nëse prona shitet me çmim më të ulët, nga vlera e përcaktuar e tregut ose blehet pronë me çmim shumë më të lartë se çmimi real i tregut, atëherë egziston dëshim i bazuar së i është shkaktuar dëm komunës. Kjo, si pasojë, sjell masë adekuate ligjore kundër personit udhëheqës të komunës.

Kontroll të punës materialo-financiare të komunës, bën Ministria për financa.

Revizion të punës materialo-financiare, bën Enti shtetëror për **revizion**.

Nëse gjatë procedurës së kontrollimit të **transaksioneve** financiare, që paraqesin harxhime të komunës në kuptim të shfrytëzimit ligjor dhe sipas dedikimit, vërtetohet se gjatë blerjes, shitjes, dhënies me qira të pronës së komunës, është realizuar **transaksion** kundër ligjit ose **transaksion**, që ka pasoja të dëmshme për komunën, gjegjësisht është kryer vepër për kundërvajtje ose vepër penale, atëherë fillohet procedurë adekuate, kundër personit në komunë, i cili ka kryer këtë vepër.

4.11. KRIJIMI I PRONËSISË

Parim themelor në krijimin e pronësisë duhet me qenë parimi: si më mirë të shfrytëzojmë resurset tona me qëllim të zmadhimit të pronësisë së komunës ose të përfitojmë sa më tepër, që është e mundur nga prona.



Bazë fillestare e krijimit të pronësisë duhet me qenë listat regjistruese të pronës dhe bilanci i harxhimeve dhe të ardhurave të komunës, të realizuara në vitin në rrjedhë.

Pas vërtetimit se, cila pronë sjell të ardhura edhe ate disa vite në të kaluarën, duhet të vendosim të zmadhojnë atë pronë, gjegjësisht të blejmë ose të ndërtojmë edhe më tutje pronën e tillë. Nëse vërtetojmë se ndonjë pronë sjell humbje për buxhetin e komunës, edhe ate disa vite me radhë në të kaluarën, atëherë patjetër duhet prona e tillë të shitet. Kjo rregull nuk do të thotë se gjithmonë duhet të respektohet, posaçërisht jo për ato objekte (psh. biblioteka, galeri, institucione kulturore etj.), që nuk i sjellin fitim komunës por janë me interes të posaçëm publik për komunën. Këto objekte nuk duhet të shiten.

Nuk ka dyshim se udhëheqja me pronën e fituar të komunës kërkon organ profesional të pushtetit lokal, që gjithmonë mund të gjen rrugën në lavirintin e procesin administrativ financiarë dhe rregullativës egzistuese ligjore.

Jemi të obliguar të ruajmë pronën e komunës, që na është besuar dhe të disponojmë me atë në mënyrë ekonomike dhe për qëllime të përcaktuara paraprake. Jemi të obliguar të përdorim pronën e komunës për interes publik dhe si amvis i mirë.

Fjalë kyçe: transaksion, transparencë, hipotekë, regjistër, revizion.

Korrniza ligjore:

- Ligji për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 52/98 dhe 5/02);
- Ligji për financimin e vetëqeverisjes lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 61/04)
- Ligji për pronësi dhe të drejta tjera mbi sende ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 18/01)
- Ligji për procedurë egzekutuese ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 53/97 dhe 73/04);
- Ligji për revizion shtetëror (tekst i pastruar) ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 73/04);
- Udhëzim për mënyrën e realizimit të bilancit për ndarje në mes Republikës dhe 34 komunave dhe Qytetit të Shkupit dhe bilancit për ndarje në mes komunave të reja dhe komunat, nga të cilat rrjedhin komunat e reja ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 17/97)
- Ligji për rregullimin e marrëdhënieve në mes njësive të reja të vetëqeverisjes lokale dhe njësive të vetëqeverisjes lokale nga të cilat kanë dalur ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 59/96).





5 | ZHVILLIMI I EKONOMISË LOKALE (ZHEL)

Ljupço Petkovski

Investim, rritje ekonomike dhe zhvillim. Si të arrihet deri te investimet, si të tërhiqet kapitali privat, cilat janë mekanizmat dhe instrumentet në dispozicion të organeve komunale për përmirësimin e jetës në komunë?

Përgjigjet e këtyre pyetjeve nuk janë patjetër aq të ndërlikuara, apo jo?

Zhvillimi i ekonomisë lokale është proces, në të cilin punojnë së bashku partnerët e sektorit afarist, sektorit financiar dhe sektorit joqeveritar (faktorët në suazat e komunës), me qëllim të formimit të kushteve më të favorshme për rritje ekonomike dhe krijim të vendeve të reja të punës në njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Të punohet për ZHEL do të thotë të punohet drejtpërdrejtë në ndërtimin e konkurrencës ekonomike në bashkësinë me qëllim të përmirësimit të së ardhmes ekonomike të saj. Vetëqeverisja lokale, në pajtim me kompetencat e reja, që i janë dhënë me decentralizimin, gjatë aktiviteteve të saja duhet t'i jep përparësi ekonomisë lokale dhe zmadhimit të konkurrencës së saj në kuptim ekonomik, sepse suksesi i vetëqeverisjes lokale, do të varet nga përshtatshmëria e saj ndaj rrethit të tregut të lirë, që ndysohet shpejtë dhe në të cilën konkurrenca është gjithnjë e më e fortë.

Çdo bashkësi lokale, ka kushtet e saja të veçanta lokale, që mund të ndihmojnë ose të vështirësojnë zhvillimin e saj ekonomik. Këto attribute lokale e formojnë bazën, mbi të cilën mund të ndërtohet strategjia e ZHEL, me qëllim të përmirësimit të konkurrencës të bizneseve lokale.

Për të zhvilluar konkurrencën secila njësi e vetëqeverisjes lokale, duhet të ketë njohuri për **resurset** e saja (potencialin natyror, pozitën gjeografike, infrastrukturën, kapacitetet egzistuese ekonomike etj.) dhe të vërejtë përparësitë dhe mangësitë e tyre, me qëllim të shfrytëzimit të mundësive potenciale dhe shmangjes së rreziqeve. Kjo është e nevojshme edhe për krijimin e klimës së favorshme ekonomike, që do të tërheq **investime** të reja për gjenerim të vendeve të reja të punës dhe pozitivisht do të ndikojë në ZHEL, e me këtë edhe në zhvillimin e njësisë së vetëqeverisjes lokale, në përgjithësi.

Puna e ekonomisë, e cila duhet të krijojë rritje ekonomike dhe zhvillim në vetëqeverisjen lokale, në masë të madhe varet nga lehtësimet e kushteve lokale (që ndikojnë në punën e saj). Detyra themelore e këshillit të komunës (pushteti lokal) është krijimi i kushteve të volitshme për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në territorin e komunës. ZHEL realizohet me krijimin e **partneritetit** të pushtetit lokal, sektorit privat dhe OJQ-ve, në interes të bashkësisë.

Detyra themelore e pushtetit lokal është formimi i skuadrës për zhvillimin e ekonomisë lokale në suazat e njësisë së vetëqeverisjes lokale. Vendimin për formimin e skuadrës e sjell këshilli i komunës. Përbërjen, strukturën dhe numrin e anëtarëve e përcakton këshilli i komunës në bashkëpunim me kryetarin e komunës.



Skuadra punon në përgaditjen e strategjisë për ZHEL edhe me palët e interesuara, me qëllim të zhvillimit të **partneritetit** në mes sektorit publik dhe privat. Ndonjëherë, **partneritetet** e tilla mund të formohen si njësi autonome ose gjysëm autonome për **implementim** të strategjive.

Në këtë rast, komuna i udhëheq këto aktivitete nëpërmjet forcimit të kapacitetit të administratës komunale dhe menaxhmentit komunal, sepse është pjesë vitale e procesit të rritjes dhe zhvillimit ekonomik. Administrata lokale këshillëdhënëse është imperativ për përkrahjen dhe arritjen e zhvillimit ekonomik, nëpërmjet aktivizimit të kushteve, strukturave organizative në aspekt të përballimit të nevojave lokale. Kjo mund të arrihet me:

- sistemin e një sporteli
- përparimin e menaxhmentit me ZHEL
- forcimin e pjesëmarrjes së qytetarëve
- përmirësimin e kualitetit të sërtimeve publike
- braktisje të shprehive burokratike dhe transformim të administratës lokale në pushtet këshillëdhënës.

Pushteti lokal, gjegjësisht këshilli i komunës i sjell programet themelore, me të cilët ndikon në realizimin e strategjisë së ZHEL edhe atë:

- **Shtytje të rritjes së afarizmit lokal** nëpërmjet formimit të rrjetës lokale të institucioneve dhe agjensioneve për përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe përkrahjen e sipërmarrjes.
 - **Shtytje të themelimit dhe zhvillimeve të ndërmarrjeve të reja** nëpërmjet dhënies së këshillave, ndihmës teknike, ndihmës, trajnime për sipërmarrje, me çka do t'ju ndihmohej personave dhe do të merrnin kurajo për fillimin e veprimtarive ekonomike.
 - **Promovim të investimeve nëpërmjet tërheqjes së veprimtarive të reja ekonomike** drejt njësisë së vetëqeverisjes lokale, nga pjesët e tjera të shtetit ose nga shtetet tjera; ndihmë për arritje të burimeve financiare kapitale, të të ardhurave.
 - **Investim** në objekte të rëndësishme të infrastrukturës, që është tepër e rëndësishme për ZHEL dhe tërheqjen e investuesve.
- ◆ Këshilli ndikon në ZHEL nëpërmjet sjelljes së programeve dhe vendimeve për lartësinë e taksave komunale, lartësia e së cilave do të ndikojë bindshëm për stimulimin e aktiviteteve ekonomike. Këshilli përcakton edhe lartësinë e tatimeve lokale, që mund të ndikojnë në mënyrë stimuluese në ZHEL.
- ◆ Në programet e tij, këshilli i komunës duhet të mundësojë zhvillim dhe modernizim të objekteve të infrastrukturës komunale:
- Ndërtim, mbindërtim dhe rikonstruim të rrugëve lokale të komunikacionit;
 - Ndërtim, rikonstruim dhe modernizim të rrjetit të ujësjelljes dhe stacioneve për pastrim të ujërave;
 - Ndërtim të deponimeve regjionale;
 - Ndërtim dhe zgjerim të tregjeve publike;
 - Formim dhe ripërtirje të sipërfaqeve të gjelbërta dhe parqeve.
- ◆ Ndërtim, rikonstruim dhe modernizim të objekteve të infrastruktures sociale:
- Qendra sportive dhe qendra për rekreim;
 - Institucione të arsimit;
 - Institucione shëndetësore;
 - Institucione sociale;
 - Institucione kulturore.



- **Bashkëpunim lokal dhe rajonal** - Pushteti lokal duhet të ndihmojë lidhjen lokale të ekonomisë dhe të bëhet katalizator i mbledhjes të të gjithë aktorëve të ekonomisë lokale dhe rajonale me qëllim të zmadhimit të konkurrencës dhe paraqitjes së përbashkët në tregje.
- **Qetësimin e tensioneve sociale nëpërmjet programeve**, që drejtojnë dhe përfshijnë popullatën e varfër dhe të rrezikuar në ekonomi. Këshilli i komunës mund të aprovojë edhe program për ndërtim të infrastrukturës sociale, me të cilën mund të angazhohen numër i konsiderueshëm i personave të pa punësuar. Me këtë do të tejkalohet gjendja e rëndë e të pa punësuarve dhe do të arriheshin rezultate pozitive në çmimin e ndërtimit e objekteve të infrastrukturës.

Të sigurohen garanca se rritja e re industriale do të zmadhojë mundësinë e punësimit të punëtorëve me të ardhura të ulëta dhe këta punëtorë të kenë qasje drejt mundësive për përparim.

- **Strategji për rigjenerim** të kapaciteteve industriale egzistuese, e që janë të mbyllura nëpërmjet gjetjes së partnerëve strategjik.

Zhvillimi i ekonomisë lokale, kërkon qasje të përshtatura me kushtet lokale. Gjatë kësaj, duhet të merren parasysh parime të caktuara.

- **Qasje e plotë**, duke përfshirë çështjet sociale, ekonomike dhe ekologjike.
- **Sërë iniciativash** - afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë për të përkrahur **partneritetet** dhe të ndërtohet besimi i palëve të interesuara.
- **Përparimi i kapaciteteve të udhëheqjes** që japin përpjekjet e tyre, kredibilitetin dhe aftësitë për të bashkuar palët e interesuara për **implementim** të programit.
- **Pushteti lokal** duhet të tregojë vullnet të fuqishëm politik për **implementimin** e strategjisë së ZHEL-it dhe të kërkojë ndihmë konkrete teknike, financiare dhe të llojit tjetër nga nivelet tjera të pushtetit.

Pushteti lokal dhe palët kryesore të interesuara duhet të balancojnë zhvillimin ekonomik me nevojat e rrethinës dhe me nevojat sociale.

SHEMBULL:

REALIZIMI I PROJEKTIT ME FORMIM TË PARTNERITETIT NË MES SEKTORIT PUBLIK DHE PRIVAT

Në Komunën e Kriva Pallankës një kohë të gjatë stacioni egzistues i autobusave me kapacitetin e saj prej një peroni, nuk i plotësonte nevojat e qytetarëve. Me lokacionin e saj egzistues në qendër të qytetit në rrugën kryesore, jo vetëm që nuk përballon nevojat por paraqet rrezik për komunikacionin në rrugën kryesore dhe pamundëson rregullimin e sipërfaqes qendrore të qytetit, sipas planit urban. Nga kjo, rrjedh edhe nevoja për dislokim të tij sa më të shpejtë.

Dislokimi i stacionit të autobusave, ishte njëri nga problemet më të rëndësishëm, që e mundonte njësinë e vetëqeverisjes lokale, tashmë një kohë të gjatë por, për shkak të mungesës së mjeteve financiare, pushteti lokal nuk ishte në gjendje të zgjidh problemin.

Për zgjidhjen e këtij problemi, komuna ndër morri këto aktivitete:

1. Formoi skuadër;
2. Skuadra bëri analizë dhe përcaktoi situatën si vijon:
 - a. Definoj lokacion të ri për ndërtim të stacionit të autobusit në pronësi të Republikës së Maqedonisë, sipas planit urban detal në pronësi të Republikës së Maqedonisë;
 - b. Përgaditi dokumentacion teknik për ndërtimin e stacionit të ri të autobusave;
 - c. Palë të interesuar për ndërtimin e stacionit - Komuna e Kriva Pallankës dhe ndërmarrja për auto - transport, "Proleter" nga Kriva Pallanka;
 - d. E përcaktoi lartësinë e investimit.



Pas shqyrtimit të lartësisë së investimit, skuadra konstatoi se komuna nuk mundet me mjete të saja të rru-bullaksojë investimit (të ndërtojë objektin).

Skuadra pas shqyrtimit të situatës faktike, definoi këto hapa për realizimin e këtij projekti dhe këto hapa ia propozoj këshillit të komunës për aprovimin e tyre:

1. Kërkesë deri te Ministria për transport dhe lidhje për dhënie të lokacionit për stacion të autobusit në pronë të komunës.
2. Vendim, që për realizimin e projektit të gjinden partnerë strategjik nga ana e këshillit të komunës.
3. Formim të **partneritetit** ndërmjet palëve të interesuara me **investime** të përbashkëta (formim të komisionit, që do të definojë kushtet e marrëveshjes).

Pas marrjes së përgjigjes pozitive nga ana e Ministrisë për transport dhe lidhje, skuadra filloi me realizimin e fazave tjera të projektit. I definoi marrëdhëniet dhe obligimet e **partneritetit** në mes komunës dhe ndërmarrjes së auto-transportit, "Proleterit" nga Kriva Pallanka. U nënshkrua marrëveshje për **partneritet** publiko-privat.

Në realizimin e projektit u kërkua dhe u fitua përkrahje nga programi "Fondi komunal për zhvillim-mjete të përbashkëta" të UNDP-së.

Kështu, ky projekt u realizua me investim të përbashkët të Komunës së Kriva Pallankës, si pronar i lokacionit të stacionit të autobusit me përkrahje financiare të UNDP-së, me pjesëmarrje të komunës me mjete të saja dhe participim të ndërmarrjes për auto - transport, "Proleterit" nga Kriva Pallanka, si shfrytëzues i drejtpërdrejtë i objektit.

Stacioni i autobusave është pronësi e njësisë së vetëqeverisjes lokale, ndërsa participimi i ndërmarrjes lokale për auto-transport, "Proleterit" nga Kriva Pallanka është pjesëmarrje paraprake për shfrytëzimin e objektit për nevoja të saja, ndërsa 50% të të ardhurave nga shërbimet e shfrytëzuesve të tjerë do të jenë të ardhura të buxhetit të Komunës së Kriva Pallankës.

5.1. UDHËHEQJE ME CIKLUSIN E PROJEKTIT

Projekti është mjet për transferimin e fondeve të jashtme në realizimin e aktiviteteve krejtësisht të orientuara me qëllim të tejkalimit (zgjidhjes) të problemeve të identifikuara më parë në planet për zhvillim të njësisë së vetëqeverisjes lokale.

PËRGADITJE PËR PROJEKTIT- Mbledhja e informatave për programe të përshtatshme, që financojnë projekte

Përgaditja për realizimin e projekteve përfshin furnizim me të gjitha materialet informative për programet, që financojnë projekte. Zakonisht, këto janë të emëruar si kushte për pjesëmarrje (VADEMECUM) dhe formularë për kandidim (Application Forms). Shumë shpesh ata janë pjesë e një paketi informativ. Më së shpeshti janë të arritshëm nëpërmjet internetit, që e lehtëson arritshmërinë dhe plotësimin e tyre.

Paketi informativ i tillë duhet të lexohet me vëmendje, duke pasur kujdes për:

1. Kriteriumet e pjesëmarrjes (çfarë janë kërkesat ndaj organizatave - psh, me qenë OJQ, univerzitete, institute për hulumtime shkencore, njësi të vetëqeverisjes lokale, projekte që kërkojnë **partneritet** në mes subjekteve të ndryshëm etj.);
2. Nevojës për **partneritet** (në shumë programe të Unionit evropian, kërkohet **partneritet** me organizata të UE-së);
3. Prioritetet e programit (cilat janë lëmitë, që kanë përparësi në financimin e projekteve);
4. Suazat maksimale të financuara (nga kjo do të varet përmbajtja e projektit, që do të përgadisni) dhe
5. Afatet për aplikim të projektit - nga kjo do të varet intenziteti i punës suaj, gjatë përgaditjes së projektit.



5.1.1. Përpunimi i projektit

Elementi i parë themelor është formimi i skuadrës për përgaditjen e projektit. Pasiqë do të bëhet zgjedhja e programit, që do të mund të financojë projektin e caktuar, duhet të përgaditet plani për përgaditjen e projektit.

Skuadra duhet të formulojë projektin, gjegjësisht të planifikojë projektin. Por, para se të bëj këtë, skuadra duhet të ketë përgjigjet e pyetjeve të ardhshme:

- Cilat grupe sociale do të kenë fitim nga projekti?
- Në cilin rajon gjeografik do të implementohet projekti-lokacioni i saktë i punëve të projektit?
- Cilat janë qëllimet specifike të projektit?
- Cilat janë metodat dhe instrumentet për arritjen e qëllimeve të parashtruara?
- Sa do të kushtojë projekti?
- A është i arsyeshëm investimi?
- Cilat janë pritjet nga projekti?
- A do të gjenerojë zhvillim të qëndrueshëm realizimi i aktiviteteve të projektit?

Në rastet kur programet nuk kanë formularë për aplikim, që e përcaktojnë në mënyrë të përpiktë formën e projektit të prezentuar, atëherë egzistojnë elemente të caktuara të përbashkëta, që sigurojnë paraqitje të qartë dhe koncize të projektit.

Faqja e titullit

Nëse propozim-projekti është më i madh se 4 faqe, është mirë të shtohet edhe faqja e titullit. Në faqen e parë të titullit duhet të gjendet emri i projektit dhe emri i organizatës, që aplikon për projektin.

Përmbajtja

Nëse propozim-projekti është më i madh se 10 faqe duhet të ketë përmbajtje të projektit.

Rezume

Rezumeja gjithmonë është pjesë e levërdishme e propozim-projektit, edhe në rastet kur ai është relativisht i shkurtër. Mbajtësit e funksioneve në organizatat donatore nuk kanë gjithmonë kohë të lexojnë tërë propozim-projektin. Për këtë shkak, rezumeja duhet të përmbledh:

- deklaratë për projektin;
- qëllimet e projektit;
- organizatën e juaj;
- buxhetin.

5.1.2. Hapat themelor gjatë përgaditjes së projektit

Në fillim duhet të bëhet studimi detal i kërkesave për pjesëmarrje në program, nga të gjithë anëtarët e skuadrës-ky është kusht i domosdoshëm për punën e mëtutjeshme.

Përmbajtja e projektit

- Titulli i saktë i projektit;
- Përshkrim i punës së deri tani-shme (analizë e gjendjes) - definim i problemit, lokacioni i aktiviteteve të propozuara të projektit;
- Përshkrim i shkurtër i natyrës së projektit;
- Qëllimi kryesor i projektit dhe qëllimet tjera të projektit;
- Grupet qëllimore;
- Detyrat e projektit;
- Aktivitete të projektit;
- Plan për dinamikën e aktiviteteve - kalendarë i aktiviteteve;
- Rezultate të pritura;
- Qëndrueshmëria e projektit, pas implementimit të tij;
- Buxheti i projektit (të ardhura, harxhime dhe dinamika e buxhetit);
- Korrniza logjike e projektit.



Nëse përcillet e tërë skema për krijimin e projektit, hapi i ardhshëm është analiza e situatës egzistuese në lëminë, në të cilën do të përpunohet projekti. Por, para kësaj, zgjidhni emër të shkurtër por interesant për projektin. Është mirë emri të asocion në aktivitetin kryesorë të projektit ose në qëllimin gjeneral.

Analiza e gjendjes egzistuese, do të mundësojë definimin e saktë të problemeve egzistuese dhe do të mundësojë qëllimet dhe detyrat e projektit të formulohen në mënyrë të përshtatshme. Kjo fazë realizohet më së miri, nëse paraprakisht bëhet mbikëqyrje lokale e problemit. Në këtë mbikëqyrje, sipas rregullës, marrin pjesë anëtarët e skuadrës por mund të thirren edhe pjesëmarrës të jashtëm relevant. Gjithmonë duhen të merren parasysh lidhjet ndërmjet problemeve dhe paraqitja e tyre me ndihmë të diagrameve, gjatë realizimit të kësaj faze. Pastaj vjen definimi i qëllimeve dhe detyrave të projektit, që janë në korelacion të drejtpërdrejtë me problemet e definuara. Në bazë të qëllimeve dhe detyrave të definuara, bëhet definimi i saktë i grupeve qëllimore, për të cilët është i dedikuar projekti dhe aktivitetet direkte.

Definimi i saktë i aktiviteteve të projektit është me rëndësi themelore, sepse realisht ato e ndërtojnë bazën e projektit dhe janë mjete për realizimin e detyrave dhe realizimin e qëllimeve të projektit.

Mundohuni të realizoni kreativitet dhe profesionalizëm.

Pas përcaktimit të aktiviteteve konkrete, duhet të përgadisni plan për dinamikën e realizimit të tyre, gjegjësisht kalendarë të aktiviteteve, në të cilin në mënyrë precize do të saktësohen datat e fillimit dhe mbarimit të secilit aktivitet veç e veç. Gjatë kësaj, gjithmonë duhet të keni kujdes të jeni në suazat e kohëzgjatjes së projektit.

Pas përgaditjes së kalendarit të aktiviteteve, duhet të definohen dhe përcaktohen saktësisht rezultatet e pritura nga realizimi i aktiviteteve të projektit. Kjo pjesë është e lidhur ngushtë me qëllimet dhe detyrat e projektit. Qëllimi i saj është të sigurojë matësinë e rezultateve të projektit.

Zakonisht, në formularët e programeve të UE-së, ka pjesë për të ashtuquajturën qëndrueshmëri të projektit (Viability sustainability).

Në pjesën për qëndrueshmërinë e projektit, duhet të paraqiten argumente për mbrojtjen e pohimit se aktivitetet e projektit mund të vazhdojnë edhe pas mbarimit të financimit të tij. Pjesa "Qëndrueshmëria e projektit" (Sustainability of the project), është element themelorë. Projektet duhet të provohen në aspekt të qëndrueshmërisë, para se të fillon realizimi i tyre. Një projekt është i qëndrueshëm kur mundet të siguron levërdi për grupin qëllimor të paraparë, për një periudhë të gjatë, edhe pas mbarimit të ndihmës financiare.

Faktorë të mundshëm të qëndrueshmërisë, që duhet të merren parasysh gjatë përgaditjes dhe dorëzimit të projektit, janë: aspektet ekonomike dhe financiare, aftësitë për udhëheqje, zhvillimi institucional etj.

Këto faktorë, në masë të madhe, varen nga përmbajtja dhe specifika e secilit projekt. Kjo do të thotë se gjatë përgaditjes së çdo projekti të veçantë, duhet të përgaditet plan për qëndrueshmëri të projektit.

5.1.3. Përgaditja e buxhetit të projektit

Buxheti standard i projektit, përmban elementet e përmendura më poshtë:

Të ardhura: Shënoni listën e të ardhurave të pritura për projektin. Saktësisht precizoni shumën, të cilën e kërkon nga donatori.

Harxhime: Bëni listën e të gjithë harxhimeve të pritura të projektit, duke përfshirë edhe harxhimet indirekte. Sigurohuni se buxheti është i pranueshëm dhe real. Shpjegoni të gjitha detajet në fusnota. Ndani harxhimet direkte nga harxhimet operative.

Dinamika e buxhetit: Shpjegoni me vëmendje, në cilën fazë çfarë sasi e mjeteve është e nevojshme.

5.1.4. Përgaditja e tekstit të projektit

Në praktikë, me ndihmën e fazave paraprake përgaditen pjesë nga propozimi definitiv i projektit. Në suazat e kësaj faze, duhet të bashkangjiten të gjitha tekstet e përgaditura gjatë fazave paraprake; të bëhet sqarimi i



atyre pjesëve, që nuk janë të sqaruara sa duhet. Kështu, propozim-projekti fitohet, si rezultat i të gjitha aktiviteteve të përmendura.

Pastaj duhet të kompletohet korniza logjike e projektit, që në të vërtetë paraqet të gjitha fazat e projektit dhe ju ndihmon njerëzve që e përgadisin projektin të bëjnë strukturimin e vërejtjeve të tyre, më mirë dhe qartë të përshkruajnë projektin në mënyrë të standardizuar.

Pas përgaditjes definitive të projektit, është e domosdoshme, një anëtar i skuadrës të koordinon kompletimin e dokumentacionit dhe dërgimin, gjegjësisht dorëzimin në afatin dhe në adresën caktuar.


5.2. PLANIFIKIMI STRATEGJIK

Nëse nuk dini drejtimin kah jeni duke shkuar, nuk e dini as kur do të arrini atje. Planifikimi strategjik merret me këtë - ku dëshironi të shkoni dhe si të arrini deri aty.

Ja disa definicione të planifikimit strategjik:

- ◆ **Planifikimi strategjik** fokusohet në çështjet, mundësitë dhe problemet me rëndësi kritike për komunën. **Planifikimi strategjik** paraqet mundësi për udhëheqësit të shikojnë në mënyrë më reale problemet e përditshme. Ndhmon të gjenden zgjidhjet e rëndësishme.
- ◆ Planifikimi strategjik fokusohet në procesin e vlerësimit të kushteve të rrethinës; në analizën e anëve pozitive dhe negative dhe në pozitën e organeve shtetërore për shfrytëzimin e tyre gjatë sfidave dhe mundësive të brendshme.
- ◆ Procesi i planifikimit strategjik është proces i vazhdueshëm, që i ndihmon organizatës suaj të përballojë ndryshimet e pa shmangshme dhe të parashikoj ardhmërinë e saj. Rëndësia e këtij procesi qëndron në faktin se i mundëson organizatës të formulojë të ardhmen e saj, e jo vetëm të përgaditet për atë.

Procesi i planifikimit strategjik:



Planifikimi strategjik, ka shumë përparësi:

- Krijimin e kuptimit nga ana e publikut për tendencat dhe për atë se çka mund të sjell e ardhmja;
- Ndërtim të vizionit dhe konsenzusit të përgjithshëm publik dhe organeve të vetëqeverisjes lokale, në aspekt të qëllimeve;
- Identifikim të aktiviteteve themelore, që duhet të realizohen për arritjen e qëllimeve të komunës;
- Forcimin e partneritetit në mes organeve të administratës komunale, organizatave komunale të biznesit, për zgjidhjen e problemeve të ndërlukuara.

1. Identifikimi i palëve të interesuara. Palë e interesuar është çdo person ose grup, brenda ose jashtë organizatës, që kërkojnë vëmendje nga ana e komunës (ndikojnë në zgjidhjen e dhënë), mund të kontribuojnë me **resurse** ose të jenë të prekur nga zgjidhja e dhënë nga ana e komunës.



Përfshirja e palëve të interesuara në etapën e hershme të përgaditjes së strategjisë, është shumë e rëndësishme për definimin e qëllimeve, si dhe përgaditje më e madhe për përmbajtjen e zgjidhjeve. Palët e interesuara për zgjidhjet komunale, mund të përfshijnë njerëz dhe organizata të ndryshme: ndërmarrje, shfrytëzues të shërbimeve, bashkësi lokale dhe asociacione qytetare.

2. Analiza e gjendjes. Analiza përfshin mbledhje të informatave për kushtet e rajonit dhe tendencave të ardhshme, me qëllim të identifikimit të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, që do të ndihmojnë në hetimin e karakteristikave themelore të rrethinës:

- ◆ karakteristikat demografike të popullatës - mosha, gjinia, arsimimi, nacionaliteti dhe karakteristika tjera të popullatës;
- ◆ karakteristika ekonomike - sektore thelbësore ekonomike, **investime** lokale, biznes klimë (çka e bën komunën tërheqëse ose jotërheqëse për komunën), privatizimi, situata e ndërmarrjeve komunale;
- ◆ karakteristika sociale - rrjeti i institucioneve shëndetësore, institucioneve arsimore, kulturore etj;
- ◆ Infrastruktura / faktorë teknik - situata e ndërmarrjeve për shërbime komunale, furnizim me ujë, kanalizim, deponime për hedhurina të ngurta, sisteme për ujitje, rrjete rrugore, rrjete hekurudhore, transport publik, postë, telekomunikacioni, elektrifikimi, rrjeti i gazit etj;
- ◆ financa - burime lokale për financim dhe mjete nga transfere prej buxhetit të Republikës së Maqedonisë;
- ◆ ambienti jetësor - rregullimi urban i hapësirës, masa dhe aktivitete për mbrojtjen e ambientit jetësor;
- ◆ faktorë normativ - ndryshime, që do të ndikojnë mbi përgjegjësitë e komunë dhe **resurset**.

3. Analiza e anëve pozitive të komunës, analiza e mundësive dhe rreziqeve (SËOT). Çfarë është gjendja e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, nga të cilët komuna mund të ketë levërdi dhe çfarë janë pengesat e brendshme dhe të jashtme të zhvillimit të saj.

4. Përgaditja e vizionit të komunës. Cilat janë aspiratat ose qëllimet e publikut? Për shembull: "Të bëhet udhëheqës turistik i vendit me shërbyes më të mirë, të trajnuar për turizëm dhe hotelieri, si dhe në të njëjtën kohë të ofrojë për popullatën standard të lartë të shërbimeve publike.

5. Përcaktimin e prioriteteve të qëllimeve gjenerale. Qëllimet gjenerale janë qëllime të përgjithshme, më konkrete se vizioni, por jo aq detale sa qëllimet konkrete. Gjatë përgaditjes së qëllimeve gjenerale, ekipi për planifikim strategjik i përcakton prioritetet. Mjetet gjithmonë janë të kufizuara, për çka duhet të përcaktohet cilët qëllime gjenerale kanë prioritet më të madh se, sa qëllimet tjera.

6. Definimi i qëllimeve specifike. Qëllimet specifike strategjike janë formulime detale për atë se, si do të arrijë komuna qëllimet e gjenerale. Për çdo qëllim gjeneral duhet të përcaktohen qëllime specifike, sepse ato do të mundësojnë realizimin e qëllimit gjeneral.

Për shembull: Për realizimin e qëllimit specifik për përmirësimin e higjienës (pastërtisë), qëllimet specifike mund të paraqiten, si vijon:

- ◆ Gjatë vitit 2004 të sigurohen me mjete të reja për hedhurina 80% të blloqeve banuese në territorin e komunës."
- ◆ Gjatë vitit 2005, ndërmarrja për mirëmbajtjen e higjienës të zmadhojë sasinë e mbledhjes së hedhurinave dhe transportin e tyre në pjesën qendrore të qendrës komunale prej tre herë në katër herë në javë".



Qëllimet specifike duhet të shprehin kapacitetin e komunës (së bashku me partnerët e saj), gjegjësisht të shprehin rezultatet nga "analiza e rrethinës".

7. Përgaditje e alternativave. Një qëllim specifik, mund të realizohet sipas drejtimeve të ndryshme dhe çdo drejtim do të ketë çmim dhe efekt të ndryshëm.

Mundësitë alternative duhet të përpunohen nga personi ose grupi ose nga grupe të ndryshme.

8. Zgjedhje e strategjisë. Në këtë fazë, zgjedhet njëra nga alternativat e shumta për realizimin e qëllimeve të përcaktuara, që shëndërrohet në strategji të komunës. Është tejet e rëndësishme, zgjedhja e strategjisë të mbështetet në kriteriume të qarta për zgjedhje të alternativave, si psh niveli i arritshmërisë, harxhimeve ose niveli i të ardhurave. Strategjia duhet të shndërrohet në një nga dokumentet udhëheqëse të komunës, i pranuar dhe përmbajtur nga administrata, organizatat partnere dhe nga qytetarët.

Për këtë, strategjia e aprovuar duhet me qenë mirë e paraqitur dhe e ndarë me të gjitha palët e interesuara dhe duhet të kalojë nëpër fazat e ardhshme:

1. Përgaditje të projekt-verzionit të strategjisë dhe përgaditje të diskutimit publik për projekt verzionin e strategjisë;
2. Përfshirje të vërejtjeve dhe propozimeve gjatë diskutimit publik për projekt-verzionin e strategjisë, në propozim-verzionin e strategjisë;
3. Paraqitjen e propozimit të strategjisë para këshillit të komunës për aprovim.

9. Realizim i strategjisë

Përgjegjësitë për realizimin e strategjisë, duhet të përcaktohen në mënyrë të qartë në mes njërive të komunës dhe organizatave partnere. Ato janë përgjegjëse për përgaditjen e planeve konkrete për veprim dhe për mjetet financiare për realizimin e strategjisë.

10. Vlerësim dhe monitoring të strategjisë. Fazë e rëndësishme në **planifikimin strategjik** është krijimi i sistemeve të monitoringut dhe vlerësimit, me përfshirje të gjërë të publikut (pjesëmarrje) në realizimin e qëllimeve gjenerale dhe qëllimeve konkrete, të përfshirë në strategjinë e komunës. Mbikëqyrja është e rëndësishme, sepse lejon të bëhen përmirësime, nëse përparimi nuk kënaq ose kushtet ndryshohen. Është me rëndësi të veçantë para publikut të paraqitet llogari për përparimin drejt realizimit të qëllimeve gjenerale, që qytetarët të shohin se, si komuna punon për realizimin e qëllimeve të përgjithshme.

Fjalë kyçe: planifikim strategjik, partneritet, resurse, investime, implementim.

Korrniza ligjore:

- Ligji për shoqëri tregtare ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 28/2004);
- Ligji për veprimtari hotelierike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 62/2004);
- Ligji për veprimtari turistike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 62/2004);
- Ligji për kryerje të veprimtarisë së artizanateve ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 62/2004);
- Ligji për themelim të Agjensionit për përkrahje të sipërmarrjes së Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr 60/2003);
- Ligji për planifikim hapësinor dhe urban ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr 45/2002).





6 PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE URBANISTIK

Katica Dimovska Taleska

Në vend të hyrjes i përdorim fjalët e autorit: " Planifikimi hapësinor është tejet i rëndësishëm për zhvillimin e përgjithshëm të komunës. Me ndihmën e e informatave për resurset natyrore, për gjendjen dhe drejtimit e zhvillimit, që i ofrojnë planet hapësinore qytetarët, gjegjësisht subjektet juridike mund të drejtojnë në mënyrë të rregullt interesin e tyre për punë, për jetesë, kulturë etj."

6.1. PLANIFIKIMI HAPËSINOR

Njëra ndër sfidat më të mëdha të procesit të decentralizimit është planifikimi urbanistik dhe dhënia e lejeve për ndërtim. Edhe deri më tani komunat janë kujdesur për përpilimin dhe sjelljen e planeve urbanistike por tash do të kujdesen edhe për realizimin e tyre, gjegjësisht për dhënien e lejeve për ndërtim, me çka qytetarët do të mund të realizojnë të drejtat e tyre në komunë. Procesi i planifikimit urbanistik është integral dhe zhvillohet në kontinuitet. Për këtë, në këtë tekst, të nderuar këshilltarë, përveç për planifikimin urbanistik, do të flasim, shkurt, edhe për planifikimin hapësinor, si proces i rëndësishëm për zhvillimin e komunave.

6.1.1. Çka është plani hapësinor dhe cili është qëllimi i tij

Plani hapësinor paraqet njërin nga dokumentet më të rëndësishëm për zhvillimin e përgjithshëm të shtetit. Me planin hapësinor përcaktohet organizimi funksional i hapësirës së shtetit, qëllimet dhe konceptcionet për zhvillim hapësinor, sipas lëmive të veçanta (truall, popullsi, ekonomi, infrastrukturë, ambient jetësor, trashëgimi kulturore e ndërtuar, shkatërrime luftarake, fatkeqësi natyrore dhe teknologjike).

Plani është strategji për zhvillim hapësinor të Republikës, që jep kahje për dedikueshmërinë, shfrytëzimin, mbrojtjen, organizimin, rregullimin dhe udhëheqjen me hapësirën në Republikë.

Plani hapësinor është plan i përhershëm, që bazohet në gjendjen egzistuese të të mirave, me të cilat disponon Republika. I lidh, organizon dhe baraspeshon në hapësirë, nëpërmjet boshteve të vendosura për zhvillim. Plani jep kahjet dhe propozon zgjidhje për lidhje me vendet tjera në rajon.



Qëllimet themelore të planit, janë:

1. Konsiderimi i faktorëve real për zhvillim;
2. Ndërrmarje e masava stimulative nga ana e fondeve shtetërore dhe fondeve tjera dhe llojeve tjera të ndihmës për programet e njësive lokale dhe afaristëve;
3. Vendosje e parimeve të tregut të lirë dhe formimin e kornizës adekuate institucionale, në të cilën do të mund të funksionojnë institucionet e tregut të lirë.
4. Krijim të ambientit të diferencuar rajonal për ekonomi, me ndihmë të politikës së përshtatshme.

6.1.2. Lloje të planeve hapësinore

Llojet e planeve janë të përcaktuara varësisht nga hapësira, që është objekt i planifikimit. Në vendin tonë përgaditet Plan hapësinor i Republikës, derisa Plani hapësinor i rajoneve dhe Plani hapësinor i rajonit me interes të posaçëm për Republikën, janë pjesë përbërëse të Planit hapësinor të Republikës.

Shembull: për "Rashçen" është sjellur plan hapësinor, si rajon me interes vital për Qytetin e Shkupit dhe për Republikën.

Shembull: parku nacional "Galiçicë" është tërësi hapësinore me rëndësi të posaçme për Republikën dhe për këtë duhet të përpilohet plan hapësinor.

Plani hapësinor i Republikës

Plani hapësinor i Republikës, sillet për gjithë territorin e Republikës.

Plani hapësinor për rajon sillet për rajon të përcaktuar me Planin hapësinor të Republikës, si tërësi gjeografike, ekonomike ose funksionale.

Plani hapësinor për rajon me interes të posaçëm për Republikën, sillet për park nacional, rajone të mbrojtura, korridore trafiku, korridore energjetike, akumulacione dhe burime të ujit, rajone për turizëm dhe rekreacion, rajone me eksploatacion të madh të lëndëve të para minerale dhe rajone të tjera me rëndësi për Republikën, që janë të përcaktuara me Planin hapësinor të Republikës

6.1.3. Përmbajtja e planit hapësinor të Republikës

Në fillim të secilit plan hapësinor, paraqiten qëllimet dhe supozimet themelore të planit dhe karakteristikat gjeostrategjike të hapësirës, për të cilën përpilohet plani.

Çdo kapitull i planit hapësinor përmban tre komponente themelore - bazën fillestare, qëllimet dhe përcaktimet planifikuese dhe tregues të bilancit.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e sjell Planin hapësinor të Republikës, ndërsa Plani hapësinor për rajon dhe Plani hapësinor për rajone me rëndësi të posaçme për Republikën, sillen si ndryshime dhe plotësime të Planit hapësinor të Republikës. Planet hapësinore sillen për, më së paku, 15 vjet.

Pas skadimit të këtyre afateve, aprovuesi i planit autorizon revizion të planit, me të cilin përcaktohet nëse është i nevojshëm ndryshimi dhe plotësimi i planit.

Planet hapësinore të sjellura, si plane të rëndësishme për zhvillimin e shtetit vërtetohen në katër egzemplarë, nga të cilët njëri ruhet në arkivin e organit, i cili është i autorizuar për sjelljen e planit; një egzemplarë ruhet në arkivin shtetëror; një egzemplarë i dorëzohet organit të administratës shtetërore - kompetent për punët në lëminë e planifikimit hapësinor dhe një egzemplarë i dorëzohet organit të administratës shtetërore - kompetent për punët në lëminë e rregullimit të hapësirës.



6.1.4. Planifikimi hapësinor si instrument për zhvillimin e komunave

Planifikimi hapësinor është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e përgjithshëm të komunave.

Nëpërmjet informatave, që ofrojnë planet hapësinore për resurset natyrore, për situatën dhe drejtimit për zhvillim, qytetarët, gjegjësisht subjektet juridike mund në mënyrë të drejtë të drejtojnë interesin e tyre për punë, jetesë, kulturë dhe të ngjajshme.

Me krijimin e parakushteve të planifikuara për hapjen-ndërtimin e subjekteve të reja ekonomike, vihen në lëvizje kapacitetet egzistuese ekonomike, hapen vende të reja të punës për popullatën e rajonit. Me punësimin përmirësohet gjendja socio-ekonomike e popullatës dhe realizohen buxhetet e komunave. Buxhetet e komunave realizohen nga tatimet, që i paguajnë qytetarët. D.m.th. komunat do të jenë në pozitë të kryejnë kompetencat e tyre.

Planet hapësinore mundësojnë edhe komponentë të barabartë zhvilluese të të gjithë territorit të shtetit dhe komunës.

Shembull: në rajonin e Tikveshit, njerëzit janë të interesuar për kultivimin e vreshtave dhe prodhimeve të rrushit, në rajonin e Strumicës, njerëzit janë të interesuar për prodhimin e perimeve të hershme, në rajonin e Ohrit dominon turizmi, në rajonin e Prilepit përpunohet duhani dhe guri, në rajonin e Pollogut dominon blegtoaria etj

6.1.5. Lidhja në mes planifikimit hapësinor dhe planifikimit urban

Planifikimi hapësinor dhe planifikimi urban janë procese në kontinuitet të nënrenditur dhe janë të lidhur në mes tyre.

Plani hapësinor i Republikës së Maqedonisë është dokumenti më i lartë planifikues, në të cilin janë të dhëna drejtimit për përpilimin e dokumeneteve më të ulta planifikuese, gjegjësisht planet urbane.

Planet urbane përgaditen në pajtim me Planin hapësinor të Republikës në aspekt të elementeve, si vijon:

- strategjisë për zhvillim ekonomik të shtetit;
- bazës për ekonomizim me ujërat,
- planit të përgjithshëm për ekonomizim me malet,
- bazës së përgjithshme të gjuetisë,
- strategjisë për zhvillim të energjetikës dhe bazave të tjera,
- programeve dhe planeve zhvilluese me interes publik,
- dedikimit dhe shfrytëzimit të hapësirave,
- politikës afatgjate të urbanizmit,
- rrjetit të infrastrukturës së madhe (magjistrale),
- rrjetit të vendbanimeve, mbrojtjes së ambientit jetësor dhe të ngjajshme.

Shembull: aprovuesi i planit gjeneral urban, planit urban për vendbanim dhe planit urban për rajon jashtë vendbanimit, është i obliguar të kërkojë kushte për planifikim në hapësirë, nga organi i administratës shtetërore - kompetent për punët në lëminë e planifikimit hapësinor.

Çdo plan në nivel më të ulët duhet të përmbajë kushte për planifikim (parametra të përgjithshëm dhe të veçantë dhe shtesë grafike) nga plani nga niveli më i lartë, me të cilin paraqiten drejtimit për përpilimin e planit.

6.2. PLANIFIKIMI URBAN

6.2.1. Çka është plan urban dhe cili është qëllimi i tij

Me planet urbane rregullohen qytetet dhe vendbanimet, njësoj sikurse secili nga ne rregullon vendin e jetesës së tij. Që të rregullohet, ato duhen të organizohen sipas normave të aprovuara. Kështu edhe qytetet, që një bashkësi e vendbanimeve të shumta organizohen dhe rregullohen sipas normave dhe standardeve të përcaktuara.



6.2.2. Lloje të planeve urbane

Llojet e planeve urbane janë të përcaktuara varësisht prej hapësirës, që është objekt i planifikimit dhe shkallës së të dhënave, që i jep plani. Te ne përpilohen dhe sillen këto **plane urbane**:

- Plan urban gjeneral;
- Plan detal urban;
- Plan urban për vend të banuar dhe
- Plan urban për territor jashtë vendit të banuar.

Shembull: plani urban, gjeneral sillet për qytetet: Shkup, Kumanovë, Shtip, Strumice, Prilep, Krushevë, Gostivar, si dhe selitë e komunave. Plani urban gjeneral ka rëndësi strategjike për zhvillimin e selive të komunave.

Plan urban gjeneral

Plani urban gjeneral sillet për: Qytetin e Shkupit dhe për qytetet, që janë seli të komunave.

Me planin urban gjeneral definohet përfshirja e planifikuar e qyteteve, gjegjësisht kufiri deri ku shtrihet qyteti.

Plani urban detal

Plani urban detal përpilohet dhe sillet për përfshirje të planifikuar, për çka është sjellur **plani urban** gjeneral. Përfshirja e planifikuar e qytetit, mund të ndahet në përfshirje më të vogla të planifikuara për shkak të shqyrtimit më të mirë të organizimit hapësinor. Përfshirjet e planifikuara në qytet janë sipërfaqe, që paraqesin tërësi funksionale, e rrumbullaksuar me rrugë, rrjedhje ujore ose lloje të tjera të kufijve natyrorë.

Plani urban detal jep të dhëna konkrete për ndërtim të ndërtesave për çdo parcelë urbanistike.

Shembull: për qytetin është sjellur plan urban gjeneral, me të cilin qyteti është i ndarë në përfshirje më të vogla të planifikuara, me sipërfaqe deri 30 Ha të shenjzuara me numra. Çdo përfshirje e planifikuar paraqet një tërësi funksionale dhe për atë mund të përpilohet plan urban detal.

Plan urban për vend të banuar

Plani urban për vend të banuar sillet për sipërfaqe të banuar me karakter të fshatit. Në komunat **plani urban** për vend të banuar, përpilohet dhe sillet për të gjitha vendbanimet fshatare në komunë.

Plan urban për sipërfaqe jashtë vendit të banuar

Plani urbanistik për sipërfaqe jashtë vendeve të banuara, përpilohet dhe sillet për rajone rurale, komplekse dhe ndërtesa jashtë vendeve të banuara, gjegjësisht sipërfaqe, që nuk janë përfshirë me **planin urban** gjeneral ose **planet urbane** për vendet e banuara.

6.2.3. Çfarë interesi kanë trupat e komunës nga planet

Planet urbane janë dokumente shumë të rëndësishme për komunën, sepse janë bazë për zhvillim socio-ekonomik dhe për zhvillim kulturor të komunës.

Çdo komunë, që dëshiron të zhvillojë ekonominë e saj, që dëshiron t'ju mundësojë kushte më të mira për jetesë banorëve të saj duhet, patjetër, të sjell, të revidojë, plotësojë dhe ndryshojë **planet urbane**, duke i përcjellur tendencat bashkëkohore për zhvillim në vend dhe botë.



Nëpërmjet **planeve urbane** trupat e komunës realizojnë programet e aprovuara për rregullim komunal, për ndërtimin e rrugëve lokale, rrjeteve të ujësjellësit, kanalizime fekale dhe atmosferike, mborjtje të ambientit jetësor dhe të ngjajshme. Administrata komunale e vetëqeverisjes lokale i udhëheq procedurat për sjelljen e planeve urbane. Nëpërmjet realizimit të **planeve urbane**, realizohen edhe të ardhura për komunën, si kompenzim për rregullimin e truallit ndërtimor. Këshilli i komunës, nëpërmjet trupave të tij punues, gjithnjë merr pjesë në sjelljen e **planeve urbane**. Këshilltarët i aprovojnë **planet urbane** me sjelljen e vendimit, i cili është pjesë përbërëse e planit.

6.2.4. Çfarë interesi ka popullata lokale nga planet urbane

Planet urbane kanë rëndësi të madhe për popullatën lokale, sepse kanë ndikim të drejtëpërdrejtë mbi kushtet e jetesës dhe punës së tyre.

Planet urbane të aprovuara, ju mundësojnë qytetarëve të realizojnë të drjetat e tyre për ndërtim të objekteve të karakterit ekonomik, objekteve për banimin, objekteve afariste dhe objekteve publike. Me ndihmën e **planeve urbane** organizohet truallit ndërtimor në parcela ndërtimore, zgjidhen çështje të caktuara pronëso-ro-juridike, mundësohet mbiformimi i parcelave ose blerja e truallit ndërtimor, mundësohet ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme deri te objektet dhe të ngjajshme.

Rëndësia e planit është në atë se qytetari mund të realizojë nevojën për ndërtim të çdo lloji të objekteve. Nëse objekti është afarist, do të mundësojë edhe punësime të tjera dhe përmirësim të kushteve socio-ekonomike edhe për qytetarët tjerë, që do të punësohen në objektin afarist. Aktivizimi i subjekteve të reja afariste e përmirëson edhe gjendjen e përgjithshme në komunë, duke bërë shtytje të zhvillimit të saj të përgjithshëm.

6.2.5. Kush është përgjegjës për planet urbane

Përgjegjës për përpilimin dhe sjelljen e **planeve urbane**, janë komunat dhe Qyteti i Shkupit.

Përgjegjësia për **planet urbane** mund të ndahet në dy lloje:

6.2.6. Procedura për përpilimin dhe sjelljen e planeve urbane

● Përpilimi i planeve urbane

Përpilimi i **planeve urbane** realizohet në dy faza: si **projekt-plan** dhe **propozim-plan**.

Për përpilimin e **planeve urbane** për komunat dhe Qytetin e Shkupit, këshilli i komunës dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit sjellin program vjetor, me propozim të seksionit-kompetent për punët e planifikimit urban të komunës dhe Qytetit të Shkupit. Gajtë përpilimit të planit, merren parasysh niveli i realizimit dhe kërkesat e qytetarëve për nevojën e përpilimit të **planit urban**, të fituara nëpërmjet shpalljes për përpilimin e programeve vjetore.

Shembull: vjen qytetari në komunë dhe kërkon nga shërbimi profesional leje për ndërtim të shtëpisë familjare. Gjegjësisht, parcela e tij është e madhe ndërsa ai ka ndërtuar shtëpi të vogël familjare. Familja e tij është zmadhuar dhe ai ka nevojë për mbindërtim të shtëpisë familjare, që të mundësojë për familjen kushte bashkëkohore dhe humane për jetë.

- Nëpunësi shikon në regjistrin e planeve, nëse për venbanimin ku gjendet shtëpia e tij është sjellur plan urban detal dhe konstaton:

Rasti i parë (nëse plani është sjellur)

- nëpunësi e hap planin dhe shikon në planin se qytetari mund të ndërtojë sipërfaqe më të madhe dhe të zmadhojë lartësinë e shtëpisë së tij familjare dhe e udhëzon qytetarin në procedurën e duhur për fitimin e lejes për ndërtim.

- D.m.th. plani urban i sjellur ka mundësuar, që qytetari të realizojë të drejtën për ndërtim menjëherë. Qytetari, i kënaqur largohet për të filluar procedurën e ndërtimit të shtëpisë familjare.

- Me ndërtimin e shtëpisë familjare, qytetari do t'i mundësojë familjes së tij zhvillim të rregullt psiko-fizik dhe socio-ekonomik;

Shembull (nëse plani nuk është sjellur): nëpunësi e lajmëron kërkuesin se nuk mund të ndërtojë shtëpi më të madhe familjare. Qytetari largohet i pakënaqur, duke mos mundur të realizojë nevojat dhe të drejtat e tij deri në momentin e sjelljes së planit urban detal për vendbanimin, në të cilin jeton ai. D.m.th. famlja e tij do të jetojë në kushte jashtë standardit edhe më tutje. Kjo do të ndikojë drejtë për drejt në zhvillimin e tyre psiko-fizik dhe socio-ekonomik.



Programet për përpilimin e **planeve urbane**, dorëzohen deri te ministritë - kompetente për punët në lidhje me rregullimin e hapësirës, për shkak të parashikimit të objekteve me rëndësi për shtetin. Planet urbane nga ky program, financohen nga buxheti i komunës dhe Qytetit të Shkupit.

PËRGJEGJËSIA E PARË është për procedurën dhe dinamikën e sjelljes së tyre. Vetëqeverisja lokale nëpërmjet seksionit për urbanizëm dhe punë komunale-njësi për planifikim urban është përgjegjëse për procedurën e sjelljes së planeve urbane dhe për planifikimin se, cilat plane urbane do të përpilohen. Dinamika e përpilimit të planeve urbane është në varësi të drejtë për drejt nga fuqia financiare e komunës dhe qytetarëve. Këshilli i komuës, poashtu është përgjegjës për planet urbane, si aprovues i tyre.

PËRGJEGJËSIA E DYTË është për saktësinë dhe kualitetin e tyre, si dhe për respektimin e dispozitave ligjore dhe kërkesave të qytetarëve. Përpiluesit e planeve janë përgjegjës, në mënyrë të drejtpërdrejtë, për përmbajtjen, saktësinë dhe kualitetin e planit; për nivelin e aplikimit të dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore, në suazat e të cilave janë të kënaqura kërkesat e qytetarëve. Nga përgjegjësia nuk mund të largohen edhe qytetarët. Përgjegjësia e tyre është e paraqitur nëpërmjet anketimit, para fillimit të diskutimeve profesionale për planet.

Shembull: në procedurën për sjelljen e planir urban detal, organizohet anketë e hapur. Me shpallje thirren qytetarët, të cilët jetojnë në atë pjesë të vendbanimit të vijnë, të shohin në planin e ekspozuar se çka është paraparë në parcelën e tyre. Në këtë mënyrë, janë të kyqur në procedurën për sjelljen e planit urban. Kyqja e qytetarëve, ka për rezultat sjelljen e planeve më kualitative dhe më reale. Përgjegjësia e qytetarëve është në obligimin e tyre të vijnë dhe të japin sugjerimet dhe mendimet e tyre të lidhur me planin, sepse pas aprovimit të planit, mendimet e tyre nuk mund të mirren parasysht.

Programet publikohen në gazetata zyrtare të komunave dhe të Qytetit të Shkupit.

Gjatë përpilimit të planeve, shfrytëzohen standarde dhe norma të dedikuara për planifikim.

Agjensioni për planifikimin e hapësirë, përpilon **plane urbane** nga Programi i Qeverisë së Republikë së Maqedonisë.

Planet urbane nga programet e komunave dhe Qytetit të Shkupit, i përpilojnë ndërmarrje të autorizuara për përpilimin e **planeve urbane**.

Bartës të planifikimit të përpilimit të **planeve urbane** munden me qenë inxhenjerë të diplomuar-arkitekt, që posedojnë licencë për përpilimin e **planeve urbane**.

● Sjellja e planeve urbane

Kur projekt-plani urban përpilohet dhe dorëzohet deri te organet kompetente, bëhet revizion profesional i tij. Vërejtjet nga revizioni profesional i shtohen projekt-planit urban. Organizohet diskutim profesional për **plan urban gjeneral** dhe prezentim dhe anketë publike për **plan urban detal**, **plan urban** për vend të banuar dhe **plan urban** për sipërfaqe jashtë vendit të banuar.

Nga diskutimi profesional, nga prezentimi dhe nga anketa publike përgaditet raport me vërejtje të definuara qartë, të pranuar dhe të pa pranuar. Ky raport dorëzohet deri te përpiluesi i planit urban për përpilimin e propozim-planit urban.

Për propozim-planet urbane duhet të merret pëlqimi nga organi i administratës shtetërore-kompetent për punët për rregullimin e hapësirës. Propozimi-plani dorëzohet dreri te këshilli i komunave dhe deri të Këshilli i Qytetit të Shkupit për aprovim.

Këshillat e komunave dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit kanë trupa punues, të cilët shqyrtojnë **planet urbane** dhe japin leje për aprovimin e tyre.

Komisioni i formuar nga kryetari i komunës, përgadit raport nga anketa publike. Ky komision është i përbërë prej tre anëtarëve: nga personi përgjegjës për planifikim, personi përgjegjës nga komuna (nga seksioni për **urbanizëm**) dhe anëtar i jashtëm (bashkëpunëtorë i shquar shkencor dhe profesional, me licencë).

Administrata komunale është e obliguar me shkrim të informojë qytetarët, të cilët kanë dorëzuar listë anketuese nëse janë pranuar ose jo kërkesat e tyre.

Plani mund të kthehet përsëri në anketë profesionale me prezentim publik, nëse vlerësohet se ndryshimet e paraqitura janë me karakter të madh.



● Diskutimi profesional

Organizmin e diskutimit profesional për **plan urban gjeneral** e bën kryetari i komunës, si dhe kryetari i Qytetit të Shkupit.

Në diskutimin profesional marrin pjesë: përfaqësues të përpiluesit të planit, administratës shtetërore, vetëqeverisjes lokale, shërbimeve për mbrojtje të përmendorëve të kulturës, ndërmarrjeve komunale dhe organeve tjera nga sipërfaqja e përfshirë me plan. Në diskutimin profesional paraqitet dhe shpjegohet plani, ndërsa secili nga të pranishmit mund të shprehë mendimin e tij me vërejtje, propozim dhe sugjerim. Komisioni profesional përgadit raport nga diskutimi profesional me vërejtje të definuara qartë, të pranuar dhe të pa pranuar.

● Propozim - plani

Propozim plani është verzioni definitiv i **planit urban** me vërejtjet e përfshira nga revizioni profesional dhe nga raportet nga anketa publike me prezentim publik dhe diskutimit profesional, i përgaditur për marrjen e pëlqimit dhe për aprovim.

● Pëlqimi

Organi i administratës shtetëror - kompetent për punët për rregullimin e hapësirës, kontrollon nëse propozim-planin urban është i përpiluar në pajtim me dispozitat egzistuese ligjore dhe jep pëlqim për propozim **planin urban** në afat prej 30 ditëve.

Këshillat e komunave dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit, aprovojnë **planet urbane**. Karakteristikë e Qytetit të Shkupit është se Këshilli i Qytetit të Shkupit aprovon vetëm planin urban gjeneral. Komunitat e aprovojnë planin urban detal, **planin urban** për vend të banuar dhe **planin urban** për sipërfaqe jashtë vendit të banuar.

Komunitat e Qytetit të Shkupit për sjelljen e **planit urban** për sipërfaqe jashtë vendeve të banuara, duhet të marrin mendim pozitiv nga organet e Qytetit të Shkupit.

Nga dita e marrjes së pëlqimit për planin, plani duhet të aprovohet në afat prej 2 muaj.

Planin urban gjeneral dhe **planin urban** për vend të banuar sillen për (me së paku) 10 vjet, ndërsa planin urban detal për 5 vjet.

Pas skadimit të këryte afateve, aprovuesi i planit lejon revizion të planit, me të cilin vërtetohet nëse ka nevojë për ndryshim dhe plotësim të planit. Ndryshimi dhe plotësimi i **planeve urbane**, kryhet sipas procedurës së njëjtë për aprovimit të **planeve urbane**.

6.2.7. Mungesat e planeve urbane

Edhe **planet urbane** kanë mungesat e tyre, duke pasur parasysh faktin se asgjë nuk është ideale.

● Kufizime të panevojshme

Shumë herë, në **planet urbane**, planifikuesit paraqesin drejtime rreptësisht të definuara për ndërtim, duke mos e konsultuar popullatën për nevojat dhe mundësitë e tyre. Ky qëndrim mundet me qenë pengesë për realizimin e **planeve urbane**.

Revizionin profesional për planet urbane e kryen personi juridik i autorizuar, të cilin e përcaktojnë organet e komunave dhe Qytetit të Shkupit. Nga revizioni profesional përgaditet raport me vërejtje dhe sugjerime, që duhet me qenë pjesë e planit. Përpiluesi i planit paraqet raport për sjelljen sipas revizionit profesional. Këto dokumente janë pjesë përbërëse e planit. Përcaktimin e projekt-planit për organizim të prezentacionit publik dhe anketës publike për planet urbane, e bën këshilli i komunës, me sjellje të vendimit. Prezentimi publik dhe anketa publike janë pjesë e procedurës, në të cilën qytetarët janë të kyqur në mënyrë intenzive. Prezentim publik dhe anketa publike për planet urbane detale, planet urbane për vend të banuar dhe planet urbane për sipërfaqe jashtë vendit të banuar, organizon kryetari i komunës. Planin shfaqet në vend publik në rrethin e bashkësisë lokale, së paku 30 ditë. Qytetarët mund të shohin planin dhe në listat anketuese të shënojnë vërejtjet, mednimet dhe sygjerimet e tyre. Prezentimin publik të planit e bëjnë persona profesional në organizim të kryetarit të komunës.



Për shembull, në planin urban detal për një vendbanim familjar është paraparë, që objektet duhet të kenë kulmin nga një material, me kufizim të pjerrësisë së kulmit. Popullata, e cila jeton në atë vendbanim nuk dëshiron të ndërtojë objektet e tyre me material të vjetëruar por dëshiron të ndërtojë kulm me materiale bashkëkohore, estetike dhe ekologjike të pastërta. Sipas planit egzistues kjo nuk mund të bëhet, për çka do të kërkohet të bëhet ndryshim dhe plotësim i planit. Në këtë rast, aprovuesi i planit do të duhet të plotësojë kërkesat e qytetarëve.

Duhet të përmendet se ndonjëherë është mjaft delikate pranimi i kërkesave të popullatës dhe bashkangjitja e tyre planit urban, sepse jo gjithmonë kërkesat janë në pajtim me dispozitat ligjore.

Duhet të përmendet se përpilimi i planeve është punë e shtrenjtë dhe, në rastet më të shpeshta, varet nga mundësitë financiare të komunës.

Shembull: Plani urban gjeneral për qytetin, duhet me qenë në pajtueshmëri me Planin hapësinor të Republikës;

Shembull: Plani urban detal, duhet të jetë në pajtueshmëri me planin urban gjeneral.

● Mungesa e planit të përshtatshëm

Mungesa e **planeve urbane** ka për rezultat ndërprerjen e zhvillimit socio-ekonomik dhe kulturor të komunave dhe popullatës së tyre.

Mungesa e **planeve urbane** ka për rezultat ndërprerjen e ndërtimit të të gjithë objekteve. Posaçërisht janë të rëndësishme objektet afariste, nëpërmjet të cilave në mënyrë të drejtë për drejt ndikohet në punësimin e personave të papunësuar dhe përmirësimin e standardit të tyre të jetës.

Dhënia e truallit, formimi i parcelave urbane, zgjidhja e marrëdhënieve pronëso-ri-juridike dhe të ngjajshme, nuk mund të kryhet nëse nuk ka **plan urban detal**.

Nëse mungon plani urban gjeneral, komuna nuk ka strategji për zhvillim, nuk mund të realizojë programet për punë, posaçërisht objektet e infrastrukturës komunale dhe infrastrukturës tjetër dhe të ngjajshme. Në këtë rast, mund të vijë deri te zhvillimi i pa organizuar i komunës.

Thënë në përgjithësi, me mungësën e planeve, puna e komunës, si shërbuese e qytetarëve, do të jetë e vështirësuar.

● Jokonsekuenca e planeve urbane

Nëse për vendbanimin nuk janë sjellur të gjitha **planet urbane**, sipas hierarkisë së përcaktuar, paraqitet problemi i jokonsekuencës. Problemi i jokonsekuencës mund të vështirësojë dhe mund të ndërprejë ndërtimin e të gjitha llojeve të objekteve. Qytetarët nuk do të mund të realizojnë të drejtat e tyre, në aspekt të truallit dhe përmirësimin të kushteve për jetesë dhe punë.

Kjo nuk do të thotë se planifikimi duhet të bëjë vetëm evidentimin e situatës egzistuese. Procesi i planifikimit duhet të bashkojë të gjitha kushtet në një tërësi funksionale, gjithsesi, duke respektuar situatën egzistuese.

6.2.8. Lidhja në mes planeve urbane

6.2.9. Akte të tjera në përbërje të planifikimit urban

● Projekt urban

Projektin urban, përveç zgjidhjes së situatës me rrugët e trafikut dhe parcelave ndërtimore, zgjidhjes së sipërfaqeve për ndërtim, linjeve ndërtimore, lartësisë maksimale, zgjidhjes përdhese, zgjidhjes së gjelbërimit, zgjidhjes së linjave themelore të infrastrukturës, përmban edhe zgjidhje ideore të objektit.

Proejtki urban përpilohet kur në një **parcelë ndërtimore** ka më tepër hapësirë për ndërtim, ndërsa për këtë parcelë egziston **plan urban detal**, **plan urban** për vend të banuar dhe **plan urban** për sipërfaqe jashtë vendit të banuar.

Me projektin urban bëhet precizimi i kushteve për ndërtim.

Projektin urban e financo investuesi, ndërsa e përgadit personi i autorizuar juridik.



Për ndërtesa me interes shtetëror, siç janë: korridoret e trafikut, sistemet e infrastrukturës, zona të lira ekonomike dhe të ngjajshme, duhet të përgaditet projekt urban, në bazë të kushteve të dhëna për planifikim të hapësirës.

Për këtë lloj të projektit urban, përgaditet revizion profesional dhe organizohet diskutim profesional dhe fitohet pajtueshmëri nga ministri - kompetent për punët e rregullimit të hapësirës.

Në bazë të projekti urban fitohet vendim për kushtet e lokacionit.

6.3. DHËNIE E LEJES PËR NDËRTIM

6.3.1. Çështje leje për ndërtim

Leja për ndërtim paraqet dokument, me të cilin lejohet ndërimi. Për të fituar **leje për ndërtim**, duhet paraprakisht të kryhen më tepër aktivitete nga lëmia e ndërtimit.

6.3.2. Planet urbane në procedurë të dhënies së lejes për ndërtim

Planet urbane (në kapitullin "B") të përshkruara më lartë, janë parakusht për dhënien e lejeve për ndërtim, sipas procedurës së përcaktuar.

Zgjidhjet e planifikuara në planet urbane, ju shpallen qytetarëve nëpërmjet ekstrakteve të **planeve urbane**.

Ekstrakti nga **plani urban**, paraqet bazë për përgaditjen e zgjidhjes ideore arkitektonike, që është e nevojshme për lëshimin e lejes për kushtet e lokacionit.

Posaçërisht të rëndësishëm janë plani urban detal, **plani urban** për vend të banuar dhe **plani urban** për sipërfaqe jashtë vendit të banuar, sepse ata i japin partametrat dhe kushtet detale për ndërtim, instalimet komunale dhe të ngjajshme, për parcelën konkrete ndërtimore.

● Vendim për kushte të lokacionit

Vendimi për kushte të lokacionit përmban kushtet për ndërtim, të përcaktuar me **planet urbane** ose projektin urban. Këto kushte janë: madhësia e ndërtesës në bazë dhe lartësi, largësia e ndërtesës nga ndërtesat e tjera dhe nga rruga, aplikimi i materialeve të përcaktuara për ndërtim, furnizimi me ujë, kanalizimi, rryma elektrike, instalimi telefonik, kufizimet eventuale të ndërtesës, etj.

Vendim për kushte të lokacionit për objekte me rëndësi për shtetin, lëshon organi i administratës shtetërore - kompetent për rregullimin e hapësirës.

Vendim për kushtet e lokacionit për objektet me rëndësi lokale, lëshon kryetari i komunës.

Fqinjët e afërt, mbi të cilët mund të ndikojë ndërtimi i ndërtesës së ardhshme, informohen me përmbajtjen e vendimit për kushte të lokacionit nga ana e organit kompetent.

Vendimi për kushtet e lokacionit për objekte me rëndësi lokale, vazhdon për një vit dhe lëshohet për 5 ditë, ndërsa për objekte me rëndësi shtetërore vazhdon dy vjet dhe lëshohet për 30 ditë.

● Pajtueshmëritë e duhura

Para se të fillohet me përgaditjen e dokumentacionit të projektit, duhet të mirren pajtueshmëritë e duhura dhe të përgaditet elaborat për të dhënat gjeodetike për truallin, që i takon objektit.

Shembull: qytetari vjen në komunë, në seksionin për ndërtimtarin dhe punë komunale, i interesuar për të ndërtuar shtëpi familjare në parcelë të veten kadasdrale në qytet. Hapi i parë është të shikohet në planin urban detal dhe të shikohen kushtet e parapara për ndërtim në atë parcelë. Nga shqyrtimi i bërë, qytetari fiton ekstrakt nga plani urban. Pasiqë të vërtetohet se në parcelën e tij është paraparë shtëpi familjare, qytetari mund të ndërmerr aktivitetet e nevojshme për fitimin e lejes për ndërtim.



Elaborati për të dhëna gjeodetike për truallin, që i takon objektit e përgadit organizata e autorizuar për punë gjeodetike, me kërkesë të investuesit ose organit të administratës shtetërore - kompetent për punët për rregullimin e hapësirës. Elaborati i paraqet të dhënat për truallin, për zgjidhjen e marrëdhënieve pronëso-ro-juridike dhe përcaktimin e të drejtës për ndërtim.

Pajtueshmëritë tjera kanë të bëjnë me të dhënat, që i japin ndërmarrjet komunale për dispozicionin dhe kapacitetin e rrjeteve të tyre, të nevojshme për përgaditjen e dokumentacionit të projektit.

● Përgaditja e dokumentacionit të projektit

Dokumentacioni i projektit është i gjithë dokumentacioni, i bazuar në parametrat teknike të nevojshme për ndërtimin e një ndërtese (objekt).

Shembull: dokumentacioni i projektit për ndërtim të shkollës do të përmbajë projektet në vijim: projekt arkitektonik; qëndrueshmëria dhe stabiliteti mekanik; elektrikë, ujësjellës dhe kanalizim, projekt makinerik (për ngrohje); mbrojtje gjatë punës; mbrojtje nga zjarri dhe rregullimi i vendit të oborrit.

PROJEKTI IDEOR është projekt, me të cilin përcaktohen zgjidhjet themelore, formuese dhe teknike të ndërtesës dhe paraqitet vendosja e ndërtesës në lokacion. Varësisht nga ndërlikueshmëria e ndërtesave, projektet ideore mund të japin zgjidhje themelore edhe për funksione tjera, siç janë: teknologjia e ndërtimit, procedura teknologjike e procesit të prodhimit etj.

Projekti ideor është dokument i përhershëm dhe ruhet tek organi, që e ka lëshuar, si dhe te investuesi.

PROJEKTI THEMELOR është përmbledhje e projekteve të përshtatura në mes tyre, me të cilat paraqitet zgjidhja teknike e ndërtimit, tregohet plotësimi i kërkesave të rëndësishme për ndërtesën dhe çështje tjera. Projekti themelor, patjetër duhet të përmbajë të dhëna nga elaboratet, që kanë shërbyer si bazë për përgaditjen, kushtet për përdorshmërinë e ndërtesës dhe kushtet për mirëmbajtjen e saj.

Projektet, që janë pjesë përbërëse e dokumentacionit të projektit, ndahen sipas nivelit të përgaditjes në:

- projekt ideor;
- projekt themelor;
- projekt për realizim dhe
- projekt për përdorimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave

Sipas dedikueshmërisë, projektet mund të jenë me qenë:

- arkitektonike;
- projekte për statikë (qëndrueshmëria dhe stabiliteti mekanik);
- elektro-teknike;
- të trafikut;
- makinerike;
- projekte për mbrojtje në punë dhe
- projekte tjera (ujësjellës dhe kanalizim).

Projektet i përgadisin projektues të autorizuar (persona me përgaditje profesionale adekuate dhe autorizim për përgaditjen e projekteve). Projektet përgaditen në pajtueshmëri me dispozitat dhe rregullativën egzistuese ligjore.

Projektet patjetër përmbajnë pjesë të përgjithshme, në të cilën janë të paraqitur të dhënat për projektuesin, investuesin, programin që definojnë kërkesën për përgaditjen e projektit, përshkrim teknik dhe matjen me llogarinë e punëve.

Projekti themelor mund të përgaditet për ndërtesë të thjeshtë, për ndërtesë të ndërlikuar, për rikonstruim të ndërtesës, si dhe për projekt tipik. Projekti themelor është dokument i përhershëm dhe ruhet te organi, që e ka lëshuar, si dhe te investuesi.

Projekti i përgaditur jashtë vendit, me doemos duhet të vërtetohet nga personi i autorizuar juridik.

● Leje për ndërtim

Për të filluar ndërtimi i ndërtesës, paraprakisht, duhet të fitohet leja e ndërtimit.



Lejen për ndërtim të ndërtesave me rëndësi për shtetin, e lëshon organi i administratës shtetërore - kompetent për punët për rregullimin e hapësirës. Për ndërtesa me rëndësi lokale - kryetari i komunës.

Ndërtesat me rëndësi për shtetin, janë ndërtesat e kategorisë së parë, posaçërisht ndërtesat e ndërlikuara dhe ndërtesat e kategorisë së dytë, gjegjësisht ndërtesat tepër të ndërlikuara.

Ndërtesa me rëndësi lokale, janë ndërtesat nga kategoria e tretë, katërt dhe pestë dhe ato i përfshijnë të gjitha lëmitë, për të cilat është kompetente komuna.

Leje për ndërtim lëshohet pas kërkesës me shkrim nga investuesi, me dokumentacionin e duhur të përcaktuar me Ligjin për ndërtim.

Leje për ndërtim lëshohet për gjithë ndërtesën, ndërsa mundet edhe për një pjesë të ndërtesës, që paraqet tërësi funksionale. Leja për ndërtim mund të ndryshohet dhe të plotësohet, kurse mund të bëhet edhe ndryshimi i investuesit. Leja për ndërtim vazhdon dy vjet, ndërsa mund të vazhdohet edhe për dy vjet të tjera.

Leja për ndërtim mund të lëshohet edhe për punë përgaditore gjatë ndërtimit të ndërtesës së ndërlikuar, në kuptim të mbrojtjes së rrethit, ambientit jetësor dhe të ngjajshme, me qëllim të organizimit të shesheve ndërtimore.

Për lloj të caktuar të ndërtimeve nuk është e nevojshme leja e ndërtimit siç janë: mirëmbajtje, adaptim i ndërtimit të përdorshëm, rikonstruim i ndërtesës së përdorshme në rrethin e komplekseve të ARM-së ose për kategoritë e personave të pa lëvizshëm ose personave me vështirësi në lëvizje, për pajisje urbane dhe të ngjajshme.

6.3.3. Ndërtim i ndërtesave

Për të filluar me ndërtim, së pari formohet shesh ndërtimor, që lajmërohet të **inspektimi** ndërtimor dhe i punës. Investuesi është i obliguar të sigurojë elaborat për shenjëzimin e ndërtesës, i përgaditur nga organi i autorizuar.

Pastaj, sheshi ndërtimor rregullohet, rrethohet, sigurohet me shenja adekuate, për shkak të pengimit të qasjes së pa kontrolluar deri në të. Sheshi i ndërtimeve shenjëzohet me tablo, në të cilën janë të dhëna informacionet për investuesin, projektin, realizuesin, mbikëqyrjen, të dhënat për lejen e dhënë për ndërtim dhe shenjë të caktuar, nëse është fjala për të mirë kulturore.

Ndërtimin e ndërlikuar mund ta ndërtojë person juridik me licencë. Në sheshin e ndërtimeve ruhet i tërë dokumentacioni projektues dhe të gjitha lejet dhe pëlqimet e fituara.

Sikurse për ndërtimin e ndërtesave, edhe për rrëzimin e tyre duhet patjetër projekt për rrëzimin e ndërtesës dhe leje për rrëzim.

● Mbikëqyrja gjatë ndërtimit

Mbikëqyrje të procesit të ndërtimit kryen inxhenjeri mbikëqyrës, i autorizuar për kryerje të mbikëqyrjes profesionale. Gjatë kohës së ndërtimit, udhëhiqet ditar ndërtimor dhe libër ndërtimor. Në ditarin ndërtimor shënohen të gjitha punët, që punohen në ndërtesë dhe të gjitha ndryshimet, që janë paraqitur gjatë procesit të ndërtimit.

Shembull: projekti themelor për shtëpi familjare përmban: projekt arkitektonik me formë dhe paraqitje të gjendjes së ndërtesës në hapësirë; projekt për konstruktiv; projekte për instalimet shtëpiake. Me projektin themelor tregohet plotësimi i kërkesave të rëndësishme.

Ndërtesat e kategorisë së tretë, janë ndërtesa të ndërlikuara, nga lëmia e ndërtesave të larta, ndërtesave të ulta dhe hidro-ndërtesave (ndërtesa nga lëmia e arsimit fillor dhe të mesem, ndërtesa sportive, ndërtesa nga lëmia e kulturës, ndërtesa me karakter fetar, ndërtesa nga lëmia e mbrojtjes shëndetësore primare dhe sekondare, ndërtesa nga lëmia e mbrojtjes sociale, ndërtesa ekonomike dhe industriale, ndërtesa hotelierike, ndërtesa afariste dhe ndërtesa banuese-afariste, rrugë lokale dhe hekurudha lokale, hidrocentrale deri në 40 MV dhe largpërçues nën 110KV, sisteme lokale për furnizim me ujë dhe sisteme të kanalizimit të stacioneve për pastrim, ndërtesa të ekonomisë ujore, deponime për hedhurina komunale dhe të ngjajshme). Ndërtesat e kategorisë së katërt, janë ndërtesa më pak të ndërlikuara (ndërtesa banimi dhe ndërtesa afariste deri në tre nivele në lartësi, shtëpi familjare, ndërtesa të ekonomisë së vogël deri në dy nivele në lartësi dhe të ngjajshme). Ndërtesa të kategorisë së pestë, janë ndërtesa të thjeshta (ndërtesa përdhese ekonomike në oborre ekonomike me zgjatje të konstruksionit deri në 6 metra, trafostacione deri në 10 KV, qoshqe dhe ndërtime tjera me konstruksion të gatshëm deri në 12m², terrene sportive që në sipërfaqen e tyre janë të vendosur në mënyrë të rrafshët - fusha për futboll, tenis - ndërtesa përdhese afariste deri në 100 m² dhe të ngjajshme.



● Pranimi teknik

Pas mbarimit të procesit të ndërtimit, duhet të bëhet pranimi teknik i ndërtesës nga ana e komisionit për pranim teknik. Komisioni për pranim teknik për objekte me rëndësi lokale, formohet nga ana e kryetarit të komunës, ndërsa për objekte me rëndësi për shtetin, komisionin e formon ministri - kompetent për punët për rregullimin e hapësirës.

● Leje për përdorim

Leja për përdorim lëshohet për ndërtesë të ndërtuar, nga ana e organit -kompetent për lëminë e rregullimit të hapësirës. Kjo leje lëshohet, pasi që me pranimin teknik do të vërtetohet se ndërtesa është e ndërtuar në pajtim me projektin kryesorë dhe se janë të plotësuara kërkesat e rëndësishme dhe ndërtesa mund të shfrytëzohet.

6.3.4. Mbikëqyrja inspektuese

Mbikëqyrja inspektuese mbi tërë procesin e dhënies së lejes për ndërtim dhe të ndërtimit të ndërtesave, kryehet nga ana e **inspektimit** ndërtimor dhe urbanistik.

● Inspektimi urban

Mbikëqyrjen inspektive mbi vendimin e lëshuar për kushte të lokacionit dhe përshtatshmërisë së projektit, e kryejnë inspektorë urban. Inspektorët urban nga Inspektimi shtetëror për ndërtimtari dhe **urbanizëm**, bëjnë **inspektim** mbi punët me rëndësi shtetërore, ndërsa inspektuesit e autorizuar urban të komunave, kryejnë mbikëqyrje inspektuese mbi punët me rëndësi lokale.

Inspektimi urban, nëse vërteton se vendimi për kushtet e lokacionit nuk është në pajtim me **planet urbane** ose projektin urban, do të asgjësojë vendimin për kushte të lokacionit dhe do të parashtrojë propozim deri te organi, që e ka lëshuar vendimin për ndërprerjen e procedurës për dhënie të lejes për ndërtim.

● Inspektimi ndërtimor

Mbikëqyrjen inspektuese të ndërtesës e bëjnë inspektues ndërtimor. Inspektuesit ndërtimor nga Inspektimi shtetëror për ndërtimtari dhe **urbanizëm**, kryejnë mbikëqyrje inspektive të ndërtesave me rëndësi shtetërore. Inspektuesit e autorizuar ndërtimor të komunave, kryejnë mbikëqyrje **inspektimi** të ndërtesave me rëndësi lokale. Inspektimi ndërtimor kryen **inspektim** të ndërtimit të ndërtesave dhe nëse vërteton pa rregullsi, mund të sjell vendim për ndërprerje të ndërtimit ose rrëzim të ndërtesës.

● Egzekutim i vendimit

Nëse **inspektimi** ka sjellur vendim për rrëzimin e ndërtesës, ndërsa investuesi nuk e ka bërë këtë në kohën e caktuar, kryhet rëzimi i ndërtesës me egzekutim nga ana e personit tjetër, ndërsa në llogari të investuesit.

6.4. TRANSPORTI

6.4.1. Rrjetet e trafikut

Në Republikën e Maqedonisë, janë prezent thuajse të gjitha llojet e trafikut (komunikacionit), duke filluar nga trafiku tokësor (rrugë dhe hekurudha), ajror dhe në masë të vogël edhe trafiku ujor.

Kryesisht, trafiku zhvillohet nëpërmjet rrugëve dhe hekurudhave. Ndërtimi dhe përmirësimi i lidhjeve të trafikut, gjithnjë është politikë e mirë dhe e rëndësishme, posaçërisht për popullatën lokale, e cila në mënyrë



të drejtpërdrejtë i ndjen përmirësimet. Mirëpo, patjetër duhet të përmendet se ndërtimi i rrjeteve të trafikut i dëmton pejsazhet natyrore dhe e rrezikon ambientin jetësor.

● **Kush është pronar dhe kush kryen administrimin**

Rrjetet e trafikut në shtet, janë të ndarë në disa kategori. Sipas rëndësisë, janë të ndara në dy grupe: me rëndësi për shtetin dhe me rëndësi lokale.

Me rëndësi lokale, janë: rrugët magjistrale dhe regjionale me të gjitha ndërtimet shoqëruese, hekurudha me të gjitha ndërtimet shoqëruese, aeroportet për trafik publik dhe trafik tjetër ajror.

Me rëndësi lokale, janë rrugët lokale.

Ndërtimet e trafikut me rëndësi për shtetin, janë pronë e shtetit dhe me ato udhëheq organi i administratës shtetërore-kompetent për punët e trafikut.

Ndërtimet e trafikut me rëndësi lokale, janë pronë e komunës dhe me ato udhëheq organi i vetëqeverisjes lokale - kompetent për punët e trafikut.

● **Kategori të rrugëve**

Rrugët bëjnë lidhjen e vendbanimeve në komunë, komunitat ndërmjet tyre dhe me qendrën e shtetit dhe shtetet me shtetet fqinje.

Varësisht nga rëndësia e tyre, rrugët janë të ndarë në: autobane, rrugë magjistrale, rajonale dhe lokale. Në praktikë, paraqiten edhe rrugë të pa kategorizuara.

● **Korridore transportuese transevropiane**

Drejtimet (korridoret) më të rëndësishme në shtet janë të definuara, si lidhje veri-jug, "Korridori 10" dhe lidhje lindje-përfundim, "Korridori 8". Këto dy korridore do të lidhin shtetin me vendet fqinje dhe me vendet evropiane, me trafik rrugor dhe hekurudhor.

● **Rrugë lokale, trotoare dhe rrugë për biçiklistë**

Rrugët lokale gjenden në territor të komunës dhe i lidhin vendbanimet me qendrën e komunës, si dhe vendbanimet ndërmjet tyre.

Rrugët e trafikut nëpër qytet, janë tepër të rëndësishme për lidhjen e mirë dhe të shpejtë të zonave për banim me zonat për punë dhe me qendrën e qytetit.

Linjat e asfaltuara, trotoaret dhe rrugët për biçiklistë, janë pjesë përbërëse e rrugëve të trafikut, që gjenden në vendbanimet.

Edhe në vendbanimet, rrugët e trafikut ndahen në disa grupe, edhe ato: rrugë komunikacioni magjistrale, rrugë komunikacioni mbledhëse, rrugë komunikacioni servimi dhe rrugë komunikacioni banuese. Kjo ndarje është bërë në pajtim me komunikacionin, që bëhet në këto rrugë.

Linjat e asfaltuara në përgjithësi ndërtohen prej asfaltit, ndërsa trotoaret dhe rrugët për biçiklistë, mund të ndërtohen edhe nga materiale tjera.

Rrjetet e trafikut nëpër qytetet janë ndotës potencial të ambientit jetësor, për shkak të gazërave të automjeteve. Për këtë është mirë të ndërtohet rreth i gjelbërt në mes linjës së asfaltuar dhe trotoarit.

6.4.2. Transporti publik

Transporti publik është kryerja e organizuar e transportit të udhëtarëve dhe mallërave. Transporti publik, kryhet nëpërmjet rrjeteve të trafikut.



● Transport i udhëtarëve

Transporti publik i udhëtarëve kryhet në qytete, në mes qyteteve, në mes vendbanimeve, në mes vendbanimeve dhe qyteteve, në mes shteteve etj.

Udhëtarët transportohen me automjete të lehta (autobus, hekurudhë, aeroplanë etj).

Transporti publik i udhëtarëve është i organizuar me mjetet transportuese, si vijon: autobusë dhe taksi-automjete. Mirëpo, jo të gjithë qytetet dhe komunat kanë transport të organizuar me autobus. Transportin publik e kryejnë ndërmarrje publike ose private, të organizuar dhe të autorizuar për kryerje të transportit publik të udhëtarëve.

Në komunat dhe qytetet, në të cilët egziston transporti publik i udhëtarëve, shenjëzohen stacionet për mjetet transportuese. Çmimet e transportit publik në komunë i kontrollon këshilli i komunës, gjegjësisht këshilli i Qytetit të Shkupit për Qytetin e Shkupit.

Transporti publik në mes komunave, shtetit tonë dhe shteteve tjera, kryhet nëpërmjet automjeteve motorike transportuese, hekurudhës dhe aeroplanëve. Këtë transport e kontrollon shteti, nëpërmjet organit të administratës shtetërore - kompetent për trafik.

● Transport i mallërave

Transporti publik i mallërave kryhet në qytetet, në mes qyteteve, në mes vendbanimeve, në mes vendbanimeve dhe qyteteve, në mes shteteve etj.

Transporti publik i mallërave në shtet kryhet nëpërmjet kamionëve dhe hekurudhës.

Transporti i mallërave nëpërmjet shtetit dhe shteteve tjera, kryhet me anë të kamionëve, hekurudhës dhe aeroplanëve transportues (kargo).

Shembull: rajoni qendror i qytetit është i ndarë në dy zona - zona e qendrës së ngushtë dhe zona e qendrës së zgjeruar. Në zonën e qendrës së ngushtë qëndrimi me automjet (parkimi) kushton dy herë më tepër se, sa në zonën e qendrës së zgjeruar, për kohëzgjatje të njëjtë të qëndrimit. Në këtë mënyrë, automjetet mbahen jashtë qendrës së ngushtë të qytetit dhe sigurohet lëvizje e sigurtë e këmbësorëve, zvogëlimi i ndotjes së ajrit me gazëra të automjeteve dhe qendra e qytetit funksionon më mirë.

6.4.3. Siguria në transport

Transporti publik zhvillohet nëpër rrjetet e komunikacionit, më së shumti nëpër rrugë dhe hekurudhë. Rrugët e komunikacionit të dimenzionuara mirë, të shenjëzuara mirë dhe projektuara mirë, mundësojnë trafik të sigurtë. Në qytetet e vjetra, nuk ndodh një gjë e tillë, ndërsa për shkak të rrugëve të ngushta, trafiku zhvillohet rëndë dhe nuk është i sigurtë. Këto probleme zgjidhen me trafik të një drejtimi, me formimin e zonave për trafik, në të cilat qëndrimi do të jetë i kontrolluar. Shprehia e qytetarëve të shkojnë me automjete personale në çdo vend, duhet patjetër të ndryshohet.

Shfrytëzimi i transportit publik të organizuar, mundëson prezencë më të vogël të automjeteve në qytet, posaçërisht në qendër të qytetit. Trafiku duhet të mënjanohet nga qendrat e qytetit dhe përreth qendrave të qyteteve të formohet një brez me komunikacion të ndaluar. Ndarja e qytetit në zona për trafik është element i rëndësishëm për eliminimin e numrit të madh të automjeteve në zonat.



Fjalë kyqe: plani hapësinor, plane urbane, urbanizëm, plan urban gjeneral, plan urban detal, parcelë ndërtimore, leje për ndërtim, inspektim.

Korrniza ligjore:

- Ligji për vetëqeverisje lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 5/02, neni 22 "Lista e kompetencave", paragrafi 1.1. Planifikimi urban (urban dhe rural), lëshimi i lejeve për ndërtim të objekteve me rëndësi lokale të përcaktuara me ligj, rregullimin e hapësirës dhe rregullimin e truallit ndërtimor.
- Ligji për realizimin e Planit hapësinor të Republikës së Maqedonisë "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 39/04;
- Rregullore për standardet dhe normat për rregullimin e hapësirës "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.2/02 dhe 50/03;
- Rregullore për përmbajtje më të afërt dhe mënyrën e përpunimit grafik të planeve dhe për mënyrën dhe procedurën e sjelljes së planeve urbane, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 2/02;
- Rregullore për standarde dhe norma për projektimin e objekteve, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.69/99, 102/00, 2/02 dhe 5/04;
- Ligji për rrugët publike, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.
- Ligji për siguri në trafik, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.

Ligjet që ndryshohen dhe janë në fazë të aprovimit të tyre

- Ligji për planifikim hapësinor dhe urban, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 4/96, 28/97, 18/99, 53/01 dhe 45/02;
- Ligji për ndërtimin e objekteve investuese, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 15/90, 11/91, 11/94, 18/99 dhe 25/99;





7.1 | NDËRMARRJET PUBLIKE DHE SHËRBIMET KOMUNALE

Panço Minov

Shërbimet komunale janë diçka, që qytetarët natyrisht i lidhin me rrolin e komunës. Kjo kompetencë specifike, edhe deri më tani është kryer nga ana e komunës. Shpresojmë se komuna e juaj do të sigurojë shërbime më kualitative për qytetarët-votues të juaj në atë rrethinë.

Shërbimet komunale janë diçka, që qytetarët natyrisht i lidhin me rrolin e komunës. Kjo kompetencë specifike edhe deri më tani është kryer nga ana e komunës. Shpresoj se ju, gjatë mandatit të juaj do të ofroni kushte për shërbim më kualitativ për qytetarët, me çka do të arsyetoni besimin, i cili ju është dhënë juve.

Në fillim duhet të njohtohemi, cilat janë shërbimet komunale me interes publik dhe me rëndësi lokale. Pse është e nevojshme kjo? Kjo është e nevojshme nëse dëshirojmë të sjellim vendim të drejtë për kryerjen e kësaj kompetence. Mund të përcaktoheni veprimtaria komunale të kryhet nëpërmjet ndërmarrjes publike, me dhënien e koncesionit për kryerje të veprimtarisë komunale dhe me leje për kryerje të veprimtarisë komuale.

Veprimtaritë, të cilat kanë karakter të veprimtarive komunale me interes publik, janë të përcaktuara në Ligjin për **veprimtari komunale**. Të tilla janë:

- furnizim me ujë për pije;
- përpunim dhe bartje të ujit teknologjik;
- bartje dhe pastrim i ujërave të përdorura, bartje dhe hedhje të ujërave atmosferike;
- transporti publik urban dhe ndërurban për qytetarët;
- përpunimi dhe deponimi i hedhurinave komunale të forta;
- deponimi i hedhurinave industriale dhe materieve të dëmshme;
- mirëmbajtja e pastërtisë publike;
- mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i parqeve, gjelbërimit dhe park-maleve; ujërave dhe sipërfaqeve rekreative;
- mirëmbajtje të shenjzimit rrugor të trafikut dhe objekteve tjera të infrastrukturës;
- mirëmbajtje të varreve, varrezave, krematoriumeve dhe dhënie e shërbimeve të varrimit;
- mirëmbajtje të ndriçimit publik;



- mirëmbajtje dhe shfrytëzim të sipërfaqes publike për parkim;
- mirëmbajtje dhe shfrytëzim të tregjeve me shumicë dhe për tregëti me pakicë;
- kryerje të shërbimeve për pastrimin e oxhaqeve;
- mirëmbajtje të paisjeve komunale;
- zhvendosje dhe ruajtje të automjeteve të parkuara në mënyrë të paligjshme; zhvendosje të automjeteve të çrregulluara, makinave bujqësore me ose pa paisje ngjitëse;
- eliminimin e kafshëve nëpër rrugë;
- zbukurim të vendeve të banuara;
- mirëmbajtje të nyjeve sanitare publike;
- stërpikje nga ajri, dezinfektim, deratizim dhe të ngjajshme.

Nëse i analizoni të gjitha këto veprimtari, do të shihni se për kryerjen e disave prej tyre është i nevojshëm **themelimi** i ndërmarrjes publike, ndërsa kryerjen e veprimtarive të tjera do ta bartni mbi persona juridik dhe fizik me arritje të marrëveshjes ose nëpërmjet të koncesionit.

Në çdo rast ju jeni ai, që duhet të përcaktojë mënyrën e kryerjes së këtyre veprimtarive. Meqë keni mundësi vetë të vendosni se, si në mënyrë më efikase do të kryhen këto veprimtari, ju, si anëtarë të këshillit të komunës do të sillni vendim për **themelim** të ndërmarrjes publike ose do të përcaktoni kushte, me respektimin e të cilëve do të mund të bartet me anë të marrëveshjes kryerja e veprimtarisë mbi person të caktuar juridik dhe fizik.

7.1.1. Ndërmarrje publike

Duke pasur parasysh se kryerja e këtyre veprimtarive në të shumtën e rasteve kryhet nëpërmjet ndërmarrjeve publike të themeluara nga komuna do të shpjegojmë disa çështje, që kanë të bëjnë me ndërmarrjet publike, siç janë:

- statusi,
- **themelimi**,
- udhëheqja,
- **financimi**,
- mbikëqyrja dhe
- kontrolli.

Statusi

Ligji për **ndërmarrje publike** nuk e definon statusin, gjegjësisht karakterin e ndërmarrjeve publike ose thënë ndryshe, nuk bën klasifikim në kuptim të barazimit të statusit të saj me atë të shoqatave tregëtare dhe as, që e definon si lloj të veçantë të ndërmarrjes.

Për dallim nga Ligji për **ndërmarrje publike**, Ligji për vetëqeverisje lokale ndërmarrjet publike i definon si shërbime publike. Kjo do të thotë se ndërmarrja publike, si shërbim publik është organizatë jo fitimprurëse për kryerje të shërbimeve publike me interes publik dhe me rëndësi lokale. D.m.th. me Ligjin për vetëqeverisje lokale, ndërmarrja publike kategorizohet si shërbim publik dhe në të njëjtën kohë përcaktohet karakteri i saj si organizatë jofitimprurëse. Organizata jo fitimprurëse nuk është asgjë tjetër, përveç organizatë, e cila gjatë punës së saj nuk realizon fitim, sepse çmimet e shërbimeve janë të përcaktuara në atë mënyrë për të siguruar vetëm punë të rregullt dhe mirëmbajtje të pajisjeve për punë.



Themelimi

Ndërmarrjet publike themelohen me sjelljen e vendimit nga ana e organit kompetent. Varësisht nga veprimtaria, nëse ajo është me karakter lokal ose shtetëror, si themelues të ndërmarrjeve publike paraqiten komunat, gjegjësisht Qyteti i Shkupit dhe Republika e Maqedonisë. Prej këtu, mund të dallojmë **ndërmarrje publike** komunale dhe **ndërmarrje publike** shtetërore. Është me rëndësi të dihet se çka duhet të përmbajë vendimi i **themelimit**. Vendimi ka formë rreptësisht të përcaktuar dhe përmban:

- veprimtarinë e ndërmarrjes publike (furnizim me ujë për pije, bartje dhe pastrim të ujërave të përdorura, kryerje të transportit urban dhe ndërrurban të qytetarëve dhe të ngjajshme);
- firmën (emrin) dhe selinë;
- kontributin themelues dhe mënyrën e sigurimit të tij;
- organizmin e ndërmarrjes publike;
- mënyrën e realizimit të vendimeve të organeve të ndërmarrjes publike;
- përgjegjësinë e ndërmarrjes publike në qarkullimin juridik;
- afatin e sjelljes së statutit;
- emërimin e organeve të ndërmarrjes publike;
- emërimin e personit në ndërmarrjen publike, i cili do të udhëheq punët deri te konstituimi i saj.

Për të punuar, si subjekt juridik ndërmarrja publike nuk është i mjaftueshëm vetëm akti themelues por është e nevojshme **themelimi** i ndërmarrjes të shënohet në regjistrin tregëtar, pranë gjyqit themelor, sipas selisë së ndërmarrjes.

Udhëheqja

Organe drejtuese të ndërmarrjes publike janë:

- këshilli drejtues;
- këshilli mbikëqyrës dhe
- drejtori.

Këshilli drejtues

Këshilli drejtues është organ për **udhëheqje** me ndërmarrjen publike. Këtu është e rëndësishme të dihet se numri i anëtarëve të këshillit drejtues përcaktohet në varësi prej madhësisë së ndërmarrjes publike, gjegjësisht prej përfshirjes së veprimtarive, të cilat ndërmarrja publike i kryen. Këshilli drejtues i ndërmarrjeve publike mund të përbëhet prej 5 deri 15 anëtarë. Dy të tretat e anëtarësisë së këshillit drejtues të ndërmarrjeve publike janë përfaqësues të personave profesional nga lëmia e veprimtarisë së ndërmarrjes publike, ndërsa një e treta janë përfaqësues të të punësuarve në ndërmarrjen publike.

Anëtarët e këshillit drejtues të ndërmarrjeve publike emërohen nga ana e këshillit të komunës. Mandati i tyre nuk mundet me qenë më i gjatë se katër vjet. Kjo do të thotë se mandati i anëtarëve të këshillit drejtues të ndërmarrjeve publike mund të zgjasë edhe më pak se katër vjet (psh dy vjet), posaçërisht nëse mandati i anëtarëve të këshillit drejtues lidhet me mandatin e anëtarëve të këshillit të komunës. Kjo çështje është e rregulluar me statutin e ndërmarrjes publike. Ndërmarrja publike e themeluar nga ana e këshillit të komunës duhet të merr pëlqim për statutin e saj prej këshillit të komunës, nga i cili është themeluar.

Më tutje, është me rëndësi të dihet se anëtar i këshillit drejtues të ndërmarrjeve publike nuk mundet me qenë kryetari dhe anëtarë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, si dhe kryetari i komunës, gjegjë-



sisht kryetari i Qytetit të Shkupit. Poashtu, duhet të dihet se anëtari i këshillit drejtues të ndërmarrjes publike nuk mund të ketë interesa personale (nëpërmjet personit të tretë ose në çfarëdo baze) në ndërmarrjen ose shoqatën tregëtare, që është në marrëdhënie afariste me ndërmarrjen publike, meqë mund të kenë ndikim në pavarësinë e tij gjatë marrjes së vendimeve në ndërmarrjen publike.

Për kryetar dhe anëtar të këshillit drejtues të ndërmarrjes publike nuk mund të emërohet person, i cili ka qenë anëtar i këshillit drejtues, organit tjetër udhëheqës ose bartës i funksionit udhëheqës në ndërmarrje, që ka ndërprerë punën e saj si rezultat i falimentimit.

Këshilli drejtues është kompetent për sjelljen e statutit të ndërmarrjes publike; të vendos për ndryshime statutare; të sjell program për punë dhe zhvillim; të sjell vendime për investime; të aprovojë llogarinë vjetore dhe raportin për punë të ndërmarrjes; të përcakton lartësinë dhe çmimin e shërbimeve; të vendosë për organizimin e brendshëm të ndërmarrjes.

Nëse keni parasysh të gjitha njohuritë e përmendura më lartë gjatë përcaktimit të juaj, për atë se cilët persona do t'i emëroni anëtarë të këshillit drejtues të ndërmarrjes publike, sigurisht se zgjedhja e juaj do të jetë e drejtë. Ju do të krijoni supozime paraprake të mira se me ndërmarrjen publike do të udhëheqin persona profesional dhe kompetent. Kjo do të jetë garancë se shërbimet e ofruara nga ana e ndërmarrjes publike në kryerjen e veprimtarisë së saj, do të plotësojnë nevojat e qytetarëve dhe shfrytëzuesve të tjerë të shërbimeve të tilla.

Këshilli drejtues

Për kryerjen e kontrollit mbi punën materialo-financiare të ndërmarrjes publike, formohet këshill për mbikëqyrje të punës materialo-financiare. Ky këshill bën kontrollin e të gjitha dokumenteve dhe shënimeve të ndërmarrjes publike; kontrollon llogarinë vjetore; kontrollon raportin vjetor të punës së ndërmarrjes publike; jep mendim për llogarinë vjetore dhe raport për punën e ndërmarrjes publike, deri te këshilli drejtues, deri te ministri i financave, si dhe deri te ministri kompetent.

Mandati i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës nuk mundet me qenë më i gjatë se katër vjet. Gjatë përcaktimit të personave, të cilët do të emërohen për anëtarë të këshillit mbikëqyrës të ndërmarrjes publike, mirë është të përcaktoheni për persona, të cilët kanë përgaditje të lartë profesionale dhe të cilët kanë njohuri dhe përvujt të punës financiare dhe të kontabilitetit. Duhet të dihet, poashtu, se për anëtarë të këshillit mbikëqyrës nuk mund të emërohet deputet, kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ministrat, anëtarët e këshillit të komunës, gjegjësisht Qytetit të Shkupit dhe kryetari i komunës. Kjo do të thotë se këto funksione janë të pa pajtueshëm me funksionin e anëtarit të këshillit mbikëqyrës.

Drejtori

Me ndërmarrjen publike udhëheq drejtori, i cili emërohet dhe shkarkohet nga ana e themeluesit, gjegjësisht në emër të themeluesit, kryetari i komunës bën zgjedhjen e drejtorit të ndërmarrjes publike nëpërmjet të konkursit.

Funksioni i drejtorit është i pa pajtueshëm me funksionin e deputetit, kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ministrit, anëtarit të këshillit të komunës, gjegjësisht të Qytetit të Shkupit dhe të kryetarit të komunës.

Drejtori i ndërmarrjes publike është kompetent të realizojë kryerjen e vendimeve dhe konkluzave të këshillit drejtues; të realizojë bazat e programit për zhvillim; të përcaktojë kriteriumet për shfrytëzim dhe disponim me mjetet dhe përdorimin e mjeteve të realizuara me punën e ndërmarrjes publike; të përshtat aktivitetin afarist të ndërmarrjes publike. Poashtu, drejtori është përgjegjës për rezultatet e punës dhe për ligjshmërinë e punës së ndërmarrjes publike; për përgjegjësinë materiale; për dëmin e shkaktuar ndaj ndërmarrjes publike gjatë realizimit të vendimeve.

Financimi

Ndërmarrja publike prej ditës së regjistrimit të saj në Regjistrin tregëtar, fiton statusin e personit juridik dhe si e tillë mund të arrijë të drejtë të pronësisë së tundshme dhe të pa tundshme; të fitojë të drejta dhe të merr



obligime dhe për obligimet e marrura të përgjigjet me të gjithë pronën e saj.

Mjete për punë dhe zhvillim, ndërmarrja publike fiton prej punës së saj, me anë të kredive dhe me ndihmë të burimeve të tjera në pajtim me ligj, si dhe nga ana e buxhetit. Burimi themelor i **financimit** të ndërmarrjes publike është çmimi i shërbimit, të cilin e ofron. Lartësia e çmimit është e kufizuar dhe atë nuk e përcakton këshilli drejtues, ndërsa për aplikimin e çmimit është i nevojshëm pajtimi paraprak nga ana e themeluesit.

Në këtë rast roli i juaj është i madh. Ju, nga njëra anë, duhet të lejon çmim, i cili do të garantojë punë të suksesshme të ndërmarrjes publike, kurse nga ana tjetër, duhet të keni vëmendje mos të ngarkoni buxhetin e shfrytëzuesve të shërbimeve, gjegjësisht të atyre, të cilët ju kanë dhënë besimin. Për këtë shkak, gjithmonë do të merrni parasysh argumentet e të dyja anëve dhe në mënyrë reale do të sillni vendim të drejtë.

Si rezultat i mënyrës së këtyllë të përcaktimit të lartësisë së çmimit të shërbimeve, ndërmarrjet publike vendosen në pozitë, që të mos ndajnë mjete për amortizim dhe akumulim. Kjo do të thotë se nuk sigurohen mjete për ripërtirjen e mjeteve themelore për punë, e mos të flasim për investime të reja. Këtu, gjithshesha do të jetë e nevojshme, që ministria kompetente të rishqyrton gjendjen dhe të gjen parametra për përcaktimin e lartësisë së çmimit, që do t'i përgjigjen harxhimeve të vërteta të dalura si rezultat i punës së ndërmarrjes.

Duke pasur në konsiderim faktin se ju jeni ata, që e sillni buxhetin e komunës, gjatë sjelljes së tij duhet të parashihni mjete për ndërtimin ose rikonstruimin e objekteve të infrastrukturës komunale. Me këtë do të krijoni kushte për përmirësimin e shërbimeve dhe plotësimin e nevojave të qytetarëve.

Mbikëqyrje dhe kontroll

Duke pasur parasysh faktin se komuna është themelues i ndërmarrjeve publike komunale, logjikisht parashtrohet pyetja se, si do të kryhet kontrolli dhe mbikëqyrja e ndërmarrjeve.

Këtu, krejtësisht në mënyrë të shkurtër, do të ndalemi në marrëdhëniet, që vendosen ndërmjet komunës dhe ndërmarrjes publike. Përmendëm se me vendimin për **themelimin** e ndërmarrjes, në mes tjerash, përcaktohet edhe afati për sjelljen e statutit të ndërmarrjes publike. Statuti për tu aplikuar, duhet të merr pëlqimin paraprak të themeluesit, gjegjësisht të këshillit të komunës, si organ i autorizuar për dhënie të pëlqimit. Kjo është mundësi për të intervenuar në statutin, nëse mendohet se disa zgjidhje të ofruara nuk janë në pajtim me ligj ose nuk janë në pajtim me aktin e **themelimit** të ndërmarrjes publike, me të cilin bartet kompetenca për kryerjen e veprimtarisë së caktuar.

Këtu, gjithsesi, duhet të përmendet se në ndërmarrjen publike nuk mund të bëhet asnjë ndryshim statutar pa pëlqimin e themeluesit - komunës.

Ndërmarrja publike nuk mund të merr hua, nëse ju nuk jepni pëlqim për hua-marrje të tillë. Pse është i nevojshëm pëlqimi për hua marrje? Pëlqimi për hua marrje nga ana e ndërmarrjes publike është i duhur për të mos lejuar hyrjen në borxh të madh të ndërmarrjes publike, të cilin pastaj nuk mund ta kthejë, me çka vendos në pikëpyetje kryerjen e veprimtarive, të cilat janë bartur mbi te. Poashtu, pëlqimi i tillë është i nevojshëm për faktin se edhe për fitimin edhe për humbjen e ndërmarrjes publike vendosni ju. Kur folëm për **financimin**, përmendëm se lartësia e çmimit të përcaktuar nga ana e këshillit drejtues mund të aplikohet nëse merr pëlqimin e këshillit të komunës. Këto janë disa nga format, nëpërmjet cilave bëhet kontrolli mbi punën e ndërmarrjes

Shembull: Këshilli drejtues sjell vendim, me të cilin përcaktohet lartësia e çmimit për ujin e harxhuar për pije për m3. Ky vendim dërgohet deri të këshilli i komunës për fitimin e pëlqimit. Ju në mbledhjen e këshillit do të shqyrtoni të gjitha elementet e rëndësishme, të cilat kanë ndikuar në përcaktimin e këtij çmimi dhe pas konstatimit se çmimi i përcaktuar nga ana e këshillit drejtues të ndërmarrjes publike është në pajtim me nevojat e ndërmarrjes dhe do të jetë i kapshëm për shfrytëzuesit e shërbimeve, do të jepni pajtueshmëri. Në të kundërtën, mund të propozoni këshilli drejtues edhe një herë të shqyrton lartësinë e çmimit dhe gjatë përcaktimit të saj të merr parasush propozimet e juaja para se të paraqes përsëri propozimin e tij para jush për marrjen e pajtueshmërisë.

Për egzistimin e mundësisë për ndarje të ndërmarrjes publike, bashkim ose bashkangjitime të saj është e nevojshme ju të jepni pëlqim për këtë ndryshim. Poashtu, nuk mund të ndryshohet as struktura e kapitalit në ndërmarrjen publike, pa pëlqimin e juaj.



publike. Mirëpo, themeluesi kryen edhe kontroll të rregullt gjysëmvetor dhe vjetor mbi punën e ndërmarrjes publike. Këto kontrollat, së pari kryhen nëpërmjet aprovimit të programeve vjetore për punë, si dhe të planeve financiare për realizimin e programeve të tilla; së dyti nëpërmjet aprovimit të llogarisë vjetore dhe raportit për punë të ndërmarrjes publike. Nëpërmjet këtyre formave, ju e keni mundësinë më të madhe dhe më të mirë të ndikoni në krijimin e politikës së ndërmarrjes, nëpërmjet aprovimit të programeve dhe planeve financiare dhe nëpërmjet dhënies së vlerësimit juaj me aprovimin e llogarisë vjetore dhe raportit për punë. Këtu duhet të përkujtojmë se nëse nuk aprovohet llogaria vjetore, në pajtim me ligjin, do të paraqiten sanksione të caktuara për personat, që kanë udhëhequr me ndërmarrjen publike. Për këtë do të flasim pak më poshtë.

Forma e dytë e kontrollit dhe mbikëqyrjes së punës së ndërmarrjes publike realizohet nëpërmjet personave, të cilët i keni emëruar si anëtarë të këshillave drejtuese dhe të këshillit mbikëqyrës. Nëpërmjet anëtarëve të këshillit drejtues, duhet të krijohet dhe mbahet lidhja në mes themeluesit dhe ndërmarrjes publike. Jo vetëm kjo. Duke pasur parasysh kompetencat e lartë përmendura të këshillit drejtues, duhet të realizohen programet e sjellura nga ana e juaj, e që janë në funksionin e krijimit të kushteve për plotësim të nevojave të qytetarëve dhe forcimin e besimit juaj te ata. Nëpërmjet anëtarëve në këshillin për mbikëqyrje, për të cilët përmendëm se është mirë me qenë me arsim të lartë, mjaft profesional për punë financiare dhe punë kontabiliteti, do të mund të përcillni punën e ndërmarrjes, do të mund të fitoni raport real për punën dhe, gjithsesi, do të mund të fitoni llogari vjetore reale. Për të realizuar të gjithë këtë, ju keni të drejtën të kërkonit nga anëtarët e organeve drejtuese t'ju informojnë, të jepni propozime dhe sugjerime tuaja dhe, nëse vlerësoni se ata nuk e kryejnë funksionin, në të cilin i keni emëruar ose e kryejnë në mënyrë jo të plotë dhe pa kualitet, të kërkonit përgjegjësi prej tyre, madje edhe t'i shkarkoni. Gjithsesi, gjatë mandatit tuaj nuk do të kënaqeni vetëm me shqyrtimin e raporteve të rregullta, sipas rregullit një herë në vit. Kontaktet dhe takimet e juaja me këta persona do të janë shumë më të shpeshta. Nga kjo do të varet edhe suksesi i punës suaj.

Çrregullimi i punës

Nëse gjatë punës në ndërmarrjen publike vjen deri te mos kryerja e veprimtarisë; nuk kryhet plani për zhvillim (me çka shkaktohet edhe mund të shkaktohet dëm ndaj shfrytëzuesve të shërbimeve); vjen deri te ndryshimi i dedikueshmërisë themelore të mjeteve të ndërmarrjes ose ndryshimi i kushteve themelore për punë, ndërsa e gjithë kjo shkakton kryerje të vështirësuar të veprimtarisë së saj themelore të përcaktuar me aktin e **themelimit**, do të paraqitet çrregullim i punës së ndërmarrjes publike. Në situatë të tillë, është e nevojshme ndërmarrja e masave të caktuara me qëllim të eliminimit të çrregullimit të tillë.

Falimentimi do të paraqitet, gjegjësisht ndërmarrja publike do të ndërpret punën nëse paraprakisht sigurohet kryerja e veprimtarisë me interes publik në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar me ligj. Kryerja e veprimtarisë mund të sigurohet me themelim të ndërmarrjes së re publike, me bartjen e veprimtarisë mbi ndërmarrje tjetër publike ose me dhënien e lejes për kryerje të veprimtarisë personit të tretë.

Mund të ndërmerren masat, si vijon:

- të shkarkohet drejtori;
- të shkarkohet këshilli drejtues;
- të shkarkohet këshilli mbikëqyrës;
- të ndryshohet organizimi i ndërmarrjes publike;
- të ndërpritet kryerja e aktit kundërlgjor nga ndërmarrja publike, me të cilin vihet në pyetje kryerja e funksionit;
- të ndërmerren edhe masa tjera, të përcaktuara me ligje të posaçme.

Përmendëm se ndërmarrjet publike themelohen për kryerje të veprimtarisë komunale me interes publik dhe më rëndësi lokale. Duke pasur parasysh se fjala është për interes publik, është e nevojshme interesi i tillë të sigurohet gjatë punës së ndërmarrjes. Interesi publik sigurohet me obligimin e ndërmarrjes publike të kryej në mënyrë të përhershme dhe pa ndërprerje veprimtarinë,

për të cilën është themeluar, si dhe të ofrojë transparencë në punën e saj.

Në këtë kuptim për ndërmarrjen publike, në përgjithësi, nuk mund të fillohet procedurë e falimentimit. Në rastet kur janë krijuar kushtet për fillim dhe aplikim të procedurës së falimentimit atëherë ju, në suazat e kompetencave të organit të komunës, i cili e ka themeluar ndërmarrjen publike, keni obligim të ndërmerri masa për sigurimin e punës dhe funksionimit të papenguar të ndërmarrjes publike dhe të garantoni plotësimin e obligimeve të ndërmarrjes publike ndaj personave të tretë



7.1.2. Kryerja e veprimtarisë me leje

Siç thamë në fillim të këtij materiali, ju mund të vendosni kryerjen e veprimtarisë me interes publik t'ia besoni, përveç ndërmarrjes publike edhe personit fizik dhe juridik. Kjo veprimtari mund të kryhet në bazë të lejes, që do ta lëshojë komuna, gjegjësisht Qyteti i Shkupit (dhënës i lejes), personave fizik dhe juridik (shfrytëzues i lejes).

Marrëdhëniet në mes komunës, gjegjësisht Qytetit të Shkupit dhe personave fizik dhe juridik, rregullohen me marrëveshje. Këtu duhet të theksohet se për të prodhuar ndikim juridik, gjegjësisht për të vazhduar, marrëveshja duhet të arrihet në formë të shkruar. Kjo do të thotë se vetëm marrëveshja e shkruar vazhdon dhe asnjë lloj tjetër e marrëveshjes dhe asnjë formë tjetër nuk mund të vazhdojë.

Më marrëveshjen, në mënyrë të veçantë rregullohen: kushtet dhe mënyra e kryerjes së veprimtarisë; afati, në të cilin ofruesi i shërbimeve do të fillojë me kryerje të veprimtarisë; të drejtat dhe obligimet ndërmjet komunës dhe personave fizik dhe juridik; kohëzgjatja e marrëveshjes; shkaqet e marrjes së lejes; shkaqe dhe kushte për shkarkim dhe ndërprerje të marrëveshjes; mënyra e zgjidhjes së çështjeve kontestuese.

Duhet të theksohet se edhe këta subjekte, që kryejnë veprimtari me interes publik, janë të obliguar të realizojnë dhe mbrojnë interesin e përgjithshëm, e kjo do të thotë se edhe ata janë të obliguar të sigurojnë në mënyrë të përhershme dhe pa ndërprerje kryerjen e veprimtarisë komunale në mënyrë kualitative, si dhe të mirëmbajnë objektet dhe pajisjen e infrastrukturës komunale në gjendje funksionale

7.1.3. Infrastruktura komunale

Infrastruktura komunale përfshin objektet e ndërtuara, pajisjet, instalimet, sipërfaqet publike për trafik dhe objekte tjera të infrastrukturës komunale për kryerje të veprimtarive komunale.

Menjëherë në fillim të përmendim se objektet e infrastrukturës komunale janë të mira me interes të përgjithshëm për Republikën dhe mund të barten për shfrytëzim dhe mirëmbajtje në mënyrë të përcaktuar me ligj.

Këto objekte ndahen në:

- themelore dhe
- sekondare.

Në objektet themelore bëjnë pjesë: sheshet e qytetit dhe hapësirat publike të qytetit; rrugët themelore të trafikut dhe rrugët me trotoare; ndriçimi rrugor i rrugëve të trafikut, ndriçimi i shesheve dhe hapësirave publike të qytetit; sipërfaqet e gjelbërta publike në qytet dhe jashtë qytetit (parqe dhe të ngajshme); kanalizimi themelor atmosferik; kanalizimi themelor dhe bartja e ujërave të shfrytëzuara; rezervoaret dhe pastrimi i ujit për pije; rrjeti themelor i ujësjellësit; rrjeti themelor largpërçues; rrjetet themelore të PTT; rrjetet themelore të ujit të nxehtë dhe të gazit; varrezat dhe krematoriumet; deponimet dhe instalimet tjera themelore komunale të përcaktuara me planin urban gjeneral.

Në objektet sekondare, bëjnë pjesë: rrugët sekondare me trotoare dhe vend-parkime publike; rrjeti sekondar i ujësjellësit; ndriçimi rrugor i rrugëve sekondare dhe vend-parkingjeve publike; gjelbërimi i njësive dhe objekteve urbane; kanalizimi atmosferik sekondar; kanalizimi fekal sekondar dhe bartja e ujërave të zeza; rrjeti sekondar (me korrent të ulët) elektrik dhe trafostacionet sekondare; rrjetet PTT sekondare dhe rrjetet dhe instalimet tjera sekondare të përcaktuara me planin urban detal.

Është mirë të njihet ndarja e objekteve të infrastrukturës për dy aspekte:

1. Së pari, për procedurën e planifikimit të hapësirës, gjegjësisht gjatë sjelljes së planeve urbane dhe detale të dihet, cilat objekte të infrastrukturës, në cilin plan do të parashihen dhe



2. Së dyti, për pjesën e kompetencave ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit.

Kështu, objektet themelore të infrastrukturës parashihen, gjegjësisht planifikohen në planet urbane gjenerale derisa objektet sekondare të infrastrukturës planifikohen me sjelljen e planeve urbane detale.

Nëse mirret parasysh kompetenca e komunave në qytetin e Shkupit dhe kompetencat e Qytetit të Shkupit, mund të konstatohet se

- Qyteti i Shkupit është kompetent për ndërtim dhe mirëmbajtje të objekteve themelore të infrastrukturës (siç janë ndërtimi, shfrytëzimi, mbrojtja dhe mirëmbajtja e rrugëve magjistrale dhe rrugëve mbledhëse, furnizimi me ujë për pije nga sistemi i vetëm për furnizim me ujë të Qytetit të Shkupit, bartja dhe pastrimi i ujërave të përdorura; bartja dhe hedhja e ujërave atmosferike, ndërtimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik të rrugëve magjistrale dhe rrugëve mbledhëse në sipërfaqen e Qytetit të Shkupit etj.);
- komunat në qytetin e Shkupit janë kompetente për objektet sekondare të infrastrukturës (ndërtim, mirëmbajtje, rikonstruim dhe mbrojtje të rrugëve shërbyese dhe banuese; ndërtim dhe mirëmbajtje të ndriçimit publik të rrugëve shërbyese dhe banuese dhe të ngjajshme).

Trualli ndërtimor

Planet urbane sillen për hapësirë të caktuar dhe trualli, i cili është i përfshirë me ato merr status të veçantë, gjegjësisht bëhet truall ndërtimor. Këtu, më konkretisht do të përpunojmë statusin e truallit ndërtimor. Së pari do të shohim ç'është truall ndërtimor, të drejtat mbi truallin ndërtimor dhe në fund, rregullimi i truallit ndërtimor.

● Definicioni

Me nocionin e truallit ndërtimor nënkuptohet çdo truall i ndërtuar dhe i pandërtuar, që me planet hapësinore dhe urbane dhe aktet, të cilët i zëvendësojnë planet e tilla, është planifikuar për ndërtim. Ky truall është e mirë me interes të përgjithshëm për Republikën, ndërsa rregullimi i tij është hapësirë me interes publik.

● Të drejtat mbi truallin ndërtimor

Trualli ndërtimor mundet me qenë pronësi e Republikës së Maqedonisë ose pronësi e personave vendas fizik ose juridik. Nga kjo mund të konstatohet se persona të huaj fizik dhe juridik nuk mundën me qenë pronarë të truallit ndërtimor në Republikën e Maqedonisë. Bartësit e së drejtës për pronësi mund të disponojnë me këtë të drejtë, e kjo do të thotë se mund të shesin truallin, ta japin truallin me qira për periudhë afatgjate ose afatshkurtër, të vendosin hipotekë mbi truallin ose ta japin me koncesion.

E drejta mbi truallin ndërtimor në pronësi të personave fizik dhe juridik mund të jetë e kufizuar. Kështu kur është e nevojshme për shkak të ndërtimit të objekteve të infrastrukturës, në kuptim të realizimit të interesit publik, truall ndërtimor mund të shpronëzohet në mënyrë dhe sipas kushteve të përcaktuara me Ligjin për shpronëzim.

Nga ajo, që thamë më lartë, mund të konstatojmë se komunat dhe Qyteti i Shkupit nuk kanë të drejtë të pronësisë mbi truallin ndërtimor. Ky është njëri ndër problemet më të mëdha, me të cilin do të ballafaqoheni edhe ju në kryerjen e funksionit.

Nga aspekti i kompetencës për marrje ose kryerje të aktiviteteve dhe veprimtarive të caktuara të lidhura me truallin ndërtimor, komunat dhe Qyteti i Shkupit janë kompetent vetëm për:

- aprovimin e programit për rregullimin e truallit ndërtimor;
- rregullimin konkret të truallit ndërtimor dhe përgaditjen dhe marrjen e kompenzimit për rregullim të truallit ndërtimor.

Shembull i kufizimit të drejtës për truall ndërtimor në pronësi të personave fizik dhe juridik: në programin për rregullimin e truallit ndërtimor është paraparë të ndërtohet rrugë. Trualli ku është planifikuar ndërtimi i rrugës është në pronësi të personave fizik. Për të filluar realizimin e programit, duhet të përgaditet elaborat me listë të indikacioneve për parcelat dhe të kërkohet nga organi kompetent (Shërbimi për punë pronëso-juridike pranë Ministrisë së financave), të fillojë procedurën për marrjen e këtij trualli. D.m.th. ky është njëri nga rastet e kufizimit të pronësisë mbi truallin ndërtimor. Rast tjetër të kufizimit të së drejtës së pronësisë kemi në rastet kur pronari i truallit dëshiron të shesë truallin ndërtimor, në të cilin është planifikuar të ndërtohet objekt me interes shtetëror. Në këtë rast, përparësi në blerje ka Republika e Maqedonisë.



Të gjitha aktivitetet dhe veprimet tjera, siç janë fitimi dhe realizimi i të drejtave mbi truallin ndërtimor (koncesion, shitje, qira afatgjate dhe afatshkurtër, hipotekë, shpronëzim), janë nën kompetencë të pushtetit qendror, gjyqjeve dhe noterëve.

Në pjesën e të drejtave dhe obligimeve të komunave dhe Qytetit të Shkupit mbi truallin ndërtimor, posaçërisht duhet të potencohet dhënia e truallit ndërtimor në shfrytëzim të përkohshëm, gjegjësisht dhënia e truallit me qira në afat të shkurtër, si dhe lejimin e të ashtuquajturave masa urbane për sanim. Këto janë nën kompetencë të Ministrisë për transport dhe lidhje.

Në praktikë, në të kaluarën dhe tash, pa konsultim të pushtetit lokal, mundësohet vendosja-ndërtimi i objekteve të përkohshme, si dhe realizimi i punëve, që i tejkalojnë masat urbane për sanim.

Gjatë kësaj shkatërrohen ose dëmtohen objektet me interes të përgjithshëm (rrugë për biçiklistë dhe për këmbësorë, sipërfaqe të gjelbërta dhe të ngjajshme), në të cilët Qyteti i Shkupit dhe komunat kanë investuar mjete në kuadër të rregullimit paraprak të truallit ndërtimor. Me veprime të tilla, gjegjësisht me mungesën e konsultimit dhe arritjes së pëlqyeshmërisë pamundësohet ose në mënyrë të konsiderueshme vështirësohet rregullimi i mëtutjeshëm i truallit ndërtimor në këto lokacione. Mirret hapësira, në të cilën komunat, gjegjësisht Qyteti i Shkupit duhet të kryejnë funksionet e tyre (higjienën komunale, mbrojtjen e ambientit jetësor, çështjet e infrastrukturës dhe rregullimin dhe pajisjen tjetër komunale, sigurinë e trafikut, shfrytëzimin e pa penguar të objekteve përrreth etj.). Për tejkalimin e problemeve të tilla dhe duke pasur parasysh shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës ose për realizim të punëve ndërtimore (ndërtim të objekteve, kryerje të masave urbane për sanim dhe të ngjajshme), sipas natyrës së tyre, autorizimi për lejim të tyre duhet me qenë nën kompetenca të komunave, gjegjësisht Qytetit të Shkupit.

● Rregullimi i truallit ndërtimor

Ligji për truall ndërtimor i obligon dhe autorizon komunat dhe Qytetin e Shkupit të rregullojnë truallin ndërtimor. Nën rregullim të truallit ndërtimor nënkuptohet ndërtimi i objekteve të infrastrukturës me qëllim të sigurimit të arritshmërisë së pa penguar të rrugës publike deri te parcela ndërtimore, vendosjes së rrjetit të kanalizimit (atmosferik, fekal), rrjetit elektrik, PTT dhe instalimit tjetër (psh. rrjetit për nxehje, rrjetit për gaz varësisht prej mundësive, nevojave dhe zhvillueshmërisë së komunës), me kyqje deri te parcela ndërtimore.

Planifikimi, projektimi dhe realizimi i kësaj infrastrukture kryhet sipas planeve hapësinore dhe urbane dhe akteve, të cilat i zëvendësojnë këto plane, si dhe sipas koeficientit të shfrytëzimit të truallit të përcaktuar me plane.

Rregullimi i truallit ndërtimor kryhet në bazë të programit vjetor, që e sjellin këshillat e komunave. Përmbajtja e këtij programi është përcaktuar në nenin 45 të Ligjit për truall ndërtimor. Kjo përmbajtje përfshin:

- hapësirën, e cila është objekt i rregullimit;
- suazat e punëve për përgaditjen dhe pastrimitin e truallit ndërtimor;
- suazat dhe shkallën e pajisjes së truallit ndërtimor me objekte të infrastrukturës themelore dhe sekondare;
- burimet për **financimin** e programit;
- llogaritjen e harxhimeve për rregullimin e truallit ndërtimor;
- lartësinë e kompenzimit për rregullimin e truallit ndërtimor, si dhe për shpërndarjen e tij;
- mënyra e shpërndarjes së mjeteve për **financim** të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës;
- mjetet e dedikuara për përpilimin e planeve urbane dhe për përpilimin e dokumentacionit për ndërtim të objekteve të infrastrukturës;

Shembull: Gjegjësisht, është e nevojshme të sjellni vendim, me të cilin do të përcaktoni truall para hapësirave afariste për kryerje të tregëtisë në të vogël. Për realizimin e këtij vendimi, gjegjësisht për të dhënë truallin për shfrytëzim para hapësirave afariste duhet, që ky truall të mirret me qira nga Republika. Në rastin konkret objektet e infrastrukturës komunale, ku bëjnë pjesë edhe objektet publike të trafikut, janë të mira me interes të përgjithshëm për Republikën dhe vetëm ajo mund të bart shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e tyre në mënyrë të përcaktuar me ligj. Në rastin konkret ky është Ligji për truall ndërtimor, ku është përmendur se trualli ndërtimor mund të jepet me qira.



- dinamikën e realizimit të programit dhe
- objektet e infrastrukturës me interes publik për Republikën e Maqedonisë dhe vlerësimin e ndikimit të tyre mbi ambientin jetësor dhe natyrën, në pajtim me ligj, të cilat financohen nga Republika, gjegjësisht investuesi, të cilit Republika ia ka dhënë truallin.

Rregullimi i truallit mundet me qenë i plotësishëm ose i pjesërishëm. Për truallin ndërtimor të rregulluar, investuesi paguan kompenzim për rregullim të truallit ndërtimor, deri në lartësi të harxhimeve reale për rregullim-kompenzim të plotë ose të pjesërishëm (varësisht nga suazat dhe shkalla e rregullshmërisë së truallit dhe mund të paguhet në kiste). Lartësia e këtij kompenzimi llogaritet në bazë të elementeve të përcaktuara në programet vjetore për rregullimin e truallit ndërtimor, si dhe në pajtim me Rregulloren për shkallën e rregullshmërisë së truallit ndërtimor dhe mënyrën e llogaritjes së harxhimeve për truall ndërtimor, sipas shkallës së rregullshmërisë.

Elementet themelore, në bazë të të cilëve llogaritet ky kompenzim janë: baza për llogaritjen e kompenzimit (e përcaktuar në programin vjetor dhe e shprehur në den. / m² neto sipërfaqe e ndërtuar); komplekset dhe zonat; sipërfaqet e shfrytëzuar e objektit; dedikueshmëria e hapësirave të objektit (për banim ose afariste) dhe lloji i infrastrukturës që realizohet ose kyqet.

Rregullimin e truallit ndërtimor, të përcaktuar me dokumentacionin urban të vendit të banuar dhe me aktet, që i zëvendësojnë planet, mund ta bëjë komuna. Nëse komuna nuk e rregullon truallin, këtë gjë e bën investuesi në llogari të tij për çka nuk paguan kompenzim për rregullim të truallit ndërtimor. Poashtu, investuesi në llogari të tij, bën rregullimin e truallit ndërtimor në rastet e ndërtimit të objekteve jashtë përfshirjes urbane të vendit të banuar, si dhe në rastet kur rregullimi nuk është paraparë me program.

Komuna, gjegjësisht Qyteti i Shkupit dhe investuesi, pas dorëzimit të dokumentacionit të vërtetuar të projektit dhe të gjitha lejeve të duhura dhe pas dorëzimit të provës për pagesë të kompenzimit për rregullim të truallit ndërtimor, nënshkruajnë marrëveshje për kompenzimin, si dhe për mënyrën e pagesës së tij. Obligim ligjor është, që komuna, gjegjësisht Qyteti i Shkupit të nënshkruajë marrëveshjen në afat prej 15 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës nga ana e investuesit. Pas këtij afati, do të konsiderohet se investuesi do të ndërtojë në truall të parregulluar ndërtimor dhe do të lëshohet leje për ndërtim të objektit.

Mjetet nga kompenzimi për rregullimin e truallit ndërtimor janë të ardhura të komunës, gjegjësisht të Qytetit të Shkupit dhe shfrytëzohen për realizimin e programit për rregullim të truallit ndërtimor.

Për realizimin e programit, gjegjësisht për ndërtim të objekteve të infrastrukturës është e nevojshme, paraprakisht, komuna të fitojë të drejta paraprake të caktuara mbi truallin. Siç thamë, komunat dhe Qyteti i Shkupit nuk kanë të drejtë të pronësisë mbi truallin ndërtimor.

Mos realizimi i programit, gjegjësisht realizimi jo i plotë i tij, do të thotë se ju nuk e keni arsyetuar besimin, që ju është dhënë. Që të mos paraqitet një gjendje e tillë gjatë sjelljes së programit, posaçërisht gjatë përcaktimit të lartësisë së kompenzimit, që duhet të paguhet, keni mundësi të sillni një program të tillë, i cili në mënyrë reale mund të realizohet. Ndërsa lartësinë e kompenzimit mund ta përcaktoni ashtu, që t'i përgjigjet vlerës së tregut.

Gjatë përcaktimit të lartësisë së kompenzimit, mund të përcaktoni lartësi të ndryshme varësisht prej lokalitetit, që duhet të rregullohet. Më tutje, mund të jepni mundësi lartësia e kompenzimit për lokalitete të caktuara, në të cilat, në pajtim me planet, është paraparë ndërtimi i objekteve ekonomike të jetë më i vogël, me çka do t'ju mundësoni subjekteve të realizojnë investimet e tyre.

Ka komuna, në të cilat numri i objekteve të ndërtuara në mënyrë të paligjshme është tejet i madh. Ju mund të sillni akt, me të cilin këto objekte, nën kushte të veçanta, do të mund të legalizohen. Mjetet e fituara nga legalizimi i objekteve, do t'i përdorni për realizimin e programit.

Mjetet e fituara nga kompenzimi për rregullim të truallit ndërtimor janë të ardhura të komunës, gjegjësisht të Qytetit të Shkupit dhe shfrytëzohen për realizimin e programit. Në fakt, realizimi i programit do të varet nga ajo se, sa mjete do të mblidhen. Duke pasur parasysh gjendjen ekonomike në komunë dhe më gjërë në Republikën e Maqedonisë, mund të ndodh të mos keni interes për ndërtim. Si pasojë e këtij mosinteresi nuk do të realizohen mjetet e planifikuara në bazë të kompenzimit. Për këtë, keni mundësinë e shfrytëzimit të mjeteve, të parapara nga ana e Republikës nëpërmjet fondeve të ndryshme të dedikuara për ndërtim të obje-



kteve të infrastrukturës në komunat. Për të realizuar këtë të drejtë, duhet të keni sjellur plane urbane dhe përgaditur dokumentacion teknik për realizimin e këtij lloji të objektit komunal.

Ky është parakushti themelor për të shfrytëzuar mjetet e këyre fondeve. Këtu duhet të përkujtohemi, cilat janë këto fonde.

- Nëpërmjet Ministrisë për transport dhe lidhje mundeni nga programi për ujësjellës dhe kanalizim të fitoni mjete për ndërtim të objekteve të tilla në sipërfaqen e komunës së juaj. Poashtu, mjete mund të fitoni edhe prej Fondit për rrugë rajonale dhe magjistrale për ndërtim të rrugëve lokale, ndërsa prej Makedonija pat-it mund të kërkonti të mirëmbajë rrugët tranzite nëpër vendbanimet e komunës.
- Nëse keni probleme me rrugët nëpër fusha, me rreshjet dhe kanalizimin atmosferik, mund të kërkonti mjete nga Ministria për bujqësi - Programi për zhvillim të bujqësisë, si dhe prej Fondit për ujëra.
- Prej Agjensionit për rajone të pazhvilluara sa duhet, e cila është në përbërje të Ministrisë për vetëqeverisje lokale mund të kërkonti mjete për ndërtim të objekteve komunale në vendet e banuara, të cilat janë përcaktuar si të pa zhvilluara;
- Poashtu, nga Ministria për ambient jetësor - Programi për mbrojtje të ambientit jetësor, mund të fitoni mjete për ndërtim të objekteve, të cilët janë në funksion të mbrojtjes së ambientit jetësor.

Në këtë rast, varësisht nga ajo se kush është pronar i truallit ndërtimor, janë të mundshme dy variјanta. Së pari, nëse pronar i truallit është Republika, atëherë dorëzohet kërkesë, me të cilën kërkohet, trualli ndërtimor në fjalë t'i jipet komunës, gjegjësisht Qytetit të Shkupit në shfrytëzim afatgjatë për çka nuk paguhet qira. Së dyti, nëse trualli është në pronësi të personave fizik, atëherë fillohet procedura e shpronëzimit (trualli mirret për leverdi të Republikës e në llogari të komunës). Këtë procedurë e udhëheq organi shtetëror kompetent. Procedura është mjaft e gjatë. Problemi më i madh në këtë procedurë është përcaktimi i lartësisë së kompenzimit për truallin e shpronëzuar. Pronarët gjithmonë kërkojnë kompenzim, që është më i lartë madje edhe se vlera sipas tregut, gjë që nuk mund të pranohet nga komuna. Meqë kompenzimi nuk mund të përcaktohet me marrëveshje, lartësia e tij do të përcaktohet para gjyqit kompetent. E gjithë kjo kërkon kohë dhe është njëri prej shkaqeve për mos realizimin në kohë të programit.

Fjalë kyçe: veprimtari komunale, ndërmarrje publike, themelim, udhëheqje, financim.

Korrniza ligjore:

- Ligji për vetëqeverisje lokale ("Gazëta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 5/02)
- Ligji për Qytetin e Shkupit ("Gazëta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.55/04);
- Ligji për veprimtari komunale ("Gazëta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.45/97, 23/99, 45/02 dhe 16/04);
- Ligji për ndërmarrje publike ("Gazëta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.38/96, 9/97 dhe 6/02);
- Ligji për truall ndërtimor ("Gazëta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 53/01).





7.2 | ARSIMI, SPORTI DHE REKREIMI

Prof. Dr. Murtezan Ismaili

Arsimi bëhet obligim i rëndësishëm i komunave. Ky është rast për të ndikuar pozitivisht me qëllim të përmirësimit të gabimeve të qëllimta dhe të paqëllimta, si dhe jokonsekuenca në menaxhimin e këtij segmenti të shërbimeve. Mundohuni të bëni gjithçka, që është në mundësinë e juaj, që fëmijët, pronësitë jonë më të vlefshme, të ndjehen krenar për shkollën dhe komunën e tyre.

Faktori më i suksesshëm për krijimin e të ardhmes së suksesshme për gjeneratat, që vijnë është të ofrohet arsim me kualitet të lartë, që do të jetë në hap me ndryshimet e shpeshta të rrethinës.

Me aplikimin e Maqedonisë për anëtarësim në Unionin evropian, u zmadhuan edhe kërkesat në aspekt të sistemit arsimor. Gjatë kësaj jo vetëm, që duhet të përshtatet dhe vendoset sistemi arsimor në pajtim me nevojat e ndryshueshme të ekonomisë së tregut por, poashtu, duhet të kryhet reforma e sistemit arsimor, si një ndër parakushtet për anëtarësim në Unionin evropian.

7.2.1. Arsimi dhe komunat

Komunat e Maqedonisë së sotme, nuk kanë përvoja paraprake në përmbajtjen e arsimit në nivel lokal. Procesi i decentralizimit parashihet marrje të kompetencave të shumta. Ndërmjet këtyre kompetencave është edhe arsimi. Pas zgjedhjeve lokale, pas themelimit të këshillave të reja të komunave dhe zgjedhjes së kryetarëve të komunave, **arsimi fillor** dhe i mesëm do të jetë nën kompetencë të komunave. Kjo do të ndodhë atëherë, kur komunat do të bëhen pronare të ndërtesave shkollore dhe pronësitë tjetër përcjellëse të shkollave fillore dhe të mesme. Komunat, duke u bërë gjithnjë e më të fuqishme dhe duke e zmadhuar kapacitetin e tyre (në aspekt të zmadhimit të të ardhurave), do të marrin përgjegjësi gjithnjë e më të mëdha. Mirëmbajtja e ndërtesave shkollore, si dhe rrogat e personelit ndihmës, që punon në to, do të jetë përgjegjësi e komunës edhe atë me vetë fillimin e decentralizimit.

Komunat patjetër duhet të jenë të dedikuara t'ju ndihmojnë shkollave në arritjen e suksesit të tyre, me përmirësim konstant të programeve, shërbimeve dhe proceseve të tyre.

Anëtarët e këshillave komunale duhet të shfrytëzojnë përvojën personale për t'ju ndihmuar arsimit në nivel shtetëror dhe në nivel lokal në përpjekjet e tyre për përmirësimin e shërbimeve arsimore. Gjithashtu duhet të përmirësojnë edhe rezultatit e punës së tyre në aspekt të sistemit të përgjithshëm arsimor të nxënësit me pengesa në zhvillim, si dhe të nxënësit e tjerë në përgjithësi.



Participimi i pamjaftueshëm i nxënësve në procesin e marrjes së vendimeve në shkolla, duhet të ndryshohet me participim aktiv të tyre në këto procese. Kjo do të zhvillojë përgjegjësinë sociale të nxënësve.

Poashtu, duhet të vendoset akcenti në:

- motivimin e nxënësve për mësim; aplikimin e proceseve proaktive arsimore dhe mësimore; krijimin e përgjegjësisë më të madhe për zhvillimin arsimorë dhe profesional të nxënësve, si dhe zhvillimin e përkushtimit të tyre drejt arsimit dhe zhvillimit profesional;
- arsimtarët dhe profesorët duhet të zhvillojnë teknika inovative, me të cilat do të bëjnë metodologjitë edukative më moderne; të kenë motivim profesional për punën e tyre dhe me sukses t'i përparojnë këto teknika;
- t'ju mundësohet prindërve të përmirësojnë pjesëmarrjen dhe kycjen e tyre në arsimin e fëmijëve të tyre;
- transparenca, në përgjithësi, e zmadhon mundësinë për krahasim të kualitetit të arsimit, e kjo do të mundëson proces të shpejtuar të zhvillimit drejt sistemeve arsimore më të avansuara;
- potencim i veçantë i edukimit të femrave;
- të mos lihet anash asnjë fëmijë.

Përmirësimi i kualitetit të infrastrukturës dhe pajisjeve, konsiderohet si çështje me prioritet për zhvillim të më tutjeshëm të sektorit arsimor.

Duhet të potencohet nevoja për krijimin e sistemit të standardeve për kualitet në të gjitha nivelet e arsimit, si psh.

- aspektet funksionale dhe abientale të ndërtesave të shkollave dhe niveli i përgaditjes së shkollave (siç janë: obbori i përshtatshëm shkollor, sipërfaqe të gjelbërta, gardhe për siguri, si dhe heqja e pengesave arkitektonike për fëmijët me nevoja të posaçme etj.);
- standarde arsimore (klasa, ripërtrirje të pajisjeve, mjete mbikëqyrëse, laboratorit gjuhësore dhe kompjuterike, palestra **sportive** hapësira për lojë dhe aktivitete tjera jashtë shkollore për nxënësit);
- kompetenca profesionale qartë të definuara për ata, që ofrojnë aktivitetet arsimor dhe udhëheqin me shkollën.

Njëri nga qëllimet kryesore të komunës është përmirësimi i kualitetit të arsimit fillor dhe standardit të nxënësve; lehtësimi i arritshmërisë së arsimit dhe zmadhimi i numrit të nxënësve, që do të vazhdojnë me arsim akademik. Popullatës, që është gjeografikisht larg shkollave, duhet t'i kushtohet vëmendje e posaçme. Nga shumë faktorë, të cilët ndikojnë në kualitetin e arsimit fillorë, faktorët e paraqitur më poshtë duhet me qenë në fokusin e vetëqeverisjes lokale:

- lokacioni, objektet, koha dhe përmbajtja e trajnimit të arsimtarëve;
- zhvillim profesional i të gjitha kategorive të pedagogëve dhe kujdestarëve;
- roli i pushtetit dhe organizatave joqeveritare, komunave dhe prindërve në arsim;
- mbikëqyrje e kushteve në secilën shkollë;
- përkrahje të udhëheqësisë së shkollës në përpjekjet e tyre drejt përmirësimit të kushteve në shkollë;
- marrëdhënie dhe komunikim me shoqatat lokale afariste;
- komunikim me organizatat ndërkombëtare donuese;
- dhënie të ndihmës dhe përkrahjes inicijativave për modernizim të shkollave.

Vetëqeverisja lokale duhet të përmbajë projektet arsimore, si dhe investimet financiare, që janë të koncentruara në stimulimin e zhvillimit dhe mundësive për edukim të fëmijëve të familjeve, ekonomikisht të marginalizuara.

Iniciativa të tjera kryesore të vetëqeverisjes lokale, në kuadër të sistemit, janë si vijon:

- pajisje me kompjuterë me qëllim të lehtësimit të mësimin dhe të përmirësimit të metodave për mësim;
- përmirësim të infrastrukturës fizike, posaçërisht në shkolla, të cilat janë të vendosura në vende më të largëta;



- përmirësim të kapaciteteve të spjegimit nga ana e arsimtarëve nëpërmjet institucioneve të ndryshme për zhvillim arsimor;
- iniciativa arsimore, përmirësim të trajnimit të arsimtarëve dhe shpejtim të metodave edukative të ndihmuara me kompjutor.

Parfaqësuesit e komunave, të cilët flasin në gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedone, do të shfrytëzojnë gjuhën e tyre dhe librat e shkruara në gjuhën e tyre.

Në fillim rrogat e arsimtarëve do t'i sigurojë pushteti qendror nëpërmjet bllok dotacioneve. Këto janë mjete të ndara në nivel vjetor të dedikuara vetëm për rroga dhe në asnjë mënyrë nuk do të mund të shfrytëzohen për qëllime tjera.

Në fazën e mëvonshme të decentralizimit, komunat do të duhet patjetër të zmadhojnë aftësinë e tyre për financim të arsimit fillorë dhe të mesëm me mjetet, që do t'i mbledhin nëpërmjet tatimeve të mbledhura në nivel lokal.

Këshilli shkollor:

- këshillit të komunës i dorëzon projekt-plan vjetor për punë, si dhe raport për punën e shkollës;
- këshillit të komunës i dorëzon projekt-plan vjetor financiar;
- këshillit të komunës i dorëzon projekt-bilanc vjetor;
- kryetarit të komunës i propozon një kandidat për drejtor.

Në pajtim me ligjet e reja për **arsim fillor dhe të mesëm, këshilli i komunës do të:**

- themelojë ose pushojë punën e shkollave;
- lajmërojë gjyqin për vendimet e tija në afat prej tre ditëve pas aproimit të aktit;
- sigurojë arritshmëri të arsimit fillor dhe të mesëm për të gjitha fëmijët;
- vendosë për lokacionin e shkollës;
- emërojë dy anëtarë në **këshillat shkollore** të shkollave fillore, gjegjësisht tre anëtarë në **këshillat shkollore** të shkollave të mesme, të cilët do të përfaqësojnë vetëqeverisjen lokale.

kryetari i komunës:

- do të emërojë dhe/ose do të shkarkojë drejtorët e shkollave;
- do të sjell vendim për hapje të shpalljes për funksionin e drejtorit të shkollës edhe ate tre muaj para mbarimit të mandatit të drejtorit paraprak, poashtu do të thëret **këshillin e shkollës** të shpall shpalljen për drejtor të shkollës;
- emëron drejtorin e ri pesëmbëdhjetë ditë pas marrjes së propozimit nga ana e **këshillit shkollor**;
- nëse për arsye të çfarëdo shkaku drejtori nuk emërohet, përsëritet e tërë procedura dhe në afat prej pesë ditëve kryetari i komunës emëron drejtor dhe
- në rast të largimit nga puna të drejtorit, kryetari i komunës emëron person të besuar për kryerjen e funksionit të drejtorit, po jo më gjatë se për gjashtë muaj.

Këshilli i shkollës është organi, i cili do të udhëheq me shkollën. Te shkollat e vogla këshillat do të përbëhen prej shtatë anëtarëve, ndërsa për shkollat më të mëdha, këshilli do të përmban nëntë anëtarë. Në të dy rastet, këshilli i komunës do të emërojë dy anëtarë në këshillin e shkollës fillore dhe tre anëtarë në këshillin e shkollës së mesme, të cilët do të përfaqësojnë vetëqeverisjen lokale

Mandati i drejtorit është katër vjet. Kandidat për drejtor mundet me qenë personi, i cili ka pesë vite përvojë pune në lëminë e arsimit dhe i cili e ka kaluar provimin për drejtor. Në rast se nuk e ka kaluar këtë provim, kandidati edhe pa provim të kaluar mund të merr funksionin e drejtorit por në afat prej një viti do të duhet të kalon provimin në fjalë. Nëse nuk e kalon provimin në afatin e paraparë kohor, atëherë ai nuk do të jetë më i kualifikuar për pozitën e drejtorit.

Njëri ndër faktorët, i cili mund të jep kontribut në arsim të suksesshëm është edhe drejtori i shkollës, i cili është personi themelor në procesin e udhëheqjes së shkollës. Poashtu, ai është personi, i cili mbikëqyr dhe ju ndihmon arsimtarëve gjatë paraqitjes së mjeshtrive të reja në klasat e tyre.



7.2.2. Sporti dhe rekreimi

Problemet e evidentuara në Republikën e Maqedonisë në lëminë e **sportit** dhe rekreacionit, janë si vijon:

- a. Kompetencat e vetëqeverisjes lokale në lëminë e **sportit** dhe **rekreimit**;
- b. Prona, pronësia dhe udhëheqja e objekteve për **sport**;
- c. Financimi i **sportit**

a. Kompetencat e vetëqeverisjes lokale në lëminë e sportit dhe rekreimit

Sipas ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për **sport**, komunat në lëminë e **sportit** janë kompetente për zhvillimin e **sportit** masovik dhe aktiviteteve rekreative të qytetarëve, të përfshira në programet e klubeve **sportive** dhe rekreativo-sportive.

Pushteti lokal është kompetent për mirëmbajtje dhe ndërtim të objekteve të **sportit**; klasifikim të tyre; shfrytëzim etj. Pastaj, për organizimin e shfaqjeve dhe manifestimeve **sportive**; për mbajtjen e garave tradicionale me karakter nacional dhe ndërkombëtar; për mbajtjen e sistemit shkollor dhe studentor të garave dhe për mbajtjen e lidhjeve komunale, si formë më të lartë të organizimeve të aktiviteteve dhe sigurim të hapësirës, kushteve materiale dhe kadrovike për funksionimin e klubeve **sportive**.

Për realizimin e kompetencave të këtilla, këshillat e komunave sjellin programe me propozim të lidhjeve **sportive**. Programet e tilla financohen prej buxhetit të komunave.

b. Prona, pronësia dhe udhëheqja e objekteve për sport

Me ndryshimet e deritanishme të Ligjit, nuk janë paraparë kompetenca plotësuese për vetëqeverisjen lokale. Një gjë e tillë do të ishte më tepër se e levërdishme për zhvillimin e **sportit**.

Prona, pronësia dhe udhëheqja me objektet për **sport** edhe më tej mbetet kompetencë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, gjegjësisht Agjencionit për rini dhe **sport**.

c. Financimi i sportit

Në lëminë e financimit të **sportit**, finacat kyqe do t'i përcaktojnë komunat prej buxheteve të tyre. Poashtu, financime do të sigurohen edhe nga sponzorë dhe donatorë të ndryshëm, të cilët janë të interesuar për ndihmë të aktiviteteve **sportive**. Komunat, sipas kompetencave ligjore, mund të themelojnë edhe fondacion për zhvillim të **sportit**.

Fjalë kyqe: arsimit fillor, arsimit mesëm, sport, rekreim, këshilli shkollor.

Korniza ligjore:

- Ligji për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 5/2002);
- Ligji për arsimin fillor;
- Ligji për arsimin mesëm;
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsim mesëm;
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sport (neni 22-a dhe neni 22-b)



7.3 MBROJTJA SOCIALE DHE SHËNDETËSORE NË KOMUNAT

Docent Dr. Jove Kekenovski

Tash, të nderuar këshilltarë dhe kryetarë të komunave, qytetarët që i përfaqësoni presin nga ju shërbime më kualitative në lëminë e mbrojtjes sociale dhe shëndetësore. Ju presin kompetenca të reja në këtë lëmi të rëndësishme për qytetarët. Mos kundërshtoni kuptimin e një pjesë të punëve, me ate që është prezentuar si pjesë e të drejtave dhe obligimeve tuaja.

Sigurimi social i qytetarëve të Republikës së Maqedonisë është ngritur në nivel të Kushtetutës. Neni 1 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë thotë se Republika e Maqedonisë është shtet i pavarur, demokrat dhe social, me çka sistemit të sigurimit social i është dhënë vend i lartë në sistemin e vlerave shtetërore. Në shtetin tonë sigurimi social i qytetarëve, realizohet me ndihmën e sistemit të sigurimit social dhe mbrojtjes sociale. Sigurimi social është sistem i masave, që ofron sigurim prej rreziqeve: sëmundje, pushim i lindjes, vjetërsi, invaliditet, vdekje, papunësi, ndërsa realizohet nëpërmjet sistemeve të sigurimit shëndetësor dhe mbrojtjes shëndetësore, sistemit të sigurimit pensional dhe invalidor dhe sistemit të sigurimit në rast të papunësisë. Mbrojtja sociale qytetarëve ju ofron ndihmë dhe shërbime sociale, kur nuk janë në gjendje ata vetë të realizojnë sigurimin e tyre social. Këto sisteme, në masën më të madhe, financohen me pagesën e kontributeve nga rroga e të punësuarve.

Gjatë dhjetë viteve të kaluara sistemi i tërë politik, juridik, ekonomik dhe social, d.m.th. edhe organizimi i shërbimeve sociale, u rishqyrtua në mënyrë kritike dhe zhvillohet mobilizim i fuqishëm për reforma sociale në pajtim me përvojën më të mirë të Bashkësisë Evropiane dhe botës. Në suazat e këtyre proceseve në vitet e fundit afirmohen edhe aktivitetet e deinstitutionalizimit.

Në bazë të Ligjit për **mbrojtje sociale** sigurohen shërbime, masa dhe aktivitete, që zhvillohen në më tepër lëmi dhe nivele edhe atë:

1. Parandalim social - ndërmarrje të masave për ndalimin e paraqitjes së rrezikut social për qytetarët, për familjet ose grupe të popullatës - nëpërmjet punës edukativo-këshilluese, zhvillimit të formave të vetë ndihmës dhe punës vullnetare;
2. Mbrojtje sociale jasht institucionale - shërbimi i parë social (tregim i zgjidhjeve të mundshme); ndihmë me këshilla; ndihmë për familje; përkujdesje dhe ndihmë shtëpiake; përkujdesje ditore (vendosje në familje);
3. Mbrojtje institucionale (e drejtë për aftësim për aktivitet prodhues dhe e drejtë për vendosje në institucion për **mbrojtje sociale**);



4. Të drejtë për **mbrojtje sociale** (ndihmë afatgjate për persona, që nuk janë të aftë për punë dhe që janë pa përkujdesje sociale, ndihmë financiare sociale për persona të aftë për punë dhe me përkujdesje sociale, kompenzim financiar për ndihmë dhe përkujdesje, të drejtë për **mbrojtje shëndetësore**, kompenzim në rrogë për kohë të shkurtuar të punës për shkak të përkujdesjes së fëmijës të hendikepuar, ndihmë të njehershme financiare ose ndihmë në natyrë dhe të drejtë për banim.

7.3.2. Programi për zhvillimin e mbrojtjes sociale

Në bazë të Ligjit për **mbrojtje sociale**, Ministria për punë dhe politikë sociale e Republikës së Maqedonisë në fillim të çdo viti sjell program për realizimin e mbrojtjes sociale, që paraqet dokument themelor për realizimin e mbrojtjes sociale për vitin në vijim. Me këtë program rregullohen lëmitë e mbrojtjes sociale, nevojat specifike të popullatës dhe mënyra e realizimit të mbrojtjes sociale.

Gjatë vitit 2004 ndihma sociale u realizua nëpërmjet sigurimit të:

- 1) shërbimeve dhe masave për **preventivë sociale**, mbrojtje jasht institucionale dhe brenda institucionale të qytetarëve, që ju janë nënshtruar rreziqeve themelore sociale dhe
- 2) ndihmës sociale për shfrytëzuesit.

Gjatë vitit 2004 ndihma sociale u realizua nëpërmjet sigurimit të:

- 1) shërbimeve dhe masave për preventivë sociale, mbrojtje jasht institucionale dhe brenda institucionale të qytetarëve, që ju janë nënshtruar rreziqeve themelore sociale dhe
- 2) ndihmës sociale për shfrytëzuesit.

Aktivitetet strategjike, që duhet të jenë rezultati i programit përbëhen prej:

- ◆ Krijimit të kushteve për bartjen e të drejtave për themelim nga pushteti qendror, në vetëqeverisjen lokale, të shtëpive për pleq në Manastir, Prilep, Kumanovë dhe Shkup, me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të Ligjit për **mbrojtje sociale** në mars të vitit 2004. Decentralizimi mund të realizohet edhe me qendrat për përkujdesje ditore për fëmijë, me nevoja të posaçme intelektuale në Prilep, Veles, Tetovë, Kriva Pallankë, Delçevë, Shkup dhe fshati Manastirec - Makedonski brod, si dhe bartjen suksesive të llojeve tjera të qendrave për përkujdesje ditore, që janë në fazë të themelimit;
- ◆ Njësitë e vetëqeverisjes lokale, në bazë të nevojave të identifikuara të popullatës, do të mund të marrin mbi vete mbrojtjen sociale për kategori të caktuara të popullatës, nëpërmjet themelimit të institucioneve të vogla dhe nëpërmjet formave tjera jasht institucionale të mbrojtjes sociale, që do të organizohen në nivel lokal ose rajonal.
- ◆ Procesi i decentralizimit dhe deinstucionalizimit, do të zhvillohet në drejtim të hapjes së qendrave për përkujdesje ditore për: fëmijë me pengesa në zhvillimin intelektual (Shkup, Kërçovë etj.); për viktimat e dhunës familjare (Shkup dhe qytete tjera); për personat që keqpërdorin drogë (Ohër, Kumanovë, Shkup); për persona pa shtëpi (Shkup); për fëmijë në rrugë (Shkup); për persona të vjetër dhe të invalidizuar (Manastir), si dhe vazhdimin e aktiviteteve në planin e zhvillimit të mënyrës së vendosjes në familje tjetër.
- ◆ Në nivel lokal, do të përmbahet nevoja për hapjen e institucioneve të vogla publike për **mbrojtje sociale**, nëpërmjet të cilave shfrytëzuesit e mbrojtjes sociale do të kenë mundësi për integrim të sërishëm në njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe në familjen por edhe mundësi për trajtim individual për shfrytëzuesit, që do të kontribuojë për kualitet më të lartë të shërbimeve.
- ◆ Dhënia e prioritetit pluralizmit, gjegjësisht krijimi i parakushteve për kyqjen dhe vendosjen e dhënësve tjerë të shërbimeve (shoqata të qytetarëve - OJQ, persona fizik, që do të kryejnë punë të caktuara nga lëmia e mbrojtjes sociale, si veprimtari profesionale).



7.3.3. Mbrojtja sociale në vetëqeverisjen lokale

Përvoja e deritanishme tregon se Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë është në pajtim me frymën demokratike të Konventës për vetëqeverisje lokale, mirëpo rregullat ligjore nuk i përmbahen asaj.

Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për vetëqeverisje lokale në shkurt të vitit 2002, u krijua mundësia për decentralizim, gjegjësisht për bartjen e kompetencave prej nivelit qendror në nivel lokal në pjesën e mbrojtjes sociale.

Neni 22, pika 7 e Ligjit për vetëqeverisje lokale, thotë se vetëqeverisja lokale në pjesën e mbrojtjes sociale, është kompetente për: **mbrojtje sociale** dhe mbrojtje të fëmijëve - foshnjore dhe shtëpi për të moshuarit (pronësi, financim, investim dhe mirëmbajtje); realizim të mbrojtjes sociale për persona të invalidizuar, për fëmijë pa prindër dhe pa kujdes të prindërve; fëmijët me probleme socialo-edukative; fëmijët me nevoja të posaçme; fëmijët në familje me një prindër; fëmijët në rrugë; persona të nënshtruar rrezikut social; personat e prekur me keqpërdorimin e drogës dhe alkoolit; ngritjen e vetëdijës së popullatës; zgjidhjen e çështjes së banimit për personat të nënshtruar rrezikut social; realizimit të së drejtës dhe edukimin e fëmijëve të moshës para shkollore.

Realizimi i këtyre kompetencave të vetëqeverisjes lokale kryhet në pajtim me Ligjin për **mbrojtje sociale**, në bazë të të cilit sillet program për zhvillimin e mbrojtjes sociale, nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, me propozim të Qeverisë, gjegjësisht Ministrisë për punë dhe politikë sociale.

Në aspekt të veprimtarisë së mbrojtjes sociale janë realizuar ndryshime adekuate, gjegjësisht ndryshime dhe plotësime të Ligjit për **mbrojtje sociale**, të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, të Ligjit për kundërshtimet administrative, që do të mundësojnë procesin e decentralizimit të kompetencave në këtë lëmi.

Në të njëjtën kohë, varësisht nga ndryshimet në Ligjin për **mbrojtje sociale**, do të duhet të kryhen ndryshime adekuate në Ligjin për familjen, Kodin penal, Ligjin për egzekutimin e sanksioneve prej ku Qendra për punë sociale në pjesë të madhe i merr kompetencat publike.

Komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit, mbrojtjen sociale e organizojnë dhe realizojnë në pajtim me Ligjin për **mbrojtje sociale**. Komunat në Republikën e Maqedonisë sjellin programe të tyre zhvilluese për nevojat specifike të qytetarëve në lëminë e mbrojtjes sociale, i përcaktojnë obligimet e përcaktuara me ligj dhe sjellin akte të përgjithshme, nga lëmia e mbrojtjes sociale. Komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit, mund të sigurojnë realizimin e mbrojtjes sociale për personat me pengesa trupore; fëmijët pa prindër dhe përkujdesje prindërore; fëmijët me nevoja të posaçme; fëmijët në rrugë; fëmijët me probleme edukativo-sociale; fëmijët me një prindër; personat të nënshtruar rrezikut social; personat e prekur me keqpërdorimin e drogës; alkoolit dhe substancave tjera; personave të moshuar pa përkujdesje familjare nëpërmjet formave të mbrojtjes sociale institucionale dhe jashtë institucionale; zgjidhjen e çështjes së personave të nënshtruar rrezikut social; ndgritja e vetëdijës së popullatës për nevojën e ofertës së mbrojtjes sociale.

Komuna, Qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit, mund të themelojnë institucione publike për mbrojtje jashtë institucionale dhe institucionale në bazë të lejes së dhënë nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, e pas mendimit paraprak të Ministrisë për punë dhe politikë sociale.

Komuna nuk mund të merr leje për qendër për punë sociale dhe institucion publik edukativ për vendosjen e fëmijëve dhe të rinjve me sjellje të çrregulluar. Për themelimin dhe fillimin me punë të institucionit për **mbrojtje sociale**, Ministria për punë dhe politikë sociale përcakton normat dhe standardet për hapësirë.

Organi udhëheqës në institucionin publik i themeluar prej komunës dhe Qytetit të Shkupit është këshilli drejtues, i cili është i përbërë prej pesë anëtarëve të emëruar nga ana e themeluesit, prej të cilëve dy janë nga rradhët e punëtorëve profesional në insitucionin për **mbrojtje sociale**.

Drejtorin e institucionit publik të themeluar prej komunës, gjegjësisht Qytetit të Shkupit, e emëron dhe shpron kryetari i komunës, gjegjësisht kryetari i Qytetit të Shkupit. Nëse në kohë nuk emërohet drejtori i institucionit publik të themeluar nga komuna, gjegjësisht Qyteti i Shkupit, ministri për punë dhe politikë sociale, emëron kryerës të detyrës drejtor, më së gjati për një vit.

Drejtori dorëzon raport për punën dhe për punën materialo-financiare deri te këshilli drejtues, ministri për punë dhe politikë sociale dhe deri te kryetari i komunës, gjegjësisht deri te kryetari i Qytetit të Shkupit.



Njësia e vetëqeverisjes lokale ka kompetencë edhe për zgjidhjen e çështjes së banimit të personave të nënshtruar rrezikut social. E drejta e banimit sigurohet për personat e rrezikuar social, që nuk kanë të zgjidhur çështjen e banimit. Kriteriumi dhe mënyra e realizimit të së drejtës për banim, përcaktohet nga ana e këshillit të komunës, gjegjësisht këshilli i Qytetit i Shkupit.

7.3.3.1. Lloje të institucioneve për preventivë sociale dhe për mbrojtje jashtë institucionale

● Qendrat për punë sociale

Për realizimin e mbrojtjes sociale, Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka sjellur vendim për përcaktim të rrjetit të institucioneve publike për **mbrojtje sociale**, me çka përcaktoi egzistimin e 27 qendrave për punë sociale dhe 11 institucioneve për **mbrojtje sociale**. Kompetencat dhe mënyra e punës dhe financimit të qendrave për punë sociale dhe institucioneve për **mbrojtje sociale** në mënyrë normative është e rregulluar në nivel qendror, ndërsa nga aspekti organizativ realizimi i mbrojtjes sociale të qytetarëve, sigurohet në nivel lokal. Qendrat për punë sociale, të cilat e mbulojnë tërë territorin e shtetit, me kompetenca të vërteta dhe me kompetenca lokale. Qendra për punë sociale themelohet për një ose më tepër komuna. Në Republikën e Maqedonisë, në këtë moment, egzistojnë 27 qendra për punë sociale të janë themeluara për më tepër komuna, si qendra për punë sociale ndërkomunale.

Qendra për punë sociale është institucion me shumë funksione, që bën bashkimin e punës profesionale me kompetencat publike. Kjo është zgjidhje origjinale. Gjegjësisht qendra për punë sociale, me aplikimin e metodave për punë sociale, realizon **mbrojtje sociale** dhe vendos për të drejtat e qytetarëve. Në këtë mënyrë integrohet procedura administrative me punën metodologjike të punës sociale.

Organi më i lartë i udhëheqjes në qendrën për punë sociale është këshilli drejtues, i përbërë prej pesë anëtarëve të emëruar nga ana e themeluesit, nga të cilët një anëtarë është përfaqësues i këshillit të komunës, në rrethin e së cilës gjendet selia e qendrës për punë sociale; një anëtarë është nga rradhët e punëtorëve profesional në qendrën e punës sociale dhe tre anëtarë janë përfaqësues të themeluesit. Përfaqësuesin e qendrës për punë sociale, që ofron **mbrojtje sociale** në territorin e Qytetit të Shkupit, e propozon Këshilli i Qytetit të Shkupit.

Qendra për punë sociale mund të themelojë fondacion me qëllim, që prona e fituar në bazë të marrëveshjes së arritur për përkujdesje për gjithë jetën ose në bazë tjetër, të shfrytëzohet për realizimin e mbrojtjes sociale të qytetarëve në komunë dhe Qytetin e Shkupit, për të cilën rrethinë është kompetente qendra për punë sociale.

Këshilli drejtues i fondacionit përbëhet prej tre anëtarëve, nga të cilët dy janë përfaqësues të qendrës për punë sociale dhe një anëtarë është përfaqësues i emëruar nga ana e këshillit të komunës, në rrethinën e së cilës është selia e qendrës për punë sociale, gjegjësisht përfaqësues i Këshillit të Qytetit të Shkupit, nëse selia e qendrës gjendet në Shkup.

● **Vendosje në familje tjetër** - për vendosjen e personave në familje tjetër kompetente janë qendrat për punë sociale.

● **Qendra për persona pa shtëpi** - ofron pranim dhe përkujdesje ditore të përkohshme të këtyre personave, nëpërmjet dhënies së shërbimeve këshilluese, shërbime të lidhura me ushqimin, qëndrim ditor, mirëmbajtje të higjienës dhe aktivitete kulturor-zbavitëse.

● **Qendra për persona, viktimë të dhunës familjare** - ofron pranim dhe përkujdesje ditore të përkohshme të këtyre personave, që mund të zgjasë më së tepërmi deri në gjashtë muaj, me mundësi për prolongim edhe për gjashtë muaj, dhënie të shërbimeve këshilluese, shërbime të lidhura me ushqimin, qëndrim ditor, mirëmbajtje të higjienës dhe aktivitete kulturor-zbavitëse

Familjet, që përkujdesen poashtu i konsiderojmë si formë të kujdesit jashtë institucional dhe instrument për deinstitutionalizim. Në Republikën e Maqedonisë vendosja e fëmijëve në familje, që kujdesën për ato ka traditë shumëvjeçare por kjo, gjatë gjithë kohës, zhvillohej në Shkup. Në vitet e fundit kjo formë u zhvillua në Makedonski Brod dhe fshatin Manastirec në këtë komunë, në Prilep, në Koçanë, në Ohër. Tash kemi 85 familje në përgjithësi, me 133 fëmijë. Në kontinuitet rrjedhin aktivitete në funksion të përmirësimit të përkujdesjes të fëmijëve, që tani më janë të vendosur nëpër familje, si dhe zmadhimin e numrit të familjeve për përkujdesje, në të gjitha komunat.



- **Qendra për dhënien e ndihmës në kushte shtëpiake** - ju mundëson personave të lodhur, personave të moshuar dhe personave tjerë shërbime në formë të ushqimit, higjienë të banesës dhe punë tjera në shtëpinë e shfrytëzuesit.
- **Qendër ditore dhe klube për persona të moshuar dhe te rritur** - qendra ditore dhe klubi për persona të moshuar dhe të rritur, kryejnë shërbime të mbrojtjes sociale, në formë të qëndrimit ditor, ushqim, higjienë personale, si dhe organizimin e aktiviteteve punuese, kulturore, argëtuese, etj.
- **Qendër ditore për fëmijët e rrugës** - ju ofron shërbime edukativo-arsimore, punë këshilluese, aktivitete kulturoro-zbavitëse dhe rekreative.
- **Qendër ditore për personat që përdorin, gjegjësisht keqpërdorin drogë dhe substanca tjera psikotropike** - këtyre personave dhe familjeve të tyre ju ofrohen shërbime këshilluese, shërbime të informimit, këshilla dhe edukim, angazhim punues, aktivitete kulturoro-zbavitëse dhe rekreative.
- **Qendër ditore për personat që keqpërdorin alkool ose shërohen prej alkoolit** - këtyre personave dhe familjeve të tyre ju ofrohen shërbime këshilluese, edukim, angazhim punues dhe aktivitete kulturoro-zbavitëse. Tanimë janë përgaditur elaboratet për punën e qendrave ditore, ndërsa me programin operativ të Ministrisë për punë dhe politikë sociale, është paraparë deri në fund të vitit 2004 të hapen në Shkup, Ohër, Kumanovë. Kjo është në funksion të përfshirjes më të madhe të problemit, si dhe në aspekt të decentralizimit të funksioneve, që deri më tani i ka spitali ditor për tretman të personave që keqpërdorin drogë në Shkup. Qendrat ditore tani janë pjesë e qendrave për punë sociale.
- **Qendra ditore për persona me pengesa intelektuale ose trupore** - duhet të mundësojë përkujdesje ditore të këtyre personave, aktivitete punuese dhe prodhuese, dhe aktivitete tjera, si dhe aftësim për aktivitet punuese dhe prodhuese. Qendrat ditore mund të themelohen si institucione publike ose private për **mbrojtje sociale**, kurse mund të themelohen edhe si pjesë organizative e institucionit për **mbrojtje sociale** ose të personit tjetër juridik.

Një pjesë e projekteve ishin të drejtuar kah krijimi i shërbimeve, që do të ishin në funksion të ndihmës-përmbajtjes së familjes, kur ka anëtar me nevojë të caktuar, nga njëra anë dhe me këtë, nga ana tjetër, mënjanohet dërgimi i personit në institucion. Kështu sigurohen kushte për personin të vazhdojë të jetojë në rrethinën, që i përshtatet më mirë qenies së personit, ndërsa familjes i mundëson të jetojë jetën e saj sociale dhe profesionale. Sot, si rezultat i aktiviteteve, u hapën qendra ditore, si model i përkujdesjes së fëmijëve me hendikep të moderuar dhe të rëndë mental, që jetojnë me familjet e tyre, me qëllim që të mbahen në rrethin e tyre familjar dhe të integruar në bashkësinë lokale. Qendrat ditore përfshijnë 20-25 fëmijë me hendikep të moderuar, të rëndë dhe tepër të rëndë, në moshë prej 5-18 vjeçare. Qendrat ditore punojnë në komunat: Kriva Pallankë, Dellçevë, Veles, Gjevgjeli, Prilep, Manastir dhe Tetovë. Në periudhën e ardhshme planifikohet të hapen qendra ditore në Kavadarçë, Kërçovë dhe Shtip. Qendra ditore, është njësi organizative e qendrës për punë sociale. Të gjitha aktivitetet e qendrës ditore, drejtpërdrejtë, i realizojnë perso-

Orientimi drejt këtij drejtimit të mbrojtjes sociale dhe punës sociale do të thotë fokusim në mbrojtje të viktimave të dhunës familjare, nëpërmjet përkujdesjes së tyre në strehimore. Gjatë vitit 2004 janë hapur strehimore në Shkup, Strumicë, Koçanë dhe Manastir, si njësi organizative të qendrave për punë sociale. Këto strehimore mund të dedikohen, jo vetëm për nevojat e komunave ku janë hapur por edhe për komuna tjera, që gravitojnë në të njëjtin rajon.

Kur bëhet fjalë për përkujdesjen e personave të moshuar, kemi shembuj vetanak të praktikës në qendrat për punë sociale, që kanë zgjedhur përkujdesje ditore, si formë jashtë institucionale për këto persona: në Veles, fshati Çashkë, klub social, që siguron shoqërim ditor, i begatuar me aktivitete të ndryshme sociale dhe kulturore për 165 persona të moshuar; Gjevgjeli- përkujdesje ditore, e shprehur nëpërmjet sigurimit të ushqimit të ngrohtë, që ju dërgohet në shtëpitë e tyre dhe ndihmë psiko-sociale për rreth 50 persona të moshuar.

Shembull: në Qytetin e Shkupit egziston përvojë e punës me fëmijë të rrugës, që realizohet si punë edukative dhe psiko-sociale me fëmijët dhe familjet e tyre, në qendrën për punë sociale. Ky program tani do të realizohet në suazat e qendrës ditore, që duhet oficialisht të hapet deri në fund të muajit nëntor të vitit 2004. Programi do të përfshijë punë me fëmijët të moshës 6-15 vjeçare. Programin do t'a realizojnë psikolog, punëtor social, pedagog, mjek dhe grup vullnetarësh.



na profesional me profile, si vijon: punëtorë social, psikolog, pedagog, defektolog, fizioterapeut dhe motra medicinale. Parashikimet e tashme tregojnë se në një qendër me kapacitet për 25 fëmijë, përmbajtjet mund të realizohen me 6 të punësuar, duke pasur parasysh faktin se logjistikën e ofron qendra për punë sociale.

7.3.3.2. Llojet e institucioneve për mbrojtje institucionale

Sipas rregullativës ligjore e drejta për vendosje në institucion për **mbrojtje sociale** mbetet si mundësi kur personi nuk ka kushte adekuate për jetesë në familje të tij ose nga shkaqe tjera duhet të vendoset në institucion. Egzistojnë disa lloje të institucioneve:

Një pjesë e projekteve ishin të drejtuar kah krijimi i shërbimeve, që do të ishin në funksion të ndihmës-përmbajtjes së familjes, kur ka anëtar me nevojë të caktuar, nga njëra anë dhe me këtë, nga ana tjetër, mënjanohet dërgimi i personit në institucion. Kështu sigurohen kushte për personin të vazhdojë të jetojë në rrethinën, që i përshtatet më mirë qenies së personit, ndërsa familjes i mundëson të jetojë jetën e saj sociale dhe profesionale. Sot, si rezultat i aktiviteteve, u hapën qendra ditore, si model i përkujdesjes së fëmijëve me hendikep të moderuar dhe të rëndë mental, që jetojnë me familjet e tyre, me qëllim që të mbahen në rrethin e tyre familjar dhe të integruar në bashkësinë lokale. Qendrat ditore përfshijnë 20-25 fëmijë me hendikep të moderuar, të rëndë dhe tepër të rëndë, në moshë prej 5-18 vjeçare. Qendrat ditore punojnë në komunat: Kriva Pallankë, Dellçevë, Veles, Gjevgjeli, Prilep, Manastir dhe Tetovë. Në periudhën e ardhshme planifikohet të hapen qendra ditore në Kavadarçë, Kërçovë dhe Shtip. Qendra ditore, është njësi organizative e qendrës për punë sociale. Të gjitha aktivitetet e qendrës ditore, drejtë për drejtë, i realizojnë persona profesional me profile, si vijon: punëtorë social, psikolog, pedagog, defektolog, fizioterapeut dhe motra medicinale. Parashikimet e tashme tregojnë se në një qendër me kapacitet për 25 fëmijë, përmbajtjet mund të realizohen me 6 të punësuar, duke pasur parasysh faktin se logjistikën e ofron qendra për punë sociale.

- **Institucion për vendosjen e fëmijëve dhe të rinjve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore** - ofron përkujdesje (banim, ushqim, veshje dhe përkujdesje) të fëmijëve, deri sa nuk sigurohen kushte për kthimin e tyre në familje, gjegjësiht deri ata nuk aftësohen për jetë dhe punë të pavarur por më se gjati deri në gjashtë muaj pas mbarimit të shkollimit të mesëm, nëse nuk egzistojnë mundësi, përkujdesja të sigurohet në mënyrë tjetër.

- **Institucion për vendosjen e fëmijëve dhe të rinjve me probleme edukativo - sociale dhe me sjellje problematike** - institucioni për vendosjen e fëmijëve dhe të rinjve me probleme edukativo-arsimore; vendos fëmijët në moshë prej 7-18 vjeçare, gjegjësiht deri te mbarimi i shkollës së mesme. Gjithashtu, ky institucion bën pranim dhe përkujdesje me afat të shkurtër të personave të mitur; observimin dhe diagnostimin e personave të mitur; vendosje të zgjatur; edukim; arsimim dhe trajtim korigjues të personit të mitur, varësisht nga nevojat e tyre me kohë zgjatje deri në 3 vjet.

Institucioni fëmijëve me sjellje problematike, ju ofron përkujdesje, edukim dhe arsim fillor, ndërsa arsimin e mesëm e ofron në institucione adekuate arsimore. Këto dy institucione janë të obliguara personave të mitur, t'ju ofrojnë kushte të përshtatshme për vendosje, ushqim, realizim të planifikuar dhe organizuar të përmbajtjeve, masave dhe aktiviteteve në procesin e arsimit dhe edukimit të tyre, aktivitete të lira dhe jetë kulturore-zbavitëse, si dhe të kujdesen për jetën dhe shëndetin e personave të mitur të vendosur në këto institucione.

- **Institucion për vendosje të fëmijëve dhe të rinjve me pengesa në zhvillimin psikik dhe institucion për vendosje të fëmijëve dhe të rinjve me invaliditet trupor.**

- **Institucion për vendosje të personave të moshuar dhe të rritur, të invalidizuar** - egzistojnë tre lloje të institucioneve për vendosje të personave të moshuar dhe të rritur, të invalidizuar: a) institucione për persona të moshuar; b) institucione për persona të rritur të invalidizuar dhe c) institucione për persona të rritur të invalidizuar, me pengesa të moderuara dhe të rënda në zhvillimin psikik.

Institucionet për persona të vjetër dhe invlaidë të rritur ofrojnë vendosje; ushqim; ndihmë dhe përkujdesja; **mbrojtje shëndetësore**; aktivitete kulturoro-zbavitëse; aktivitete punuese dhe rekreative, varësisht nga nevojat, aftësitë dhe kërkesat e shfrytëzuesit.

Institucioni për persona të rritur me pengesa të moderuara dhe të rënda në zhvillimin psikik, ofron vendosje; **mbrojtje shëndetësore**; tra-

jtim punues në pajtim me aftësitë e tyre dhe gjendjen shëndetësore.



7.3.4. Mbrojtja shëndetësore

Sistemin e mbrojtjes shëndetësore e përbëjnë masat, aktivitetet dhe procedurat për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit dhe ambientit jetësor dhe punues; të drejtat dhe obligimet, që realizohen në mbrojtjen shëndetësore, si dhe masat, aktivitetet dhe procedurat, që i aplikojnë organizatat nga lëmia e shëndetsisë për ruajtje dhe përparim të shëndetit të njerëzve. Në këtë sistem bën pjesë edhe pengimi dhe shërimi i sëmundjeve, lëndimeve dhe çrregullimet tjera shëndetësore, hetimi i hershëm i sëmundjeve, gjendja shëndetësore, rehabilitim dhe shërimi me kohë dhe efikas, me aplikimin e masave, aktiviteteve dhe procedurave profesionale dhe medicinale.

E drejta për sigurim shëndetësor, realizohet si:

- 1) sigurim i obligueshëm shëndetësor;
- 2) sigurim plotësues i obligueshëm;
- 3) sigurim vullnetar, me çka ofrohet shfrytëzim i mbrojtjes shëndetësore me nivel më të lartë dhe komfort më të madh gjatë shfrytëzimit të mbrojtjes shëndetësore, që është mbi standardet, e përcaktuara nga ana e Ministrisë për shëndetsi;
- 4) shërbime shëndetësore, që paguhen me mjete personale;
- 5) mbrojtje e obligueshme shëndetësore.

7.3.4.1. Vetëqeverisja lokale dhe mbrojtja shëndetësore

Në nenin 22, pika 9 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, është përcaktuar kompetenca e vetëqeverisjes lokale në lëminë e mbrojtjes shëndetësore. Sipas kësaj dispozite, vetëqeverisja lokale është kompetente të udhëheq me rrjetin e institucioneve dhe objekteve publike shëndetësore të mbrojtjes primare shëndetësore, nëpërmjet kyqjes, gjegjësisht delegimit të përfaqësuesve të saj në këshillat drejtuese të këtyre organizatave shëndetësore, që janë në pronë publike.

Këshilli drejtues i institucioneve publike shëndetësore të mbrojtjes primare shëndetësore, përbëhet prej nëntë anëtarëve, nga të cilët tre përfaqëues nga rendi i personave profesional dhe kompetent nga institucioni shëndetësor, të cilët i zgjedh organi profesional; katër përfaqësues të themeluesit dhe dy përfaqësues të vetëqeverisjes lokale, nga të cilët njërin e zgjedh këshilli i komunës, në rrethinën e së cilës është selia e institucionit publik shëndetësor, ndërsa tjetrin e zgjedh këshilli i komunës, me numër më të madh të banorëve në rajonin, që e mbulon institucioni shëndetësor. Në raste të veçanta, të dy përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale në këshillin drejtues të institucionit publik shëndetësor, që ofron **mbrojtje shëndetësore** në rajonin e Qytetit të Shkupit, i emëron Këshilli i Qytetit të Shkupit.

Këshilli drejtues sjell statutin e institucionit publik shëndetësor, sjell vendime për ndryshime statutore, aprovon raportin për punën e institucionit, përcakton planin financiar, vërteton llogarinë përfundimtare, sjell akte të përgjithshme dhe përcjell realizimin e tyre, si dhe kryen punë tjera të përcaktuara me statutin e institucionit.

Në Republikën e Maqedonisë egzistojnë institucione për:

- Dy institucione për fëmijë pa prindër dhe përkujdesje prindërore: për fëmijë deri në moshën 3 vjeçare. Shtëpi për foshnje dhe fëmijë të vegjël - Manastir (me kapacitet për 100 fëmijë dhe 25 nëna. Aty, mesatarisht, vendosen 70 fëmijë) dhe Shtëpia për fëmijë "11 Tetori" - Shkup për fëmijë prej moshës 3-18 vjeçare (me kapacitet për 144 fëmijë, aktualisht ka 105 fëmijë);
- Dy institucione për fëmijë me probleme edukativo-sociale dhe delikvent të mitur në Shkup. Institucioni për përkujdesjen e fëmijëve me probleme edukativo-sociale (me kapacitet për 71 fëmijë) dhe Enti për përkujdesje, edukim dhe arsimim të fëmijëve dhe të rinjve, "Ranka Millanoviç" (me kapacitet për 75, ndërsa me 35 shfrytëzues);
- Tre institucione për persona me hendikep fizik dhe mental: Enti për rehabilitim të fëmijëve dhe të rinjve - Shkup (me kapacitet për 150, ndërsa me 108 shfrytëzues); Enti special, Demir Kapi (me kapacitet për 420, ndërsa me 380 shfrytëzues) dhe Enti për mbrojtje dhe rehabilitim - Banja Banski, Strumicë (me kapacitet për 65 persona);
- Katër shtëpi për persona të moshuar: Enti gerontologjik, "13 nëntori", njësia "Nëna Terezë" në Shkup (me kapacitet për 107 persona); Shtëpia për persona të moshuar, "Sju Rajder" në Manastir (me kapacitet për 147 persona); Shtëpia për persona të moshuar, "Kiro Krsteski-Platnik" në Prilep (me kapacitet për 150, ndërsa me 94 persona të vendosur) dhe Shtëpia për persona të moshuar, "Zafir Sajto" në Kumanovë (160);
- Institucioni i parë privat, "SOS fshati i fëmijëve" për fëmijë pa prindër (me kapacitet për 84, ndërsa të vendosur 2 fëmijë), që është në fazë të mbushjes së kapacitetit.

Në institucionet, përgjithësisht, janë të vendosur 1337 persona, prej të cilëve 494 janë fëmijë dhe 843 të rritur. Në numrin e të rriturve, bëjnë pjesë 508 persona të moshuar.



Poashtu, komuna është kompetente të ndërmerr aktivitete preventive, të përkujdeset për shëndetin e punëtorëve dhe mbrojtjen gjatë punës, të kryen mbikëqyrje të përhershme shëndetësore mbi ambientin jetësor dhe mbikëqyrje për parandalimin e sëmundjeve ngjithëse dhe veprimtari tjera, që janë të përcaktuara me ligj me qëllim të përparimit të shëndetit.

Fjalë kyçe: mbrojtje sociale, mbrojtje shëndetësore, preventivë sociale.

Korrniza ligjore:

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 52/91);
- Ligji për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.5/02);
- Ligji për mbrojtje sociale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.50/97, 16/00, 17/00 dhe 65/04);
- Ligji për mbrojtje sociale, tekst i pastruar ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 17/97)
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtje sociale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.10/04)



7.4 | KULTURA

Evgenija Bektash Josifovska

Biblioteka, muze, kinema, muzika, drama, teatër, art, film. Si të definojmë ndryshe këto fjalë, përveç si KULTURË.

Cilat janë kompetencat e juaja në këtë lëmi do të mësoni nga fletat në vijim.

Kultura është proces i gjithëshëm dhe sistem i hapur, i bazuar mbi disa rregulla themelore:

- arritshmëri
- lloj-llojshmëri
- transparencë
- përgjegjësi
- përshtatshmëri

1. **Arritshmëria** deri te vlerat kulturore ka të bëjë me realizimin e të drejtave kulturore të gjithë qytetarëve. Arti bëhet kulturë në thellësimin dhe përjetimin e vlerave të tij nga ana e publikut dhe atëherë ai ndryshon dhe përmirëson kualitetin e jetës.

2. **Lloj-llojshmëria** ka të bëjë me kultivimin e pasurisë së lloj-llojshmërisë në futurën kulturore (identitetin) të Maqedonisë, si dhe të nevojës për përhapjen e formave krijuese dhe lirisë artistike. Në kulturë shprehen dallimet dhe përvojat e ndryshme, si të vlerave të personit, ashtu edhe të grupeve sociale dhe popujve. Nëpërmjet kësaj, shprehet edhe përkatësia e tyre dhe karakteristika e personalitetit të tyre (identiteti).

Me amandamentet e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë nga viti 2002, potencohet multikultura e shoqërisë. Duke u nisur nga kjo (nga Kushtetuta dhe amandamentet), me Ligjin për kulturë shteti ndihmon kulturën, nëpërmjet krijimit të kushteve të barabarta për shprehje, kujdesje dhe vërtetim (afirmim) të veçantisë kulturore (identitetit), të të gjitha bashkësive;

3. **Transparenca** është rregull themelore e sistemit kulturor. Ajo egziston vetëm nëpërmjet transparencës dhe komunikimit, meqë në këtë mënyrë provon veten dhe përparon.

Vendi ynë, jo vetëm nga aspekti kulturor por edhe nga shkaqe ekonomike dhe politike, duhet të merr pjesë,

Kultura është shumë e diturive, besimeve, artit, moralit, drëjtësisë, traditave dhe përfitimeve të tjera të njeriut, nëpërmjet të cilës shprehen nevojat shpirtërore dhe sjellja e njerëzve ndaj fenomeneve në rrethinën e tyre. Kultura është mbindërtim krijues i realitetit bashkëkohorë me realizime dhe vlera të reja, me të cilat përparohen të drejtat dhe liritë e njeriut.



sa është e mundur më tepër, në shkëmbimin kulturor me botën dhe të zhvillon politikë kulturore aktive, ndërkombëtare; të lidhet me institucionet kulturore evropiane dhe botërore, me asociacionet profesionale të **muzeve** profesionale, **bibliotekave**, galerive, etj; të merr pjesë (konkurron), në fondet ndërkombëtare dhe të merr pjesë aktive në lidhjen regjionale dhe bashkëpunimin kulturorë, me fqinjët.

4. **Përgjegjësia** nënkupton respektimin e normave morale të profesionit dhe obligimet juridike. Programi nacional për kulturë bëhet fuqi për aktivizim të energjisë kreative në institucionet kulturore.

5. **Përshtatshmëria** ka të bëjë me nevojën e shfrytëzimit të të gjitha mundësive të mira për zhvillim kulturorë. Përveç punës me institucionet publike, interesi publik në kulturë realizohet edhe në bashkëpunim me sektorin joqeveritar dhe sektorin privat.

Decentralizimi i kulturës

Kultura mund të realizohet, si interes nacional, lokal dhe interes personal, me qëllim fitimprurës dhe jofitimprurës.

Interesi nacional në kulturë është interesi i saj publik për të gjithë qytetarët e Republikës. Ka për qëllim të mundësojë për të gjithë ata, pjesëmarrje të barabartë, si krijues dhe shfrytëzues.

Interesi lokal në kulturë është interesi i saj publik me rëndësi lokale për qytetarët në njësinë e vetëqeverisjes lokale. Sasia dhe realizimi i interesit lokal në kulturë, përcaktohet me aktet e komunës, ndërsa financohet në pajtim me programin për kulturë, që e sjell këshilli i vetëqeverisjes lokale. Institucionet lokale kulturore me kontakt të drejtëpërdrejtë me qytetarët në mënyrë më precize hetojnë nevojat e tyre kulturore dhe format e kënaqjes së tyre. Duke pasur parasysh se pushteti lokal ka të ardhura burimore personale, jeta kulturore në komunë do të jetë më e pasur, më e lloj-llojshme, më dinamike dhe më kualitative. Banorët nuk presin vetëm vizitat e rralla dhe të rastësishme por organizojnë edhe produksion të tyre kulturor. Në këtë mënyrë, zvogëlohet largesa në mes qendrave kulturore dhe provincës.

Interes personal në kulturë është kultura, të cilën e realizojnë artistët, institucionet dhe persona tjerë juridik dhe fizik, në bazë të vendimeve dhe mjeteve të tyre.

Realizimi i kulturës

Kulturën e realizojnë artist të pavarur, institucione publike dhe private, persona tjerë juridik dhe fizik.

Artist është çdo person fizik, i cili krijon vepër autoriale nga lëmia e krijimtarisë artistike (pikturë, **muzikë**, literaturë, skulpturë etj.), ose publikon vepër autoriale, gjegjësisht vepër të krijimtarisë popullore, pavarësisht nga niveli i arsimit, statusit juridik, regjistrimit, shtetësisë etj.

Artisti i pavarur realizon krijimtarinë si mjeshtër (profesionalisht) dhe, në pajtim me dispozitat për shoqatat tregëtare, regjistrohet për kryerje të veprimtarisë artistike.

Institucion është person juridik, i cili kryen veprimtari nga lëmia e kulturës, duke mos pasur për qëllim fitimin. Institucioni mund të themelohet nga personi fizik ose juridik dhe mundet me qenë privat ose lokal. Institucioni publik mundet me qenë lokal, në rast se themelohet nga ana e njësisë së vetëqeverisjes lokale ose nacional, kur themelohet nga ana e shtetit.

Shfrytëzimi i kulturës si burim (resurs) për zhvillim

Filozofitë e reja të kulturës dhe format e nxjerrura prej tyre për programin nacional, trajtojnë kulturën si zhvillim. Kultura duhet të përtërihet dhe zhvillohet në kontinuitet, nëse dëshirojmë të fisnikërojmë dhe të ngrit kualitetin e jetës; të shndërrohet në element dhe pajisje e zhvillimit shoqëror; të sigurojë ripërtirje ekonomike dhe shpirtërore (reproduksion).



Me politikën e re ekonomike, u krijuan kushte institucionet të motivohen për gjetjen e burimeve materiale plotësuese, siç janë: dhuratat (donacionet), nga vendi apo nga jashtë; ndihmë (sponzorim); kredi; motivim për më tepër burime personale me dhënien e shërbimeve kualitative; nëpërmjet dhënies së hapësirës me qira, shitjes së buletave, anëtarësisë; nëpërmjet zhvillimit të turizmit kulturor; nëpërmjet taksave të posaçme kulturore, etj.

Republika e Maqedonisë ka traditë të zhvilluar, në të cilën janë shtresuar më tepër shtresa civilizuese, ndikime kulturore, morale dhe fetare. Ajo, sipas krijimit të saj (gjenezës) dhe sipas burimit të saj, është multikulturore.

Punimet e artizanatit nga një traditë e tillë, hulumtohen për qëllime shkencore dhe ruhen si udhërrëfyes dhe përkujtim të së kaluarës, për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme.

Përmirësimi i udhëheqjes (menaxhmentit) në kulturë

Përmirësimi i udhëheqjes në kulturë, nënkupton aftësimin e kuadrit egzistues në institucionet kulturore, nëpërmjet trajnimit, qëndrimeve studimore, bartjen e diturisë, këmbimeve dhe formave tjera të bashkëpunimit në vend dhe në planin ndërkombëtar.

Planifikimi (strategjia)

Dekoncentrimi i kapitalit bëhet për qëllim të shpërndarjes më adekuate dhe me qëllim të krijimit të mundësive për institucionet kulturore, që ato të kryejnë në mënyrë maksimale punën e tyre, gjegjësisht në mënyrë profesionale dhe kualitative të realizojnë programet e tyre, si dhe projektet individuale dhe ta pavarura të japin rezultatet e pritura.

Në bazë të shqyrtimit profesional, përcaktohen kriteriumet për realizimin e prioriteteve të programit nacional për kulturën. Shpërndarja e mjeteve bëhet sipas dinamikës, e cila mundëson realizimin efikas të projekteve kapitale në kulturë, realizimi i të cilëve me vite është shtyrë për të ardhmen.

Me decentralizimin e pushtetit decentralizohen edhe kompetencat. Për nevojat kulturore në nivel lokal kujdesen dhe vendosin pushtetet lokale. Nevojat e tilla financohen në pajtim me programin për kulturë të aprovuar nga ana e këshillit të vetëqeverisjes lokale, ndërsa kujdesi për veprat kulturore me interes nacional edhe më tutje do të jetë kompetencë e shtetit.

Kultura gjendet në periudhë kalimtare. Me Ligjin për kulturë filloi procesi i decentralizimit dhe përcaktimi i rrjetit dhe statusit të institucioneve kulturore. Statusi dhe rrjeti aktual i institucioneve kulturore nuk është definitiv. Edhe në të ardhmën do të mund të inicohen dhe pranohen iniciativa për themelimin e institucioneve të reja kulturore, si rezultat i nevojave të zhvillimit kulturor ose për rishqyrtimin e statusit të institucioneve egzistuese.

Përparësitë (prioritetet) në zhvillimin kulturor

Duke pasur parasysh qëllimet e përcaktuara dhe instrumentet për realizimin e tyre, në Programin nacional për kulturë veçohen përparësitë në zhvillimin kulturor.

Vlerat e përgjithshme, siç janë: decentralizimi, përmbajtja e trashigimisë kulturore dhe të krijimtarisë bashkëkohore; përmirësimi në udhëheqjen me kulturën; përcaktimi i veçorive kulturore të bashkësive; bashkëpunimi me organizatat joqeveritare dhe bashkëpunimi ndërkombëtar kanë të bëjnë me programin e përgjithshëm, nacional për kulturë. Përcaktohen edhe përparësi të veçanta, duke pasur parasysh specifikat e tyre, edhe ato:

- Mbrojtja e trashigimisë kulturore;
- Mbrojtja e trashigimisë shpirtërore;
- Veprimtaria e **muzeve**;
- Veprimtaria e **bibliotekave**;
- Veprimtaria e **kinemave**;



- Veprimtaria publikuese dhe literatura;
- Krijimtaria muzikore;
- Krijimtaria dramaturgjike;
- Qendra të kulturës;
- Krijimtari **filmike**;
- Krijimtari e pikturës;
- Turizëm kulturor;
- Organizata joqeveritare (shoqata të qytetarëve);
- Industri kulturore;
- Hulumtime kulturore;
- Bashkëpunim ndërkombëtar kulturor;
- Manifestacione kulturore;
- Mbështetje të kuadrove deficitare dhe talentëve të rinj;
- Mbrojtje të drejtave autoriale dhe të drejtave të ngjajshme;
- Investime në kulturë;

Mbrojtje të përmendoreve dhe përkujtimeve

Me ngritjen e përmendoreve dhe përkujtimeve memoriale shënohen ndodhi të rëndësishme dhe personat të veçantë nga historia dhe kultura e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, popullit maqedonas, si dhe të qytetarëve, të cilët jetojnë në suazat e kufijve të saj, e që janë pjesë e popullit shqiptar, popullit turk, popullit vllah, popullit serb, popullit rom, popullit boshnjak dhe popujve tjerë. Me ngritjen e tyre shënohet edhe historia dhe kultura në përgjithësi, që janë me interes të veçantë për zhvillimin shoqëror të Republikës së Maqedonisë, me çka kontribuohet në realizimin dhe përparimin e lirive dhe të drejtave të qytetarëve, si dhe për afirmimin, aplikimin dhe respektimin e parimeve të humanitetit dhe vlerave të përgjithshme civilizuese.

Përmendoret memoriale janë objekte të veçanta ose grup i objekteve dhe vepra monumentale të arkitekturës, skulpturës, pikturës dhe artit aplikativ, me përmabjtje dhe vlera historike dhe artistike, që ngriten për ruajtje afatgjatë të kujtesës së ndodhive dhe personave, e që janë me rëndësi të jashtëzakonshme për Republikën e Maqedonisë.

Inicijativë dhe investim të mjeteve për ngritjen e përmendores monumentale mund të japin: Kuvendi i Republikës së Maqedonisë dhe organet e administratës shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale, institucione, shoqata të qytetarëve dhe fondacione, persona tjerë juridik të interesuar, si dhe qytetarë.

Këshilli i komunës aprovon program për shënimin e përmendoreve të ndodhive dhe personave me rëndësi lokale. Programi i komunës aprovohet me shumicë të votave të anëtarëve të këshillit të komunës.

Për ngritje, ruajtje dhe mirëmbajtje, mbrojtje dhe shfrytëzim të përkujtimeve, këshilli i komunës sjell vendim, si dhe emëron këshill për ngritje të përmendores. Këshilli i komunës me vendim rregullon edhe çështjen për dhënie e pëlqimit për ndryshim të përmendores ose për veprime në afërsi të saj, me të cilat veprime mund të çrregullohet integriteti i përkujtimeve; për çvendosje të saj, si dhe për çështje tjera në lidhje me përkujtimoren.

Për përmendoret dhe përkujtimeve memoriale të ngritura mbahen regjistra të veçantë. Regjistrin e përmendoreve memoriale e mban organi i administratës shtetërore - kompetent për punët në lëminë e kulturës, ndërsa regjistrat e përkujtimeve i mbajnë komunat.

Për shkak të regjistrimit të përkujtimeve në regjistrin qendror të përkujtimeve, këshilli i komunës është i obliguar të dorëzojë ekstrakt të regjistrit deri te Ministria për kulturë, në afat prej 15 ditëve nga dita e regjistrimit të kryer në regjistrin komunal, gjegjësisht ndryshimit të tij.

Për ngritjen e përmendores dhe përkujtimeve memoriale aplikohen dispozitat për ndërtimin e objekteve investuese dhe dispozitat për planifikim hapësinor dhe urban.



Trashigimia kulturore

Trashigimi kulturore janë të mirat materiale dhe jomateriale, të cilat si shprehje ose dëshmi të krijimtarisë njerëzore në të kaluarën dhe në kohën e tashme ose si vepra të përbashkëta të njeriut dhe natyrës, për shkak të vlerave të tyre arkeologjike, historike, urbane, ambientale, teknike, sociologjike dhe vlerave, cilësive, përbajtjeve ose funksioneve tjera kanë rëndësi kulturore dhe historike.

Trashigimia kulturore mundet me qenë:

- **e patundshme** (lokalitete arkeologjike, kisha, manastire, konaqe, sahat kulla, hamame, xhami, arkitektura e vjetër qytetare, arkitektura e vjetër fshatare, përmendore, përkujtimore, ura, shpella);
- **e tundshme** (sende e muzeve, sende arkeologjike, dorëshkrime të vjetra, sende etnologjike, ikona, freska, materijal fonetik dhe materijal kinematik);
- **shpirtërore** (këngë, loja, zakone).

Qëllimi themelor i mbrojtjes së trashigimisë kulturore është:

- ruajtja e trashigimisë kulturore në gjendjen burimore;
- krijim të kushteve të volitshme për mbijetim të trashigimisë kulturore dhe ruajtje të integritetit të të gjitha të dhënave, të cilat ajo i mban në vete, si dëshmi, burim ose dokument i llojit të vet;
- përhapjen e njohurive për vlerën dhe rëndësinë e trashigimisë kulturore dhe rrolin e tij në identifikimin kulturorë;
- aftësimin e trashigimisë kulturore për tu përdorur për kënaqjen e nevojave kulturore, shkencore, edukative, estetike, fetare, ekonomike, turistike, si dhe nevojave tjera të qytetarëve dhe shoqërisë.

Realizimi i mbrojtjes së trashigimisë kulturore është detyrë e shtetit dhe organeve të tij dhe organeve publike. Njësitë e vetëqeverisjes lokale, organet e tyre dhe shërbimet publike janë përgjegjëse për realizimin e mbrojtjes në suazat e kompetencave të tyre. Kujdesin për trashigiminë kulturore dhe për rezpektimin e saj është detyrë e çdo qytetari.

Aktivitete për përkrahjen e institucioneve kulturore lokale

Me qëllim të krijimit të kushteve më të volitshme materiale për decentralizimin e rrjetit të deritanishëm të institucioneve kulturore, sipas Ligjit për kulturë dhe sipas dispozitave tjera për vetëqeverisje lokale, shfrytëzohen edhe masat, si vijon:

- Ministria për kulturë, nëpërmjet konkursit, do të përmbajë projektet e institucioneve kulturore lokale, që janë me interes nacional. Komunitat janë të obliguara të financojnë aktivitetin e tyre të rregullt;
- Ministria për kulturë institucioneve kulturore lokale, themelues të të cilave janë komunitat, fillimisht, si përkrahje, do t'ju sigurojë një pjesë të mjeteve të nevojshme për punë të rregullt të tyre edhe nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë. Fjala është për financim të përbashkët të programeve nga Ministria për kulturë dhe nga komunitat;
- Nëpërmjet të një pjese të institucioneve nacionale, posaçërisht nëpërmjet të atyre, që me transformim prej dy ose më tepër institucioneve themelohen si qendra për kulturë (pilot projekte), do të mundësohet krijimi i grupeve teatrore, aktiviteteve vizatimore dhe ripërtirje të veprimtarive të kinemave, atje ku egzistojnë kushte, me qëllim të begatimit të jetës kulturore edhe në komunitat, në të cilat nuk ka kësi lloji institucionesh;
- Nëpërmjet organizatave jo qeveritare (shoqatave të qytetarëve), në periudhën e ardhshme do të vazhdojë financimi i projekteve për përmbajtje të procesit të decentralizimit, posaçërisht për forcimin e kapaciteteve për udhëheqje me institucionet lokale për planifikim dhe financim të kulturës në nivel lokal, edhe prej burimeve tjera;
- Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare (shoqatave të qytetarëve), nëpërmjet realizimit të projekteve të përbashkëta, kanë qëllim ngritjen e vetëdijes publike për trashigiminë kulturore, kulturën në përgjithësi, forcimin e dialogut ndërmjet kulturave dhe dialogun publik. Shoqatat e qytetarëve ripërtirjnë vullnetin



Shembull: për aktivitet të mirë dhe të suksesshëm në lëminë e kulturës është pritja e organizuar e vitit të ri në sheshin e qytetit, që e praktikojnë më tepër komuna, si Shkupi, Manastiri, Prilepi etj. Mjetet për një manifestim të tillë ndahen nga buxheti i komunës. Gjithsesi, me ndihmën e formave të ndryshme të gjetjes së mjeteve plotësuese (sponzorime), mund të begatohet programi. Ky program mund të realizohet me shoqatat kulturo-artistike lokale, me korre, me shoqëri tatrale amatore, me muzikant lokal etj. Kështu, i tërë qyteti ka mundësi të kënaqet dhe të merr pjesë në program, i cili është i arritshëm për qytetarët.

Shembull: Për festën fetare të Kërshëndellave - Buzëm, në Manastir ndizen zjarre në çdo mëhallë. Komuna e Manastirit, para tre viteve, organizoi zjarr të madh me rastin e natës së Buzmit në sheshin e qytetit, ku me kënaqësi morrën pjesë qytetarët. U nda një shumë e caktuar e mjeteve nga buxheti i komunës (për zmadhimin e tonit dhe për muzikë mekanike) dhe me ndihmën e ndërmarreve publike, të cilat dhanë: rërë, dru, dhe pije alkoolike dhe joalkoolike, qytetarët u zbavitën disa orë. Ky manifestacion mbahet tradicionalisht për çdo vit, në levërdi të qytetarëve.

rinë dhe amaterizimin në force shtytëse në kulturë. Ato vendosin praktikë të punës me kualitet të lartë, punë efikase dhe racionale, që mund të ndikojë në punën e institucioneve publike. Duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë incimit të ripërtrijes së artizanateve të vjetra dhe mjeshtrove tradicionale;

- Aktiviteti i forcuar dhe lëvizshmëria territoriale e njësive kulturore, ka si rezultat zmadhimin e lëvizshmërisë së ndodhive kulturore në vend. Shpesh herë ndodh në të njëjtën kohë të caktohen më tepër shfaqje kulturore, me çka vjen deri te ndarja e publikut. Për këtë është e nevojshme të përgaditet kalendar i aktiviteteve kulturore;
- Organe të institucionit kulturor, lokal janë: drejtori dhe këshilli drejtues;
- Drejtorët e institucioneve lokale kulturore emërohen nga ana e kryetarit të komunës, me konkurs. Kandidati për drejtor, patjetër duhet të dorëzoj propozim-program për zhvillim të institucionit;
- Kryetari ka të drejtë të zgjedh dhe të emëron dhe shkarkon anëtarët e këshillit drejtues të institucionit kulturor, lokal. Këshilli drejtues ka pesë anëtarë, nga të cilët dy janë nga rradhët e personave të veçuar kulturor, një përfaqësues i bashkësisë lokale dhe dy të punësuar në institucionin kulturor, lokal. Anëtarët e këshillit udhëheqës emërohen sipas parimit të profesionalitetit dhe kompetencës në kohëzgjatje për katër vjet, me të drejtë edhe për një mandat. Ata mund të shkarkohen edhe para skadimit të mandatit, nëse punojnë në kundërshtim me ligjin.

Ka ende shumë shembuj se, si mund të shfrytëzohen kapacitetet lokale për organizim të manifestacioneve të ndrshme kulturore. Për tu përshëndetur janë shembujt, si karnevali i Vevçanës dhe Festivali i birrës në Prilep.

Fjalë kyçe: bibliotekë, muze, kinema, muzikë, film.

Korrniza ligjore:

- Ligji për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 5/02);
- Ligji për kulturë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 49/03

(tekst i pastruar);

- Ligji për mbrojtje të përmendoreve të kulturës (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 24/73; 42/76);
- Ligji për përdorimin e gjuhës maqedone (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.5/98 (63/99 Vendim i Gjyqit kushtetues));
- Ligji për të drejtën autoriale dhe të drejtat e ngjajshme (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 47/96; 3/98; 98/02);
- Ligji për veprimtari të muzeve (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 25/79; 51/88; 12/93; 31/98);
- Ligji për veprimtari të bibliotekave (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 31/98);
- Ligji për financimin e vetëqeverisjes lokale, (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 61/04).



8 MBROJTJA E AMBIENTIT JETËSOR

Toni Popovski

Ambienti jetësor është vendi, në të cilin punojmë dhe i realizojmë dëshirat dhe ambiciet tona. Ambienti jetësor është edhe shtëpia, në të cilën e ndërtojmë familjen dhe rrethinën, që e rrethon komunën tonë. Është logjike të kujdesemi për hapësirën, në të cilën jetojmë, me qenë e mbrojtur në mënyrë të përshtatshme. Të bëjmë gjithçka, që është e mundur komuna me qenë udhëheqëse në mbrojtjen e ambientit jetësor.

Ambienti jetësor është hapësirë, në të cilën jetojmë, shtëpia jonë, vendi ku punojmë, vendi për mësim dhe lojë të fëmijëve tanë, si dhe rrethina e tërësishme, vendbanimet dhe natyra. Ambienti jetësor nuk i takon vetëm njerëzve por botës së përgjithshme të gjallë, duke i përfshirë bimët dhe kafshët. Çfarëdo prishje e balancit ka si rezultat pasojat, që jo rrallë kanë karakter të përgjithshëm. Ndotja e ajrit, ujit dhe truallit negativisht dhe drejtëpërdrejtë reflektohet mbi shëndetin e njerëzve dhe zvogëlon lloj-llojshmërinë biologjike. Trendi i ndotjes së ambientit jetësor, që është i inicuar nga procesi i industrializimit dhe globalizimit, krijon efekte globale, prej të cilëve më i rëndësishëm është efekti i ndryshimeve të klimës. Këto efekte globale ndikojnë në mënyrë serioze mbi jetën e të gjithë njerëzve në të gjitha shtetet dhe bashkësitë, sepse ndotja e ambientit jetësor nuk njihet kufinj administrativ. Mbrojtja dhe përparimi i ambientit jetësor është një nga sfidat themelore të njerëzimit, mu për shkak të nevojës së sigurimit të egzistencës së gjeneratave të reja. Mënyra më e mirë për zgjidhjen e problemeve të lidhura me gjendjen e ambientit jetësor, është krijimi i instrumenteve adekuate, krijimi i politikës, ligjeve dhe institucioneve për zgjidhjen e tyre në nivel global, nacional dhe lokal. Parim, përgjithësisht i pranuar, është nëse parandalimi nuk jep rezultat, problemi më së miri zgjidhet në vendin e paraqitjes së tij, kështuqë duhet të mendojmë në aspekt global por të veprojmë në aspekt lokal.

Karakterit teorik i rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë për mbrojtje dhe përparim të ambientit jetësor, si vlerë themelore, është i bazuar mbi parimin ndërkombëtar për zhvillim, nëpërmjet realizimit të baraspeshës me nënsistemet ekonomike, sociale dhe ekologjike. Ky zhvillim në teori është i njohur edhe me emrin zhvillim i qëndrueshëm.

E drejta për ambient të shëndoshë jetësor është e drejtë individuale por edhe obligim kolektiv për të gjithë qytetarët të kujdesen për rezlizimin e saj.

Çdo njeri ka të drejtë për ambient të shëndoshë jetësor. Secili është i obliguar të përparon dhe mbron ambientin jetësor dhe natyrën. Republika ofron kushte për realizimin e të drejtës së qytetarëve për ambient të shëndoshë jetësor (neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë).

Të gjitha pasuritë natyrore të Republikës së Maqedonisë, bota bimore dhe shtazore, të mirat në përdorim publik, duke përfshirë edhe infrastrukturën komunale, sipa Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë dhe sipas Ligjit për të mirat me interes të përgjithshëm për Republikën, janë nën mbrojtje të veçantë.



Korniza themelore ligjore (e bazuar në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë), në të cilën janë të përmbajtura parimet themelore në mbrojtjen e ambientit jetësor është përcaktuar me Ligjin për ambientin jetësor ose të ashtuquajturin kushtetutë ekologjike. Me këtë ligj është përcaktuar kornizë institucionale për mbrojtjen e ambientit jetësor si dhe procedurat administrative, të cilat janë të njëjta për të gjithë ligjet tjera të veçantë, që rrjedhin nga ky ligj-kornizë.

Ligji për ambientin jetësor definon parimin e zhvillimit të qëndrueshëm me qëllim të plotësimit të nevojave për ambient jetësor të shëndoshë, si dhe nevojat sociale dhe ekonomike të gjeneratave të tashme, pa u cënuar, gjatë kësaj, të drejtat e gjeneratave të ardhshme në plotësimin e nevojave të tyre. Ligji parashikon, gjatë ndërmarrjes të çfarëdo aktiviteti ose kryerjes së çfarëdo veprimtarie, me domosdoshmëri të mirret parasysh shfrytëzimi racional dhe i qëndrueshëm i resurseve.

Si formë administrative të bashkësisë lokale, vetëqeverisja lokale është e obliguar të mbrojë dhe përparojë ambientin jetësor. Çështjet e lidhura me mbrojtjen dhe përparimin e ambientit jetësor, janë çështje me interes të drejtëpërdrejtë për qytetarët. Mbrojtja dhe përparimi i ambientit jetësor është njëra ndër çështjet më karakteristike dhe, në të njëjtën kohë, shtytje për implementimin e së drejtës së qytetarëve në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe të parvarur, të vendosin për çështje me interes lokal. Zgjedhja e institucioneve lokale dhe organeve përfaqësuese, krijojnë kushte për udhëheqje të drejtë për drejtë, përveç të tjerave, edhe me pjesët themelore të nënsistemit ekologjik.

Kompetenca paraqet përmbledhje të të drejtave dhe obligimeve të organeve të pushtetit. Njëra ndër çështjet themelore të vetëqeverisjes lokale është, gjithsesi, çështja e veprimtarisë ose suazat e veprimtarisë së saj. Në vitin 2002 u aprovua Ligji për vetëqeverisje lokale. Në këtë ligj (neni 22), si kompetencë lokale u përcaktua edhe mbrojtja e ambientit jetësor dhe natyrës, nëpërmjet implementimit të masave për mbrojtje dhe pengim të ndotjes së ujit, ajrit, truallit, mbrojtjes së natyrës, mbrojtjes nga zhurma dhe **rezatimit** jo-

nik. Organet e decentralizuara, që do të realizojnë kompetencat e decentralizuara në lëminë e ambientit jetësor, është paraparë të kenë autonomi organizative, funksionale, personale dhe financiare. Pushteti qendror mban të drejtën e mbikëqyrjes së ligjshmërisë së akteve dhe aktiviteteve të organeve lokale.

Ministria e ambientit jetësor dhe planifikimit hapësinor nuk ka njësi në nivel lokal, kështuqë në kontekst të decentralizimit, nuk do të ndodhë bartje e zyrtarëve prej nivelit qendror në atë lokal. Për shkak të drejtimit të centralizuar të ambientit jetësor, administrata lokale ishte pak e involvuar në aktivitetet konkrete të Ministrisë. Mungesa e resurseve për mbrojtje të ambientit jetësor, kufizoi kapacitetin institucional, jo vetëm të administratës lokale por edhe të administratës shtetërore. Deri tani, pushteti lokal ishte i autorizuar vetëm për veprimtari komunale, duke përfshirë mbledhjen e hedhurinave dhe gjelbërimin e sipërfaqeve, që në thelb nuk paraqet kompetencë të vërtetë të drejtimit me ambientit jetësor. Është e qartë se pushteti lokal, për shkak të mungesës së kompetencave të vërteta, ka përvojë krejtësisht të vogël në këtë lëmi. Prej këtu rrjedh nevoja për forcim urgjent të kapaciteteve institucionale, lokale.

Duhet të presim, bartja institucionale e kompetencave të shkojë relativisht ngadal në pajtim me mundësitë e kufizuara financiare, teknike dhe mundësitë tjera të komunave, në mesin e të cilave janë të rëndësishme edhe mundësitë kadrovike. Për plotësim të vërtetë të kompetencave, do të duhet të plotësohen një sërë e parakushteve reale, teknike dhe materiale. Është e nevojshme, reforma institucionale e procesit të udhëheqjes me drejtimin e ambientit jetësor, të përmbahet dhe koordinohet nga ana e pushtetit qendror. Në këtë kontekst, duhet të mirret parasysh reforma në rrjedhë e administratës publike.

Në bazë të realizimit të decentralizimit në lëminë e ambientit jetësor, komunat në Republikën e Maqedonisë, në mes tjerash, duhet të plotësojnë edhe obligimet e reja në vijim:

- **Të japin përkrahje në kontinuitet në ngritjen e nivelit të arsimimit dhe ndërgjegjes publike për mbrojtje dhe përparim të ambientit jetësor.** Përfshirja e aktiviteteve të komunave në këtë kontekst, duhet me të vërtetë të jetë e gjërë dhe e determinuar nga gjendja e ambientit jetësor, nga gjendja e resurseve natyrore dhe nivelit të zhvillimit ekonomik. Arsimi dhe informatat për ambientin jetësor, duhet të promovohen dhe financiarisht të përmbahen. Të gjitha komunat, sipas shembullit të komunave Karposh dhe Veles, duhet të formojnë qendra për zhvillim të ndërgjegjes publike, gjegjësisht zyre për marrëdhënie me publikun, si dhe qendra edukative, që do ta forconin ndërgjegjen publike për çështje të lidhura me mbrojtjen e ambientit jetësor. Komunat mund të promovojnë kampanja të tyre ekologjike, nëpërmjet organizimit të ditës së komunës për mbrojtje të ambientit jetësor, ngjarje dhe manifestime të ndryshme;



- **Të sjellin dhe realizojnë plan ekologjik akcional, lokal (PEAL) në pajtim me planin ekologjik akcional, nacional (PEAN)** për periudhë gjashtë vjeçare. Këshillat e komunave, të Qytetit të Shkupit dhe të komunave në suazat e qytetit të Shkupit, duhet të formojnë trup të udhëhequr nga kryetari i komunës, i cili do të përcjell implementimin e planit ekologjik akcional, lokal dhe për këtë, një herë në vit të informojë organin e administratës shtetërore - kompetent për punët në lëminë e ambientit jetësor, i cili është në pozicion të propozojë ndryshime në planin ekologjik akcional, lokal me qëllim të pajtueshmërisë së tyre me PEAN-in. Planet ekologjike akcionale lokale, në bazë të vlerësimit të nivelit të ndotjes së ambientit jetësor në rrethinën e caktuar, përmbajnë masa dhe aktivitete afat-mesme dhe afat-gjate për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe shëndetin e njerëzve në ineres dhe nën kompetenca të komunave, të Qytetit të Shkupit dhe komunave në qytetin e Shkupit, posaçërisht për:
 - mbrojtje nga ndotja dhe përmirësimi i kualitetit të ajrit;
 - furnizim me ujë kualitativ për pije dhe mbrojtje të ujërave nga ndotja;
 - pastrim të ujërave të përdorura;
 - udhëheqje me hedhurina;
 - mbrojtje nga zhurma dhe **vibracionet** e krijuara, si rezultat i veprimeve dhe aktiviteteve ekonomike dhe veprimeve tjera;
 - zhvillim urbanistik dhe planifikim hapësinor;
 - zhvillim të transportit lokal dhe komunikacionit në rajon;
 - zmadhim të efikasitetit energjetik;
 - zhvillim të turizmit ekologjiko-turistik dhe ndikimi i tij në ambientin jetësor;
 - mbrojtja të diverzitetit biologjik;
 - udhëheqje dhe shfrytëzim të resurseve natyrore;
 - ngritje të vetëdijes publike dhe zhvillim të arsimit për mbrojtje dhe përparim të ambientit jetësor;
 - pasojat nga zhvillimi ekonomik mbi ambientin jetësor dhe
 - subjektet e autorizuara për realizimin e elementeve të veçanta të planit.

Përgaditja dhe aprovimi i PEAL-it është njëri ndër projektet thelbësore për zhvillimin në nivel lokal, sepse paraqet bazë për planifikim strategjik të nënsistemit ekologjik të zhvillimit të qëndrueshëm të komunës. Pushteti lokal i përbërë nga popullata lokale, për shkak të informimit të popullatës lokale me kushtet dhe situatën lokale, ka në disponim aftësi më të madhe për përcaktim të prioritetëve zhvillimore lokale, në krahasim me pushtetin shtetëror. Komunat, të cilat kanë përgaditur dhe aprovuar PEAL-in, automatikisht sigurojnë situatë fillestare më të mirë, në aspekt të mundësisë për shfrytëzim të mjeteve financiare të pa kthyeshme nga donatorët ndërkombehtar, si partnerë zhvillimor të Republikës së Maqedonisë;

- **Të përdorin vlerësim strategjik të ndikimit mbi ambientin jetësor nga ana e strategjive, planeve dhe programeve të caktuara në bazë të pjesëmarrjes së publikut.** Në Republikën e Maqedonisë së shpejti do të krijohet, i ashtuquajturit sistem nacional për vlerësimin e ndikimit mbi ambientin jetësor, duke përfshirë vlerësim strategjik të ndikimit mbi ambientin jetësor nga strategjitë, programet dhe planet e ndryshme. Vlerësimi strategjik i ndikimit është e vetmja masë operative, që mundëson inkorporim të suksesshëm të politikës për mbrojtje të ambientit jetësor në politikat sektoriale. Ky instrument, në pajtim me metodologjitë më të reja, rekomandon kyqje të hershme të publikut në procesin e planifikimit, me çka në mënyrë shumë konkrete, plotësohen dy parime thelbësore të përmendura në Ligjin për ambientin jetësor, të shtuquajturit parim për parandalim dhe parim për pjesëmarrje. Është paraparë edhe pjesëmarrje e komunave në procesin e përgaditjes së vlerësimit strategjik të ndikimit në nivel shtetëror, me çka komunave ju sigurohet pjesëmarrje në vendimet strategjike, të cilat mund të kenë ndikim në situatën e ambientit jetësor në territorin e tyre. Kjo, posaçërisht është e rëndësishme në aspekt të zhvillimit të infrastrukturës strategjike, korridoreve dhe rrugëve, lidhjes energjetike me vendet fqinje dhe të ngjashme;



- **Të japin mendim për projekte, që duhet të realizohen në territorin e komunës në bazë të studimit të përgaditur për vlerësimin e ndikimit mbi ambientin jetësor dhe të marrin pjesë në diskutimin publik.** Ministria për ambient jetësor dhe planifikim hapësinor, është përgjegjëse për përgaditjen e metodologjisë dhe sistemit për vlerësim të ndikimit mbi ambientin jetësor, si dhe për udhëheqjen e bazës së të dhënave për vlerësim të ndikimit mbi ambientin jetësor. Meqë kjo procedurë është e lidhur me planifikimin urban, që është nën kompetenca të komunës, me qëllim të sjelljes së vendimeve kualitative me rëndësi lokale, do të jetë i domosdoshëm bashkëpunimi funksional dhe efikas në mes administratës qendrore dhe lokale, si dhe njohje e thelluar e procedurave për vlerësim të ndikimit. Çdo komunë do të duhet, së paku të ketë një të punësuar, i cili do të realizojë procedurat për vlerësim të ndikimit mbi ambientin jetësor. Poashtu, komuna duhet të parashikojë harxhimet për shpallje të shpalljeve, distribuimin e materialeve për diskutime publike dhe të ngajshme;
- **Të japin lejet e ashtuquajtura B eko leje të integruara në bazë të pjesëmarrjes së realizuar në publik.** B - leja ekologjike e integruar ka të bëjë me iniciativa të reja të biznesit nga ana e ndërmarrjeve, që shkaktojnë ndotje të ambientit jetësor në suazat e njësisë së vetëqeverisjes lokale. Ndërmarrjet janë të obliguara të fitojnë B-leje ekologjike të integruar. Qeveria e Republikës së Maqedonisë përcakton instalimet, për të cilat është e nevojshme B-leje e ekologjike e integruar. Ministri, i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore - kompetent për punët në lëminë e ambientit jetësor, përcakton procedurën për dhënie, ndryshim, bartje të plotë ose të pjesërishtme të B-lejes ekologjike të integruar, me kryetarët e komunave dhe të Qytetit të Shkupit. Në rastet kur instalimi gjendet në rrethinë të mbrojtur me ligj, organi-kompetent për dhënien e B-lejes ekologjike të integruar është organi i administratës shtetërore-kompetent për punët në lëminë e hapësirës jetësore. Për dhënie të B-lejes ekologjike të integruar, komunat dhe Qyteti i Shkupit duhet të kenë të punësuar, së paku, dy nëpunës shtetëror, gjegjësisht nga një për secilin sektor të industrisë. Komunat dhe Qyteti i Shkupit informojnë organin e administratës shtetërore-kompetent për punët në lëminë e ambientit jetësor për plotësimin e kushteve. Komunat mund të formojnë edhe administratë të përbashkët për dhënien e B-lejeve ekologjike të integruara. Në B-lejen ekologjike të integruar përbahen të dhëna për ndërmarrjen dhe instalimin, si dhe kushtet, të cilat ndërmarrja duhet të plotësojë patjetër, në lidhje me punën e instalimit në pajtim me kushtet e përcaktuara me ligj dhe dispozitave të sjellura me ligj;
- **Të japin mendim për të ashtuquajturën A - leje ekologjike të integruar.** Aktivitetet e instalimeve të reja, që shkaktojnë ndotje më të madhe të ambientit jetësor ose ndryshim të konsiderueshëm të instalimeve egzistuese të përcaktuara nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, mund të kryhen vetëm pas marrjes paraprake të lejes ekologjike të integruar, të ashtuquajtur A-leje, të cilën e lëshon administrata shtetërore - kompetente për punët në lëminë e ambientit jetësor;
- **Të përgadisnin plan të jashtëm për gjendje të jashtëzakonshme të bazuar në planet e brendshme për gjendje të jashtëzakonshme të përgaditura nga ana e ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve publike dhe t'i dorëzojnë deri te komuna.** Në planet për gjendje të jashtëzakonshme operuesi është i obliguar të kyqë masa, që duhet të ndërmerren brenda në sistem në rast të çrregullimit eventual dhe planin ta dorëzojë deri te komunat dhe Qyteti i Shkupit, me qëllim që t'ju mundësojë të përgadisnin plan të jashtëm për situata të jashtëzakonshme. Plani duhet të dorëzohet edhe deri te organi shtetëror - kompetent për punët në lëminë e ambientit jetësor. Planet për gjendje të jashtëzakonshme duhet të mundësojnë:
 - lokalizim dhe kontrollim të çrregullimeve me pasoja ekologjike, me qëllim të minimizimit të pasojave dhe të kufizimit të dëmeve për jetën dhe shëndetin e njerëzve, ambientit jetësor dhe pronës;
 - realizim të masave të nevojshme për mbrojtjen e njerëzve dhe ambientit jetësor nga pasojat e çrregullimeve;
 - bartjen e informatave të nevojshme drejt publikut, si dhe shërbimeve dhe organeve të prekura dhe të interesuara për këtë problematikë; ripërtirje dhe pastrim të ambientit jetësor, pas paraqitjes së çrregullimit.

Kryetari i komunës dhe kryetari i Qytetit të Shkupit, janë të obliguar të mundësojnë qasje të publikut deri te përmbajtja e planit të jashtëm dhe të brendshëm për situata të jashtëzakonshme. Planet e brendshme dhe të



jashtme për situata të jashtëzakonshëm, duhet të aplikohen pa vonesë nga ana e operatorit dhe, nëse është e nevojshme, nga ana e komunave dhe Qytetit të Shkupit, në raste të çrregullimeve me pasoja ekologjike ose ndodhive të pakontrolluara. Kryetarët e komunave dhe të Qytetit të Shkupit, janë të obliguar planin e jashtëm për gjendje të jashtëzakonshme, në afat prej 15 ditëve nga dita e sjelljes së tij, ta dorëzojnë deri te organi i administratës shtetërore - kompetent për punët në lëminë e ambientit jetësor. Operatori, kryetarët e komunave dhe kryetari i Qytetit të Shkupit dhe organi i administratës shtetërore - kompetent për punët në lëminë e ambientit jetësor, janë të obliguar në periudhë jo më të gjatë së tre vjet, të bëjnë analizimin dhe testimin, ripërtrijen dhe revidimin e planeve të jashtme dhe të bërëshme për gjendje të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj duhet të kihet kujdes për arritjet e reja teknologjike në lëminë e ballafaqimit me çrregullime, me pasoja ekologjike;

- **Të autorizojnë inspektorë lokal për ambient jetësor.** Mbikëqyrja inspektive mbi të gjitha mediet e ambientit jetësor, ndoshta është pjesa më e rëndësishme nga kompetencat e reja të komunave në lëminë e ambientit jetësor. Madhësia e suazave të mbikëqyrjes, që do t'ju besohet komunave do të varet nga lloji i ndotjes, si dhe nga kapaciteti i komunave. Komunitat mund të bashkëpunojnë në lëminë e mbikëqyrjes inspektive, mbi gjendjen e ambientit jetësor. Ministria për ambient jetësor dhe planifikim hapësinor do të organizojë inspektim regjional për ambientin jetësor, që do të kryen mbikëqyrje në nivel shtetëror. Në parim, komunitat do të organizojnë mbikëqyrje inspektive për kontrollin e ndotjes dhe ndotësve, që nuk përhapen jashtë territorit të komunës. Prej këtu rrejdheve nevojë e ekipimit sa më të shpejtë të komunës me kuadër dhe pajisje teknologjike për realizim efikas të mbikëqyrjes inspektive;
- **Të aplikojnë parimin (e ashtuquajtur), ndotësi paguan dhe në këtë mënyrë të sigurojnë të ardhura plotësuese.** Ligji për ambientin jetësor definon parimin e obligimit të ndotësit për kompenzimin e harxhimeve për largimin e rrezikut për ndotje të ambientit jetësor; të paguaj harxhimet për sanimin dhe të paguan kompenzim adekuat për dëmin e shkaktuar mbi ambientin jetësor dhe të sjell ambientin jetësor, në masën më të madhe të mundshme, në gjendjen sikur para dëmtimit;
- **Të sjellin dhe realizojnë plan të posaçëm për udhëheqjen me hedhurinat të bazuar mbi planet e përgaditura për udhëheqje me hedhurinat e personave juridik dhe fizik në territorin e komunës.** Deri në këtë moment aktivitetet e komunave ishin të kufizuara në grumbullimin e hedhurinave komunale, edhe atë me mungesë të çfarëdo lloji të strategjisë integrale për udhëheqje. Ministria për ambient jetësor, do të përcaktojë standardet për udhëheqje me hedhurinat e ngurta. Përgjegjësia për realizimin dhe mbikëqyrjen e këtyre standardeve, bartet mbi komunitat. Ministria do të mbetet kompetente për përgaditjen dhe realizimin e strategjisë për udhëheqje me hedhurinat, për planifikim të deponimeve rajonale sanitare dhe për përcaktimin e standardeve për udhëheqje me hedhurinat. Hedhurinat e rrezikshme mbesin nën kompetencat e Ministrisë për ambient jetësor dhe planifikim hapësinor. Edhe në këtë lëmi, nevojë për trajnim dhe asistencë teknike në nivel lokal është më tepër se e qartë. Egziston mundësi komunitat të realizojnë këto aktivitete në mënyrë të përbashkët, nëpërmjet formimit të institucioneve dhe formave të përbashkëta të financimit;
- **Të mbajnë evidencë për krijimin e masës së hedhurinave në territorin e tyre;**
- **Të sjellin dhe realizojnë program për zvogëlimin e ndotjes së ajrit dhe përmirësimin e kualitetit të ajrit të ambientit;**
- **Të marrin pjesë në sjelljen dhe realizimin e Planit nacional për ujëra me bazë ekonomike, si dhe në sjelljen e planeve për udhëheqjen dhe në trupat drejtuese të shtretërve të lumenjëve.** Duke pasur parasysh strukturën e ujërave, si resurs në Republikën e Maqedonisë, si dhe faktin se ujërat më së shpeshti kalojnë nëpër territor të më tepër komunave, kjo çështje do të kërkojë nivel optimal të bashkëpunimit dhe koordinimit në mes pushtetit dhe strukturave komunale dhe atyre shtetërore. Obligimi i mbrojtjes dhe udhëheqjes së ujërave është i ndarë në mes disa ministrive. Rrolin kryesorë e kanë: Ministria për ambient jetësor dhe planifikim hapësinor dhe Ministria për bujqësi, pylltari dhe ujëra. E gjithë kjo qartë sugjeron se çështja e udhëheqjes me ujërat kërkon qasje të përbashkët të disa sektoreve me participim aktiv të pushtetit lokal. Komunitat janë përgjegjëse për aprovimin e planeve për mbrojtjen e ujërave lokale në territorin e tyre. Planet e tilla duhet me qenë në pajtueshmëri me planet nacionale nëpërmjet koordinimit gjatë përpunimit dhe të aprovuara në bazë të pajtueshmërisë së ministrisë kompetente. Obligimi i posaçëm i komunave është i lidhur me realizimin e masave për ndotësit më të vegjël të ujërave. Ky obligim në mënyrë të drejtëpërdrejtë është i lidhur me realizimin e mbikëqyrjes inspektive lokale. Direktiva kornizë e Unionit evropian për ujërat parasheh formim të trupave drejtues për shtretër të



lumenjëve, përgjegjës për udhëheqjen me ujërat e rrjedhjes së plotë. Me pjesëmarrjen në këto trupa drejtues komunitat, do të mund të ndikojnë në mbrojtjen e ambientit jetësor. Kompetenca në aspekt të kualitetit dhe udhëheqjes me ujërat nëntokësore, do të mbetet në duart e administratës shtetërore. Mbrojtja e ujërave është e lidhur ngushtë edhe me planifikimin hapësinor, posaçërisht për shkak të projekteve ndërtimore të infrastrukturës dhe nevojës për lokacione adekuate. **Vetë ndërtimi i stacioneve për pastrim të ujërave të përdorura dhe udhëheqja me ato, është nën kompetenca të komunave.** Pastrimi i ujërave të përdorura në periudhën që vijon, posaçërisht në kontekst të integritimit evropian dhe nevojës për harmonizim të kornizës institucionale dhe ligjore të Republikës së Maqedonisë me Unionin evropian, do të krijojë ngarkesë jashtëzakonisht të madhe, nëse jo edhe ngarkesën më të madhe financiare, që më së pari duhet ta bartin komunitat në Republikën e Maqedonisë. Kalkulimet tregojnë në nevojën e investimit të 157 euro për banorë, vetëm për ndërtimin e infrastrukturës për mbrojtje të ujërave nga ndotja. Kur kësaj do t'i shtohet nevoja për mbikëqyrje të kualitetit të ujërave, si dhe mjetet e duhura për mirëmbajtje të kësaj infrastrukture, do të konkludojmë se ujërat ndoshta janë sfida më thelbësore, financiare në procesin e integritimit evropian. Për shkak të kësaj duhet të insistohet në krijimin e kushteve për tërheqje dhe absorbim të ndihmës së nevojshme teknike dhe financiare, si nga ana e pushtetit nacional, ashtu edhe nga ana e donatorëve ndërkombëtarë;

- **Të propozojnë dhe të shpallin zona mbrojtëse të trupave ujore, që me domosdoshmëri hyjnë në planet urbane.**

Përveç obligimeve për komunitat, me ligje të posaçme nga lëmia e ambientit jetësor, janë siguruar shumë mundësi për iniciativë autentike në nivel lokal, prej të cilave do të dallojmë:

- **Komunitat mund të formojnë rrjete lokale për mbikëqyrje të situatës së ambientit jetësor; të mbajnë regjistër të materieve dhe substancave ndotëse; të mbajnë kadastër për ambient jetësor** (të ndotësve, krijuesve të hedhurinave, rajone të mbrojtura). Ligji për ambient jetësor definon rrjetet lokale për mbikëqyrje të medimeve dhe rajoneve të veçanta të ambientit jetësor. Komunitat dhe Qyteti i Shkupit, në pajtim me ligjin e posaçëm, formojnë rrjete lokale për mbikëqyrje. Ndërsa mjetet për formimin, punën, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit lokal për mbikëqyrje, sigurohen prej buxhetit të komunave dhe Qytetit të Shkupit dhe prej burimeve tjera, në pajtim me ligjin dhe aktet e komunave dhe Qytetit të Shkupit. Ligji i njëjtë e rregullon edhe delegimin e së drejtës për kryerje të mbikëqyrjes. Organi i administratës shtetërore - kompetent për punët nga lëmia e ambientit jetësor, mund të delegon kryerjen e mbikëqyrjes mbi komunitat. Edhe pse mbikëqyrja nuk është obligative megjithatë, në pajtim me strategjinë për përmirësimin e kualitetit të ajrit, disa komuna, para se gjithash Qyteti i Shkupit, do të duhet të formojnë rrjete komunale për mbikëqyrje për matjen e kualitetit të ajrit. Në kontekst të integritimit evropian, do të duhen investime të konsiderueshme në aspekt të arritjes së standardeve të UE-së për kualitet të ajrit. Me situatën e tashme të ndotjes së ajrit, shuma e përafërt e investimeve lëviz rreth 75 euro për banor. Nëse ndodh zhvillimi shumë i prituri i shtetit, si rezultat direkt i tij, përveç zmadhimit të hedhurinave industriale dhe hedhurinave të rrezikshme do të paraqitet edhe zmadhimi i ndotjes së ajrit. Me këtë do të nevojitet edhe zmadhim i investimeve të domosdoshme në nivel të komunës për kufizimin e ndotjes së tillë në kufijtë e përcaktuar me standardet për kualitetin e ajrit. Më të nevojshme në këtë moment, janë investimet në sektorin e transportit dhe transportit publik lokal, si dhe në sektorin e energjetikës me këmbimin e karburanteve të rënda, të ngurta dhe në gjendje të lëngët në industrinë dhe në sistemet për ngrohje qendrore, me gaz. Deri tani raporti për gjendjen në ambientin jetësor, përgaditej nga ana e Ministrisë për ambient jetësor dhe planifikim hapësinor. Pasiqë komunitat do të organizojnë rrjetet e tyre për mbikëqyrje, do të obligohen të mundësojnë qasje deri te informatat për publikun dhe të përgadisnin raport për gjendjen e ambientit jetësor në territorin e komunës së tyre. Ligji për ambient jetësor parasheh se organet shtetërore dhe organet e komunave dhe Qytetit të Shkupit, si dhe organet e komunave në qytetin e Shkupit, janë të obliguar të sigurojnë të gjitha masat e duhura dhe janë të obliguara të përcaktojnë procedurat, me të cilat sigurohet e drejta për qasje deri te informatat dhe pjesëmarrje të publikut në sjelljen e të gjitha vendimeve, që kanë të bëjnë me situatën e ambientit jetësor, si dhe të mundësojnë shprehjen e publikut në procedurën e sjelljes së vendimeve të tilla;
- **Mund të propozojnë shpallje të rajonit të mbrojtur dhe të marrin pjesë në përgaditjen e planeve për udhëheqje me rajonin e mbrojtur.** Me aprovimin e Ligjit për mbrojtje të natyrës përgjegjësia është e ndarë në mes ministrisë kompetente dhe komunave. Udhëheqja dhe mbikëqyrja e rajoneve të mbrojtura me interes lokal (siç janë përmendoret e natyrës dhe pyjet-parqe), ju është deleguar komunave.



Ministria për ambient jetësor dhe planifikim hapësinor, do të mbetet kompetente për mbrojtjen e rajoneve me interes nacional dhe do të mbikëqyr rajonet e mbrojtura, duke bërë koordinimin e aktiviteteve, që kanë ndikim mbi lloj-llojshmërinë biologjike dhe konzervimin e eko - sistemeve natyrore. Ministria kompetente, do të kontrollojë obligimet ligjore, që rrjedhin nga udhëheqja me rajonet e mbrojtura, rrethinat dhe lokalitetet e veçanta, ndërsa komunat do të duhet të përgadisnin dhe aprovojnë plane për udhëheqje me rajonet e mbrojtura, që do të jenë objekt i kontrollit të ministrisë kompetente.

Me decentralizimin e kryer në lëminë e ambientit jetësor, qytetarët fitojnë mundësi për qasje të drejtëpërdrejtë deri te informatat e lidhura me ambientin jetësor. Përdorimi i mekanizmave të pjesëmarrjes në trupat drejtues të komunave, do të mundësojë pjesëmarrje të drejte për drejtë të qytetarëve dhe të gjithë subjekteve të interesuar, në procesin e sjelljes së vendimeve për kualitetin e ambientit jetësor të tyre. Komunat fitojnë instrumente të domosdoshme për përgaditjen e politikave adekuate, planifikim dhe realizim të aktiviteteve për përmirësimin e kualitetit të ambientit jetësor në teritorin e tyre, si dhe me instrumente për ndalimin e ndotjes së ambientit jetësor.

Decentralizimi i realizuar në lëminë e ambientit jetësor në nivel të kornizës ligjore dhe institucionale, do të jetë hap i konsiderueshëm përpara, në drejtim të harmonizimit me standardet e Unionit Evropian, gjatë së cilës do të krijohen kushtet e duhura për shfrytëzimin e fondeve para antarësimi në UE në rast se Republika e Maqedonisë së shpejti do të fiton statutin e vendit-kandidat për antarësim në UE. Megjithatë, duhet të përmendet se sfida e vërtetë për absorbimin dhe realizimin e kompetencave të reja është ende para neve. Për ballafaqim efikas me këtë sfidë në momentin është prioritet ndërtimi i kapaciteteve të administratës lokale, si dhe investimi në forcimin e fuqisë së saj operative.

Fjalë kyqe: vibracione, rrezatim, regjistër, kadastër.

Korniza ligjore:

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 52/97, 1/92, 31/98 dhe 91/01;
- Ligji për vetëqeverisje lokale, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 52/95;
- Ligji për vetëqeverisje lokale, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 5/02;
- Rezoluta evropiane për vetëqeverisje lokale, Këshilli i Evropës, 15.10.1985;
- Ligji për mbrojtje të natyrës, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 67/04;
- Ligji për kualitetin e ajrit në ambient, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 67/04;
- Ligji për udhëheqje me hedhurina, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 68/04;





9.1 | PARTICIPIMI POLITIK NË NIVEL LOKAL

Doc. Dr. Jove Kekenovski

Qytetarët kanë të drejtë t'ju mbikëqyrin. Ata kanë të drejtë t'ju përmbajnë ose t'ju kritikojnë. Në kapitullin në vijim, njohtohuni me fuqinë e qytetarit - votuesit, që mund të ndikojë si korrektor i sjelljes së pushtetit në komunë.

Të gjithë ne në jetën e përgjithshme, fitojmë njohuri për politikën dhe të gjithë ne jetojmë në një kontekst politiko-kulturor. Por, si përdorim socializimin tonë politik dhe si sillemi, në kontekst të kulturës sonë politike? Në shikim të parë mund të thuhet se njerëzit aspektin e karakterit të tyre, e shprehin në mënyra të ndryshme. Disa individë, janë jashtëzakonisht aktiv dhe kyqen në parti politike, agjitojnë për kandidatët në kohën e zgjedhjeve dhe kryejnë punë administrative në ndonjë organizatë partiake lokale. Të tjerët i bashkangjiten disa grupeve të interesit, grupit për shtypje, lëvizjeve të ndryshme, që kanë për qëllim zgjidhjen e çështjes së caktuar ose parashetrojnë kërkesë të caktuar, derisa persona tjerë zgjedhin rrugën e politikantit dhe me sukses e kryejnë shërbimin e tyre. Në kundërshtim të plotë me këta, disa njerëz abstenojnë nga aktivitetet politike, madje as nuk votojnë.

Pyetja më e shpeshtë është: pse njerëzit kyqen në politikë?

Një shpjegim është se te njerëzit egziston dëshirë për sukses gjatë jetës për realizimin e të drejtave personale, egziston frikë për sigurinë personale, dëshirë për realizimin e nivelit të caktuar arsimor dhe kulturor, dëshirë për të arritur deri te informacionet dhe shumë faktorë dhe shkaqe tjera. Si shkak i posaçëm përmendet aftësia e shtetit për kyqje me forcë të qytetarëve në sferën e politikës. Karakteristika themelore e të gjitha veprimeve të individëve ose grupeve të personave, është aspirata e tyre të ndikojnë në përmbajtjen dhe karakterin e zgjedhjeve politike të institucioneve të pushtetit shtetëror, në çfarëdo niveli.

Participimin politik mund ta definojmë si veprim i personit, qëllimi formal i të cilit është ndikimi mbi personat e pushtetit, gjegjësisht në vendimet që i sjellin organet e shtetit.

Ose **participimi** politik, paraqet aksion vullnetar, me të cilin njerëzit dëshirojnë të marrin pjesë në krijimin e politikës publike.

Diapazoni dhe format e **participimit** ndryshojnë varësisht nga llojet e sistemeve politike. Në demokacitë liberale egziston norma e **participimit** vullnetar. Njerëzit mund të zgjedhin nëse dëshirojnë të participojnë (psh, me daljen ose jo në votime) dhe si do të participojnë (psh, me anëtarësim në parti politike, me nënshkrim të peticioneve, etj.). Përrjashtimi më i rëndësishëm nga kjo normë e **participimit** vullnetar është obligimi për votim të domosdoshëm gjatë zgjedhjeve, që e gjejmë në disa **demokraci**, si psh: Australi, Belgjikë, Greqi, etj. Në sistemet totalitare kemi normë për udhëheqje të **participimit**. Kjo nënkupton shprehje të përmbajtjes së kuadrove udhëheqëse dhe të politikës aktuale por edhe zgjidhje tjetër.



Funksioni më i rëndësishëm i kësaj norme është mobilizimi i njerëzve në provat e regjimit për ndryshimin e sistemit shoqëror, në pajtim të idealit të komunizmit ose të fashizmit.

Llojet kryesore të **participimit** politik janë:

- 1) votimi i qytetarëve në zgjedhje;
- 2) votimi në referendum;
- 3) agjitim dhe forma të tjera të kampanjës zgjedhore;
- 4) pjesëmarrje aktive në parti politike;
- 5) pjesëmarrje aktive në grupe për ndikim dhe në organizata joqeveritare;

Abstinenca nga jeta politike

Kur diskutojmë për participim të qytetarëve nuk guxojmë të harrojmë personat, që abstenojnë, gjegjësisht ata që nuk marrin pjesë në rrjedhjen e jetës politike. Njërit, që marrin pjesë aktive në jetën politike, sipas rregullit, janë pakicë në aspekt të numrit të përgjithshëm të qytetarëve, me të drejtë vote. Mos itnteresimi për politikë është karakteristikë themelore, pothuajse e gjitha sistemeve politike. Shkaqet për mos pjesëmarrje në jetën politike janë të ndryshme. Ata rrjedhin nga karakteri i njerëzve dhe nga mos interesimi i tyre për politikë. Mos pjesëmarrja mund të jetë rezultat edhe e pakënaqjes ose kënaqësisë me gjendjen egzistuese, nga kuptimi i paqëllimshmërisë personale dhe pamundësisë për kontribut pozitiv në shoqëri, nga humbja e besimit në afësitë personale dhe shkaqe tjera.

Egzistojnë disa grupe, që vullnetarisht heqin dorë nga pjesëmarrja në jetën politike dhe ata mund t'i përcaktojmë si:

- a) apatik - këta janë njerëz, te të cilët nuk egziston interesim për pjesëmarrje dhe kyqjen e politikës në problemet, nevojat, profesionin personal, gjegjësisht në jetën e tyre. Për këta njerëz, politika është diçka e pakuptimtë, humbje e kohës së vlefshme.
- b) të tjetërsuar - në këtë grup marrin pjesë njerëzit, të cilët konsiderojnë se politika ka hequr dorë nga ata. Pa marrë parasysh nëse këta njerëz do të marrin pjesë në votime, ata konsiderojnë se vendimi tanimë është sjellur paraprakisht nga shtresa politike. Sipas tyre, politika është në shërbim vetëm të elitës politike. Për dallim të apatisë, tjetërsimi nuk është vetëm pasivitet pasiv por tjetërsim i plotë nga sistemi politik, si i tillë.
- c) anemik - në këtë grup marrin pjesë njerëzit, që kanë humbur besimin në mundësitë personale dhe kuptimin e jetës. Për këta njerëz ndryshimet sociale janë të paparashikueshëm dhe të pakontrolluar, ndërsa udhëheqësit në politikë, janë të paaftë në çfarëdo mënyrë t'ju kundërvihen problemeve të tilla.

6) pjesëmarrje në demonstrata politike;

7) pjesëmarrje në forma të ndryshme të padëgjueshmërisë qytetare - mospagimi i tatimit, mos shkuarje në ushtri etj;

8) pjesëmarrje aktive në këshillat dhe trupat këshilluese të qeverisë dhe pushtetit lokal;

9) anëtarësi në këshilla të konsumuesve dhe këshilla drejtuese dhe këshilla tjera të ndërmarrjeve publike;

10) pjesëmarrje në realizmin e politikës sociale;

11) forma të ndryshme të aktiviteteve në bashkësinë (psh. në lidhje me problemet ekologjike, banesore, komunale) etj.

Egzistojnë disa grupe, që vullnetarisht heqin dorë nga pjesëmarrja në jetën politike dhe ata mund t'i përcaktojmë si:

a) apatik - këta janë njerëz, te të cilët nuk egziston interesim për pjesëmarrje dhe kyqjen e politikës në problemet, nevojat, profesionin personal, gjegjësisht në jetën e tyre. Për këta njerëz, politika është diçka e pakuptimtë, humbje e kohës së vlefshme.

b) të tjetërsuar - në këtë grup marrin pjesë njerëzit, të cilët konsiderojnë se politika ka hequr dorë nga ata. Pa marrë parasysh nëse këta njerëz do të marrin pjesë në votime, ata konsiderojnë se vendimi tanimë është sjellur paraprakisht nga shtresa politike. Sipas tyre, politika është në shërbim vetëm të elitës politike. Për dallim të apatisë, tjetërsimi nuk është vetëm pasivitet pasiv por tjetërsim i plotë nga sistemi politik, si i tillë.

c) anemik - në këtë grup marrin pjesë njerëzit, që kanë humbur besimin në mundësitë personale dhe kuptimin e jetës. Për këta njerëz ndryshimet sociale janë të paparashikueshëm dhe të pakontrolluar, ndërsa udhëheqësit në politikë, janë të paaftë në çfarëdo mënyrë t'ju kundërvihen problemeve të tilla.



9.1.1.. Forma të realizimit të të drejtave të qytetarëve për vetëqeverisje lokale

Qytetarët kanë të drejte t'ju mbikëqyrin. Ata kanë të drejtë për t'ju përmbajtur ose për t'ju kritikuar. Në kapitullin, që vijon mësoni për fuqinë e qytetarit-votues, që mund të veprojë si korrektor i sjelljes së pushtetit në komunë.

Rolin kryesor për realizimin e të drejtës së qytetarëve në vetëqeverisjen lokale në njësitë e vetëqeverisjes lokale e kanë vetë qytetarët, të cilët janë bartës të çdo lloji të vendosjes.

Të drejtën e tyre për vetëqeverisje lokale, qytetarët e realizojnë nëpërmjet dy formave themelore:

- drejtpërdrejtë
- indirekte, nëpërmjet përfaqësuesve në vetëqeverisjen lokale

Në njësitë e vetëqeverisjes lokale qytetarët, drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet përfaqësuesve, marrin pjesë në vendosjen për çështje me rëndësi lokale, posaçërisht në lëminë e shërbimeve publike, urbanizmit dhe planifikimit rural, mbrojtjes së ambientit, zhvillimit lokal ekonomik, financimit lokal, veprimtarive komunale, kulturës, sportit, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve, arsimit, mbrojtjes shëndetësore dhe në lëmi tjera të përcaktuara me ligj. (2).

Mënyra indirekte e pjesëmarrjes në vendosje, realizohet nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë demokratike në organet e vetëqeverisjes lokale, kurse pjesëmarrja direkte e qytetarëve në procesin e vendim marrjes për çështje me rëndësi lokale në njësitë e vetëqeverisjes lokale, realizohet nëpërmjet iniciativës qytetare, tubimit të qytetarëve, referendimit dhe formave tjera të përcaktuara me ligj.

9.1.2. Pjesëmarrja indirekte e qytetarëve

Mënyra e pjesëmarrjes indirekte në vendosjen për çështjet me interes lokal në suazat e njësisë së vetëqeverisjes lokale, realizohet nëpërmjet procesit zgjedhor. Zgjedhjet paraqesin proces të selektimit dhe organizimit të bartësve themelor të pushtetit politik. Zgjedhjet janë mekanizëm i ndërlikuar për lidhje, adaptim dhe realizim të interesave dhe veprimtarive të ndryshme të grupeve dhe bashkësive shoqërore. Zgjedhjet janë pjesë e grupit të aktiviteteve më të rëndësishme politike të qytetarëve, me të cilat kryhet rikonstruimi i institucioneve egzistuese të sistemit politik dhe vlerësohet sistemi i arritur i **demokracisë** në një shoqëri.

Qytetarët në zgjedhje nuk përcaktohen vetëm për parti politike dhe programin e saj por ata, kanë mundësi të përcaktohen edhe për personin, në të cilin kanë besim. Në këtë mënyrë ai ndjehet i respektuar, sepse me pjesëmarrje në votime është pjesëmarrës në konstituimin e qeverisë.

Zgjedhjet periodike për personin janë një lloj dialogu i kohë pas kohshëm me pushtetin, si dhe këmbim i ndikimit politik në mes bartësve të pushtetit. Me pjesëmarrje në zgjedhje personi e përmban pushtetin ose ia merr legjitimitetin dhe përcaktohet për opozitën.

Mënyra indirekte e vendosjes karakterizohet me disa karakteristika:

1) te **demokracia** indirekte sovraniteti mund të bartet, gjegjësisht nëpërmjet zgjedhjeve bëhet transferimi i sovranitetit prej popullit mbi përfaqësuesit e zgjedhur;

2) zgjedhjet janë të përgjithshme, të lira, të drejtpërdrejta dhe realizohen me votim të fshehtë;

3) nëpërmjet zgjedhjeve bëhet rekrutimi i elitës politike. Zgjedhjet kanë edhe funksionin e legjitimitetit të bartësve të pushtetit. Mandati është i lirë dhe egziston organizim në baza të interesave të përbashkët.

Në Republikën e Maqedonisë pjesëmarrja e qytetarëve në zgjedhje është e rregulluar me Ligjin për zgjedhje lokale, Ligjin për zgjedhje të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, Ligjin për zgjedhjen e kryetarit të Republikës së Maqedonisë, Ligjin për njësitë zgjedhore për zgjedhje të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe Ligjin për listën zgjedhore.



Qytetarët në zgjedhje të përgjithshme, të drejtë për drejta dhe të lira, me votim të fshehtë, zgjedhin anëtarë të komunave, kryetarë të komunave, deputet dhe kryetarë të Republikës së Maqedonisë. Anëtarët e këshillave të komunave dhe deputetët në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë zgjidhen sipas parimit proporcional, ndërsa kryetarët e komunave dhe kryetari i Republikës së Maqedonisë, zgjidhen sipas parimit të shumicës.

Sipas ligjeve pozitive të vendit askush nuk mund të thërret votuesin në përgjegjësi për shkak të votimit, e as të kërkojë nga ai të tregojë për kënd ka votuar ose pse nuk ka votuar

Të drejtë për votim ka secili shtetas i Republikës së Maqedonisë, që ka mbushur 18 vjet dhe ka aftësi afariste. Të drejtë për tu zgjedhur ka çdo shtetas i Republikës së Maqedonisë nëse: ka mbushur 18 vjet, ka aftësi afariste dhe nuk gjendet në kryerje të dënimit me burg për vepër të kryer penale. Listat e kandidatëve, gjegjësisht lista e kandidatit për kryetar të komuës propozohen nga ana e partive politike të regjistruara dhe prej grupeve të zgjedhësve. Në rastet kur si propozues paraqitet grup i zgjedhësve, atëherë nënshkrimet e grupit zgjedhor mblidhen në organin e autorizuar në formular të përcaktuar nga Komisioni shtetëror zgjedhor.

9.1.3. Forma themelore të pjesëmarrjes së drejtëpërdrejtë të qytetarëve në vendim marrjen në njësitë e vetëqeverisjes lokale

Format e pjesëmarrjes të drejtëpërdrejtë, gjegjësisht të **demokracisë** së drejtëpërdrejtë ju mundësojnë qytetarëve kyqje aktive në realizimin e proceseve politike dhe në krijimin e politikës në nivel lokal.

Gjithashtu, këto forma paraqesin një lloj të mundësisë dhe të drejtës së qytetarëve në rastet kur komuna bën ignorimin e kërkesave dhe nevojave të tyre; kur nuk është vendimtare dhe pasive; kur nuk ka perspektivë dhe është pa ide, si dhe me qëllim të shtytjes së komunës dhe organeve të saja të ndërmarrin veprime të caktuara, të sjell ndonjë akt ose zgjidh ndonjë problem nga kompetenca e tyre.

Sipas rregullativës egzistuese ligjore të Republikës së Maqedonisë, qytetarët mund të përdorin format vijuese, të cilat ju mundësojnë pjesëmarrje të drejtëpërdrejtë gjatë vendim marrjes dhe zhvillimit të proceseve politike në nivel lokal.

a) Iniciativa qytetare

Sipas ligjit për vetëqeverisje lokale, njëra ndër mënyrat e pjesëmarrjes së drejtëpërdrejtë të qytetarëve në procesin e vendim-marrjes për çështje me rëndësi lokale është iniciativa qytetare (3). Qytetarët kanë të drejtë të propozojnë, këshilli i komunës të sjell akt të caktuar ose të zgjedh çështje të caktuar nën kompetencat e tij. Këshilli është i obliguar të diskutojë në lidhje me propozimin e qytetarëve, nëse këtë propozim e përmbajnë 10% ta votuesve të komunës, gjegjësisht të bashkësisë lokale, me të cilën ka të bëjë çështja e caktuar. Nëse është i plotësuar kushti paraprak, këshilli i komunës është i obliguar ta realizojë diskutimin rreth propozimit në afat prej 90 ditëve nga dita e dorëzimit të iniciativës dhe është i obliguar të informojë qytetarët për vendimin e tij (4).

b) Tubim i qytetarëve

Tubimi i qytetarëve si formë e pjesëmarrjes së drejtëpërdrejtë e qytetarëve gjatë vendim marrjes për çështje me rëndësi lokale në njësitë e vetëqeverisjes lokale, është tubim i përgjithshëm i qytetarëve.

Tubimi i qytetarëve mund të thirret për territorin e gjithë komunës ose për territorin e bashkësisë lokale. Tubimin e qytetarëve e përbëjnë të gjithë qytetarët, me banim të përhershëm në rrethinën, në të cilën mbahet tubimi. Tubimin e qytetarëve e thërret kryetari i komunës, me iniciativë të tij në kërkesë të këshillit ose në kërkesë të, së paku 10 % të votuesve të komunës, gjegjësisht të bashkësive lokale, me të cilën ka të bëjë çështja e caktuar. Në tubimin e qytetarëve informatë jep kryetari i komunës. Sipas nevojës, informata mund të japin edhe persona tjerë të autorizuar, gjegjësisht përfaqësuesit e organeve të vetëqeverisjes lokale. Qytetarët kanë të drejtë për pjesëmarrje të barabartë në punën e tubimit, të drejtë për pjesëmarrje në diskutim, të parashtrojnë propozime për çështjet, për të cilat është thirrur tubimi, të votojnë dhe të ngjajshme.



Në bazë të diskutimit të realizuar në lidhje me çështjet, për të cilat është thirrur tubimi i qytetarëve, me shumicë të votave nga qytetarët prezent mund të aprovohen konkluzat ose drejtime të përgjithshme në lidhje me çështjet e diskutuara.

Organet e komunës janë të obliguara në afat prej 90 ditë, nga dita e aprovimit, të bëjnë shqyrtimin e konkluzave dhe drejtimeve të përgjithshme në tubimin e qytetarëve dhe t'i marrin parasysh gjatë ndërmarrjes së masave për çështjet, me të cilat kanë të bëjnë, si dhe të informojnë qytetarët për vendimet e tyre.

c) Referendumi

Në njësitë e vetëqeverisjes lokale mund të shpallet **referendum** për çështje me rëndësi lokale dhe në kompetencë të vetëqeverisjes lokale. Çështja e **referendumit** në njësinë lokale, rregullohet me statutin e njësisë së vetëqeverisjes lokale. Referendumi, si formë e drejtëpërdrejtë e pjesëmarrjes në vendim marrjen për çështjet me rëndësi lokale, ka rëndësi të madhe dhe mundësi për aplikim të gjërë në njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Referendumi është forma më e mirë për pjesëmarrje të drejtëpërdrejtë të qytetarëve në vendim-marrjen. Sipas thelbësisë së tij, **referendumi** ka rëndësi dhe peshë më të madhe në krahasim me tubimet e qytetarëve. Ai është instrument për shprehje më të lirë dhe më të plotë të mendimit të qytetarëve. Si i tillë është masë e domosdoshme për pajtueshmëri të parimeve formale dhe materiale të **demokracisë** plurale në nivel lokal. Referendumi është instrument i rëndësishëm i barazimit të metodave të drejtëpërdrejtë dhe indirekte të vendim-marrjes në njësitë e vetëqeverisjes lokale. Ai është element i domosdoshëm i vetëqeverisjes lokale, si në realizimin e vetëqeverisjes në bashkësitë lokale dhe realizim të vetëqeverisjes në njësitë e vetëqeverisjes lokale, në përgjithësi (komunat dhe Qyteti i Shkupit). Rezultati pozitiv i **referendumit** është garancë se vendimi do të realizohet.

Referendum mund të shpall këshilli i njësisë së vetëqeverisjes lokale për çështje nën kompetencë të tij, me iniciativë të tij. Egzistojnë raste kur, këshilli është i obliguar të shpall **referendum**, nëse këtë e kërkojnë 20% të votuesve të komunës (6).

Referendumi realizohet me votim të fshehtë. E drejta e votimit, gjegjësisht votimi në **referendum** kryhet me fleta votuese, kurse për pyetjen e parashtruar qytetarët vendosin në përgjithësi me votim "për" ose "kundër". Vendimi në **referendum** është i aprovuar, nëse për të kanë votuar shumica e votuesve, me kusht nëse në të njëjtën kohë kanë votuar më tepër se gjysma e numrit të përgjithshëm të votuesve.

Vendimi i aprovuar në **referendum** është i domosdoshëm për këshillin e komunës. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes lokale në rast se propozimi i tij nuk aprovohet në **referendum**, nuk mund të sjell vendim dhe të ndërmer masa, në kundërshtim me vendimin e aprovuar në **referendum**.

Vetëm pas kalimit të periudhës së caktuar këshilli i njësisë së vetëqeverisjes lokale, do të mund të iniciojë sjelljen e vendimit, gjegjësisht përsëri të organizojë **referendum** për të njëjtën çështje, që ka qenë e hedhur poshtë në **referendumin** e më parshëm.

Mënyrën dhe procedurën për kërkesë të shpalljes së **referendumit** në njësitë e vetëqeverisjes lokale janë të obliguara ta rregullojnë me statut të njësisë së vetëqeverisjes lokale, në pajtim me lgji (7).

9.1.4. Forma dhe mundësi tjera të participimit qytetar

a.) *Peticione dhe propozime*

Çdo qytetar i Republikës së Maqedonisë ka të drejtë, vetë ose së bashku me qytetarë tjerë për punën e njësisë së vetëqeverisjes lokale dhe administratës komunale, deri te kryetarët e njësisë së vetëqeverisjes lokale, të dorëzojë peticione dhe propozime (8). Kryetari i komunës ka obligim të krijojë kushte për dorëzimin e peticioneve dhe propozimeve nga ana e qytetarëve dhe më së voni në afat prej 60 ditëve nga dita e pranimit të peticionit, gjegjësisht propozimit parashtruesit ose parashtruesve, t'ju dorëzojë përgjigje me shpjegim.

Nëse peticionet dhe propozimet nuk kanë të bëjnë me punët dhe kompetencat e organeve të komunës, atëherë kryetari i komunës është i obliguar t'i dërgojë ato deri te organi kompetent i caktuar dhe për këtë të informojë parashtruesin.



b). *Tribuna të hapura, anketa dhe propozime*

Gjatë përgaditjes së dispozitave të komunës këshilli, gjegjësisht kryetari i komunës, paraprakisht mund të organizojë tribuna të hapura, të realizojë anketa ose të kërkojë propozime nga qytetarët (9).

Është i njohur shembulli me këshillin e qytetit të Shkupit në vitin 2000, kur të gjithë këshilltarët e këshillit të Qytetit ishin edhe anëtarë të këshillave drejtues të ndërmarrjeve publike komunale. Ky është shembull klasik i uzurpimit të të drejtave të qytetarëve për demokraci të drejtpërdrejtë, nga ana e këshilltarëve. Nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve, që ishte 15, 10 anëtarë ishin të deleguar. Këshilli në Prilep në ndërmarrjen e vetme publike komunale "Komunalec", nga numri i përgjithshëm i anëtarëve (9 anëtarë), kishte deleguar 2 këshilltarë të komunës. Në Kumanovë në tre ndërmarrje publike, "Ujësjellësi dhe kanalizimi", nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit drejtues, gjashtë i kishte deleguar këshilli i komunës nga rradhët e anëtarëve të tij. Në NPK, "Pastërti dhe gjelbërim", nga numri i përgjithshëm i këshillit drejtues, gjashtë ishin përfaqësues të këshillit të komunës, ndërsa në NPK "Tregu komunal", nga numri i përgjithshëm i këshillit drejtues (15), dhjetë ishin përfaqësues të këshillit të komunës. Me rëndësi është të theksohet se me vendim në vitin 1996, këshilltarëve të këshillit të komunës nuk ju është e lejuar, në të njëjtën kohë të jenë këshilltarë në këshillat e komunave dhe anëtarë të këshillave drejtues të ndërmarrjeve publike komunale. Në komunën e Strugës, egzistojnë dy ndërmarrje publike nga të cilat njëra, "Proakua", është e përbashkët me Ohrin dhe ka 15 anëtarë, nga të cilët 5 anëtarë delegon secila komunë. NPK, tjetër është "Komunalja", e cila ka gjithsej 9 anëtarë në këshillin drejtues, prej të cilëve 6 janë përfaqësues të komunave. Edhe në këtë komunë egzistojnë anëtarë, të cilët në të njëjtën kohë janë këshilltarë dhe anëtarë të këshillave drejtues të NPK-ve.

c). *Pjesëmarrja në këshillat drejtuese të ndërmarrjeve publike, komunale*

Në pajtim me Ligjin për ndërmarrje publike (10), njëri nga organet e ndërmarrjes publike është këshilli drejtues. Këshilli drejtues, sipas ligjit, përbëhet prej 5-15 anëtarëve. Në këshillin drejtues udhëheqësi emëron, gjegjësisht shkarkon përfaqësues nga rendi i profesionistëve të afirmuar në lëminë e punës së ndërmarrjes publike dhe përfaqësues të punëtorëve të ndërmarrjes publike, me propozim të këshillit të të punësuarve. Numri i përfaqësuesve të punëtorëve të ndërmarrjes publike në këshillin drejtues është një e treta nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit. Këshilli drejtues i ndërmarrjeve publike kryen punët, si vijon: sjell statutin e ndërmarrjes; vendos për ndryshime të statusit dhe themelimin e shoqatave, në pajtim me ligj; aprovon programin për punë dhe zhvillim të ndërmarrjes; përcakton politikën afariste; aprovon llogarinë vjetore dhe raportin për punën e ndërmarrjes publike; vendos për përdorimin e mjeteve të realizuara me punën e ndërmarrjes publike dhe mbulesën e humbjeve; sjell vendimet për investime; përcakton çmimet e prodhimeve dhe shërbimeve; vendos për organizimin e brendshëm të ndërmarrjes, si dhe punë tjera të përcaktuara me aktin e themelimit dhe statutin e ndërmarrjes publike.

Duke pasur parasysh mundësinë e interpretimit më të lirë të dispozitave të ligjit në pjesën e propozimit të anëtarëve të këshillave drejtues, shpesh ndodh që përfaqësuesit e partive politike të përfaqësuara në këshillin e komunës (këshilltarët), për shkak të interesit të ngushtë partiak dhe, para se gjithash, për shkak të interesit personal, vetë të propozohen për anëtarë të këtyre këshillave drejtues, me çka në masë të madhe ngushtohet mundësia për delegim dhe pjesëmarrje të qytetarëve në udhëheqjen me ndërmarrjen publike në territorin e tyre.

ç). *Pjesëmarrja në këshillat shkollore të shkollave fillore dhe shkollave të mesme*

Ligji për arsim fillor dhe të mesëm jep mundësi të vogël për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendim marrjen dhe udhëheqjen me shkollat fillore dhe të mesme, edhe atë nëpërmjet këshillit shkollorë dhe këshillit të prindërve. Prej numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillave shkollore (11) të shkollave të mesme, 4 janë përfaqësues të mësuesve, arsimtarëve, punëtorëve profesional dhe edukuesve; 3 janë përfaqësues të prindërve të nxënësve; 2 përfaqësues të themeluesit (tash për tash themeluesi është ende Qeveria e Republikës së Maqedonisë) dhe 2 përfaqësues të njësisë së vetëqeverisjes lokale. Përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale i emëron dhe shkarkon organi i vetëqeverisjes lokale, gjegjësisht këshilli i komunës, ndërsa përfaqësuesit e prindërve i emëron dhe shkarkon këshilli i prindërve. Në shkollat e mesme këshilli shkollor ka 9 anëtarë: 2 përfaqësues të themeluesit (Qeverisë së Republikës së Maqedonisë), tre përfaqësues

të prindërve të nxënësve dhe 4 përfaqësues të mësuesve, që do të thotë se komuna nuk ka mundësi të delegojë përfaqësues të saj.



Këshilli shkollor sjell program vjetor për punën e shkollës, e përcakton planin financiar, aprovon llogarinë vjetore, sjell statutin e shkollës, shpall konkurs për emërimin e drejtorit të shkollës, vendos për ankesat në lidhje me notat dhe kryen punë tjera.

Duhet të përmended mundësia, të cilën këto dy ligje japin për pjesëmarrjen e drejtëpërdrejtë të qytetarëve në udhëheqjen, edhe ate nëpërmjet këshillit të prindërve. Këshillin e prindërve e përbejnë përfaqësues të prindërve të nxënësve të shkollës, që nuk janë të punësuar në shkollën. Ky këshill e përcjell punën e shkollës dhe jep mendim për realizimin e punës edukativo -arsimore. Puna, numri i anëtarëve, mënyra e zgjedhjes dhe organizimi i këshillit të prindërve, përcaktohet me statutin e shkollës.

9.1.5. Vetëqeverisja në nivel të bashkësisë lokale

E drejta e qytetarëve për vetëqeverisje në nivel të bashkësisë lokale për të parën herë është përcaktuar me Kushtetutën e Republikës Socialiste të Maqedonisë në vitin 1963 kur është vendosur bashkësia lokale, si formë elementare e vetëqeverisjes dhe organizimit dhe **participimit** politik.

Sot bashkësia lokale është grup i caktuar i qytetarëve, territorialisht i përcaktuar, që në aspekt sociologjik lidhet me kolektivitete të tilla, siç janë: fshati, vendbanimi ose pjesë e qytetit (bloku ose mëhalla dhe të ngjashme). Bashkësia lokale nuk paraqet komunë të vogël ose sektor apo njësi të vetëqeverisjes lokale. Sipas funksionit dhe strukturës së saj, ajo është e organizuar në bazë territoriale, formë elementare e organizimit qytetar për përcaktimin dhe zgjidhjen e një sërë të nevojave dhe problemeve të përbashkëta dhe të drejtë për drejta të qytetarëve, që jetojnë dhe banojnë në territorin e saj. Ajo paraqet shprehje e së drejtës për vetë organizim dhe mundësi për paraqitje të organizuar para komunës nga ana e një grupi të popullatës, që realizohet në pajtim me statutin e komunës dhe Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe Kushtetutës së shtetit.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë nga viti 1991 mundëson në komunat të organizohen forma të vetëqeverisjes në nivel të bashkësive lokale (12). Më konkretisht, vetëqeverisja në nivel të bashkësisë lokale është rregulluar me Ligjin e vetëqeverisjes lokale nga viti 2002 (13). Sipas dispozitave të Ligjit, në komunë mund të organizohen dy forma të vetëqeverisjes lokale në nivel të bashkësisë lokale: në qytetet-bashkësi urbane dhe në vendbanimet-bashkësi lokale.

Sipërfaqja, për të cilën themelohen bashkësitë urbane, janë kufijnë të bashkësive urbane, sipas planit urbanistik të qytetit. Ndërsa sipërfaqja, në të cilën themelohen bashkësitë lokale, janë kufijnë të komunave sipas kadastrës së vendbanimeve.

Me statutin e komunës përcaktohen më së afërmi format e organizimit të vetëqeverisjes në nivel të bashkësive lokale, që themelohen në suazat e komunës. Sidoqoftë, këto janë bashkësi urbane në qytete dhe bashkësi lokale në vendbanime të tjera. Poashtu, me statut përcaktohen marrëdhëniet e bashkësisë urbane dhe bashkësisë lokale me organet e komunës; punët nën kompetencë të kryetarit të komunës, kryerja e të cilëve mund të delegohet deri te kryetari i këshillit të komunës; mënyra e sigurimit të mjeteve për kompetencat e deleguara dhe punë të tjera me rëndësi për vetëqeverisjen në nivel të bashkësisë lokale.

Banorët e bashkësive urbane, gjegjësisht bashkësive lokale shqyrtojnë çështje, marrin qëndrime dhe përgadisin propozime për çështje me vendim të drejtëpërdrejtë për jetën dhe punën e përditshme të banorëve të asaj rrethine, në tubime të qytetarëve.

Këshilli i bashkësisë urbane, gjegjësisht bashkësisë lokale zgjedhet në tubimet e qytetarëve të tyre në mënyrë dhe procedurë, që është e përcaktuar me statutin e komunës. Këshilli i bashkësisë urbane, gjegjësisht bashkësisë lokale nga rradhët e anëtarëve të tij, zgjedh kryetar me mandat prej katër viteve. Deri te zgjedhja e kryetarit të këshillit me te udhëheq anëtari më i vjetër i këshillit. Për kryetar të këshillit zgjidhet kandidati, i cili ka fituar shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të bashkësisë urbane, gjegjësisht të bashkësisë lokale. Nëse në rrethin e parë asnjë nga kandidatët për kryetar të këshillit nuk ka fituar numrin e duhur të votave, organizohet rrethi i dytë i votimit për dy kandidatë, të cilët kanë fituar numër më të madh të votave.

Kryetari i këshillit thërret dhe udhëheq me mbledhjet e këshillit dhe kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit. Poashtu, ai nënshkruan aktet e sjellura nga ana e këshillit dhe është i obliguar në afat prej tre ditëve nga dita e sjelljes së tyre, t'i dorëzojë deri te kryetari i komunës për shkak të publikimit të tyre në gazetën zyrtare të komunës.



Kryetari mund të delegojë kryerjen e disa punëve të caktuara, me interes dhe rëndësi të drejtëpërdrejtë për jetën dhe punën e përditshme të banorëve, mbi kryetarin e këshillit të bashkësisë urbane, gjegjësisht bashkësisë lokale në mënyrë të përcaktuar me statutin e komunës. Në të njëjtën kohë, me vendimin për delegimin e kryerjes së punëve me interes të drejtë për drejtë, përcaktohen edhe mjetet e nevojshme për kryerjen e punëve dhe mënyra e kryerjes së mbikëqyrjes nga ana e komunës / kryetarit të komunës.

Kryetari mund të delegojë kryerjen e disa punëve të caktuara, me interes dhe rëndësi të drejtëpërdrejtë për jetën dhe punën e përditshme të banorëve, mbi kryetarin e këshillit të bashkësisë urbane, gjegjësisht bashkësisë lokale në mënyrë të përcaktuar me statutin e komunës. Në të njëjtën kohë, me vendimin për delegimin e kryerjes së punëve me interes të drejtë për drejtë, përcaktohen edhe mjetet e nevojshme për kryerjen e punëve dhe mënyra e kryerjes së mbikëqyrjes nga ana e komunës / kryetarit të komunës.

Fjalë kyqe: participim, demokraci, referendum.

Korniza ligjore:

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë nga 17 nëntori i vitit 1991 dhe amandamentet e Kushtetutës;
- Ligji për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 5/02)
- Ligji për zgjedhje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.46/96, 46/00, 12/02 dhe 35/04);
- Ligji për zgjedhje të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 42/02);
- Ligji për zgjedhje të kryetarit të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.20/94 dhe 34/04)
- Ligji për njësi zgjedhore për zgjedhje të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 43/02);
- Ligji për listën zgjedhore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 42/02);
- Ligji për referendum dhe iniciativë qytetare ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 24/98);
- Ligji për ndërmarrje publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.38/96);
- Ligji për arsim fillorë dhe Ligji për arsim të mesëm ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.52/02);
- Ligji për rrugë publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 26/96 dhe 40/99);
- Vendimi për themelimin të Fondit për rrugë lokale të Komunës së Gazi Babës ("Gazeta zyrtare e Qytetit të Shkupit", nr. 8/96).



9.2 | MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Ace Kocevski

Juve ju është dhënë mundësia të bëni vepra të mira për komunën e juaj. Për shkak të suksesit në misionin e juaj, hapni komunën për qytetarët, organizatat joqeveritare dhe për të gjithë ata, që janë të interesuar për punën e juaj. Vetëm nëpërmjet informimit të rregullt, do të mund të shpjegoni si punoni dhe si i zgjidhni problemet, por edhe të fitoni edhe inicijativa të reja për aktivitetet e juaja të më tutjeshme. Shfrytëzoni të gjitha mundësitë për komunikim, që ju mundëson teknologjia bashkëkohore.

9.2.1. DEFINIMI I MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Definicioni i marrëdhënieve me publikun mundet me qenë i ndryshëm por ky nocion, gjithmonë, përfshin elementet, si vijon:

- Marrëdhëniet me publikun paraqesin zhvillim të ndërgjegjes për pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e marrjes së vendimeve;
- Marrëdhëniet me publikun janë krijim dhe mirëmbajtje të lidhjeve të mira mes publikut dhe ndonjë organizate;
- Marrëdhëniet me publikun janë proces, i cili shfrytëzohet për zhvillimin e mendimit pozitiv ose modifikimin e mendimit negativ për një organizatë;
- Marrëdhëniet me publikun janë udhëheqje e reputacionit të një organizate

Komunikacioni, si pjesë themelore e marrëdhënieve me publikun është proces i gjatë dhe në kontinuitet, e jo proces afatshkurtër. Komunikacioni i mirë nuk parasheh rrjedhje të një kahshme të informatave drejt publikut. Informacioni duhet të drejtohet në dy kahje. Në shikim të parë, duket se nocioni "publik" përfshin diapazon tepër të gjërë të grupeve të njerëzve. Në thelb, ky nocion ka të bëjë me interesa individuale, të cilat janë të njëjta ose të ngjajshme te një grup i caktuar i njerëzve, të cilët në emër të interesit të tillë, paraqiten së bashku. Mu për këtë, gjatë zhvillimit të marrëdhënieve me publikun në nivel të vetëqeverisjes lokale është e domosdoshme, së pari të dallohen qartë grupet qëllimore dhe të definoohen interesat e tyre. Vetëm në këtë mënyrë, pushteti lokal mund të implementojë dhe udhëheqë politikë të suksesshme të komunikimit me publikun, nga e cila mund të presin efekte pozitive.



9.2.2. KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

Komunikimi me publikun, me grupe të ndryshme të qytetarëve, me mediumet dhe pjesëmarrja e qytetarëve në krijimin e politikës, në marrjen e vendimeve dhe në procesin e kontrollit, janë elemente të rëndësishme të secilës shoqëri të rregulluar në mënyrë demokratike.

Në demokraci pushteti ju përket qytetarëve. Këtë asnjëherë nuk duhet ta harroni. Qytetarët duhet gjithnjë me qenë në qendër. Por jo vetëm para zgjedhjeve, sepse demokraci nuk janë vetëm zgjedhjet e drejtëpërdrejtja dhe të lira. Qytetarët dijnë të shpërblejnë dhe të dënojnë.

Nën nocionin "publik" në një komunë mund të nënkuptohen të gjithë qytetarët e komunës, banorët e qytetit, banorët e një pjese të qytetit ose banorët e një ose më tepër fshatrave. Poashtu, "publik" munden me qenë edhe grupe të qytetarëve, të përbërë nga persona me nevoja të përbashkëta - me interesa, moshë, gjini të përbashkët, si dhe me përkatësi etnike të përbashkët, status ose profesion të përbashkët (femra, të rinj, nxënës, student etj).

Komunikimi me publikun është proces i ndërlikuar, i cili zhvillohet ndërmjet dy anëve. Në mes jush dhe komunës juaj, nga njëra anë dhe publikut, nga ana tjetër. Ai është proces i përbashkët, i dyanshëm dhe proces interaktiv i ndikimit të dyanshëm.

Marrëdhëniet me publikun, ndonjëherë, gabimisht barazohen me marketingun, gazetarinë ose me prezantinim për publikun, që janë vetëm një pjesë e tërësisë.

Si kryetar i komunës ose anëtar i këshillit, do të ballafaqoheni edhe me pyetjen: Çka ju nevojitet juve, si përfaqësues të vetëqeverisjes lokale, nga qytetarët?

Në shkallën tjetër duhet të përcaktoni, cilat metoda të komunikimit më së shumti ju përgjigjen për nevojat e juaja, por edhe nevojave të grupeve qëllimore.

A do të jeni të suksesshëm ose jo, varet nga ajo se, si publiku e vlerëson punën e juaj. Për këtë, nuk duhet të bëni improvizime por të keni qasje në faza drejt hulumtimit, analizës, të përgadisni plan për prezantim dhe komunikim, të definoni strategjinë, qëllimet, grupet qëllimore, metodologjinë, të bëni evaluim dhe analizë të asaj, që keni bërë për të nxjerrur mësim, i cili do të jetë i levërdishëm për aktivitetet tjera.

Shembull: buxheti i komunës, programi për rregullimin e truallit ndërtimor, programi për aktivitetet e komunës në lëminë e kulturës, programi për aktivitetet e komunës në lëminë e sportit etj.

DISKUTIME PUBLIKE

Diskutimet publike janë takime të hapura të kryetarit të komunës dhe anëtarëve të këshillit të komunës me grupe qëllimore të qytetarëve nga komuna, gjatë së cilëve diskutohen temat me rëndësi të madhe për jetesën e bashkësisë.

Organet e vetëqeverisjes lokale gjatë diskutimit publik, informojnë qytetarët dhe prezantojnë propozimet, qëndrimet dhe vizionet për temat aktuale. Qytetarët, nga ana e tyre, shprehin vlerësimet e tyre, qëndrimet dhe mendimet e tyre, si dhe kërkesat në lidhje me temat me interes themelor.

Zakonisht, qytetarët shfrytëzojnë rastin për të vlerësuar efektivitetin dhe efikasitetin e pushtetit lokal dhe suksesin në mbrojtjen e interesave të bashkësisë.

Diskutimet publike janë urë e suksesshme informative në mes qytetarëve dhe pushtetit lokal. Ato kanë edhe mungesa por dominante janë anët pozitive, sepse mundësojnë komunikim me numër të madh të njerëzve dhe sigurojnë informata kthyesë, nga të cilat mund të shqyrtohet suksesshmëria e politikës dhe të rrjedhin ide të reja të levërdishme.

ANKETA

Anketat janë rast i mirë për hulumtimin e opinionit publik nga ana e organeve të pushtetit lokal për çështje të caktuar, që shkakton interes të madh në publik dhe në bazë të rezultateve të sjellin vendimet përfundimtare. Kjo mund të përforcojë në mënyrë të konsiderueshme pozicionin e tyre, sepse vendimet e marrura do të arsyetohen dhe do të përmbahen nga ana e shumicës së qytetarëve të bashkësisë.



Anketimet mund të kryhen nëpërmjet listave anketuese me kontakt të drejtpërdrejtë ose ndërmjet bisedave telefonike. Në të dy rastet, me rëndësi është anketa të kryhet me numër reprezentativ të të anketurave të zgjedhur në mënyrë të rastësishme, që rezultati të pasqyrojë realitetin.

TAKIME ME QYTETARËT

Takimet me grupe qëllimore të caktuara të qytetarëve, janë formë e levërdishme e komunikacionit, që praktikohet shpesh. Në krahasim me diskutimet publike, japin mundësi për këmbim të informatave dhe të bëhen konsultime për më tepër çështje, që janë objekt i bisedimeve.

TELEFON I HAPUR

Është mirë komunat të kenë të ashtuquajturin telefon të hapur, gjegjësisht linjë telefonike, me ndihmën e së cilës qytetarët mund të lajmërohen deri te komunat dhe të bartin idetë, propozimet, vërejtjet, ankesat e tyre.

Pushteti lokal, si shërbyes i qytetarëve ka obligim, që në mënyrë serioze të trajtojë ato dhe të merr në konsiderim, nëse tregohen të levërdishme dhe të pranueshme.

RAPORTE VJETORE

Ende bëhet rrallë por në të ardhmen pushtetet lokale do të praktikojnë botimin e raportit vjetor për punën e njësisë së vetëqeverisjes lokale. Është mirë të bëhet botimi i raportit në egzemplarë të mjaftueshëm, me qëllim të shpërndarjes së tij deri te çdo familje.

Me raportin vjetor qytetarët do të fitojnë pasqyrim të punës vjetore për punën e të zgjedhurve të tyre, për realizimin e premtimeve, për harxhimin e të hollave të tyre si të obliguar me tatim dhe të lexojnë planet dhe vizionet për vitin e ardhshëm.

MBLEDHJE TË HAPURA TË KËSHILLIT TË KOMUNËS

Mbledhjet e këshillit të komunës duhet me qenë të hapura për publikun. Personat dhe grupet e qytetarëve kanë të drejtë të përcjellin punën e këshillit. Me lajmërim paraprak, është e preferueshme qytetarëve të interesuar t'ju jepet mundësi t'i drejtohen këshillit dhe të mundohen të marrin përkrahjen e anëtarëve të këshillit, për të shprehur qëndrimet e tyre në lidhje me çështjet, që janë me interes të madh për ata (plane detale urbane etj).

TRANSMETIM TË MBLLEDHJEVE TË KËSHILLIT TË KOMUNËS

Transmetimi direkt televiziv ose nëpërmjet të radios ose emetimi i inçizimit nga mbledhjet e këshillit është mënyrë e mirë për transparencë të punës të organeve të pushtetit lokal. Nëse keni mundësi, është e preferueshme të krijoni një praktikë të tillë.

LETRA, PAMFLETA

Qytetarët mund t'i drejtohen kryetarit të komunës ose këshillit të komunës me anë të letrës, në të cilën do t'i shfaqin qëndrimet, vërejtjet, propozimet ose ankesat e tyre, për çështje të lidhura me marrjen e vendimeve nga ana e vetëqeverisjes lokale.

Organet e njësisë së vetëqeverisjes lokale janë të obliguar të marrin parasysh mendimet dhe me shkrim të informojnë qytetarin ose grupin e qytetarëve ose të caktojnë takim me ata.

Pushteti lokal mund të shtyp pamfleta, të cilat do t'ju shpërndahen grupeve qëllimore.

DITA E HAPUR - DITA PËR PRANIM

Takimet e drejtpërdrejta me qytetarët, janë mundësia më e mirë për komunikim, pa ndërmjetësues. Në mënyrë direkte këmbëhen mendime për çështje aktuale.



Publiku duhet të informohet për ditët dhe terminet, në të cilat mund të takohet me të zgjedhurit e tyre në pushtetin lokal. Në takimet me kryetarin e komunës, është e preferueshme të marrin pjesë edhe përfaqësues të administratës komunale, përfaqësues të ndërmarrjeve publike ose të shërbimeve tjera publike të themeluara nga ana e komunës, varësisht nga tema e bisedimit. Në këtë mënyrë, qytetarët do të fitojnë përgjegje të saktë dhe të qartë, pa u dërguar në institucione tjera. Në periudhën e deri tanishme, numër i madh i kërkesave për takim me kryetarin e komunës kanë qenë për çështje, të cilat nuk janë në kompetencë të komunës (punësim, ndihmë sociale, banesa sociale), për çka edhe qytetarët ktheheshin të dëshpëruar nga takimet. Por me decentralizimin dhe fitimin e konsiderueshëm të kompetencave, gjendja do të ndryshohet në mënyrë të konsiderueshme, në të mirë.

QENDRA QYTETARE SHËRBYESE

Qendrat qytetare shërbyese, të cilat dolën nga qendrat për informim të qytetarëve, ishin kënde nëpër komunat, në të cilat qytetarët shpesh drejtoheshin për tu informuar për aktivitetet e komunës, për çështje me rëndësi për ata ose për të kërkuar të zgjedhin ndonjë problem nga jeta e përditshme. Ato për ne janë mënyrë e re, mënyrë efikase dhe e thjeshtë për informim të qytetarëve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve dhe në atmosferë të këndshme dhe shoqëruese t'ju japin informata, rekomandime, këshilla dhe drejtime për zgjidhje të problemeve të tyre.

Duke e vendosur qytetarin në qendër të vëmendjes, qendra shërbyese qytetare mundëson plotësimin e një pjese të nevojave për informata por edhe mundësi për paraqitje të ankesave nga ana e qytetarëve për çështje nën kompetencë të komunës.

Rekomandohet që pas 01 korrikut të vitit 2005, qendrat shërbyese qytetare të shndërrohen në zyre për një ndalje.

Me Ligjin për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 05/02), organet e komunës, komisionet e këshillit të komunës dhe shërbimet publike të komunës, janë të obliguar, pa kompenzim, të informojnë qytetarët për punën e tyre, si dhe për planet dhe programet, që janë me rëndësi për zhvillimin e komunës. Poashtu, komuna është e obliguar, qytetarëve t'ju mundësojë qasje deri te informatat themelore për shërbimet, që ju ofron.

9.2.3. KOMUNIKIMI ME MEDIUMET

Në shoqërinë aktuale komunikimi me mediumet ka rëndësi të jashtëzakonshme, për shkak të fuqisë së tyre të madhe në krijimin e mendimit publik.

Obligim i juaj është të siguronit qasje të lirë deri te informatat, të cilat janë të rëndësishme për qytetarët, sepse ndikojnë në kualitetin e jetës së tyre.

Njëra nga mënyrat më efikase për informimin e qytetarëve janë mediumet e shkruara dhe ato elektronike. Me qytetarët, nëpërmjet medimeve, mund të komunikoni në mënyrë të drejtëpërdrejtë, me ndihmën e paraqitjeve publike, pres-konferenca-ve, intervistave etj. Dhe në mënyrë indirekte me anë të kumtesave zyrtare për publik, letrave deri te lexuesit, demante, hapësirë të paguar etj.

Për shkak të rëndësisë të informatave, në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë janë dhënë standardet, me të cilat garantohet: liria e qasjes deri te informatat; liri gjatë pranimit dhe bartjes së informatave; liri të fjalës; liri e paraqitjes publike dhe informimit publik.

Ju, si përfaqësues i komunës në paraqitjet publike, duhet të jeni bindës dhe të dini të dërgoni porosi të vërteta, që do të shkaktojnë efekt te qytetarët. Në bazë të hulumtimeve të mëparshme, në bazë të analizave, definimit të gupeve qëllimore dhe vlerësimeve, duhet të përcaktohet në mënyrë precize tema, për të cilën do të flisni, mënyra e foljes dhe pamja. Gjatë paraqitjes duhet me qenë të qartë, preciz, të kuptueshëm, të shfrytëzoni argumente të bazuara në fakte, të mos shfrytëzoni zhargon, të mos përdorni fjalë fyese, të mos gjestikuloni, të dukeni i përshtatshëm me paraqitjen dhe temën dhe të jeni bindës.

PRES-KONFERENCA (KONFERENCA PËR MEDIUME)

Pres - konferenca është mënyra e praktikuar më shpesh në komunikimin direkt me mediumet e shtypit dhe mediumet elektronike. Ato duhet të caktohen me kohë dhe të fillojnë në kohën e caktuar. Paraqitjet dhe drejti-



met duhet me qenë precize, të shkurtëra dhe të qarta për tu larguar mundësia e lëshimit të asaj, që është më e rëndësishme për ju, gjatë selektimit dhe zgjidhjes së pjesëve nga ana e gazetarëve.

Më së miri është gjatë pres-konferencës, gazetarëve t'ju jepni mundësi për parashtrim të pyetjeve. Duhet me qenë poashtu bindës dhe të hapur gjatë përgjigjeve, që të fitoni publikun në anën e juaj. Është e preferueshme pres-konferencat t'i mbani në hapësirë të përshtatshme me ikonografi të përshtatshme (flamur të shtetit dhe flamur të komunës, stemën e komunës ose logo të ndonjë manifestimi). Por, ndonjëherë, takimet me gazetarët mbani në terren, nëse duhet të shënoni fillimin ose mbarimin e ndonjë projekti ose dëshironi të flisni në vendin e caktuar në lidhje me ndonjë problem të rëndësishëm për publikun, gjegjësisht për grupin qëllimor, të cilit i drejtoheni.

EMISIONE NË TELEVISION DHE RADIO ME LINJA TË HAPURA TELEFONIKE

Kjo, poashtu, është një formë tepër e mirë e komunikimit me publikun. Pranoni sfidën e ballafaqimit me qytetarët nëpërmjet pyetjeve të tyre direkte, që ndonjëherë mundën me qenë jo aq të këndshme por këtë duhet ta pranoni, si pjesë përbërëse e kryerjes së funksionit të juaj publik.

Mos gjestikuloni, mos ofendoni, duhet të jeni të fresket të hapur dhe direkt. Flisni me fakte. Mos paraqitni nevrozë. Edhe atëherë kur nuk keni përgjigje, që do të kënaqë shijet e disa qytetarëve duhet të jeni i sinqertë dhe të pranoni se nuk keni bërë atë që duhet, por se asaj çështje do t'i kushtoni vëmendje në periudhën e ardhshme.

KUMTESAT PËR OPINION

Nëpërmjet shkrimit të kumtesave për opinion, që shpërndahen nëpër medime, drejtoheni publikut për çështje, për të cilat konsideroni se nuk është i nevojshëm komunikimi direkt në pres-konferencë. Përgaditni tekstin në mënyrë precize, me çështjet kyqe për grupet kyqe, të cilëve dëshironi t'ju bartni informatat e nevojshme.

INTERVISTË PËR MEDIUMET E SHKRUARA

Me kënaqësi pranoni ofertën nga medimet lokale ose shtetërore për dhënie të **intervistës**. Kjo është mundësi e mirë, publikut t'i prezentoni vlerësimet, qëndrimet, projektet dhe vizionet e juaja. Preferoni bisedë spontane në të gjallë. Mos kërkoni paraprakisht t'ju dorëzohen pyetjet, në të cilat ju do të prezentoni përgjigjet në formë të shkruar. Do të leni përshtypje të keqe, meqë gazetarëve do t'ju shkurtoni mundësinë e paraqitjes së nënpyetjeve. Është mirë të jeni origjinal dhe të keni stilin e juaj njohës dhe karakteristik.

BULETINE, SHPALLJE, AFISHE, POROSI TELEVIZIVE DHE POROSI PËR RADIO

Nëse vlerësoni se ka nevojë për shtypje të **buletinit**, me qëllim të prezentimit të informatave për qytetarët, bëni këtë. Mund të praktikoni edhe publikimin e **shpalljeve**, si në medimet e shkruara, ashtu edhe në medimet elektronike. Për ndodhi të caktuara mund të shfrytëzohen edhe pllakatet. Ndonjëherë edhe porositë në televizion dhe në radio në formë të klipeve mund të kenë efekt mbi publikun dhe grupet qëllimore. Për projekte më të mëdha organizoni kampanja reklamuese. Fitoni vëmendjen e qytetarëve. Bindni ata. Fitoni besimin dhe përkrahjen e tyre.

9.2.4. KOMUNIKIM ME GRUPE TË TJERA QËLLIMORE

Organet e vetëqeverisjes lokale kanë nevojë për komunikim të përditshëm, jo vetëm me qytetarët dhe gazetarët por edhe me grupe tjera qëllimore: shoqata të qytetarëve, afarist, institucione qevitare, institucione të jashtme, asociacione ndërkombëtare etj.

Të gjitha këto kanë nevoja dhe interesa të ndryshme. Kontaktet, me të gjithë këta, janë specifike dhe kërkojnë përgaditje të veçantë. Marrëdhëniet duhet të kultivohen, të zhvillohen, të thellohen, të zhvillohet partneritet etj.



KOMUNIKIM ME ORGANIZATA JOQEVERITARE - ORGANIZATA JOFITIMPRURËSE

Nuk ka demokraci pa sektorin civil të zhvilluar, pa rrjetë të fortë të shoqatave të qytetarëve, pa organizata joqeveritare, pa organizata jofitimprurëse, nëpërmjet të cilëve qytetarët mund të realizojnë nevoja dhe interesat të caktuara dhe specifike.

Krijoni marrëdhënie të mira me ato. Kjo është e domosdoshme. Në këtë mënyrë do të jepni kontribut për realizim më të shpejtë, më të lehtë dhe më të thjeshtë të disa interesave specifike të qytetarëve. Përmbani projektet e tyre. Zhvilloni marrëdhënie partneriteti.

KOMUNIKIMI ME AFARISTË

Sektori i biznesit është fuqi shtytëse i zhvillimit të komunës. Nga zhvillimi i këtij sektori varet përparimi, fuqia ekonomike, shkalla e punësimit, gjendja sociale, mirëqenia. Për këtë dedikoni vëmendje të veçantë të krijimit dhe mirëmbajtjes së marrëdhënieve të mira me afaristët. Kërkoni zgjidhje të kapshme.

KOMUNIKIMI ME QEVERINË, INSTITUCIONET QEVERITARE, TË HUAJA DHE NDËRKOMBËTARE

Qeveria është e obliguar me ligj të bashkëpunojë me komunat, për çështje me interes për komunat. Posaçërisht për ligjet, që kanë të bëjnë me komunën dhe shpërndarjen e dotacioneve.

Përveç kësaj komunat, me domosdoshmëri, duhet të konsultohen për procedurat për planifikim të punëve publike, gjatë përgaditjes së planit hapësinor të Republikës.

Qeveria mund të lidh marrëveshje për bashkëpunim me një ose më tepër komuna për planifikim, për programim dhe implementim të politikave në lëmitë e caktuara me interes të përbashkët.

Për shkak të zgjidhjes së thjeshtë të çështjeve me interes jetik për qytetarët, janë të nevojshëm kontakte të shpeshta me ministrinë në Qeverinë, me agjensionet, me fondet dhe byrotë.

Në periudhën e tranzicionit, posaçërisht, por edhe më vonë, me rëndësi të madhe është bashkëpunimi me organizatat e huaja - qeveritare dhe joqeveritare, si dhe me organizatat dhe asociacionet ndërkombëtare.

KOMUNIKIM ME GRUPE QËLLIMORE SPECIFIKE

Në komunën tuaj ka shumë klube sportive, shoqëri kulturo-artistike, orkestra, organizata të nxënësve, studentë, femra, pensionistë, luftarë, persona me nevoja specifike dhe shumë tjerë. Të gjithë ata janë tepër të rëndësishëm për bashkësinë, sepse bashkojnë numër të madh të qytetarëve. Bëni gjithçka të krijoni forma të bashkëpunimit dhe partneritetit. Ndiqmoni në realizimin e suksesshëm të misionit dhe vizionit të tyre. Kjo është me interes të madh për bashkëqytetarët tuaj.

9.2.5. KONVENTA QYTETARE

Për ta bërë punën tuaj më transparente, më të përgjegjshme dhe më të afërt për qytetarët, aprovoni konventë qytetare, në të cilën do t'i përmendni shërbimet, që i ofroni dhe standardet e përgjithshme për punë. Bëne të arritshme për numër sa më të madh të qytetarëve. Me këtë do të kontriboni në shpejtimin dhe rritjen e kualitetit të shërbimeve të pushtetit lokal, ndërsa administrata komunale do të përmirësojë transparencën dhe efikasitetin gjatë punës.

Vendosni standarde, të cilat do të respektohen me doemos gjatë punës me qytetarët. Këtë do ta arrini me qëndrim të paanshëm dhe të sjellshëm gjatë komunikimit. Krijoni parakushte për sigurim të shërbimit profesional, preciz dhe në kohë për qytetarët.

Ju dhe të punësuarit në administratën komunale duhet të mbani mend se qytetari nuk është dikush, i cili ju pengon por ai është qëllimi i punës juaj. Ju jeni këtu për shkak të tij e jo ai për ju. Ju nuk i bëni shërbim, me atë që e shërbeni por ai ju bën shërbim juve, me atë që ju jep shansë për ta shërbyer.



9.2.6. SI TË KOMUNIKONI NË MËNYRË EFEKTIVE DHE TË VEPRONI NË MËNYRË PREVENTIVE NDAJ KONFLIKTEVE

Konfliktet janë pjesë e jetës. Sistemet e vlerave sociale dhe individuale ndoshta janë barriera më e madhe për komunikim. Problemi është kompleks, sepse nën vlera nënkuptohet mënyra e perceptimit, stili i komunikimit i zhvilluar në fëmijëri, përvoja, pritjet personale dhe temperamentit. Të gjithë ne i zgjidhim punët në jetë në mënyrë karakteristike vetëm për ne, e cila është e paracaktuar nga pritjet tona dhe nga përvoja jonë. Mu për këtë krijohen konfliktet. Thjesht, ato janë pasojë e karakteristikave individuale. Si të tillë, konfliktet janë pjesë e punës suaj të përditshme, si kryetar i komunës ose anëtar i këshillit të komunës. Mu për këtë, në marrëdhëniet me publikun duhet t'i keni parasysh metodat dhe alternativat për zgjidhjen e konflikteve.

METODA PËR ZGJIDHJE TE KONFLIKTEVE

Njëra ndër metodat më të aplikuara për zgjidhjen e konflikteve në vendet e zhvilluara është metoda e drejtimit të vëmendjes drejt marrëdhënieve me person ose grup të caktuar, në vend drejt rezultatit të konfliktit. D.m.th. në vend, që të drejtoheni kah çështja kush do të fitojë e kush do të humb në konfliktin, është e rekomandueshme të dedikoheni drejt qëndrimit të personit ose grupit, me të cilin jeni në situatë konfliktuozë. Varësisht nga situata ndoshta do të jeni të detyruar të përdorni metodën e autoritetit, duke u munduar të favorizoni mendimin e juaj, me ndihmën e kompetencave, që i keni.

Megjithatë, përvojat në këtë lëmi tregojnë se efekte më të mira arrihen me ndihmën e metodës së kompromisit ose marrëveshjes, që përfshijnë zgjidhje më të madhe të zgjidhjeve alternative.

Pa marrur parasysh se, për cilën metodë do të përcaktoheni gjithmonë duhet të keni parasysh se duhet të parashtroni pyetje të hapura, duhet me qenë ndëgjues i mirë, të keni durim, të keni kujdes në qëndrimin ndaj grupit ose personit dhe duhet të komunikoni në mënyrë efektive.

Në këtë proces me rëndësi të madhe është definimi i drejtë i problemit, si dhe qëndrimi ndaj tij.

Zhvillimi i mjeshtërive për zgjidhje të konflikteve, në masë të madhe ndikon në komunikimin e juaj të përditshëm.

9.2.7. APLIKIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIKE - KOMUNIKUESE

Jetojmë në kohën e globalizimit, që është rezultat i zhvillimit të shpejtë teknologjik dhe i kompjuterizimit. Kohë, në të cilën demokracia, zhvillimi, mirëqenia varen nga proceset globale teknologjike, posaçërisht prej **internetit** dhe kryerjes së shërbimeve nëpërmjet rrugës elektronike. Informacioni është resursi më i rëndësishëm, ndërsa dituria dhe mbindërtimi janë faktor i rëndësishëm për përcjelljen dhe pranimin të ndryshimeve dhe konkurrencës.

Shoqëria informatike është rezultat i ndryshimeve të shpejta në aplikimin e teknologjive të reja të komunikimit dhe të teknologjive kompjutorike. Zhvillimi i saj është i definuar dhe potencuar në Planin aksional të Komisionit evropian të Unionit evropian -eEUROPE 2005 dhe me Konventën përfundimtare të Samitit botëror për shoqëri kompjutorike WSIS Gjenevë, Tunis 2003-2005, e cila është nënshkruar edhe nga Republika e Maqedonisë.

Në Republikën e Maqedonisë shoqëria kompjuterike (informatike) duhet të shpejtojë zhvillimin e saj, të krijojë ekonomi stabile, të bëjë shtytje të konkurrencës, të zvogëlojë papunësinë, të zhvillojë administratë shtetërore digjitale.

Ndryshimi i teknologjisë kompjuterike-komunikuese (TKK) në nivel lokal do të përmirësojë kualitetin e shërbimeve, të cilat i ofron komuna. Nën krijimin e modelit të ri të komunës në Maqedoni për qytetarët, me rëndësi tejet të madhe do të jetë siguri i arritshmërisë dhe shfrytëzimi i informatave të sektorit publik, si dhe krijimi i parakushteve për stimulim të komunikimit "on line" në mes komunës dhe qytetarëve.

Ardhmëria është në zhvillimin e TKK-së. Sa më shpejtë të kuptoni këtë, aq më mirë për ju, komunën tuaj, për qytetarët dhe për bashkësinë. Për këtë shkak, mos pritni! Menjëherë filloni përgaditjet për sjelljen e strategjisë për aplikimin e TKK-së në komunën e juaj!



Pasojat do të jenë tepër të mëdha. Do ta ngrisin demokracinë në nivel të rëndësishëm. Do ta zmadhoni transparencën, posaçërisht pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e marrjes së vendimeve. Do të zmadhoni efektivitetin dhe efikasitetin e organeve dhe administratës komunale. Do të kontribuoni në zmadhimin e aktivitetit ekonomik. Do të tërhiqni investuesit. Do ta forconi dhe përparoni bashkëpunimin me sektorin e biznesit dhe me organizatat jofitimprurëse.

Me TKK-në, posaçërisht do të siguron:

- qasje në informata gjatë 24 orëve në ditë, shtatë ditë në javë, për të gjithë të interesuarit;
- integrim të vetëqeverisjes lokale me ekonominë lokale;
- sigurim të shërbimeve të drejtë për drejta dhe të shpejta për qytetarët dhe subjektet juridike;
- integrim të bazave të të dhënave, qasje deri te ato dhe komunikim më të mirë të brendshëm, me çka do të kurseni kohë, energji, të holla, kurse zmadhohet edhe kualiteti i shërbimeve;
- informata dhe të dhëna për komunën e juaj, për të drejtat, obligimet, përgjegjësitë, për punën e juaj, për buxhetin dhe për vendime, programe dhe projektke tjera të rëndësishme, etj.

Për të arritur gjithë këtë, është i nevojshëm integrimi i të gjithë nënsistemeve, bartje e informatave dhe komunikim efikas në të gjitha nivelet. Sistemi i juaj informatik duhet të përbëhet nga dy pjesë integruese: prej **intranetit** dhe **internetit**.

Me **intranetin** do të siguron lidhje të të punësuarve të juaj në komunë, me çka do t'i përforconi funksionet e brendshme administrative. Me **internetin** mundësoni komunikim me shfrytëzuesit e jashtëm, ndërsa të gjithë të punësuarit do të kenë qasje në internet nëpërmjet portalit të **intranetit**, i cili ju mundëson të këmbejnë informata dhe të dhëna, dokumente etj.

Për fat të keq, situata ekonomike dhe sociale dhe fuqia e vogël blerëse e qytetarëve, nuk mundëson të gjitha familjet e interesuara të kenë kompjuterë. Por të shpresojmë se punët do të ndryshohen shpejtë për të mirë dhe se numri i shfrytëzuesve të **internetit** do të zmadhohet në mënyrë drastike, sikurse në shtetet tjera në tranzicion, të cilat janë para nesh me reformat.

WEB FAQE

Secila komunë duhet patjetër të ketë **web faqen** e saj. Është e preferueshme kjo **web faqe** me qenë e dizajnuar mirë dhe e qartë për shfrytëzuesit dhe vizituesit e saj, si dhe të bëhet azhurimi i saj me kohë me informata më të reja. Përveç informatave themelore për kornizën juridike, statutit dhe informatave tjera për komunën, në **web faqen** mund të publikohen të gjitha vendimet e aprovuara nga ana e këshillit dhe kryetarit të komunës, si dhe informata për të gjitha ngjarjet e rëndësishme në komunë.



POSTA ELEKTRONIKE (e-mail)

Me postën elektronike shpejtësia e barjtes së porosive është e pakrahasueshme me shërbimet e rëndomta të postës. Pa marrur parasysh largësinë, letrat dhe dokumentet arrijnë menjëherë. Kursimi i kohës dhe të hollave është i madh, ndërsa pasojat janë të pakrahasueshme.

Ju rekomandoj të krijoni praktikë, që qytetarët t'ju parashtrajnë pyetje nëpërmjet rrugës elektronike, ndërsa ju të përgjigjeni me respekt, në kohë dhe me argumente.



NËNSHKRIMI ELEKTRONIK

Në të ardhmen e afërt edhe në Maqedoni do të krijohen kushte, sikurse në vendet e zhvilluara ose sikurse në Estoni, qytetarët të mundën obligimet e tyre financiare t'i kryejnë nëpërmjet rrugës elektronike, nga shtëpia e tyre (llogaritë për telefon, energji elektrike, ujë, hedhurinë komunale dhe të ngjajshme), si dhe të dorëzojnë dokumente nga shtëpia, duke shfrytëzuar nënshkrimin elektronik.

Për këtë është e domosdoshme të sillen dispozita ligjore, që do të garantojnë siguri gjatë komunikimit; është e nevojshme të definojnë qartë procedurat për qasje drejt informatave; të krijohen forma të përshtatshme elektronike; certifikatë etj.

KONFERENCË ME NDIHMËNE E MJETEVE ELEKTRONIKE DHE FORUME PËR DISKUTIME

Për disa çështje dhe tema të veçanta për qytetarët ose për grupe qëllimore të caktuara, mund të organizohen edhe e-konferenca ose forume për diskutim, ndërmjet të cilëve qytetarët mund të paraqesin qëndrimet e tyre. Kjo do të jetë me lehtësi të madhe për organet e komunës në procesin e marrjes së vendimeve.

TELEFONIA MOBILE

Me zgjerimin e shpejtuar të rrjetit të shfrytëzuesve të telefonave mobil, zmadhohen mundësitë për krijimin e komunikimit të shpejtë dhe të drejtëpërdrejtë të organeve të komunës dhe administratës së komunës me qytetarët, pa marrur parasysh ku gjenden ata - nëpërmjet thirrjeve telefonike, dërgimit të porosive të shkurtëra SMS, ndërsa në të ardhmen edhe nëpërmjet dërgimit të postës elektronike (e-mail) me telefonat mobil.

9.2.8. SISTEM ME NJË SPORTEL

Në të ardhmen, qendrat shërbyese qytetare është mirë të transformohen në të ashtuquajturën zyre fillestare (front office). Ato do të bëhen kënde, në të cilët qytetarët do të realizojnë kontaktin e parë të drejtëpërdrejtë për të realizuar ndonjë të drejtë, të lidhur me procesin e marrjes së vendimeve në vetëqeverisjen lokale.

Zyret fillestare të këtyra kanë efekte të mëdha në komunat e vendeve, të cilat janë para me realizimin e reformave. Në vend, që palët të shkojnë prej sporteli në sportel dhe të anashkalohen nga ana e nëpunësve të papërgjegjshëm, do të shëtisin dokumentet dhe lëndët e tyre. Në fund, pas kryerjes së procedurës administrative, do të informohen dhe thirren për të marrur lëndën ose dokumentin e caktuar të tyre.

Zyra fillestare do të përmbahet nga zyra e pasme (back office), në të cilën do të përpunohen dhe zgjidhen lëndët.

Paraqitje skematike:



Ky sistem i të ashtuquajturës komunë elektronike në masë të madhe do të ngrit nivelin e kualitetit të shërbimeve për qytetarët, si qendër e vëmendjes së juaj. Në mënyrë pozitive do të ndikojë në efikasitetin dhe efektivitetin në punë dhe do të rezultojë me pasoja pozitive: zmadhim të besimit të qytetarëve në vetëqeverisjen lokale.



Fjalë kyqe: intervistë, buletin, shpallje, intranet, internet, web faqe, e-konferencë.

Korrniza ligjore:

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë:, nr. 52/91);
- Ligji për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë:, nr. 5/02);
- Ligji për ratifikimin e Konventës evropiane për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë:, nr. 23/97);
- Ligji për shoqata të qytetarëve dhe fondacione ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë:, nr. 31/98);
- Deklarata për zhvillim të shpejtuar të shoqërisë informatike dhe ekonominë digjitale në Republikën e Maqedonisë si prioritet nacional ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë:, nr. 48/02-11);
- Plani aksional i Unionit evropian e EUROPE +;
- Plani aksional eEUROPE 2005 - sshoqëri informatike për të gjithë;
- Deklarata përfundimtare e Samitit botëror për shoqëri informatike WSIS Gjenevë, Tunis 2003-2005.



10 | BASHKËPUNIMI NDËRKOMUNAL

Goran Angellov

Për disa probleme, vetë mund të gjeni zgjidhje. Por, për zgjidhje të disa problemeve ju nevojitet ndihmë nga farefisi juaj dhe nga shokët tuaj. Disa probleme dhe kompetenca në komunën tuaj, poashtu, mund t'i zgjedhni vetë por për disa, mënyra më efikase është t'i zgjidhni në bashkëpunim me komunë tjetër ose me komuna të tjera. Ky kapitull do t'ju jep disa të dhëna themelore dhe drejtime për atë se ku mund të drejtoheni për ndihmë. Rezultati do të jetë zmadhimi i motivacionit dhe kreativitetit tuaj.

Thelbi i **bashkëpunimit** ndërkomunal rrejdh nga nevoja e njërive të vetëqeverisjes lokale të bashkëpunojnë ndërmjet tyre për zgjidhje të problemeve të përbashkëta për dy ose më tepër komuna, me qëllim të arritjes së efektit pozitiv për qytetarët e komunave, të cilat bashkëpunojnë ndërmjet tyre.

Bashkëpunimi ka të bëjë me lëmi të ndryshme të lidhura me kryerjen e përditshme të kompetencave të komunave nga niveli më i ulët, si mundësi për formim të trupave administrative të përbashkëta, themelim të shërbimeve publike të përbashkëta e deri te realizimi i projekteve të përbashkëta të lidhura me infrastrukturën komunale, të cilët në parim janë tepër të shtrenjtë për të mundur një komunë e vetme t'i realizojë ato. Ndërsa edhe shkalla e shfrytëzimit dhe qëndrueshmërisë së tyre do të ishte tepër e vogël vetëm për një komunë. Nga këto shkaqe, thjeshtë, nevojat për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta të qytetarëve të dy ose më tepër komunave na udhëzojnë në **bashkëpunim** për t'ju mundësuar qytetarëve të realizojnë qëllimet e tyre. Ne jemi të obliguar të krijojmë kushtet e nevojshme për plotësimin e nevojave të qytetarëve.

Ligji për vetëqeverisje lokale ofron parakushte ligjore për realizimin e **bashkëpunimit** ndërmjet njërive të vetëqeverisjes lokale. Madje, lirisht mund të thuhet se nuk egziston asnjë pengesë për bashkëpunim ndërmjet komunave përveç asaj, me të cilën çenohet sistemi kushtetues i Republikës së Maqedonisë. Ligji për vetëqeverisje lokale në më tepër nene flet për **bashkëpunimin** ndërmjet komunave (nenet 14, 15, 81 etj).

Në 14 vitet e kaluara nga mbajtja e zgjedhjeve të para pluraliste, lokale në Republikën e Maqedonisë, e posaçërisht në tetë vitet e fundit të aplikimit të Ligjit për vetëqeverisje lokale (nga vitet 1995/1996) dhe Ligjit për ndarje territoriale (viti 1996), mund të konstatohet se në shumë raste për shkak të pengesave subjektive, ky **bashkëpunim** nuk është realizuar ashtu siç duhet. Mos kuptimi i thelbit të **bashkëpunimit** ndërmjet komunave është njëri nga shkaqet, që në më shumë raste funksionerët e zgjedhur të komunës (kryetarët e komunave dhe këshillat e komunave), mbylleshin në kufijtë e komunave të tyre dhe aprovoheshin plane për zhvillim të komunave, sipas të cilave parashikohej se të gjitha problemet, posaçërisht projektet më të mëdha të infrastrukturës, do të mund të realizohen vetëm për komunën e tyre, që për fat të keq ishte dhe ende është mënyrë



e gabuar e zgjidhjes së problemeve. Në raste të caktuara, është prezent edhe mosdurimi partiak në mes kryetarëve të komunave të ndryshme, me përkatësi partiake të ndryshme, kështuqë verbëria partiake e kryetarëve të komunave e pengon **bashkëpunimin** ndërmjet komunave.

Nga shkaqe objektive, që negativisht ndikonin në **bashkëpunimin** ndërmjet komunave duhet të përmendet edhe mungesa e burimeve më të mëdha financiare për përmbajtjen e këtij lloji të **bashkëpunimit** dhe, kuptohet, koha e gjatë e nevojshme për vendosjen e **bashkëpunimit** të tillë. Por faktet tregojnë se ata, që me të vërtetë ishin përcaktuar për **bashkëpunim** ndërmjet komunave dhe nuk u dorëzuan gjatë vitit të parë të **bashkëpunimit**, me të vërtetë janë shembuj të mirë për **bashkëpunim**.

Përvoja evropiane dhe e Maqedonisë, tregojnë se ky proces është i gjatë dhe mund të ndodh, rezultatet e para të arrihen pas 4-5 dhe më shumë vite, gjë që, me të vërtetë, ndikon në mënyrë jostimuluese për pjesëmarrësit në **bashkëpunim**. Por nuk duhet të harrohet se, në të shumtën e rasteve, edhe ne vetë e pengojmë **bashkëpunimin** me kërkesat tona lokal-patriotike si psh: " Nëse drejtori i ndërmarrjes publike ose selia e ndërmarrjes publike ndërkomunale nuk vendoset në komunën tonë, unë nuk marr pjesë në **bashkëpunimin** ndërkomunal".

Shembull i bashkëpunimit ndërkomunal: për furnizim me ujë në rajonin e Tikveshit; zgjidhjen e problemit me deponimin e hedhurinave komunale të ngurta dhe hedhurinave tjera në Maqedoninë jugperëndimore dhe bashkëpunimin administrativ në mes Komunës së Vinicës dhe Komunës së Zërnovcës në lëminë e inspektimit komunal.

Në Maqedoni, në vitet e kaluara, kemi më tepër shembuj të **bashkëpunimit** rajonal ndërkomunal në më tepër lëmi. Për shkak të hapësirës në këtë libër, do të përmend shembujt më poshtë:

Periodha për implementimin e ligjit në fuqi për vetëqeverisje lokale është para jush. Ju bind se do të ballafaqoheni me numër të madh të kompetencave të reja, të cilat do të bëhen sfidë e madhe për ju por nuk duhet të harroni se qytetarët nga "komuna e re" nuk presin shumë, sepse qytetarët tanë e dinjën se decentralizimi është proces, i cili do të ngrit standardin e jetesës.

Për numër të madh të kompetencave, thjesht do të jeni të detyruar të bashkëpunoni në mes vete në mënyrë, që bashkarisht të realizoni kompetencat e reja. Kështu, së bashku, shumë më lehtë dhe me efikasitet më të madh dhe në mënyrë më ekonomike do të implementoni të gjitha kompetencat e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë.

10.1. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR NË MES KOMUNAVE

Nevoja për **bashkëpunim** në mes komunave në kohën e tashme i tejkalon kufijtë nacional dhe në shumë raste, komunat nga vende të ndryshme vendosin të zhvillojnë **bashkëpunim** nga shkaqe të ndryshme. Njëra nga shkaqet themelore për zhvillimin e **bashkëpunimit** ndërkombëtar është këmbimi i informatave, përvojave, zhvillim i **bashkëpunimit** kulturorë, **bashkëpunimit** ekonomik, zgjidhje regjionale të problemeve nga më tepër komuna të venedeve të ndryshme, etj. Në Evropën bashkëkohore thuhet nuk ka komunë, që nuk ka realizuar donjë lloj të **bashkëpunimit** ndërkombëtar. Një gjë e tillë është prezent në Evropë dhe botë.

Përgjithësisht, **bashkëpunimi** ndërkombëtar mund të ndahet në dy lloje: **bashkëpunim** bilateral ose **vëllazërim**, që në disa raste mund të jetë edhe multilateral - në rastet e vëllazërimit të më tepër njësisive të vetëqeverisjes lokale me një akt juridik dhe **bashkëpunim** evroregional, kur prej më tepër komunave nga vende të ndryshme formohet evroregjion për atë pjesë të Evropës.

Përveç këtyre dy llojeve të **bashkëpunimit** ndërkombëtarë të komunave në Maqedoni por edhe në Evropë egziston mundësia, që njësitë e vetëqeverisjes lokale të anëtarësohen në organizata ndërkombëtare të pushteteve lokale ose të bashkëpunojnë me to.

10.1.1. VËLLAZËRIMI

Vëllazërimi, më së shpeshti, është marrëveshje bilaterale në mes dy komunave nga vende të ndryshme, me të cilën komunat merren vesh për lëmitë e **bashkëpunimit** dhe çfarë forma të **bashkëpunimit** do të imple-



mentojnë. Kjo formë e **bashkëpunimit** është praktikuar shpesh nga komunat në vendin tonë, në të shumtën e rasteve për këmbim të informatave, përvojave në mes komunave të ndryshme, si dhe për **bashkëpunim** kulturor, sportiv dhe ekonomik në mes njësisive të vetëqeverisjes lokale të vëllazëruara.

Karakteristikë e këtij lloji të **bashkëpunimit** është mundësia e zgjedhjes së komunave të shumta, të interesuara për **bashkëpunim** ndërkombëtar nga Evropa dhe bota. Në zgjedhjen e komunave të interesuara për këtë lloj të **bashkëpunimit**, nuk jemi të kufizuar vetëm në vendet fqinje me Maqedoninë (siç është rasti me formimin e evroregjioneve) por mund të bashkëpunojmë edhe me vendet e Evropës dhe botës. Ju jeni ata, që duhet të vendosni kontakte me komunën e caktuar dhe të realizoni **vëllazërimin** në mes komunës suaj dhe komunës tjetër, që shpreh interes për këtë. Mos u habitni nëse faza e kërkimit të komunës partnere jashtë Maqedonisë zgjat një kohë të gjatë. Kjo mund të ndodhë si pasojë e dy shkaqeve:

- komuna, me të cilën dëshironi të vëllazëroheni tanimë është e vëllazëruar me komuna të tjera;
- procedura e gjatë ligjore në disa vende, të cilën duhet të kalon komuna e zgjedhur nga ju për **vëllazërim**, para se të hyjë formalisht në **vëllazërim** me komunën tuaj.

Trendet bashkëkohore evropiane janë mjaft pozitive dhe vijnë në shprehje gjithnjë e më shumë. Madje, në disa vende komunat stimulohen të bashkëpunojnë me komuna jashtë vendit.

Në procesin e decentralizimit dhe afrimit të Republikës së Maqedonisë me Unionin evropian, çfarë domethënie ka **vëllazërimi** i komunave nga Republika e Maqedonisë me komunat e vendeve-anëtare të Unionit evropian, nuk duhet të shpjegohet. Një **vëllazërim** i tillë është më se i dobishëm. Ju nuk duhet të heqni dorë për të arritur këtë edhe nëse ndonjë komunë nga vendet-anëtare në Unionin evropian ju refuzon - egzistojnë shumë komuna tjera, të cilat dëshirojnë të bashkëpunojnë me komunën e juaj.

Ligjet në Republikën e Maqedonisë, që rregullojnë këtë lëmi, janë tepër liberale në kuptim të asaj se nuk kërkohen leje ose mendime të caktuara nga ana e pushtetit lokal, që të mund një komunë e caktuar e Maqedonisë të zhvillojë **bashkëpunim** ndërkombëtar. Vetëm Ministria e vetëqeverisjes lokale është e obliguar të mbajë evidencë të të gjitha llojeve të **bashkëpunimit** ndërkombëtar të komunave tona.

Në suazat e fondeve të Unionit evropian, egziston programi i quajtur: "Ndhmë për vëllazërim", i cili ndihmon dhe stimulon financiarisht komunat e Unionit evropian dhe komunat e vendeve tjera (para se gjithash vendet me status të kandidatit për anëtarësim në UE), me qëllim të afrimit të komunave, të cilat nuk janë pjesë e Unionit evropian, me komunat, të cilat janë pjesë përbërëse e Unionit evropian.

10.1.2. BASHKËPUNIMI EVRO-RAJONAL

Bashkëpunimi evrorajonal në Evropë fiton intenzitet në vitet e gjashtëdhjeta të shekullit 20, ndërsa në trojat përreth nesh, në 20 vitet e fundit.

Karakteristika themelore e **bashkëpunimit** evrorajonal, është domosdoshmëria e tij të realizohet ndërmjet dy ose më tepër komunave të vendeve fqinje, për shkak të afërsisë së tyre gjeografike për realizim të interesit të përbashkët në më shumë lëmi, siç është shtypje ndaj pushteteve qendrore të vendeve të tyre për qarkullim më të madh të njerëzve, mallërave, informatave, tregëtisë, liberalizimin e procedurave doganore dhe të vizave etj. Për dallim të **vëllazërimit**, me këtë formë të **bashkëpunimit** është i mundshëm edhe realizimi i projekteve të infrastrukturës së përbashkët për tërë evrorajonin.

Në Evropë egziston një numër i madh i **evrorajoneve** ku me të vërtetë janë zhvilluar marrëdhënie tepër të mira në mes faktorëve të evro-rajoneve. Gjatë kësaj janë reaalizuar bashkarisht edhe numër i madh i projekteve në interes të të gjitha palëve, pjesëmarrëse në **bashkëpunimin** evrorajonal.

Sot në evropë egzistojnë numër i madh i **evrorajoneve**. Në hartën gjeografike më poshtë është paraqitur situata nga viti 2000.



Harta e evro-rajoneve

Në Republikën e Maqedonisë gjatë dy decesive të kaluara, janë filluar më tepër iniciativa për formimin e **evrorajoneve** por, për fat të keq, nga shkaqe subjektive dhe objektive, deri më tani në aspekt juridiko-formal është formuar vetëm rajoni Shkup-Nish-Sofje. Ndërsa në fazë të formimit legal janë edhe rajonet:

- Ohër- Prespë dhe
- Kumanovë-Preshevë-Gjilan.

Shpresojmë se kemi pasur sukses t'ju kurajojmë të filloni ndonjë lloj të **bashkëpunimit** ndërkombëtar, sepse një **bashkëpunim** i tillë është i domosdoshëm për komunat tona.

10.2. BASHKËSIA E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE (BNJVL) - PROMOVUES I INTERESAVE TË PËRBASHKËTA TË KOMUNAVE

Bashkimi i lirë i pushteteve lokale me qëllim të zgjidhjes së problemeve me interes të përbashkët, është i zhvilluar në të gjitha vendet evropiane por edhe në vendet e tjera të botës.

Egzistojnë dy shkaqe themelore të bashkimit të pushteteve lokale në shoqata dhe asocia-cione:

- për mbrojtjen e interesave të tyre të përbashkëta;
- për këmbim të informatave, shërbimeve dhe veprimtarive.

Bashkësia e njësive të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Maqedonisë (**BNJVL**), paraqet asociacion të vetëm, në të cilën komunat e Republikës së Maqedonisë, si njësi të vetëqeverisjes lokale dhe Qyteti i Shkupit, si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale, organizohen me qëllim të këmbimit të përvojave dhe përparimit të demokracisë.

BNJVL, si bashkësi e vetme e njësive të vetëqeverisjes lokale është formuar në vitin 1972 dhe përsëri e themeluar në vitin 1996 më Ligjin për vetëqeverisje lokale.

Në periudhën 1990-1996 kur nuk kishte ligj gjithëpërfshirës për vetëqeverisje lokale, **BNJVL** ishte paisje për lidhjen e aktiviteteve të komunave dhe reprezent i qëndrimeve të komunave.

MISIONI

Misioni gjeneral i **BNJVL** është:

- Afirmimi i parimeve dhe vlerave të vetëqeverisjes lokale;
- Bashkimi i njësive të vetëqeverisjes lokale dhe
- Paraqitje dhe veprim i Bashkësisë si lobi-grup i njësive të vetëqeverisjes lokale për shtypje konstante mbi pushtetin qendror për decentralizim dhe realizim të intereseve dhe nevojave të tyre.

Në periudhën prej viteve 1990-1996, kur nuk kishte ligj të përgjithshëm për vetëqeverisjen lokale, **BNJVL** ishte lidhëse e aktiviteteve të komunave, si dhe përfaqësues i qëndrimeve të komunave.



AKTIVITETE PËR REALIZIMIN E MISIONIT

- Promovim dhe nxitje të **bashkëpunimit** të përbashkët dhe këmbim të informatave në mes anëtarëve;
- Formim të grupit për lobim dhe veprim si këshill këshillëdhënës në lëminë e vetëqeverisjes lokale;
- Promovim të **bashkëpunimit** konstruktiv dhe konstant të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe pushtetit qendror;
- Vendosje të marrëdhënieve me asociacione nacionale dhe ndërkombëtare të pushteteve lokale;
- Organizim të trajnimeve dhe konferencave për anëtarët e saj.

ORGANIZIMI

Bashkësia e njësive të vetëqeverisjes lokale është e përbërë prej:

- Kuvendit të kryetarëve të komunave;
- Kuvendit të këshillave;
- Kuvendit të përhershëm;
- Kryetarit të **BNJVL** / dy nënkryetarë të **BNJVL**

KUVENDI I KRYETARËVE TË KOMUNËS

Kuvendi i kryetarëve të komunave është organ i Bashkësisë, të cilin, sipas funksionit, e përbëjnë kryetarët e komunave të të gjitha njësive të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë dhe nga kryetari i Qytetit të Shkupit.

KUVENDI I KËSHILLAVE

Kuvendi i Këshillave është organ i Bashkësisë, i cili përbëhet nga një përfaqësues i këshillave të çdo komune në Republikën e Maqedonisë dhe të Qytetit të Shkupit.

FORMA E PUNËS SË KUVENDEVE

Kuvendet punojnë dhe mbledhen në mbledhje të veçanta. Por të dy kuvendet mund të mbajnë mbledhje të përbashkët për çështje me interes të përbashkët, si dhe për çështjet, për të cilat kryetarët e kuvendeve do të vlerësojnë, gjegjësisht do të merren vesh t'i shqyrtojnë në mbledhje të përbashkët.

KOMITETI I PËRHERSHËM

Komiteti i përhershëm është organ i Bashkësisë i përbërë prej 30 anëtarëve, edhe atë prej:

- kryetarit të Kuvendit të kryetarëve të komunave, i cili njëherit është edhe kryetar i Komitetit të përhershëm të Bashkësisë;
- nënkryetarit të Kuvendit të kryetarëve të komunave, i cili njëherit është edhe nënkryetar i Komitetit të përhershëm, që zgjidhet nga përfaqësuesit e bashkësive etnikë, që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë;
- kryetarit të Kuvendit të këshillave, i cili njëherit është nënkryetar i Bashkësisë dhe Komitetit të përhershëm;
- 13 përfaqësues të Kuvendit të kryetarëve të komunave, të zgjedhur nga rradhët e anëtarëve të Kuvendit dhe
- 14 përfaqësues të Kuvendit të këshillave, të zgjedhur nga rradhët e anëtarëve të Kuvendit.



KOMISIONET E BNJVL

Komiteti i përhershëm mund të formojë trupa punues (komisione), për përgaditje dhe shqyrtim të propozimeve dhe materialeve, si dhe për studim dhe diskutim të çështjeve tjera për organizim të aktiviteteve të caktuara dhe të ngjajshme.

Komisionet mundën me qenë të përhershme dhe të përkohshme.

Në komisione, përveç anëtarëve të Komitetit të përgjithshëm, mund të përcaktohen edhe persona tjerë profesional.

Në përbërje të **BNJVL** momentalisht janë të formuara dhe funksionojnë 10 komisione:

- Komisioni për financa dhe administratë;
- Komisioni për planifikim hapësinor dhe urban;
- Komisioni për arsim;
- Komisioni për organizim territorial;
- Komisioni për veprimtari komunale;
- Komisioni normativo-juridik;
- Komisioni për sport dhe kulturë;
- Komisioni për shëndetësi;
- Komisioni për zhvillimin e ekonomisë lokale
- Komisioni për organizimin e Panairit të komunave.

10.3. E TASHMJA DHE ARDHMËRIA

Me Ligjin për vetëqeverisje lokale të vitit 1996, anëtarësimi në Bashkësinë e njërive të vetëqeverisjes lokale ishte i domosdoshëm. Por me ligjin e ri për vetëqeverisje lokale të vitit 2002 është bërë një hap i madh demokratik, kështuqë anëtarësia në Bashkësinë e njërive të vetëqeverisjes lokale është e drejtë dhe dëshirë e komunave dhe të Qytetit të Shkupit.

Fakt është se Bashkësina e njërive të vetëqeverisjes lokale në vitet e kaluara, mbeti asociacioni i vetëm i njërive të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë, në të cilën anëtarësojnë të gjitha komunat e Republikës së Maqedonisë dhe Qyteti i Shkupit.

Në vitet e kaluara, Bashkësia e njërive të vetëqeverisjes lokale ishte e fokusuar në formimin e kornizës ligjore për decentralizim. Gjatë kësaj periudhe, komisionet dhe Komiteti i përhershëm, në mënyrë konstante kanë punuar në krijimin e një numri tepër të madh të ligjeve nga lëmia e decentralizimit. Gjatë këtij procesi, shumë vërejtje dhe qëndrime të Bashkësisë së njërive të vetëqeverisjes lokale, bëheshin pjesë e projekteve ligjore të aprovuara nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.

Përfaqësues të Bashkësisë së njërive të vetëqeverisjes lokale kanë marrur pjesë në punën e komisioneve të ministrive kompetente, të cilat kanë përgaditur ligjet e domosdoshme për implementimin e Ligjit për vetëqeverisje lokale.

Dedikueshmëria e përditshme për mbrojtje dhe zhvillim të vetëqeverisjes lokale, mbi parimet e demokracisë dhe decentralizimit, ka sjellur deri te **bashkëpunimi** i përditshëm dhe konstant me pushtetin qendror. Një intenzitet i tillë i **bashkëpunimit**, rezultoi me nënshkrimin e Memorandumit për **bashkëpunim** në mes Qeverisë dhe Bashkësisë së njërive të vetëqeverisjes lokale, me çka u bë rregullimi normativo-juridik i **bashkëpunimit** të tillë.

Përveç këtyre aktiviteteve, Bashkësia e njërive të vetëqeverisjes lokale në vitet e kaluara ka punuar edhe në shërbimet, të cilat duhet të ofrojë një asociacion bashkëkohor. Kështu u organizuan dy Panairë të komunave (në vitin 2001 dhe vitin 2003), ndërsa pothuajse 38% të administratës komunale është përfshirë me programet e trajnimit të Bashkësisë së njërive të vetëqeverisjes lokale.

Sipas statutit të aprovuar më 27 tetor të vitit 2004, organizimi i brendshëm i Bashkësisë së njërive të vetëqeverisjes lokale do të ndryshohet, me qëllim të efikasitetit më të madh në kryerjen e punës.



Dy kuvendet e deritanishme, ndërrohen me Kuvendin e përgjithshëm, si organ më i lartë i Bashkësisë së njësive të vetëqeverisjes lokale. Në këtë kuvend, çdo njësi e vetëqeverisjes lokale ka një votë. Kryetarët e njësive të vetëqeverisjes lokale janë edhe delegatë të Kuvendit të përgjithshëm, ndërsa kryetarët e këshillave janë zëvendës të tyre.

Komiteti i përhershëm do të transformohet në Këshill drejtues, që do të ketë 15 anëtarë, me çka shpresojmë se do të jetë trup shumë më fleksibil i Bashkësisë së njësive të vetëqeverisjes lokale.

Organi i tretë i Bashkësisë së njësive të vetëqeverisjes lokale është Këshilli mbikëqyrës, i cili është i përbërë prej 5 anëtarëve. Ky këshill në mënyrë të përgjithshme kontrollon ligjshmërinë dhe statutshmërinë e punës materialo-financiare të Bashkësisë së njësive të vetëqeverisjes lokale.

10.4. INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE TË PUSHTETEVE LOKALE

10.4.1. Këshilli i Evropës - Kongresi i pushteteve lokale dhe regjionale


Këshilli i Evropës është institucion ndërkombëtar i themeluar në vitin 1949 nga ana e dhjetë vendeve themeluese. **Këshilli i Evropës** sot numëron 45 vende - anëtare nga Evropa.

Republika e Maqedonisë është anëtarësuar në Këshillin e Evropës në vitin 1995 me çka një numër i madh i dokumenteve juridike të Këshillit të Evropës, janë pjesë përbërëse e Ligjvënies së Maqedonisë. Një dokument i tillë është edhe Konventa evropiane për vetëqeverisje lokale, që është ratifikuar në vitin 1997 nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

Selia e Këshillit të Evropës gjendet në qytetin e Strazburgut në Francë.

Qëllimet themelore, për arritjen e të cilëve është themeluar **Këshilli i Evropës** janë:

- Forcimi i demokracisë;
- Mbrotjtje e të drejtave të njeriut dhe sundimi i së drejtës dhe ligjeve;
- Ruajtja e trashigimisë dhe lloj-llojshmërisë kulturore evropiane;
- Paraqet forum permanent të respektimit dhe zgjidhjes së një rrethi të gjërë të problemeve sociale të shoqërisë dhe përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve të Evropës; për stabilitet demokratik në Evropë me përmbajtje të reformave politike, ligjore dhe konstitutive.



Organet e Këshillit të Evropës janë:

Kryetarë të komunave dhe këshilltarë të respektuar, shpresoj se, në përgjithësi, e kuptoni rrolin dhe misionin e Bashkësisë së njësive të vetëqeverisjes lokale, sepse ajo egziston vetëm për ju dhe për komunit tuaja, gjegjësisht Bashkësia e njësive të vetëqeverisjes lokale jeni vetë ju. Fuqia dhe pushteti i bashkësisë së njësive të vetëqeverisjes lokale rrjedh prej jush. Çfarë do të jetë ardhmëria e Bashkësisë së njësive të vetëqeverisjes lokale, varet nga ju dhe nga dedikueshmëria e juaj ndaj Bashkësisë së njësive të vetëqeverisjes lokale, si dhe tolerancës ndërmjet jush. Në bashkësinë e njësive të vetëqeverisjes lokale nuk egzistojnë interesa dhe qëndrime partiake por vetëm një interes dhe një qëndrim - interesi i përbashkët i njësive të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë.



Asembleja parlamentare është organ përfaqësues dhe ligjvënës, në të cilin anëtarësojnë deputetë nga parlamentet nacionale të vendeve - anëtare të Këshillit të Evropës. Numri i anëtarëve në Asemblenë parlamentare varet nga madhësia e vendit. Republika e Maqedonisë është e përfaqësuar me tre deputetë dhe tre zëvendës të tyre.

Komiteti i ministrave është organ i Këshillit të Evropës, i cili është i përbërë nga ministrat për punë të jashtme të vendeve-anëtare. Ky Komitet mbledhet, më së paku, dy herë në vit.

10.4.2. KONGRESI I PUSHTETEVE LOKALE DHE RAJONALE

Kongresi i pushteteve lokale dhe rajonale është organ konsultativ i Këshillit të Evropës i themeluar në vitin 1994. Ky organ përfaqëson pushtetet lokale të vendeve-anëtare, nëpërmjet personave të zgjedhur nga secili vend-anëtarë.

Njësoj si Asemblea parlamentare, edhe Kongresi është i përbërë nga delegacionet e secilit vend-anëtarë në Këshillin e Evropës. Delegacioni më i madh është i përbërë prej 18 anëtarëve dhe 18 zëvendësve, kurse delegacioni më i vogël prej 2 anëtarëve dhe 2 zëvendësve. Vëndi ynë është i përfaqësuar me delegacion prej 3 anëtarëve dhe 3 zëvendësve.

Përbërjen e delegacionit të Republikës së Maqedonisë në Kongresin e pushteteve lokale dhe rajonale në Këshillin e Evropës e përcakton Ministria për vetëqeverisje lokale, në propozim të Bashkësisë së njësive të vetëqeverisjes lokale, ndërsa informim formal për përbërjen e delegacionit bën Ministri për punë të jashtme, i cili informon sekretarin gjeneral të Këshillit të Evropës për përbërjen e delegacionit.

Gjatë formimit të delegacionit, Bashkësia e njësive të vetëqeverisjes lokale duhet të respektojë kriteriumet, si vijon:

- delegatët duhet të jenë nga komuna të ndryshme (të zhvilluara, më pak të zhvilluara dhe të pazhvilluara);
- më së paku një e katërta ndërsa më së tepërmi një e treta e delegatëve duhet me qenë përfaqësues të bashkësive etnike, të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë, ndërsa, sipas mundësive, gjysma e delegacionit duhet me qenë femra;
- në përbërje të delegacionit nuk munden me qenë dy përfaqësues nga e njëjta komunë, si dhe një komunë nuk mundet dy herë me rradhë të ketë përfaqësues në delegacion;
- duhet të njihet së paku njëra nga gjuhët e punës së Këshillit të Evropës (gjuha angleze dhe franceze);

Delegacioni ka edhe sekretarin e tij, i cili në të shumtën e rasteve është nga të punësuarit në Bashkësinë e njësive të vetëqeverisjes lokale.

Kongresi ka dy dhoma. Njëra dhomë është për pushtetet lokale, ndërsa dhoma tjetër është për pushtetet rajonale, me numër të përgjithshëm prej 313 anëtarëve dhe 313 zëvendës të anëtarëve.

Kongresi i pushteteve lokale dhe rajonale ka disa trupa:


- Byroja, e cila është e përbërë nga kryetarët dhe nënkryetarët e Dhomave dhe nga drejtori egzekutiv i Kongresit;
- Komiteti i përhershëm, i cili është i përbërë nga udhëheqësit e delegacioneve nacionale;
- egzistojnë edhe komitete konstante: Komiteti institucional, Komiteti për qëndrueshmëri dhe zhvillim, Komiteti për kulturë dhe arsim dhe Komiteti për kohezion social.

Sipas nevojës formohen edhe trupa punues të përkohshëm, siç është grupi punues ad-hok për Evropën juglindore, i cili e përcjell situatën e demokracisë lokale në këtë rajon të Evropës.

Funksionet themelore të Kongresit të pushteteve lokale dhe rajonale janë:



- shqyrtimi i të gjitha çështjeve të lidhura me situatën e pushteteve lokale dhe shkallën e decentralizimit të vendeve-anëtare dhe dhënie të ndihmës këshillëdhënëse të Komitetit të ministrave dhe Asemblesë parlamentare për çështje të lidhura me pushtetet lokale dhe rajonale;
- ofrim të mbikëqyrjes në lidhje me aplikimin e Konventës evropiane për vetëqeverisje lokale;
- përgatitje të dokumentave për gjendjen e demokracive lokale dhe rajonale në vendet-anëtare.



10.4.3. KËSHILLI I KOMUNAVE DHE RAJONEVE EVROPIANE (CEMP)

Këshilli i komunave dhe rajoneve evropiane (CEMP), me seli në Bruksel dhe Paris, është organizatë ndërkombëtare përfaqësuese e pushteteve lokale dhe rajonale të Evropës, e themeluar më vitin 1951, në të cilën anëtarësojnë asociacione nacionale të pushteteve lokale dhe rajonale nga Evropa.

Në fillim kjo organizatë quhej Këshill i komunave në Evropë por në vitin 1984 organizatës i bashkangjiten edhe Rajonet evropiane, me çka fiton emrin e tanishëm.

Që nga viti 1990 **CEMR** është pjesë përbërëse e Lidhjes ndërkombëtare të pushteteve lokale. Bashkësia e njësive të vetëqeverisjes lokale nga Republika e Maqedonisë është anëtare e plotë e **CEMR**, prej majit të vitit 2003. Në këtë organizatë, jemi të pranuar me emrin tonë kushtetues.

10.4.4. NALAS-RRJETA E ASOCIACIONEVE TË PUSHTETEVE LOKALE DHE NACIONALE TË EVROPËS JUGLINDORE

Iniciativa për themelimin e rrejtit të pushteteve lokale dhe rajonale të Evropës juglindore - **NALAS**, rrjedh prej mbajtjes së forumit të parë - "Forum i qyteteve dhe rajoneve të Evropës juglindore" në organizim të Kongresit të pushteteve lokale dhe rajonave të Evropës (Shkup, nëntor të vitit 2000), ku u potencua rëndësia e asocia-



cioneve të pushteteve lokale në procesin e zhvillimit të demokracisë lokale në Evropën juglindore, si faktor i stabilitetit në rajon.

Me aprovimin e Rezolutës 111 (2001), **Kongresi i pushteteve lokale dhe rajonale** të Evropës (CLRAE), e potencon nevojën e formimit të asociacioneve në Evropën juglindore, nëpërmjet procesit të krijimit të rrjetit të lidhshmërisë së përbashkët me qëllim, që ky asociacion në të ardhmen të rritet në union të asociacioneve.

Asociacionet nacionale fillojnë me punën e tyre intenzive të përbashkët në vitin 2001, duke këmbyer përvoja nga praktika e deritanishme dhe duke ekspozuar programet e tyre zhvillimore me ndihmë financiare dhe teknike nga ana e donatorëve të shumtë në suazat e aktiviteteve të Paktit për stabilitet të Evropës juglindore, deri në formimin e Rrjetit të asociacioneve nacionale të pushteteve lokale dhe rajonale të Evropës juglindore - **NALAS**.

NALAS-i është organizatë e pavarur në aspekt politik (nga qeveritë e vendeve amzë të asociacioneve anëtare; nga organizatatat ndërkombe-tare joqeveritare), multigjuhësore, multietnike, multikulturore, në lidhje të ngushtë me Kongresin e pushteteve lokale rajonale. NALAS-i promovon, inicon dhe përkrah proceset e decentralizimit të pushtetit, bashkëpunon me pushtetet qendrore dhe mundohet për shkallë sa më të lartë të autonomisë lokale, si qëllim themelor në procesin e tranzicionit të vendeve në Evropën juglindore. NALAS-i në të njëjtën kohë kontribon në stabilitetin dhe përmirësimin e standardit jetësor të qytetarëve të gjithë rajonit.

Përkrahje të madhe të aktiviteteve të **NALAS**-it, përveç prezencës dhe ndihmës së sinqertë nga ana e më shumë ekspertëve të Këshillit të Evropës, ka ofruar edhe Pakti për stabilitet të Evropës juglindore, nëpërmjet realizimit të numrit të madh të iniciativave për **bashkëpunim** të ndërsjellë ndërmjet asociacioneve të shteteve të rajonit.

NALAS është themeluar në bazë të vendimeve të sjellura nga ana e trupave drejtues të asociacioneve-anëtare, ndërsa me përkrahje të Këshillit të Evropës dhe me përkrahje teknike dhe financiare të Qeverisë së Zvicrës, FEDRE kurse në cilësi të përkrahjes financiare dhe teknike, janë prezent edhe donacionet e OSI-LGI.

Sekretariati i **NALAS**-it është i organizuar në bazë të rrotacionit në mes asociacioneve-anëtare të organizatës, me mandat prej një viti. Asociacioni, pas kandidaturës së paraqitur paraprakisht dhe të planit për aktivitete të lidhura me kryerjen e funksioneve të sekretariatit, me shumicë të votave të anëtarëve të Komitetit të nëpunësve për lidhje (Committee of liason officers), fiton mandatin me kohëzgjatje prej një viti.

Aktivitetet, të cilat janë të parapara me fitimin e mandatit për kryerjen e funksionit të sekretariatit të **NALAS**-it, nënkuptojnë: përcjellje aktive të të gjitha aktiviteteve të **NALAS**-it, përgaditje e mbledhjeve, procesverbaleve, informatave, internet faqes dhe përcjellje të të gjitha aktiviteteve të ardhshme, të cilat do të paraqiteshin si rezultat i zmadhimit të punës së organizatës.

Prej 7 prillit të vitit 2004, me vendim të Komitetit të nëpunësve për lidhje të **NALAS**-it, mandati me kohëzgjatje prej një viti për kryerje të funksionit të sekretariatit të **NALAS**-it, bartet mbi Bashkësinë e njërive të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Maqedonisë.

Fjalë kyqe: bashkëpunim, vëllazërim, evrorajone, BNJVL, Këshilli i Evropës, Kongresi i pushteteve lokale dhe rajonale, CEMR, NALAS.

Korniza juridike:

- Ligji për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 5/02);
- Konventa evropiane për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 23/97);
- Statuti i BNJVL (1999);
- Statuti i BNJVL (2004).



11 KOMUNAT DHE UNIONI EVROPIAN

Prof. Dr. Ilija Todorovski

Maqedonia është në rrugë drejt Unionit Evropian, ndërsa ndikimi i këtij procesi në komunat pritet të shqyrtohet në vazhdim.

11.1. UNIONI EVROPIAN SI BASHKËSI E SHTETEVE

Unioni evropian është bashkësi mbinacionale, e krijuar si rezultat i procesit të bashkëpunimit dhe integritit të më tepër shteteve evropiane. Këtij bashkëpunimi i paraprinte Bashkësia evropiane për qymyr dhe çelik nga viti 1950, e bazuar në planin e ministrit francez, Robert Shuman, për krijimin e marrëveshjes ndërmjet Francës dhe Gjermanisë për prodhim dhe distribuim të qymyrit dhe çelikut. Kësaj marrëveshje menjëherë ju bashkangjitën Belgjika, Italia, Holanda dhe Luksemburgu. Gjatë ekzistencës së saj 50-vjeçare, **Unioni evropian** kishte disa zgjerime, kështu që ai sot numëron 25 shtete-anëtare. Vetë nocioni "**Unioni evropian**" është paraqitur në vitin 1993 me Marrëveshjen e Mastrohtit.

Bashkësia e shteteve-anëtare bazohet në tre shtylla: Shtyllën e parë e përbën Bashkësia ekonomike evropiane dhe Bashkësia evropiane për energji atomike, i cili u thellua dhe u përhap me unionin ekonomik dhe monetar. Shtylla e dytë përfshin politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë. Shtylla e tretë përfshin bashkëpunimin në lëminë e gjyqtarisë dhe punëve të brendshme.

11.2. PËRFITIMET PËR REPUBLIKËN E MAQEDONISË NGA INTEGRIMI NË UE

Tendenca e integritit të shteteve më pak të zhvilluara të Evropës centrale dhe juglindore në UE është e bazuar në interesin e përbashkët. Shtetet perëndimore, që tanimë një kohë të gjatë janë të integruar në UE, kanë interes të fitojnë treg më të madh të përbashkët, Evropë më të sigurtë dhe qarkullim të papenguar të mallërave dhe shërbimeve, si dhe lëvizje të papenguar të personave në territor sa më të madh. Motivi për integrim i vendeve më pak të zhvilluara, ku bën pjesë edhe Republika e Maqedonisë është në masë shumë më të madhe i rëndësishëm. Përfitimet në këtë rast, do të ishin si në vijim: vendosjen e normativës evropiane në ligjëdhënien e vendit, që paraqet rregullim të marrëdhënieve në mënyrë të provuar dhe kualitative; mundësi për shfrytëzim më të madh të arritjeve të shteteve të zhvilluara të Evropës në lëminë e shkencës, zhvillimit teknologjik dhe lëmitë tjera shoqërore; treg i hapur dhe i përbashkët me konkurrencë të lirë; mundësi për shfrytëzimin e **fondeve** evropiane, që do të shpejtonin zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin e përgjithshëm shoqëror



të Republikës së Maqedonisë; politikë të përbashkët të punëve të jashtme dhe të sigurisë; sistem gjyqësor të përbashkët, që gjykon sipas dispozitave të përbashkëta evropiane dhe, më në fund, mundësi për zgjedhje të vendit për banim në cilindo shtet evropian.

11.3. INSTITUCIONE DHE ORGANE TË UNIONIT EVROPIAN

11.3.1. Parlamenti evropian

Parlamenti evropian është trup ligjvënës i Unionit evropian. Fillimet e tij mund të gjenden në marrëveshjet e shteteve evropiane në vitin 1950. Por nga viti 1979 deputetët e parlamentit evropian zgjidhen në votime të drejtë për drejta nga ana e qytetarëve të vendeve-anëtare të UE, në çdo 5 vjet. D.m.th. Parlamenti evropian e prezenton vullnetin demokratik të popullit. Numri i përgjithshëm i deputetëve në këtë moment është 732, që rrjedhin nga 25 vende-anëtarë të Unionit evropian. Gjatë kësaj, çdo shtet ka të drejtë të zgjedh deputetë, varësisht nga madhësia. Kështu, shtetet më të vogla me rreth 2 milionë banorë, si Qiproja, Malta dhe Sllovenija delegojnë 6-7 deputetë; shtetet më të mëdha si Mbretëria e bashkuar e Britanisë së madhe dhe Irlandës veriore, Franca dhe Italia, që kanë nga 60 milionë banorë delegojnë 78 deputetë, ndërsa shteti më i madh - Gjermania, që ka rreth 80 milionë banorë delegon 99 deputetë.

Selia e Parlamentit evropian është në Strazburg, Francë por ai mban sesione dhe në Belgjikë dhe Luksemburg.

Tash, çështja më e rëndësishme është çka bën ai ose cilat janë kompetencat e tij.

Parlamenti evropian ka tre rrole kryesore:

Së pari, ai ka kompetencë ligjvënëse ose të drejtë të sjell aktet më të rëndësishme të Unionit evropian. Por Parlamenti evropian **kompetencën ligjvënëse** e kryen së bashku me një trup tjetër të Unionit evropian-ky është Këshilli evropian, për të cilin do të tregojmë diçka më vonë.

Parlamenti evropian ka edhe funksionin buxhetor dhe funksionin mbikëqyrës.

11.3.2. Këshilli i Unionit evropian

Në suazat e Këshillit të Unionit evropian, takohen ministrat e vendeve anëtare. Secili vend është i përfaqësuar prej ministrit, i cili është përgjegjës për çështjen, që është në rend të ditës të Këshillit (punë të jashtme, financa, çështje sociale, transport, bujqësi, etj). Këshilli mblidhet në 9 trupa (konfiguracione), ndërsa secili vend-anëtarë udhëheq më këshillin për gjashtë muaj, në bazë të rotacionit.

Në suazat e Këshillit të Unionit evropian në çdo gjashtë muaj mbahet Samiti i shefave të shteteve dhe qeverive (kryetarë të shteteve, kryeministra). Në Samitin, burrështetasit më të lartë marrin qëndrime në aspekt të çështjeve konkrete, të cilat më tutje, Këshilli i ministrave i operacionalizon.

Këshilli i Unionit evropian ka gjashtë kompetenca:

1. Sjelljen e ligjeve evropiane. Në shumë lëmi, ai e ndan këtë kompetencë me Parlamentin evropian;
2. Koordinimin e politikave ekonomike të vendeve-anëtare;
3. Arritjen e marrëveshjeve ndërkombëtare në mes Unionit evropian me shtete të ndryshme ose organizata ndërkombëtare;
4. Aproximin e buxhetit të Unionit evropian, së bashku me Parlamentin evropian;
5. Zhvillimin e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurise të vendeve-anëtare të Unionit evropian, në bazë të udhëzimeve të Këshillit evropian;
6. Koordinimin e bashkëpunimit në mes gjyqeve nacionale dhe forcave policore në lidhje me çështjet e kriminalitetit.



11.3.3. Komisioni evropian

Komisioni është institucion i pavarur politik, i cili përfaqëson interesat e Unionit evropian, si tërësi. Ai numëron 25 anëtarë dhe është forca shtytëse në suazat e sistemit institucional të Unionit evropian. Ai propozon **legjislacionin**, politikën dhe programe aksionale dhe është përgjegjës për kryerjen e vendimeve të Parlamentit dhe Këshillit.

Komisioni evropian ka katër kompetenca:

1. Ju propozon **legjislacion** Parlamentit dhe Këshillit;
2. Udhëheq dhe egzekuton politikat dhe buxhetin e UE-së;
3. Realizon të drejtën evropiane (së bashku me Gjyqin e drejtësisë);
4. Përfaqëson Unionin Evropian në skenën ndërkombëtare (psh. Nëpërmjet negociatave për arritje të marrëveshjeve në mes Unionit evropian dhe vendeve tjera).

Në këtë kontekst, me rëndësi është të na lemi në iniciativën ligjore, gjegjësisht të shikojmë se në çfarë mase ajo rrjedh nga organet e unionit evropian, e në çfarë mase nga organet nacionale të vendeve - anëtare.

Propozimi (projekti) i akteve ligjore evropiane mund të rrjedh nga Komisioni; mund të paraqitet si iniciativë e një grupi të vendeve-anëtare; iniciativë e Parlamentit Evropian; kërkesë e Gjyqit të drejtësisë; rekomandim i Bankës Qendrore Evropiane, si dhe kërkesë e Bankës Evropiane Investuese.

Këto propozime (projekte) ju dorëzohen parlamenteve nacionale, nëpërmjet ndonjërit nga organet e Unionit evropian (Këshillit, Parlamentit, Komisionit).

Parlamentet nacionale, mund t'ju dërgojnë kryetarëve të Këshillit evropian, Parlamentit ose Komisionit mendim të arsyetuar nëse propozimet (projektet) e akteve ligjore janë në pajtim me parimin e subsidiaritetit; në pajtim me procedurat e përmbajtura në këtë Protokol për aplikimin e parimeve të subsidiaritetit dhe proporcionalitetit.

Organe tjera të Unionit evropian janë:

1. **Gjyqi i drejtësisë:** ky gjyq duhet të sigurojë, **legjislacioni** i UE-së (i njohur teknikisht si " e drejtë e unionit") të interpretohet dhe aplikohet në mënyrë të njëjtë në secilin vend - anëtarë të UE.

2. **Banka qendrore evropiane:** Banka qendrore evropiane (BEQ) që themeluar në vitin 1998 me Marrëveshjen për Unionin evropian, me qëllim të parqitjes dhe udhëheqjes me valutën e re (euro), të bëjë transaksionet e këmbimit devizor me vendet e huaja dhe të sigurojë veprim të pa penguar të sistemeve pagesore. BQE, poashtu, është përgjegjëse për koncipim dhe ekzekutim të politikës ekonomike dhe monetare.

3. **Banka investuese evropiane:** Banka investuese evropiane (BIE) që themeluar në vitin 1958. Ajo ndihmon në realizimin e qëllimeve të Unionit, nëpërmjet financimit të llojeve të ndryshme të projekteve investuese.

4. **Ombudsmeni (avokati popullor):** Avokati popullor vepron si ndërmjetësues në mes qytetarëve dhe pushtetit të UE. Ai është i autorizuar të pranojë dhe hulumtojë ankesa prej qytetarëve, subjekteve afariste dhe **institucioneve** të UE, si dhe nga çdo subjekt tjetër, i cili gjendet ose ka qëndrim juridik në ndonjë nga vendet e UE.

Institucioni i fundit, i cili duhet të përmendet ndaras nga **institucionet** tjera, meqë është i rëndësishëm për vetëqeverisjen lokale është **Komiteti i regjioneve (KOR)**. Ky komitet që formuar me Marrëveshjen e Mاستrihtit, si trup i pavarur këshillëdhënës dhe qëllimi kryesor i tij është mbrojtja e interesave të trupave rajonale dhe lokale të qytetarëve të UE në proceset e marrjes së vendimeve në Union. Njëri ndër qëllimet kryesore të KOR është forcimi i kohezionit social dhe ekonomik të vendeve - anëtare të UE-së dhe të veprjës si roje e parimit të subsidiaritetit. Detyrat kryesore të KOR janë:

- Të prezentojë qëndrimet lokale dhe rajonale para **institucioneve** të UE-së, gjatë përpilimit të propozimeve dhe udhëheqjes së politikave;
- Të informojë qytetarët për politikën, që sillen dhe aplikohen nga ana e UE-së.



Nga ajo, që u tha më lartë mund të hetohet se, në nivel të Unionit evropian egziston një strukturë e zhvilluar e organeve dhe trupave, e cila, në masë të madhe, të përkujton organet dhe trupat e një shteti të zhvilluar parlamentar. Këto organe dhe trupa veprojnë si organe të pavarura në kryerjen e funksioneve të tyre ligjëvendëse, egzekutive dhe gjyqtare. Gatë kësaj, ato janë të ndihmuar nga **institucione** të shumta financiare.

11.4. LEGJISLACIONI I UNIONIT EVROPIAN

Legjislacioni ndahet në **legjislacion** primar dhe sekondar. Legjislacioni primar përfshin kontratat dhe marrëveshjet tjera, që kanë status të njëjtë. Ai krijohet nëpërmjet negociatave direkte në mes qeverive të vendeve. Këto marrëveshje, më tutje, janë objekt i ratifikimit nga ana e parlamenteve nacionale. Legjislacioni sekondar është i bazuar në marrëveshjet dhe nënkupton shumë të procedurave, të cilat janë të definuara në dispozita të ndryshme.

11.5. POLITIKAT E UNIONIT EVROPIAN ME RËNDËSI PËR VETËQEVERISJEN LOKALE NË RM

Në suazat e marrëveshjeve, që e themelojnë Unionin evropian, e drejta e Unionit mund të haset në format, si vijon:

a) Rregullativa, të cilat janë direkt ta aplikueshme dhe të obliguara për të gjitha vendet - anëtare të UE-së, pa nevojë për legjislacion implementues nacional;

b) Direktiva, të cilat i obligojnë vendet - anëtare të UE-së, qëllimet që dalin prej tyre, të arrihen për një periudhë kohore të caktuar. Pushteteve nacionale ju jepet e drejta e zgjedhjes së formës dhe mjeteve, nëpërmjet të cilëve do të aplikoheshin. Direktivat duhet të aplikohen në legjislacionin nacional, në pajtim me procedurat e secilit vend, veç e veç.

c) Vendime, të cilat janë obliguese në të gjitha aspektet e tyre për ata, për të cilët janë sjellur.

Vendimet nuk kërkojnë legjislacion nacional, implementues. Një vendim ka fuqi për secilin vend - anëtar të UE-së, ndërmarrje ose përsëritje të veçantë.

c) Rekomandime dhe mendime, të cilat nuk janë të obligueshme.

Unioni evropian arrin qëllimet e tij nëpërmjet udhëheqjes së politikës në lëmi të ndryshme, për realizimin e të cilave siguron edhe **fonde** të përshtatshme. Politika më e rëndësishme e saj është politika regjionale, e drejtuar kah zvogëlimi i ndryshimeve regjionale (disparitetet). Por, gjithashtu, e rëndësishme është edhe politika e përgjithshme bujqësore, politikat për zhvillimin e transportit, telekomunikacioni dhe energjisë, politika hulumtuese dhe zhvilluese, politika e shoqërisë informatike, politika e konkurrencës, etj. Megjithatë, për komunat e Maqedonisë, duke pasur parasysh kompetencat e reja, politikat më të rëndësishme do të ishin ato, për të cilat **Unioni evropian** jep ndihmë financiare dhe ekspertizë:

1. **Politika e zhvillimit ekonomik dhe social**, e cila është e drejtuar kah përmirësimi i nivelit të kualifikimit të sektorit afarist (biznesit), prodhimit të ushqimit, zhvillimin e ekonomisë së vogël etj;

2. **Politika e mbrojtjes së ambientit jetësor**, që është e drejtuar drejt përmirësimit të udhëheqjes me hedhurina, ngritjen e kualitetit të ajrit dhe ujit, mbrojtje nga ndotja e të gjitha segmenteve të ambientit jetësorë - ujit, trualli dhe ajrit;

3. **Politika e bashkëpunimit ndërkufitar**, që mund të realizohet në shumë lëmi siç janë veprimtaritë komunale, ekonomia, mbrojtja e ambientit jetësor, etj.

11. 6. FONDET QË JANË NË DISPONIM PËR VENDET - ANËTARE TË UNIONIT EVROPIAN

Anëtarët më të zhvilluara të Unionit evropian, kanë kuptuar së Unioni nuk do të mund të funksionojë në mënyrë efektive, nëse ka shkallë të lartë të diversitetit. Për këtë zhvillimi i vendeve - anëtare më të varfëra, nga njëra anë dhe anëtarësimin e vendeve tjera, nga ana tjetër, e lehtëson me anë të ndarjes së ndihmave të ndryshme financiare. Në këtë mënyrë **Unioni evropian** zvogëlon ndryshimet ose disparitetet, që egzistojnë në aspekt të bruto prodhimit të vendit dhe nivelit të punësimit edhe në mes vetë vendeve - anëtare të UE-së, edhe në mes rajoneve të ndryshme në suaza të një shteti. Për këtë qëllim, Unioni Evropian, nëpërmjet **fondeve** të ndryshme në periudhën mes viteve 2000-2006 ka shpërndarë 216 miliardë euro nëpër 15 vende-anëtare dhe 22 miliardë euro vendeve-kandidatë për anëtarësim, në periudhën para anëtarësisë së tyre të plotë. Ndërsa janë

të dedikuara edhe 22 miliardë euro për përshtatjen e tyre në periudhën prej vitit 2004 deri në vitin 2006. D.m.th për këtë qëllime, Unioni evropian në periudhën prej vitit 2000-2006, ka ndarë 257 miliardë euro, që është 37% nga buxheti i tij. Ndarja e mjeteve bëhet nëpërmjet më tepër **fondeve**, nga të cilët më të rëndësishëm janë:



Fondi koheziv. Fondi kohëziv shërben për të forcuar kohezionin social dhe ekonomik në suazat e Unionit evropian. Për të fituar këtë fond, bruto prodhimi nacional i vendit duhet me qenë nën 90% nga ai mesatar i Unionit evropian. Në dhjetëvjetëshin e fundit, këtë fond e kanë shfrytëzuar: Spanja, Portugalia dhe Republika e Irlandës (deri në vitin 2003), ndërsa pas pranimit të dhjetë vendeve në vitin 2004 (Sllovenia, Hungaria Polonia, etj), të gjithë iu bashkangjitën grupit të mëparshëm prej tre vendeve në shfrytëzimin e mjeteve nga ky fond. Sot, 13 vende janë shfrytëzues të tij. Mjeteve të këtij fondi, ju shtohen edhe mjetet nacionale të vendit-anëtarë. D.m.th ky është fond i ko-financuar, që shërben për disa qëllime:

- ambient jetësor;
- rrjete transportuese trans-evropiane;
- harmonizimin e **legjisllacionit** nacional me legjisllacionin e Unionit evropian në lëmitë e lartë përmendura.

Fonde strukturale. Egzistojnë katër **fonde** strukturale dhe secili nga ato mbulon lëmi të veçantë nga zhvillimi i përgjithshëm shoqëror.

- **Fondi rajonal evropian i zhvillimit;**
- **Fondi social evropian;**
- **Instrumenti financiar për udhëheqje me peshkimin;**
- **Fondi evropian për udhëheqje dhe garantim të zhvillimit bujqësor.**

Fondi rajonal evropian i zhvillimit siguron mjete për:

- infrastrukturë;
- hapje të vendeve të reja të punës;
- zhvillim lokal;
- ndihmë për ndërmarrje të vogla.

Fondi evropian social siguron mjete për kthimin e grupeve të papunësuarve dhe të paprivileguara në vendet e tyre të punës, nëpërmjet:

- trajnimit;
- sistemeve të punësimit.

Instrumenti financiar për udhëheqje me peshkimin është fond, i cili siguron mjete për adaptimin dhe modernizimin e industrisë së peshkimit.

Fondi evropian për udhëheqjen dhe garantimin e zhvillimit të bujqësisë financon:

- masa për zhvillim rural;
- ndihmë për fermerët, kryesisht në rajonet më pak të zhvilluara.

11.7. RRUGA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË DERI TE ANËTARËSIA NË UNIONIN EVROPIAN

11.7.1. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOHEN

Në mbledhjen e Këshillit të Evropës në Kopenhagë në vitin 1993, përfaqësues të dalluar të vendeve-anëtare të Unionit evropian, u pajtuan të pranojnë në anëtarësi të Unionit evropian shtetet e Evropës qendrore dhe lindore, që do të shfaqin dëshirë për anëtarësim nën supozim se do të plotësojnë kriteriumet e ardhshme ekonomike dhe politike: (1) egzistim i stabilitetit të **institucioneve**, respektim i të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve;



(2) egzistim i ekonomisë së tregut të lirë; (3) aftësi e ndërmarrjeve (të vendeve-anëtare të ardhshme) të përballojnë shtypjen e tregut të subjekteve të Unionit evropian dhe (4) aftësi të marrjes mbi vete të obligimeve, që rrjedhin nga anëtarësia, duke përfshirë realizimin e qëllimeve të unionit politik, ekonomik dhe monetar. Këto kriteriume janë të njohura si kriteriumet e Kopenhagës.

D.m.th. vendet e Evropës qendrore dhe juglindore, me përjashtim të shteteve të Ballkanit perëndimorë (Kroacia, Serbia dhe Mali i zi, Bosnja dhe Hercegovina, Shqipëria dhe Maqedonia), nënshkruajnë marrëveshje për asocim ose marrëveshje evropiane për hyrje në Unionin evropian. Shtetet e Ballkanit perëndimor nënshkruajnë marrëveshje për stabilizim dhe asocim. Çfarë është dallimi? Për shtetet e para kërkohet të plotësojnë kriteriumet e Kopenhagës, ndërsa për grupin e dytë të shteteve, gjegjësisht për shtetet e Ballkanit perëndimor, kërkohet plotësim i kriteriumeve plotësuese. Motivi për plotësimin e kriteriumeve plotësuese, rrjedh nga tensionet dhe konfliktet luftarake, që u paraqitën në këtë rajon, kështu që nga ato kërkohet të manifestohet përgaditshmëri dhe të realizojnë bashkëpunim rajonal dhe stabilizim paqësor dhe politik. Gjatë kësaj politike që realizohet nga ana e Unionit evropian në këtë aspekt është, psh Republika e Maqedonisë të bëjë realizimin në praktikë të dispozitave të Marrëveshjes së Ohrit; Republika e Kroacisë të bashkëpunojë me Gjykatën e Hagës dhe të krijojë kushte për kthimin e serbëve etj.

Në përgjithësi, këto kriteriume për vendet e Ballkanit perëndimor janë të përmbajtura në Paktin e stabilitetit. Nga ato, më të rëndësishëm janë:

1. Vendet e Evropës juglindore . . . në suazat e bashkësisë ndërkombëtare, duhet të zhvillojnë strategji të përbashkët për stabilitet dhe rritje të rajonit dhe të bashkëpunojnë ndërmjet tyre. . . për të eliminuar mungesat dhe çështjet kontestuale.
2. Të orvaten për paqe të përhershme, prosperitet dhe stabilitet të Evropës juglindore.
3. Të vazhdojnë reformat demokratike dhe ekonomike.
4. Të pengojnë dhe përfundojnë tensionet dhe krizat, si parakusht për stabilitet të përhershëm.
5. Të fillojnë procese të pjekura demokratike, të bazuara në zgjedhje të lira dhe të drejta dhe sundimit të së drejtës, respektimin e të drejtave të minoriteve nacionale dhe medimeve të pavarura, gjyqje të pavarura . . .
6. Të luftojnë kundër kriminalitetit të organizuar, korrupsionit, terrorizmit . . .
7. Të pengojnë zhvendosjen me forcë të popullatës, si dhe emigrimin e shkaktuar nga varfëria.
8. Të sigurojnë kthim të refugjatëve dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre, etj.

11.8. FAZAT NË PROCESIN E ANËTARËSIMIT NË UNIONIN EVROPIAN

Faza e parë e anëtarësisë së një shteti në Unionin evropian, fillon me kërkesën e tij për anëtarësim. Këshilli i Unionit evropian, vendos njëzërit për fillimin e negociatave. Por rol kryesor luan Komisioni për anëtarësi, i cili realisht udhëheq negociatat. Negociatat kanë të bëjnë më çështje të rëndësishme. Shteti, i cili kërkon anëtarësim në Unionin evropian, obligohet se do të përshtat zhvillimin në drejtim të kërkesave, që dalin nga pozicioni i Unionit evropian. Në disa lëmi negociatat janë relativisht të thjeshta (psh. arsim dhe turizëm), por në disa lëmi janë më të ndërlikuara dhe më të gjata (tregu i brendshëm, politika e përbashkët bujqësore, politika e brendshme dhe juridike). Pas kësaj vjen arritja e marrëveshjes për asocim në mes vendeve-anëtar të Unionit evropian dhe vendeve-kandidat për anëtarësi.

Faza e dytë paraqet rezultat i mbarimit të suksesshëm të fazës së parë, gjegjësisht plotësimin të një pjese të kushteve të shtetit, i cili kërkon anëtarësim në UE. Në fazën e dytë shteti, i cili kërkon anëtarësim në UE, fiton statusin e kandidatit. Ky vendim në një pjesë është vendim diskrecion i trupave të Unionit evropian, sepse nuk egzistojnë kriteriume egzakta, që do të vlerësojnë përparimin e arritur të shtetit, i cili kërkon anëtarësi në UE. Edhe në fazën e dytë, shteti plotëson kushtet, që kanë qenë objekt i negociatave por ai tash më ka status më të sigurt dhe **fonde** më të mëdha në disponim për përshtatje strukturore të tij. Kjo fazë mbaron me anëtarësim të plotë të shtetit në fjalë në Unionin evropian.

Republika e Maqedonisë është në fazën e parë të këtij procesi, në të cilën, ajo, përveç kërkesave standarde, të cilat duhet të plotësohen para anëtarësimin në Unionin evropian, duhet të stabilizohet në aspekt të sigurisë dhe të bashkëpunojë me vendet e rajonit.



Në aspekt të kërkesave, Republika e Maqedonisë do të duhet plotësisht të merr **legjislacionin** e Unionit evropian (acquis communautaire). Këtu bëjnë pjesë të gjitha marrëveshjet e rëndësishme dhe tërë rregullativa juridike e Unionin evropian në fuqi. Gjatë kësaj, egzistojnë dy procedura për marrjen e aki në **legjislacionin** nacional: afrim dhe harmonizimi.

Aproksimacioni (afrimi) d.m.th. integrim i drejtë për drejt i **legjislacionit** të Unionin evropian në **legjislacionin** e Maqedonisë. Shembull për këtë është Direktiva e Këshillit të UE-së 92/43/1992 për ruajtjen e habitatit natyrorë dhe ruajtjen e faunës dhe florës së egër, ku janë të definuar nocionet e ruajtjes, habitate etj., të cilët me definicion të njëjtë futen në Ligjin për ruajtje të natyrës, në Maqedoni.

Harmonizimi (përshtatje) paraqet vendosje të qëllimeve ose standardeve minimale nga ana e UE-së, të cilat **legjislacioni** nacional i Republikës së Maqedonisë do të duhej t'i përpunojë. Shembull është Direktiva e Këshillit të UE-së për standarde minimale për përcaktimin e statusit të refugjatit, në të cilën UE-ja kërkon, që personat e hendikepuar të kenë mbrojtje të përshtatshme por lejton, që Republika e Maqedonisë të përpunojë këtë çështje në rregullativën e saj.

Megjithate, duhet të përmendet se marrëdhëniet e saja me Unionin evropian kanë histori më të gjatë, me paraqitje kronologjike, si vijon:

1992: Republika e Maqedonisë vendosi përfaqësues të saj në Bruksel;

1995: Republika e Maqedonisë vendosi marrëdhënie diplomatike me UE-në;

1996: Republika e Maqedonisë u bë anëtare e barabartë e PHARE programit, me çka u hap mundësia për shfrytëzim të ndihmës për realizimin e ndryshimeve strukturore dhe shpejtimin e reformave;

1999: Republika e Maqedonisë paraqet kërkesë oficiale për anëtarësi asociative në UE-në;

2000: Republika e Maqedonisë fiton mandat nga ana e këshillit të Unionit evropian, Komisioni evropian të fillojë negociata për arritjen e Marrëveshjes për stabilizim dhe asocim;

2001: Nënshkruan marrëveshjen për stabilizim dhe asocim;

2004: Mbaron procesin e ratifikimit të Marrëveshjes për stabilizim dhe asocim;

2004: Parashtron kërkesë për anëtarësim në Unionin evropian.

11.9. FONDET QË JANË NË DISPONIM PËR SHTETET NË FAZA TË NDRYSHME TË RRUGËS SË TYRE DREJT ANËTARËSISË NË UNIONIN EVROPIAN

11.9.1. Faza e stabilizimit dhe asocimit

CARDS. Ky është akronim ose shkurticë për Community Assistance for Reconstruction, Development and Stabilisation (ose në shqip: Ndihmë e Bashkësisë për rekonstruim, zhvillim dhe stabilizim).

Qëllimi i përgjithshëm i CARDS-it është të ofrojë ndihmë Shqipërisë, Bosnjes dhe Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë dhe Serbisë dhe Malit të zi në procesin e stabilizimit dhe asocimit. Buxheti i CARDS programit në periudhën prej vitit 2000-2006 është 4.65 miliardë euro. Mjetet janë të drejtuara drejt sektorëve, si vijon:

- **Drejtësi dhe punë të brendshme;**
- **Ndërtimi i kapacitetit administrativ;**
- **Zhvillim ekonomik dhe social;**
- **Stabilizim demokratik**
- **Ambeinti jetësor dhe resurse natyrore**



CARDS në Republikën e Maqedonisë

Mjetet e dhëna Republikës së Maqedonisë nga CARDS programi në periudhën prej vitit 2002-2004 (mil. euro)

Sektori	2002	2003	2004	Gjithsejt
Drejtësi dhe punë të brendshme	7.0	12.5	17.0	36.5
Ndërtimi i kapacitetit administrativ	14.0	9.0	8.5	31.5
Zhvillimi ekonomik dhe social	11.5	11.0	14.0	36.5
Ambienti jetësor dhe resurse natyrore	-	1.0	2.0	3.0
Stabilizimi demokratik	3.0	3.0	3.0	9.0
Të tjera	6.0	7.0	6.5	19.5
Mjete gjithsejt të ndara	41.5	43.5	51.0	136.0

Për çfarë projekte konkrete kanë qenë të dedikuara mjetet nga programi CARDS?

Në lëminë e **drejtësisë dhe punëve të brendshme** mjetet kanë qenë të dedikuara për reformën e policisë, nëpërmjet riorganizimit të Ministrisë për punë të brendshme, themelimin e akademisë policore dhe përforcimin e luftës kundër kriminalitetit. Me këto mjete janë realizuar edhe trajnime në gjyqet kurse janë dedikuar mjete edhe për formim të sistemit të integruar informatik në gjyqet. Është formuar edhe policia speciale kufitare, e aftësuar të përballojë kontrabandistët, emigrimin e paligjshëm etj.

Në lëminë e **ndërtimit të kapacitetit administrativ** janë investuar mjete për trajnim të vetëqeverisjel lokale.

Në lëminë e **zhvillimit ekonomik dhe social** janë investuar mjete për ngritjen e kualitetit të drejtuesve afaristë; janë siguruar edhe mikro-kredi për ndërmarrjet e vogla. Shembull i investimit të mjeteve në ndihmën sociale është projekti, me të cilin 20 nënave nga Shkupi ju është dhënë detyra të kujdesen për 100 persona të moshuar.

Në lëminë e **ambientit jetësor** janë siguruar mjete për bashkëpunim ndërkufitar i dedikuar për udhëheqje dhe mbrojtje të resurseve të përbashkëta ujore me Greqinë. Janë siguruar mjete për Ministrinë e ambientit jetësor dhe planifikimit hapësinor të përparon ligjet; të sigurojë pajisje për përmirësimin e kualitetit të ujit, ajrit etj.

Në lëminë e **stabilizimit demokratik**, janë siguruar mjete për kampanja informative për tolerancë, aktivitete jashtë shkollës për grupet e nxënësve të përzier etnikisht etj.

TEMPUS

Ky është program trans-evropian dhe është në lëminë e arsimit të lartë. Me mjete të kombinuara nga ky program dhe nga PHARE programi është bërë përpilimi i programit arsimor dhe elaborat për themelimin e Studimeve inter-disciplinore (Fakultet) për administratë publike në Manastir, i pajisur me mjete dhe literaturë adekuate.

11.9.2. Faza para hyrjes në UE

Deri në vitin 2004 ndihma ju është ndarë 10 shteteve në procesin e tyre për arritjen e anëtarësisë së plotë në Unionin evropian (Sllovenia, Sllovakia, Hungaria, Polonia, Qiproja etj.), ndërsa në moment ndihma është duke ju dhënë dy kandidatëve të mbetur për anëtarësi- Bugarisë dhe Rumunisë.

Për këtë fazë dedikohen tre **fonde**:

PHARE

Ky fond është i dedikuar për përforcimin e **institucioneve** në shtetet e lartëpërmendura, me qëllim të përpilimit të rregullativës së harmonizuar me rregullativën e Unionit evropian, si dhe investime në lëmi tjera të ndryshme - infrastrukturë, ndërmarrje, masa sociale, si dhe bashkëpunim ndërkufitarë.



SAPARD

Ky fond është i dedikuar për zhvillimin e bujqësisë dhe vendeve rurale, për mbrojtje të ambientit jetësor dhe të ngajshme.

ISPA

Ky fond është i dedikuar për financimin e projekteve të rëndësishme në lëminë e mbrojtjes së ambientit jetësor dhe rrjeteve transportuese trans-evropiane.

11.10 QASJE PËRFUNDIMTARE

Siç mund të shihet nga paraqitja e **institucioneve** të Unionit evropian, ai është bashkësi mbinacionale fortë e integruar dhe mirë e strukturuar. Integrimi i tij rrjedh nga fakti se shtetet-anëtare të Unionit evropian kanë shumë interesa të përbashkëta-ekonomike, sociale etj, dhe ruajtja dhe zhvillimi i tyre realizohet nëpërmjet një strukture të degëzuar, që plotësisht është e ngajshme me **institucionet** nacionale, që kryejnë funksione ligjëvënëse, egzekutive dhe gjyqësore por edhe nëpërmjet sistemit të degëzuar juridik, që rregullon shumë lëmi. Në funksionimin e Unionit Evropian parimi dominant është parimi i bashkëpunimit dhe solidaritetit, realizimi i të cilit bëhet nëpërmjet **fondeve** të shumta të dedikuara, para se gjithash, për shtetet dhe rajonet më pak të zhvilluara.


Në këtë kontekst, duke i njohur prioritetet zhvilluese të Unionit evropian, njëri nga të cilët është edhe zhvillimi i vetëqeverisjes lokale dhe **fondet** e Unionit evropian, që janë në disponim për komunat por edhe për qytetarët, organizatat joqeveritare dhe subjektet afariste, si dhe mundësinë e shfrytëzimit të diturisë evropiane, përvojës dhe vullnetit të mirë për bashkëpunim, komunat në Republikën e Maqedonisë, do të mund të vërejnë dhe shfrytëzojnë mundësitë për intensifikim të zhvillimit të tyre, që i ofron **Unioni evropian**.

Fjali kyçe: Unioni evropian, institucione, legjislacion, fonde.

Korrniza ligjore:

- Akti për Evropë unike, i nënshkruar në Luksemburg më 17 shkurt të vitit 1986 dhe në Hagë më 28 shkurt të vitit 1986;
- Marrëveshja e Grenlandës (1984);
- Marrëveshja e Amsterdimit;
- Marrëveshja e Nicës, e publikuar në Official Journal C 80 of 10.03.2001 (2001/C);
- Marrëveshja e Parisit për themelimin e Bashkësisë evropiane për çelik dhe qymyr (1951);
- Marrëveshje, me të cilën formohet këshilli unik dhe komisioni unik i Bashkësive evropiane, e nënshkruar në Bruksel më 8 prill të vitit 1965;
- Bashkësia ekonomike evropiane u rrit në bashkësi evropiane me sjelljen e Marrëveshjes për formimin e bashkësisë evropiane të sjellur në të njëjtën kohë me Marrëveshjen për Union evropian në Mاستriht në vitin 1992 dhe të publikuar në të njëjtën gazetë zyrtare (92/C 224/01);
- Akti final dhe deklaratat u aprovuan në Konferencat ndër-qeveritare në Mاستriht në 7 shkurt të vitit 1992 të publikuara në Official Journal of the European Communities, C 224 / 31.08.1992 (Volume 35) (92/C 224/01); Tekstet e pastuara u publikuan në Official Journal C 325 of 24.12.2002.





12 ORIENTIM NË AKTET JURIDIKE

Kire Kitevski

Decentralizimi është proces i bartjes së kompetencave mbi komunat. Për të kuptuar dispozitat, që kanë të bëjnë me këtë lëmi, duhet të përkujtohemi se për çfarë drispozita bëhet fjalë, çfarë është fuqia e tyre dhe kush është kompetent për sjelljen e tyre

Decentralizimi është proces i bartjes së kompetencave konkrete dhe mjeteve nga shteti mbi komunat për kryerje dhe udhëheqje të tyre. Për të kuptuar dispozitat, që kanë të bëjnë me këtë lëmi, duhet të përkujtohemi se për çfarë drispozita bëhet fjalë, çfarë është fuqia e tyre dhe kush është kompetent për sjelljen e tyre.

Pse është kjo e nevojshme? Decentralizimi kryhet me sjelljen e **ligjeve**, me ndryshimin dhe plotësimin e tyre. Në disa **ligje** propozohet ndonjë çështje e caktuar të rregullohet me akt nënligjor ose me akt të sjellur nga organet e komunave.

Në Ligjin për vetëqeverisje lokale është dhënë vetëm lista e lëmive të caktuara, ndërsa cilët punë dhe në cilat lëmi do të kryhen nga ana e komunave, përcaktohen me **ligj**. Kështu psh, komunat janë kompetente për sjelljen e **planeve** hapësinore dhe urbanistike, rregullimn e truallit ndërtimor dhe dhënien e lejeve për ndërtim të objekteve me rëndësi lokale. Formulimi i tillë në **ligj** është tepër i përgjithësuar. Precizimi i tij do të bëhet me **ligje** të veçanta, akte nënligjore dhe akte të komunave.

Në rastin konkret, me Ligjin për planifikim hapësinor dhe urbanistik, përcaktohet, cilat **plane** i sjell komuna, procedura e sjelljes së tyre, kush do t'i realizojë ato **plane** dhe çështje tjera.

Me Ligjin për ndërtimtari përcaktohet procedura për dhënien e lejes për ndërtim, përcaktohen objektet, që kanë rëndësi lokale, mbikëqyrja në realizimin e **ligjit** dhe të ngjajshme. Në **ligjin** për truall ndërtimor përcaktohet definicioni i truallit ndërtimor, rregullimi i tij dhe çështje tjera.

Më tutje, në këto **ligje** është thënë se për rregullimin e çështjeve të përmendura në këto **ligje**, do të sillen **akte nënligjore**, gjegjësisht akte nga ana e komunës.

Këtu mund të shihet, për cilat punë të lëmisë së caktuar është kompetente komuna dhe sa është përfshirja e kompetencave.

- Kompetencat e komunës në lëminë e urbanizmit janë përcaktuar me tre **ligje** dhe disa **akte nënligjore**.
- Në lëminë e zhvillimit ekonomik lokal, kompetencat e komunës bartën nëpërmjet disa **ligjeve**, siç janë: Ligji për tregëti, Ligji për shërbime hotelierike, Ligji për veprimtari turistike, Ligji për artizanate. Ligji për ndërmarrje publike dhe **ligje** tjera. Mu në këto **ligje** është dhënë e drejta organit të caktuar shtetëror të



sjell **akte nënljigjore**. Psh, në Ligjin për veprimtari hotelierike është përcaktuar se forma e regjistrimit, që do të udhëheqë komuna për hotelieri, me akt të veçantë do ta përcaktojë ministri.

- Numri i **ligjeve**, me të cilat do të barten kompetencat mbi komunën në lëminë komunale, është ende më i madh.

Për këto shkaqe është e nevojshme të njihemi me aktet juridike, që egzistojnë në shtetin tonë.

Në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë më shumë lloje të akteve juridike me fuqi të ndryshme juridike. Këto janë: Kushtetuta, **ligjet**, aktet e ndryshme nënljigjore, aktet e sjellura nga ana e organeve të komunës dhe marrëveshjet kolektive.

Sipas fuqisë juridike, Kushtetuta është akti më i lartë **ligjor** dhe të gjitha aktet tjera juridike duhet të jenë në pajtueshmëri me Kushtetutën. Në vendin e dytë për fuqinë e tyre juridike janë **ligjet**. Pas tyre janë aktet nënljigjore, aktet e organeve të komunës dhe marrëveshjet kolektive.

Më parë, thamë se të gjitha aktet juridike duhet të jenë në pajtueshmëri me Kushtetutën. Mirëpo, aktet nënljigjore, aktet e komunave dhe marrëveshjet kolektive, përveç që duhet me qenë në pajtueshmëri me Kushtetutën, duhet me qenë në pajtueshmëri edhe me **ligjin**.

Ju e dini se organi i vetëm, i cili mund të vlerëson kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e ndonjë akti, është Gjyqi Kushtetues i Republikës së Maqedonisë. Kjo do të thotë se vetëm ky gjyq mund të asgjësojë akt juridik, nëse vlerëson se ai është në kundërshtim me Kushtetutën ose **ligjin**.

Shembull: këshilli i komunës sjell plan urbanistik në kundërshtim me kompetencat e dhëna me Ligjin për planifikim hapësinor dhe urbanistik ose plani është sjellur pa respektuar procedurën e përcaktuar me ligj për sjelljen e tij. Ky plan do të jetë në fuqi, derisa nuk hiqet ose asgjësohet nga ana e Gjyqit Kushtetues.

Këtu, me të drejtë parashtrohet pyetja si do të informohet Gjyqi kushtetues për faktin se ndonjë komunë e caktuar ka sjellur plan urbanistik në kundërshtim me **ligjin**. Gjyqi kushtetues do të fillojë procedurë për vlerësimin e ligjshmërisë me iniciativë të ndonjë subjekti. Ky subjekt, në mes tjerëve, mundet me qenë edhe kryetari i komunës, si njëra nga kompetencat e tij; ministri i vetëqeverisjes lokale, duke kryer të drejtën e mbikëqyrjes së ligjshmërisë së dispozitave të sjellura nga organet e komunës; person i vetëm etj. Në situatë të tillë, Gjyqi Kushtetues do të asgjësojë planin urbanistik.

12.1. LIGJE

Meqë decentralizimi bëhet nëpërmjet **ligjeve**, duhet të njohetoheni së kush i sjell **ligjet**; me çfarë shumicë sillen **ligjet**; çfarë **ligje** ka; ku publikohen; kush jep interpretime.

Ligjet i sjell Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në procedurë të caktuar. Ligjet aprovohen me votimin nga ana e deputetëve. Varësisht nga ajo se, a është fjala për **ligj** sistemor apo **ligj** të zakonshëm, për aprovimin e tyre është e nevojshme shumicë e ndryshme. Kështu, **ligjet** sistemore sillen me dy të tretat e votave, derisa **ligjet** e zakonshme sillen me shumicë të ndryshme-shumicë absolute dhe shumicë të rëndomtë. Shumicë absolute kemi kur, për aprovimin e **ligjit** është e nevojshme shumicë nga numri i përgjithshëm i deputetëve, ndërsa shumicë e rëndomtë ose relative egziston kur për aprovim është e nevojshme shumicë nga deputetët prezent por jo më pak se një e treta nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Për sjelljen e **ligjeve**, që janë të lidhur në mënyrë direkte me kulturën, përdorimin e gjuhëve, arsimin, dokumentet personale, përdorimin e simboleve si dhe **ligjet**, që kanë të bëjnë me vetëqeverisjen lokale (Ligji për vetëqeverisje lokale, Ligji për Qytetin e Shkupit, **Ligji** për organizimin territorial të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë, Ligji për financimin e komunave dhe Ligji për zgjedhjet lokale), përveç shumicës së paraparrë patjetër duhet të ketë shumicë të votave nga numri prezent i deputetëve - përfaqësues të bashkësive, që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

Egzistojnë dy lloje të **ligjeve**: **ligje** të përgjithshme (gjenerale) dhe **ligje** të posaçme (specifike). Me **ligjet** e përgjithshme çështjet e caktuara rregullohen në mënyrë të përgjithshme dhe në këto **ligje** përmendet se çështja në fjalë do të rregullohet me **ligj** të posaçëm.



Në këtë situatë, parashtrohet pyetja se çfarë është veprimi juridik i këtyre **ligjeve**. Meqenëse **ligjet** e posaçëm në mënyrë më detale e rregullojnë materien juridike nga lëmia, për të cilën janë sjellur ata e derogojnë vazhdimin e **ligjeve** të përgjithshëm. Kjo do të thotë se do të aplikohet **ligji** i posaçëm.

Gjatë aplikimit të **ligjit**, mund të ndodhë ndonjë kapitull ose nen i **ligjit** të mos jetë i qartë sa duhet, me çka mund të paraqitet mundësia e interpretimit të ndryshëm. Për të mos u paraqitur mundësia e interpretimit të ndryshëm, varësisht nga ai që e interpreton, vetëm Kuvendi i Republikës së Maqedonisë është i autorizuar të jep interpretim autentik të **ligjeve**.

Ligji i aprovuar mund të ndryshohet dhe plotësohet. Ndryshim dhe plotësim të **ligjit** do të ketë atëherë, kur nga aplikimi i tij është konstatuar se **ligji** nuk i përshtatet qëllimeve, për të cilat është i sjellur.

Ndryshimi dhe plotësimi i **ligjit**, bëhet me **ligj** për ndryshimin dhe plotësimin e **ligjit**, që është në fjalë. Shpallja dhe hyrja në fuqi e këtij **ligji**, bëhet në procedurën e njëjtë sikurse për **ligjin**, i cili ndryshohet dhe plotësohet.

Nëse gjatë vazhimit të **ligjit**, janë bërë me tepër ndryshime dhe plotësime të tij, të publikuara në numra të ndryshëm të "Gazetës zyrtare të Republikës së Maqedonisë", me çka vështirësohet aplikimi i tij, bëhet përgatitja e tekstit të pastruar të **ligjit**. Ky tekst i pastruar publikohet në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë". Teksti i publikuar, ka për qëllim vetëm të lehtëson aplikimin e **ligjit**.

Këtu, duhet të përkujtohem se pjesë e rregullimit juridik të shtetit tonë, janë edhe marrëveshjet ndërkombëtare. Marrëveshjet ndërkombëtare bëhen pjesë e rregullimit juridik të brendshëm pasi që, në pajtim me Kushtetutën, do të ratifikohen nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Ratifikimi i tyre bëhet me sjelljen e **ligjit**.

Marrëveshjet ndërkombëtare nuk mund të ndryshohen dhe plotësohen me sjelljen e **ligjit**.

Shembull: në Ligjin për vetëqeverisje lokale (ligj i përgjithshëm) në lidhje me financimin e komunave është dhënë e drejta, komnatat të kenë burime të tyre të të ardhurave, që vetë do t'i përcaktojnë. Është dhënë e drejta komnatat vetë të përcaktojnë kategoritë, të marrin hua dhe vetë të disponojnë me mjetet. Më tutje, ky ligj thotë se financimi i komunave, do të rregullohet me ligj. Ligji për financimin e njërive të vetëqeverisjes lokale është ligj i posaçëm, në aspekt të ligjit për vetëqeverisje lokale.

12.2. AKTE NËNLIGJORE

Për shkak të realizimit të akteve **ligjore** ose për shkak të rregullimit më të saktë të çështjeve të caktuara të përmendura në **ligjet** dhe aplikim më të lehtë të tyre, sillen **akte nënligjore**. Sjellja e akteve nënligjore, patjetër duhet të parashikohet me vetë **ligjin**. Egzistojnë më tepër **akte nënligjore** edhe atë: **dekretligj, urdhëresë, rregullore** etj.

Dekretligji është akt nënligjor i përgjithshëm, me rendësi më të madhe. Dekretligjin e sjellin organet egzekutive ose administrative të shtetit (Qeveria, ministritë). Me **dekretligj**, rregullohen normat e **ligjit** dhe në këtë mënyrë, më afër rregullohen marrëdhëniet shoqërore. Me **dekretligje** përpunohen më konkretisht norma të caktuara të **ligjit**, me çka mundësohet aplikimi i papenguar i tyre.

Egzistojnë dy lloje të **dekretligjeve**:

- **dekretligje** për egzekutimin e **ligjeve** dhe
- **dekretligje** me fuqi **ligjore**.

Për aplikimin e ligjeve është e nevojshme të dihet se kur ato hyjnë në fuqi. Ligjet, sikurse aktet tjera juridike, në pajtim me Kushtetutën, publikohen. Ligjet publikohen në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë". Ato hyjnë në fuqi, sipas rregullës, në ditën e tetë nga dita e publikimit të tyre, ndërsa në raste të caktuara (kur këtë do të përcaktojë Kuvendi i Republikës së Maqedonisë), me ditën e publikimit të tyre. Gjithsesi, ligji nuk mund të hyjë në fuqi, para se të publikohet në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Dekretligjet për egzekutimin e **ligjeve**, sillen me qëllim të egzekutimit të **ligjit**. Për të sjellur **dekretligj** është e nevojshme ligdhënësi të përmend këtë në vetë **ligjin**, gjegjësisht me **ligjin** të autorizojë ose saktësisht të **urdhërojë** Qeverinë. Këto **dekretligje** vazhdojnë derisa vazhdon **ligji**, në bazë të të cilit janë sjellur.



Dekretligje me fuqi **ligjore** sillen nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, në rast të egzistimit të gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme. Me **dekretligjin** mund të rregullohen dispozita ligjore. Ky **dekretligj** vazhdon deri në përfundimin e gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme.

Urdhëri është akt nënligjor i përgjithshëm, që silllet nga ana e organeve të administratës shtetërore, me qëllim të egzekutimit të **ligjeve** dhe dispozitave tjera. Me **urdhër** rregullohet situatë e caktuar me domethënie të përgjithshme. Baza për sjelljen e **urdhërit** është në **ligj** ose dispozitës tjetër, për egzekutimin e të cilit silllet. Me **urdhërin** përpunohen ose shpjegohen më mirë disa pjesë të aktit më të lartë se **urdhëri**. Me **urdhërin** nuk mundet, për subjektet e drejtësisë, të vendosen të drejta dhe obligime, që nuk janë të bazuara në **ligj**.

Rregullorja është akt nënligjor i përgjithshëm, që e sjellin organet e administratës shtetërore. Me **rregulloren**, nuk mund të vendosen të drejta dhe obligime, nëse nuk janë të bazuara në **ligj** konkret. Rregulloret sillen për egzekutimin dhe përpunimin e **ligjeve** dhe dispozitave dhe akteve tjera të Kuvendit dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Edhe **rregulloret** sillen në bazë të dhënë në dispozitën, për egzekutimin e të cilit silllet rregullorja.

Nëse paraqitet nevojë për aplikim të ligjit, atëherë përmenden të gjitha numrat e "Gazetës zyrtare të Republikës së Maqedonisë", në të cilët është publikuar ndryshimi ose plotësimi i bërë. Kjo do të thotë se nuk guxojmë të thiremi në numrin e "Gazetës zyrtare të Republikës së Maqedonisë", në të cilin është publikuar teksti i pastërt. Jeni duke sjellur vendim, me të cilin i merrni të drejtat e themeluesit të insititucioneve të caktuara nga lëmia e kulturës, me karakter lokal (kjo e drejtë ju është dhënë komunave më Ligjin për kulturën, i cili ka pasur më tepër ndryshime dhe plotësime dhe për të cilin është përgaditur edhe tekst i pastruar, që është publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë"). Në bazën juridike nuk do të thiremi në numrin e "Gazetës zyrtare të Republikës së Maqedonisë", në të cilin është publikuar teksti i pastruar i ligjit, por do të thirreni në nenin, që e jep të drejtën dhe do të numëroni të gjithë numrat e "Gazetës zyrtare të Republikës së Maqedonisë", në të cilët është publikuar teksti bazik dhe të gjitha ndryshimet dhe plotësimet. Psh, Në bazë të nenit ___ të Ligjit për kulturë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. ___/___/___ dhe ___/___).

Komunat, në pajtim me Ligjin për kontabilitet të buxheteve dhe shrytëzuesve të buxheteve, bëjnë regjistrimin e mjeteve themelore, arkës, kërkesave dhe obligimeve. Ligji përmend se me **rregullore** do të bëhet rregullimi i mënyrës për kryerje të regjistrimit, numri dhe përbërja e komisioneve, afatet për fillimin dhe mbarimin e regjistrimit si dhe afati, në të cilin duhet të dorëzohet raporti për regjistrimin e kryer. D.m.th., me **rregulloren** për kontabilitet të buxheteve dhe shrytëzuesve të buxheteve, si akt nënligjor, përpunohen normat nga **ligji**, me qëllim të lehtësimit të aplikimit të tyre.

12.3. REGJISTRI

Përmendëm se aktet juridike të sjellura nga organet kompetente, publikohen në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë". Si do të dini në cilin numër të "Gazetës zyrtare të Republikës së Maqedonisë" është publikuar **ligji** ose akti i caktuar nënligjor? Pas mbarimit të vitit kalendarik, përgaditet regjistër i dispozitave të sjellura dhe publikuara. Në këtë regjistër, janë të përmbajtur të gjitha **ligjet** dhe aktet nënligjore, që janë sjellur gjatë vitit. Poashtu, në regjistër është i publikuar edhe numri i "Gazetës zyrtare të Republikës së Maqedonisë", si dhe fleta në të cilën gjendet. Me shfrytëzimin e këtij regjistri, mundeni të gjeni **ligjin** dhe numrin e "Gazetës zyrtare të Republikës së Maqedonisë", në të cilin është i publikuar.

12.4. AKTET E KOMUNAVE DHE PËRGADITJA E TYRE

Llojet e akteve

Organet e komunave gjatë kryerjes së kompetencave të tyre, sjellin akte të përgjithshme dhe të veçanta.

Me **aktet e përgjithshme** në mënyrë origjinere (burimore), rregullohen marrëdhënie dhe të drejta e obligime për qytetarët dhe personat juridik në suazat e kompetencave të komunës. Ato përmbajnë norma të përgjithshme juridike, që kanë të bëjnë me numër të pakufizuar të rasteve.

Organet e komunës sjellin **akte të veçanta** kur vendosin në procedurë administrative ose kur bëhet zgjedhje apo emërim, si dhe në raste tjera të parapara me **ligj** ose dispozitë tjetër.



Këshilli i komunës në suazat e kompetencave të tij, sjell akte të përgjithshme, edhe ato:

- **statut;**
- **programe;**
- **plane;**
- **vendime dhe**
- dispozita tjera të përcaktuara me **ligj**.

Me **statutin** e komunës, si akt më i lartë, rregullohen organizimi dhe puna e komunës, organizimi dhe puna e komisioneve të këshillit, kryerja e punëve me interes publik dhe rëndësi lokale, që nuk janë hequr nga kompetencat e komunes, e as që janë nën kompetencat e organeve të pushtetit shtetëror, mënyra e informimit të qytetarëve, rastet e përjashtimit të publikut nga mbledhjet e këshillit, mënyra dhe procedura e dorëzimit të peticioneve dhe propozimeve për punën e organeve të komunës, mënyra e organizimit të tribunave publike, realizimin e anketave dhe mbledhjen e propozimeve nga ana e qytetarëve, mënyra e realizimit të obligimeve nga lëmia e mbrojtjes gjatë gjendjes së luftës, si dhe çështje të tjera me rëndësi për vetëqeverisjen lokale.

Me **programe dhe plane** rregullohen dhe përpunohen çështje të caktuara për egzekutimin e **ligjeve** dhe dispozitave tjera, me të cilat është bartur kompetenca mbi komunën e për çka është e nevojshme të parashihen afate dhe dinamikë e realizimit (psh, **programi** për higjienë komunale, **programi** për furnizim me ujë, etj).

Me **vendime**, më konkretisht, rregullohet çështje e caktuar nën kompetencë të komunës (psh, vendim për themelimin e shërbimeve publike nën kompetencë të komunës, vendim për aprovimin e planeve urbanistike, etj.).

12.5. PROCEDURA E SJELLJES (APROVIMIT)

Procedura e sjelljes së akteve të përgjithshme, fillon me dorëzimin e propozimit për sjellje të aktit të përgjithshëm.

Propozimi për sjellje

Propozim për sjellje të aktit të përgjithshëm mund të parashtrojë kryetari i komunës, anëtarët e këshillit të komunës, trupat punuese të këshillit si dhe 10% të votuesve të komunës.

Propozimi për sjellje të aktit të përgjithshëm përmban shkaqet për sjelljen, si dhe përmbajtjen e aktit. Në propozimin për sjellje mund të përmenden edhe parimet, në të cilat mbështetet sjellja e aktit.

Ju, si propozues i autorizuar, propozoni të sillt vendim për përcaktim të hapësirës, në të cilën mund të bëhet tregëti në të vogël. Për këtë qëllim, dorëzoni propozim për sjellje të vendimit të tillë, ku do të përmendni se ka raste të kryerjes së tregëtisë së vogël jashtë hapësirave afariste, me çka pengohet trafiku normal ose bëhet uzurpimi i trotoarëve, që janë të dedikuar për lëvizjen e këmbësorëve.

Nëse me propozimin për sjellje dorëzohet edhe propozimi i aktit, propozimi i aktit të përgjithshëm duhet të mbajë edhe bazë juridike për sjelljen e tij, shpjegim, mjete financiare të nevojshme për realizimin e tij dhe mënyrën e sigurimit të mjeteve.

Propozimin për sjelljen e aktit të përgjithshëm kryetari i këshillit e dorëzon deri te trupi punues kompetent në afatin e caktuar me **rregulloren** e këshillit. Poashtu, propozimi për sjelljen e aktit të përgjithshëm, dorëzohet edhe deri te kryetari i komunës, nëse ai nuk është propozues, me qëllim të dhënies së mendimit të tij deri te këshilli i komunës dhe deri te trupi punues kompetent.

Trupi punues, pas shqyrtimit të propozim-aktit të përgjithshëm, merr qëndrim për bazën dhe nevojën e sjelljes së aktit dhe për këtë informon këshillin e komunës.

Këshilli i komunës shqyrton propozimin, së bashku me qëndrimin e trupit punues dhe mendimin e kryetarit të komunës dhe e përcakton bazueshmërinë.



Nëse vërtetohet bazueshmëria dhe nevoja për sjelljen, do të përcaktohet përpilues i aktit në formë të projekt-aktit (dispozitës), nëse bëhet fjalë për akt, i cili sillet në bazë të projektit, ose në formë të propozimit. Nëse me propozimin për sjelljen e aktit është i dorëzuar edhe propozim-akti, pas vërtetimit të bazueshmërisë dhe nevojës për sjelljen e aktit, bëhet diskutim rreth aktit.

Dispozitën, që e propozoni të sillet nuk është parashikuar të sillet në dy faza. Këshilli pas vërtetimit së bazueshmërisë dhe nevojës për sjellje, do të përcaktojë përpilues të propozim-vendimit. Përpiluesi duhet të përgaditë vendimin në atë mënyrë, që ai të përmbajë bazë juridike, titull, përmbajtje dhe shpjegim dhe, si propozim-vendim ta dorëzojë deri te këshilli për aprovim.

Shembull: trëgëtarët e vegjël kërkojnë t'ju mundësohet kryerje e veprimtarisë jashtë hapësirave afariste, gjegjësisht para hapësirës afariste. Do të përmendni se vendimi duhet të rregullojë këtë çështje, gjegjësisht të përcaktojë në cilat pjesë dhe çfarë sasive mund të përdoret për kryerje të veprimtarisë së tillë, mënyra e fitimit të lejes dhe kush bën mbikëqyrje mbi realizimin e këtij vendimi.

Projekt - akti

Projekt - akti i aktit të përgjithshëm diskutohet nëpër trupat punues të këshillit të komunës, që janë kompetent për këtë dhe vendoset në rendin e ditës së mbledhjes së këshillit të komunës. Në mbledhjen e këshilli diskutohet për projekt-aktin e përgjithshëm - në parim dhe në veçanti. Në diskutimin në parim, këshilltarët diskutojnë nëse projekt-akti i përgjithshëm i pasqyron në mënyrë të përpiktë parimet, mbi të cilat duhet me qenë i bazuar akti i përgjithshëm dhe, nëse ai nuk aprovohet në parim, kthehet deri te propozuesi për tu përpunuar.

Nëse projekt-akti aprovohet në parim, kalohet në diskutim të veçantë. Diskutimi në veçanti bëhet për pjesë të veçanta (kapituj) dhe nene të projekt-aktit. Pas mbarimit të diskutimit në veçanti për projekt-aktin, qëndrimet dhe vërejtjet me konkluzat i dorëzohen propozuesit, me qëllim që propozuesi t'i ketë parasysh gjatë përpilimit të propozim-aktit.

Propozimi

Propozimet e akteve të përgjithshme aprovohen me votimin e këshilltarëve me shumicë të ndryshme, varësisht prej aktit. Kështu, për akte të caktuara kërkohet shumicë nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve, ndërsa për aktet tjera shumicë nga anëtarët prezent.

Pas sjelljes së aktit, ai i dorëzohet kryetarit të komunës për publikim. Kryetari i komunës sjell konkluzë, me të cilën bën shpalljen e aktit dhe ai publikohet në gazetën zyrtare të komunës.

Me përshtim, akt i përgjithshëm mund të sillet edhe në procedurë urgjente. Me procedurë të urgjente mund të sillet vetëm vendim, me të cilin rregullohet çështje të tilla për rregullimin e të cilëve egziston nevojë e vërtetë dhe urgjente dhe nëse shtyrja e rregullimit të çështjeve të tilla, do të kishte pasoja të dëmshme.

Propozuesit, së bashku me propozimin për sjellje të aktit, duhet të dorëzojnë edhe propozim të aktit, si dhe të shpjegojnë nevojën për procedurë urgjente. Nëse propozimi për sjelljen e aktit aprovohet, atëherë propozim-akti i përgjithshëm vendoset në rednin e ditës në mbledhjen e njëjtë.

Ndryshimi dhe plotësimi i propozim-vendimit, kryhet me **amandament**.

Sipas rregullës, amandamenti dorëzohet, më së voni, tre ditë para ditës kur është caktuar mbajtja e mbledhjes së këshillit, në të cilën do të shqyrtohet propozim-vendimi.

Me përjashtim, amandament mund të dorëzohet edhe në vetë mbledhjen, kur shqyrtohet propozim-vendimi.

Në të dy rastet, amandamenti dorëzohet në formë të shkruar dhe patjetër duhet të përmban arsyetim.

Për amandamentin bëhet shqyrtim i posaçëm. Për amandamentin vendoset, para se të votohet për nenin e propozim-vendimit, me të cilin ka të bëjë amandamenti. Amandamenti i aprovuar, konsiderohet si pjesë përbërëse e vendimit.



12.6. PËRMBLEDHJE E AKTEVE TË PUBLIKUARA

Administrata komunale mban përmbledhje të akteve të publikuara, të sjellur nga ana e organeve të komunës. Në përmbledhjen aktet evidentohen sipas emërimit të tyre. Kjo do të thotë se ndaras evidentohen **planet** dhe **programet**, ndaras **vendimet** dhe llojet e tjera të akteve, që janë sjellur. Në përmbledhjen gjendet teksti i plotë i aktit, me numër dhe datë të sjelljes së tij, si dhe numri i gazetës zyrtare të komunës, në të cilin është publikuar. Poashtu, evidentohen të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e kryera ndaj akteve.

Qytetarët e interesuar në çdo kohë mund të shqyrtojnë përmbledhjen dhe të marrin informatat e duhura.

Fjalë kyçe: ligj, akte nënligjore, dekretligj, urdhër, rregullore, statut, program, plane, vendime.

Korniza nënligjore:





13 GRUAJA DHE POLITIKA LOKALE

Violeta Alarova

Ju jeni kryetar i komunës ose këshilltar. Edhe pse këto fjalë janë të gjinisë mashkullore, nëse mirë e kryeni punën e juaj, do të fitoni mirënjohje - së pari si njeri, e pastaj si mashkull ose femër.

Para jush është komuna e juaj. Për secilin qytetar ose banor, pa marrë parasysh, komuna zgjon ndjenjë të përkatësisë. Por, megjithatë, ndjenjën më përgjegjëse dhe me të mirë e ka njeriu i parë, gjegjësisht kryetari i komunës. Nëse kryetari i komunës është femër, meriton respekt të veçantë.

13.1. E DREJTA E FEMRAVE PËR TË VOTUAR

Në vendet demokratike e drejta e votës është e përgjithshme, e barabartë, e drejtëpërdrejtë dhe e fshehtë. Në të kaluarën, kategori të tëra të qytetarëve, për shkak të përkatësisë së tyre gjinore, kanë qenë të privuar nga e drejta e votës. Të përkujtohem: femrat fitojnë të drejtën e votës për të parën herë, në nivel lokal në Suedi në vitin 1867 dhe në Vajoming, SHBA në vitin 1869.

Me këtë, faktikisht, ka filluar procesi i kyqjes aktive të femrave në procesin e krijimit të jetës politike. Vendi i fundit, i cili ka menjanuar censurën gjinore në vitin 1984 është Lihtenshtajni. Me këtë, mund të themi së mbaroi padrejtësia historike ndaj gjinisë femërore.

Të drejtat e femrës rrjedhin prej Deklaratës universale për të drejtat e njeriut, të aporvuar nga Kuvendi gjeneral i Kombeve të bashkuara, ndërsa e shpallur me 10.12 të vitit 1948. Në të potencohet:

Në preambulën e Deklaratës për të drejtat e njeriut, potencohet:

Preambula e Deklaratës univerzale përmban porosinë:

Nga kjo Deklaratë rrjedh edhe konventa, e cila mënjanon diskriminimin e femrave në jetën politike dhe publike të vendit.

"Secili ka të drejtë të marrë pjesë në udhëheqjen me vendin e tij - drejtëpërdrejtë ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur. Secili ka të drejtë për arritshmëri të barabartë deri te shërbimet publike në vendin e tij."

"...pranimi i të drejtave të barabarta dhe të patjetërsuara të gjithë anëtarëve në shoqëri, bazohet në lirinë, drejtësinë dhe paqen në botë."

"... respektimi i dinjitetit, pranimit dhe jotjetërsimit të të drejtave të njeriut dhe besimit në vlerën e personalitetit të njeriut dhe në të drejtat e barabarta në mes mashkullit dhe femrës."



13.2. FEMRAT NË MAQEDONI

Në zgjedhjet e para lokale në Maqedoninë e pavarur, të mbajtur në vitin 1990 nga, gjithsejt, 70 këshilltarë në Këshillin e Qytetit të Shkupit, 4 qenë femra. Nga, gjithsejt, 1510 këshilltarë të zgjedhur në këshillat e komunave në tërë Maqedoninë, vetëm 74 qenë femra. Ndodhën zgjedhjet lokale në vitin 1996. Gjithsejt qenë zgjedhur 124 kryetarë të komunave. Kuptohet, të gjithë meshkuj. Asnjë femër. Në këshillat e komunave nga 1710 këshilltarë, vetëm 105 qenë femra. Në vitin 2000, gjatë zgjedhjeve lokale, garën zgjedhore, me sukses, e mbaruan tre femra, si kryetare të komunave. Në këto zgjedhje nga 1906 këshilltarë, 161 qenë femra.

Zgjedhjet në vitin 2000 hapën dyert vetëm për tre femra - kryetare të komunës: në komunën Qendër për Violeta Allarovën, në Komunën Oslomej për Sanije Sadikun dhe në Komunën Miravci për Sunçica Petkovskën. Nga 124 komuna, qenë zgjedhur vetëm tre femra. 121 kryetarë të komunave qenë meshkuj. E njëjta gjë ndodh edhe me numrin e këshilltarëve. Ta përsjellim zgjedhjen.

Megjithatë, përvojat nga shumë vende tregojnë se shumë femra - politikane të veçuara, hapat e tyre të parë i kanë bërë në pushtetin lokal. Konsiderohet se pushteti lokal, ndoshta është angazhimi më i pranuar politik për femrën, sepse ky angazhim politik është afër vendbanimit të saj dhe ajo i njeh problemet me rëndësi lokale.

13.3. LOBI I FEMRËS NË MAQEDONI, VITI 2000

Viti 2000 do të mbahet mend me procesin e hyrjes së femrave në politikë. Në atë verë të nxehtë, u mblohdën gratë nga të gjitha partitë politike dhe nga gjithë organizatat tjera dhe formuan Lobin e femrave të Maqedonisë. Pas formimit, vizituan të gjithë udhëheqësit partiak për të nënshkruar deklaratë se 30% të kandidatëve në zgjedhjet lokale, do të jenë femra.

Filloi realizimi i planit nacional për barazi gjinore. U paraqit projekti për "Përfaqësim më të madh të femrave në vetëqeverisjen lokale". U organizuan seminare për kryetarë të komunave dhe anëtarë të këshillave të komunave të gjinisë femrore, si dhe për administratën lokale. Qëllimi ishte të krijohet bashkëpunim interaktiv me ata, në aspekt të barasisë në mes gjinive.

13.4. FEMRA NË MAQEDONI

Të përcjellim zgjedhjen. Në zgjedhjet e para lokale në Maqedoninë e pavarur të vitit 1990, prej 70 këshilltarëve të këshillit të Qytetit të SHkupit, 4 ishin femra. Prej, gjithsejt, 1510 këshilltarëve të zgjedhur në këshillat e komunave në Maqedoni, vetëm 74 ishin femra. Në zgjedhjet lokale të vitit 1996, u zgjodhën 124 kryetarë të komunave. Kuptohet, të gjithë meshkuj. Nuk kishte asnjë femër. Në këshillat e komunave, prej gjithsejt, 1710 këshilltarëve, vetëm 105 ishin gra. Në vitin 2000, gjatë zgjedhjeve lokale, garën zgjedhore, në mënyrë të suksesshme, e mbaruan tre femra, si kryetare të komunave, ndërsa prej 1906 këshilltarëve të zgjedhur, 161 ishin femra.

Numrat janë modest por, megjithatë, rriten. Organizatat e femrave ngushëlluan femrat, me porosinë e një kinezi të mençur: "Mos u frigoni nga ecja e ngadalshme por nga ngecja në vend."

Ishte e mundur të arrihen edhe rezultate më të mira. Pengesa kryesore ishte kampanja kundër femrës, e paraqitur në medime, nga ana e meshkujve, intelektualëve, qëndrimi negativ drejt shoqatave joqeveritare, blokime dhe paragjykimet personale për femrat, si subjekt politik dhe, më së shpeshti, vendosja e femrave si dekor në listat zgjedhore.

A ishte zgjedhja e tre femrave për kryetar të komunave zgjedhje e vërtetë? Në fund të mandatit u konstatua se ato u gjenden mirë në funksionin e ri. U bashkuan së bashku dhe realizuan projekte të shumta. Siç shkru-

Në vitin 2004 në Ligjin për zgjedhje lokale, në nenin 22, është vendosur kuotë prej 30%. Ky nen thotë: në listën e propozuar për kandidatë për anëtarë të këshillit të komunës dhe Qytetit të Shkupit, secila gjini do të përfaqësohet me, së paku, 30% edhe në pjesën e lartë edhe në pjesën e poshtme të listës.

Shembull: me këtë projekt u formuan komisione për barazi gjinore në këshillat e dhjetë komunave - Veles, Kavadarçë, Krivogashtanë, Manastir, Strugë, Tetovë, Delçevë, Probishtip, Koçanë dhe Prilep.



ajti një revistë, lanë gjurmë pas tyre, jo vetëm me parfumin e bukur të tyre por edhe me projekte kualitative, me të cilat i ndryshuan komunat e tyre. Nga ky mandat, do të mbetet rruga kryesore në Komunën Qendër-rruga Maqedonia, e cila me bukurinë e saj, me siguri se do të tërheq edhe shumë gjenerata.

Por mos të gënjehemi. Femrat e tundën detin e qetë të pushtetit lokal me tradita dhe norma tradicionale. Megjithatë, e dërguan porosinë edhe pse komunat e femrave-kryetarë të komunës përjetuan fat të çuditshëm. Komuna e Qendrës u përgjysmua, komuna Oslomej fitoi edhe katër vite jetë, ndërsa komuna Miravci u shkri në komunën e Gjevgjeliës.

GRUAJA NË MAQEDONI - TË JETË OSE TË MOS JETË

Dispozitat ligjore mundësonë kushte për pjesëmarrje të zmadhuar të femrave në pushtetin lokal.

Ndodhi edhe koncepti gjinorë në nivel lokal. Lidhja e organizatave të femrave të Republikës së Maqedonisë, në bashkëpunim dhe me përmbajtje financiare nga Ministria për punë dhe politikë sociale - Njësia për përparimin e baraspeshës në mes gjinive, filloi me implementimin e projektit: "Promovim të barazisë gjinore në nivel lokal".

Këto komisione të formuara do të trajnohen, me çka do të mundësohet zmadhimi i kapacitetit të tyre në bashkësi dhe shtet. Projekti zhvillohet në tre faza:

- Faza e parë është vendosja institucionale e komisioneve, me formimin e komisioneve, si trupa të përhershëm në komunat;
- Faza e dytë është zmadhimi i vetëdijës gjinore me organizim të seminarëve, punëtorive dhe kampanjave;
- Faza e tretë është formimi dhe punë e rrjetit nacional të komisioneve për barazi gjinore.

Megjithatë, duket se beteja ende është para nësh. Ate, që faktikisht femrat janë duke e kërkuar, është e drejtë themelore njerëzore - e drejta e zgjedhjes dhe pjesëmarrjes. Nuk duhet të flasim për meshkuj dhe femra në komuna. Duhet të flasim dhe të zgjedhim njerëz të vyeshëm, human, të aftë dhe të afirmuar.

Fjalë kyçe: të drejtat njerëzore, përfaqësim më i madh, ndërgjegje gjinore, komisione për barazi gjinore.

Korrniza ligjore:

- Ligji për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 05/02);
- Ligji për zgjedhje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 35/04);

Hyrja në pushtetin lokal, faktikisht, është realizimi i misionit të madh për të mirën e komunës dhe qytetarëve të juaj.



PËRMBAJTJA

1.	KORRNIZA LIGJORE E VETËQEVERISJES LOKALE	5
1.1.	Korniza kushtetuese dhe ligjore	5
1.2.	Konventa evropiane për vetëqeverisje lokale	8
1.2.1.	Parime themelore të Konventës evropiane për vetëqeverisje lokale	8
1.2.2.	Rregullativa juridike e Maqedonisë dhe Konventa evropiane për vetëqeverisje lokale	10
1.3.	Kompetencat e komunave dhe Qytetit të Shkupit	11
1.3.1.	Kompetencat e komunës	11
1.3.2.	Kompetencat e Qytetit të Shkupit	14
1.3.3.	Kompetencat e komunave në qytetin e Shkupit	16
1.4.	Kompetenca të deleguara	18
1.5.	Mënyra e kryerjes së kompetencave	18
2.	E KOMUNËS - ORGANIZIM DHE ADMINISTRIM EFIKAS	19
2.1.	Këshilli i komunës	19
2.1.1.	Konstituimi i këshillit	19
2.1.2.	Kompetencat	20
2.1.3.	Komisionet e këshillit	20
2.1.4.	Zgjedhje dhe obligime të kryetarit	21
2.1.5.	Mbledhjet e këshillave	22
2.1.6.	Ndërprerja e mandatit	23
2.1.7.	Shpërndarja e këshillit	23
2.2.	Kryetari i komunës	24
2.2.1.	Kompetencat	24
2.2.2.	Kontrolli i ligjshmërisë	25
2.2.3.	Konflikt i interesave	26
2.2.4.	Ndërprerja e mandatit	26
2.3.	Administrata e komunës	26
2.3.1.	Organizimi	27
2.3.3.	Statusi i të punësuarve	27
2.3.3.	Klasifikimi i nëpunësve shtetëror	28
2.3.4.	Punësimi	28
2.3.5.	Të drejtat e nëpunësve shtetëror	29
2.3.6.	Obligime	29
2.3.7.	Avansimi dhe sistemi i rrogave	29
2.3.8.	Përgjegjësia	30
2.3.9.	Vlerësimi	30
2.3.10.	Ndërprerja e marrëdhënies së punës	30
3.	FINANCIMI DHE BUXHETI	33
3.1.	Sistemi i financimit publik lokal	33
3.2.	Buxheti	34
3.3.	Financimi i komunave	36
3.3.1.	Burimet e financimit	36
3.3.2.	Përcjellje e zhvillimit të sistemit të financimit të komunave	37
3.4.	Përcaktimi dhe mbledhja e të ardhurave të komunave	37
3.5.	Marrje hua nga ana e komunave	38
3.6.	Evidenca kontabiliste, kontrolli dhe revizioni	38
3.7.	Jostabiliteti financiar komunës	39



3.8.	Implementimi i decentralizimit fiskal	39
3.9.	Furnizime publike	40
4.	MENAXHMENT ME PRONËSINË KOMUNALE	43
4.1.	Prona dhe fitimi i pronës themelore komunale	43
4.2.	Blerja dhe shitja e pronës	45
4.3.	Dhënia e pronës me qira	46
4.4.	Regjistri i pronës	46
4.5.	Mbrojtje të pronës	47
4.6.	Udhëheqja me pronën	47
4.7.	Pronë infrastrukturore	47
4.8.	Bashkëpunimi në mes komunave në lëminë e pronës	47
4.9.	Si fitohet pronësia	48
4.10.	Përgjegjësi për keqpërdorimin e pronës së komunës	48
4.11.	Krijimi i pronësisë	48
5.	ZHVILLIMI I EKONOMISË LOKALE (ZHEL)	51
5.1.	Udhëheqje me ciklusin e proejktit	54
5.1.1.	Përpunimi i projektit	55
5.1.2.	Hapat themelor gjatë përgaditjes së projektit	55
5.1.3.	Përgaditja e buxhetit të projektit	56
5.1.4.	Përgaditja e tekstit të projektit	56
5.2.	Planifikimi strategjik	57
6.	PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE URBANISTIK	61
6.1.	Planifikimi hapësinor	61
6.1.1.	Çka është plani hapësinor dhe cili është qëllimi i tij	61
6.1.2.	Lloje të planeve hapësinore	62
6.1.3.	Përbajtja e planit hapësinor të Republikës	62
6.1.4.	Planifikimi hapësinor si instrument për zhvillimin e komunave	63
6.1.5.	Lidhja në mes planifikimit hapësinor dhe planifikimit urban	63
6.2.	Planifikimi urban	63
6.2.1.	Çka është plan urban dhe cili është qëllimi i tij	63
6.2.2.	Lloje të planeve urbane	64
6.2.3.	Çfarë interesi kanë trupat e komunës nga planet	64
6.2.4.	Çfarë interesi ka popullata lokale nga planet urbane	65
6.2.5.	Kush është përgjegjës për planet urbane	65
6.2.6.	Procedura për përpilimin dhe sjelljen e planeve urbane	65
6.2.7.	Mungesat e planeve urbane	67
6.2.8.	Lidhja në mes planeve urbane	68
6.2.9.	Akte të tjera në përbërje të planifikimit urban	68
6.3.	Dhënie e lejes për ndërtim	69
6.3.1.	Çështje leje për ndërtim	69
6.3.2.	Planet urbane në procedurë të dhënies së lejes për ndërtim	69
6.3.3.	Ndërtim i ndërtesave	72
6.3.4.	Mbikëqyrja inspektuese	72
6.4.	Transporti	73
6.4.1.	Rrjetet e trafikut	73



6.4.2.	Transporti publik	74
6.4.3.	Siguria në transport	74
7.1	NDËRMARRJET PUBLIKE DHE SHËRBIMET KOMUNALE	77
7.1.1.	Ndërmarrje publike	78
7.1.2.	Kryerja e veprimtarisë me leje	83
7.1.3.	Infrastruktura komunale	83
7.2	ARSIMI, SPORTI DHE REKREIMI	89
7.2.1.	Arsimi dhe komunat	89
7.2.2.	Sporti dhe rekreimi	92
7.3.	MBROJTJA SOCIALE DHE SHËNDETËSORE NË KOMUNAT	93
7.3.2.	Programi për zhvillimin e mbrojtjes sociale	94
7.3.3.	Mbrojtja sociale në vetëqeverisjen lokale	95
7.3.3.1.	Lloje të institucioneve për preventivë sociale dhe për mbrojtje jashtë institucionale	96
7.3.3.2.	Llojet e institucioneve për mbrojtje institucionale	98
7.3.4.	Mbrojtja shëndetësore	99
7.3.4.1.	Vetëqeverisja lokale dhe mbrojtja shëndetësore	100
7.4.	KULTURA	101
8.	MBROJTJA E AMBIENTI JETËSOR	107
9.1.	PARTICIPIMI POLITIK NË NIVEL LOKAL	115
9.1.1.	Forma të realizimit të të drejtave të qytetarëve për vetëqeverisje lokale	117
9.1.2.	Pjesëmarrja indirekte e qytetarëve	117
9.1.3.	Forma themelore të pjesëmarrjes së drejtëpërdrejtë të qytetarëve në vendim marrjen në njësitë e vetëqeverisjes lokale	118
9.1.4.	Forma dhe mundësi tjera të participimit qytetar	119
9.1.5.	Vetëqeverisja në nivel të bashkësisë lokale	121
9.2.	MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN	123
9.2.1.	Definimi i marrëdhënieve me publikun	123
9.2.2.	Komunikimi me publikun	124
9.2.3.	Komunikimi me MEDIUMET	126
9.2.4.	Komunikim me grupe të tjera qëllimore	127
9.2.5.	Konventa qytetare	128
9.2.6.	Si të komunikomi në mënyrë efektive dhe të veproni në mënyrë preventive ndaj konflikteve	129
9.2.7.	Aplikimi i teknologjisë informatike - komunikuese	129
9.2.8.	Sistem me një sportel	131
10.	BASHKËPUNIMI NDËRKOMUNAL	133
10.1.	Bashkëpunimi ndërkombëtar në mes komunave	134
10.1.1.	Vëllazërimi	134
10.1.2.	Bashkëpunimi evro-rajonat	135
10.2.	Bashkësia e njësisë të vetëqeverisjes lokale (BNJVL) - promovues i interesave të përbashkëta të komunave	136



10.3.	E tashmja dhe ardhmëria	138
10.4.	Institucionet ndërkombetare të pushteteve lokale	139
10.4.1.	Këshilli i evropës - Kongresi i pushteteve lokale dhe regjionale	139
10.4.2.	Kongresi i pushteteve lokale dhe rajonale	140
10.4.3.	Këshilli i komunave dhe rajoneve evropiane (CEMP)	141
10.5.	Nalas - rrjeta e asociacioneve të pushteteve lokale dhe nacionale të evropës juglindore	141
11.	KOMUNAT DHE UNIONI EVROPIAN	143
11.1.	Unioni evropian si bashkësi e shteteve	143
11.2.	Përfitimet për Republikën e Maqedonisë nga integrimi në UE	143
11.3.	Institucione dhe organe të Unionit evropian	144
11.3.1.	Parlamenti evropian	144
11.3.2.	Këshilli i Unionit evropian	144
11.3.3.	Komisioni evropian	145
11.4.	Legjislacioni i Unionit evropian	146
11.5.	Politikat e Unionit evropian me rëndësi për vetëqeverisjen lokale në RM	146
11.6.	Fondet që janë në disponim për vendet - anëtare të Unionit evropian	146
11.7.	Rruga e Republikës së Maqedonisë deri te anëtarësia në Unionin evropian	147
11.7.1.	Kushtet që duhet të plotësohen	147
11.8.	Fazat në procesin e anëtarësimit në Unionin evropian	148
11.9.	Fondet që janë në disponim për shtetet në faza të ndryshme të rrugës së tyre drejt anëtarësisë në Unionin evropian	149
11.9.1.	Faza e stabilizimit dhe asociimit	149
11.9.2.	Faza para hyrjes në UE	150
11.10.	Qasje përfundimtare	151
12.	ORIENTIM NË AKTET JURIDIKE	153
12.1.	Ligje	154
12.2.	Akte nënligjore	155
12.3.	Regjistri	156
12.4.	Aktet e komunave dhe përgaditja e tyre	156
12.5.	Procedura e sjelljes (aprovimit)	157
12.6.	Përmbledhje e akteve të publikuara	159
13.	GRUAJA DHE POLITIKA LOKALE	161
13.1.	E drejta e femrave për të votuar	161
13.2.	Femrat në Maqedoni	162
13.3.	Lobi i femrës në Maqedoni, viti 2000	162
13.4.	Femra në Maqedoni	162



LISTA E AUTORËVE SIPAS KAPITUJVE:

Kire Kitevski	1. KORRNIZA LIGJORE E VETËQEVERISJES LOKALE
Kire Kitevski	2. ORGANET E KOMUNËS - ORGANIZIM DHE ADMINISTRIM EFIKAS
Ace Kocevski	3. FINANCIMI DHE BUXHETI
Romeo Dereban	4. MENAXHMENT ME PRONËSINË KOMUNALE
Ljupço Petkovski	5. ZHVILLIMI I EKONOMISË LOKALE (ZHEL)
Katica Dimovska Talevska	6. PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE URBANISTIK
Panço Minov	7.1. NDËRMARRJET PUBLIKE DHE SHËRBIMET KOMUNALE
Prof. Dr. Murtezan Ismaili	7.2. ARSIMI, SPORTI DHE REKREIMI
Doc. Dr. Jove Kekenovski	7.3. MBROJTJA SOCIALE DHE SHËNDETËSORE NË KOMUNAT
Evgenija Bektash Josifovska	7.4. KULTURA
Toni Popovski	8. MBROJTJA E AMBIENTI JETËSOR
Doc. Dr. Jove Kekenovski	9.1. PARTICIPIMI POLITIK NË NIVEL LOKAL
Ace Kocevski	9.2.. MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN
Goran Angellov	10. BASHKËPUNIMI NDËRKOMUNAL
Prof. Dr. Ilija Todorovski	11. KOMUNAT DHE UNIONI EVROPIAN
Kire Kitevski	12. ORIENTIM NË AKTET JURIDIKE
Violeta Alarova	13. GRUAJA DHE POLITIKA LOKALE